KOALICIONI PËR REFORMA, INTEGRIM DHE INSTITUCIONE TË KONSOLIDUARA
COALITION FOR REFORMS, INTEGRATION AND CONSOLIDATED INSTITUTIONS

në bashkëpunim me:

QENDRA E ZHVILLIMIT TË SHOQËRISË CIVILE - DURRËS
QENDRA FORUMI CIVIL SELENICË
QENDRA "LËVIZIA RINORE PËR DEMOKRACI"- PUKË
QENDRA E KËSHILLIMIT TË GRAVE DHE SHËRBIMEVE SOCIALE KUKËS
QENDRA RINORE VLORË (QRV)
QENDRA KËSHILLIMORE PËR NJERËZIT ME AFTËSI TË KUFIZUAR"- SHKODËR
QENDRA "TË GJITHË SË BASHKU PËR INTEGRIMIN E ROMËVE" (TIRC)
SHOQATA "PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË GRUAS FSHATARE DHE QYTETARE"- BERAT
QENDRA E ZHVILLIMIT TË SHOQËRISË CIVILE - KORÇË

SJELLJA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE

E INSTITUCIONEVE DHE AKTORËVE TË PËRFSHIRË NË PROCESIN ZGJEDHOR TË 30 QERSHORIT 2019

RAPORT MONITORIMI

NËNTOR 2018 - SHKURT 2020

TIRANË, QERSHOR 2020

KOALICIONI PËR REFORMA, INTEGRIM DHE INSTITUCIONE TË KONSOLIDUARA
COALITION FOR REFORMS, INTEGRATION AND CONSOLIDATED INSTITUTIONS

në bashkëpunim me:

QENDRA E ZHVILLIMIT TË SHOQËRISË CIVILE - DURRËS

QENDRA FORUMI CIVIL SELENICË

QENDRA "LËVIZJA RINORE PËR DEMOKRACI" - PUKË

QENDRA E KËSHILLIMIT TË GRAVE DHE SHËRBIMEVE SOCIALE KUKËS

QENDRA RINORE VLORË (QRV)

QENDRA KËSHILLIMORE PËR NJEREZIT ME AFTËSI TË KUFIZUAR" - SHKODËR

QENDRA "TË GJITHË SË BASHKU PËR INTEGRIMIN E ROMËVE" (TIRC)

SHOQATA "PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË GRUAS FSHATARE DHE QYTETARE" - BERAT

QENDRA E ZHVILLIMIT TË SHOQËRISË CIVILE -KORÇË

SJELLJA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE
E INSTITUCIONEVE DHE AKTORËVE TË PËRFSHIRË NË PROCESIN ZGJEDHOR TË 30 QERSHORIT 2019

RAPORT MONITORIMI

NËNTOR 2018 - SHKURT 2020

Tiranë, Qershor 2020

Përgatiti: © KRIIK **KOALICIONI PËR REFORMA, INTEGRIM DHE INSTITUCIONE TË KONSOLIDUARA**
COALITION FOR REFORMS, INTEGRATION AND CONSOLIDATED INSTITUTIONS

Të drejtat e botimit të këtij Dokumenti janë të rezervuara.
Pjesë të këtij materiali mund të përdoren lirisht. Në një rast të tillë lutemi citoni burimin.

A: Rr. "Ymer Kurti", Nd.4, H.2, Ap.3, Nj.Adm.5, Tirana, 1019 | Mailing Address: P.O.Box. 2396 Tirana, 1001, Albania;
T: + 355 4 2245078 | M: + 355 673890174; + 355 682039297 | E: info@kriik.al | W: www.kriik.al ;

Ky Raport Monitorimi është rezultat i punës së KRIIK, aktivistëve të tij e organizatave partnere dhe një pjesë e tij u financua me fonde të Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Ambasada e Zvicrës në Shqipër

Mendimet e shprehura në këtë Dokument dhe në çdo publikim tjetër në kuadër të këtij Raporti Monitorimi, janë të KRIIK dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht edhe ato të Ambasadës së Zvicrës në Shqipëri.

PËRMBAJTJA

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE 7

II. HYRJE 11

III. KONTEKSTI POLITIK DHE INSTITUCIONAL 15

IV. KUADRI LIGJOR DHE SISTEMI ZGJEDHOR 17

IV.1. Dekretimi i datës së zgjedhjeve dhe ngërçi institucional që pasoi 17

IV.2. Sistemi zgjedhor 19

IV.2.1. Mekanizmi i shpërndarjes së mandateve për këshillin bashkiak 19

IV.3. Infrastruktura zgjedhore 21

IV.4. Përgatitja e Listës së Zgjedhësve 21

IV.5. Aktet nënligjorë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 22

IV.6. Drejtësia zgjedhore 22

IV.6.1. Penalizimi i veprave që cenojnë zgjedhjet 22

IV.6.2. Sistemi i ankimim-apelimeve 23

IV.7. Financat e subjekteve zgjedhore 24

IV.8. Reformimi i kuadrit ligjor zgjedhor 25

V. ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE 26

V.1. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve 26

V.1.1. Trupa e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 26

V.1.1.1. Qëndrimi i trupës së KQZ në lidhje me dekretin e Presidentit të Republikës të datës 10 qershor 2019 27

V.1.1.2. Qëndrimi i trupës së KQZ-së në lidhje me dekretin e Presidentit të Republikës të datës 27 qershor 2019 29

V.1.2. Vendimmarrja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 31

V.1.2.1. Ceremonialiteti i mbledhjeve dhe sjellja e trupës 31

V.1.2.2. Problematika të vërejtura 32

V.1.3. Transparenca e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 34

V.1.3.1. Publikimi i materialeve paraprake të mbledhjeve 34

V.1.3.2. Publikimi i vendimeve 35

V.1.3.3. Transmetimi viziv në kohë reale i mbledhjeve të KQZ-së dhe aksesueshmëria e tyre në vazhdim 35

V.1.3.4. Përdorimi i teknologjisë së informacionit për rritjen e transparencës 37

V.1.3.5. Aksesi në materialet e publikuara në faqen e internetit 37

V.1.3.6. Transmetimi i rezultateve 38

V.1.3.7. Mospërputhjet në publikimin e pjesëmarrjes në votime dhe të rezultateve zgjedhore 38

V.1.4. Ndryshimi i emrit të Kryetarit të Partisë Socialdemokrate në fletën e votimit 41

V.1.5. Procesi i dekriminalizimit 42

V.1.5.1 Ecuria e procesit të dekriminalizimit deri më datë 30 qershor 2019 42

V.1.5.2. Ecuria e procesit të verifikimit të kandidatëve në funksion të zgjedhjeve të 30 qershorit 43

V.1.5.2.1. Dorëzimi dhe publikimi i formularëve të vetëdeklarimit 44

V.1.5.2.2. Procesi i dekriminalizimit pas përfundimit të zgjedhjeve të 30 qershorit 46

V.1.5.2.2.1. Kandidati për Kryetar i Bashkisë Shkodër 46

V.1.5.2.2.2. Kryetari i Bashkisë Vorë 47

V.1.5.2.2.3. Kryetari i Bashkisë Vau Dejës 49

V.1.5.2.2.4. Kryetari i Bashkisë Mat 49
V.1.5.2.2.5. Kryetari i Bashkisë Mallakastër 50
V.1.5.2.2.6. Kryetari i Bashkisë Librazhd 51
V.1.6. Plotësimi i vakancave në Kuvend, pas dorëzimit të mandateve nga deputetët e PD dhe LSI 51
V.1.7. Miratimi dhe zbatueshmëria e Planit të Veprimit 53
V.1.7.1. Emërimi i Auditëve Teknicienë 53
V.1.7.2. Ngritja e Zyrave Rajonale Zgjedhore 53
V.1.7.3. Ngritja e Bordit të Monitorimit të Mediave 54
V.2. Komisionet Zonale të Administrimit Zgjedhor (KZAZ) 55
V.2.1. Ndërtimi i KZAZ-ve dhe infrastruktura mbështetëse 55
V.2.1.1. Refuzimi i listave të PD dhe LSI për anëtarë dhe sekretarë të KZAZ-ve 56
V.2.1.2. Përcaktimi i Vendeve të numërimit të Votave 58
V.2.2. Aktiviteti i Komisioneve Zonale të Administrimit Zgjedhor 59
V.2.2.1. Grupet e Numërimit të Votave 60
V.2.2.2. Komisionet e Qendrave të Votimit 61
VI. INSTITUCIONE TË TJERA TË PËRFSHIRA NË PROCESIN ZGJEDHOR 62
VI.1. Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil dhe Task-Forca e ngritur nga Këshilli i Ministrave për monitorimin e përdorimit të administratës dhe burimeve shtetërore në fushatë 62
VI.2. Ministria e Brendshme 64
VI.3. Prefekturat 66
VI.4. Bashkitë 66
VI.5. Gjykatat 67
VI.5.1. Verifikimi i mandatit të kryebashkiakes së zgjedhur të Durrësit nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës 67
VI.5.2. Verifikimi i mandatit të kryebashkiakut të zgjedhur të Vorës nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë 68
VI.5.3. Kërkesat në lidhje me përfshirjen në listat e zgjedhësve 68
VI.5.4. Vendimmarrja e gjykatave në lidhje me vepra penale që lidhen me zgjedhjet 69
VI.6. Policia e Shtetit 69
VI.7. Prokuroria 70
VII. REGJISTRIMI I SUBJEKTEVE ZGJEDHORE 71
VII.1. Regjistrimi i partive politike 72
VII.2. Regjistrimi i kandidatëve 76
VII.2.1. Regjistrimi i kandidatëve me vërtetim nga Kuvendi 79
VII.2.2. Regjistrimi njëkohësisht si kandidat për Kryetar Bashkie dhe si anëtar i Këshillave Bashkiakë 81
VII.2.3. Regjistrimi i kandidatëve me lidhje familjare të shkallës së parë si anëtarë të të njëjtit këshill bashkiak 82
VIII. LISTAT E ZGJEDHËSVE 83
VIII.1. Lista finale e Zgjedhësve 85
VIII.2. Problematika të evidentuara nga auditët teknicienë 86
VIII.3. Njoftimi me shkrim i zgjedhësve 90
IX. MJEDISI I FUSHATËS 91
IX.1. Fushata e parakohshme 91
IX.2. Fushata në median sociale 92
IX.3. Aktivitetet gjatë fushatës 92

IX.4. Përdorimi i administratës në fushatë 93
IX.5. Zyrat zgjedhore 93
IX.6. Task-Forca për monitorimin e veprimtarisë së administratës në fushatë 94
IX.7. Angazhimi zyrtarëve të lartë qendrorë në fushatë 95
X. FINANCIMI I FUSHATËS ZGJEDHORE 95
X.1. Kuadri ligjor dhe mekanizmat e mbikëqyrjes 96
X.2. Shpërndarja e fondeve publike për fushatën zgjedhore 98
X.2.1 Shpërndarja e fondeve publike 98
X.2.2. Kthimi i fondeve publike 99
X.2.3. Alokimi i fondeve vjetore për partitë politike për vitin 2020 101
X.3. Raportet e vetë-deklarimit financiar të partive politike për fushatën zgjedhore 102
X.3.1. Të ardhurat e partive politike sipas raporteve të vetë-deklarimit 104
X.3.1.1. Financimi publik 104
X.3.1.2. Financimi jo-publik 105
X.3.2. Shpenzimet e partive politike sipas raporteve të vetë-deklarimit 106
X.3.2.1. Mitingjet elektorale 108
X.3.2.2. Ligji i vullnetarizmit 108
X.3.3. Raportimi nga kandidatët 109
X.4. Raportet e monitorimit dhe raportet e auditimit 110
X.4.1. Dorëzimi dhe publikimi i raporteve të monitorimit dhe të auditimit 111
X.4.2. Përmbajtja dhe problematika të vërejtura në raportet e monitorimit dhe të auditimit 113
X.4.2.1. Problematika që lidhen me përmbushjen e detyrës prej ekspertëve financiarë 114
X.4.2.2. Deklarimi i llogarive të posaçme bankare 117
X.4.2.3. Shkelje të tjera të vërejtura 118
XI. MEDIA 120
XI.1. Veprimtaria e Bordit të Monitorimit të Medias 122
XII. DITA E ZGJEDHJEVE DHE NUMËRIMI I VOTAVE 124
XII.1. Aktiviteti i KZAZ-së përpara ditës së zgjedhjeve 124
XII.2. Aktiviteti i KZAZ-ve gjatë ditës së zgjedhjeve 126
XII.3. Marrja në dorëzim e materialeve zgjedhore 126
XII.4. Aktiviteti i KZAZ-ve gjatë procesit të numërimit 127
XII.5. Mosrealizimi i votimit në disa QV të Bashkisë Shkodër 128
XIII. ANKESAT DHE APELIMET 130
XIII.1. Procesi i ankimimeve para ditës së zgjedhjeve 131
XIII.1.1. Kërkesa e PD dhe LSI për të emëruar komisionerë në KZAZ 132
XIII.1.2. Kërkesa e Partisë së Unitetit Kombëtar për çregjistrimin nga zgjedhjet 133
XIII.2. Procesi i ankimimeve pas ditës së zgjedhjeve 134
XIII.2.1. Kërkesat ankimore nga Partia Bindja Demokratike për shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve në një numër bashkish 134
XIII.2.2. Rinumërimi i votave për 11 QV të Bashkisë Lezhë 135
XIII.2.3. Shpërndarja e mandateve nga Kolegji 137
XIV. VËZHGUESIT 137
XV. PJESËMARJA E GRAVE, PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA DHE MINORITETEVE 140

XV.1. Pjesëmarja e grave 140

XV.2. Personat me afësi të kufizuara 141

XV.3. Minoritetet 141

XVI. SHPALLJA E REZULTATEVE DHE SHPËRNDARJA E MANDATEVE 142

XVI.1. Shpërndarja e mandateve për Kryetarët e Bashkive 142

XVI.2. Shpërndarja e mandateve për anëtarët e këshillave bashkiakë 144

XVII. REKOMANDIME 146

XVII.1. Rekomandime parësore 146

XVII.2. Rekomandime të tjera 147

XVIII. MBI KRIIK 150

XVIII.1. Mbi organizatën 150

XVIII.2. Angazhimi i mëparshëm në lidhje me integritetin zgjedhor 150

XIX. AKRONIME 151

XX. SHTOJCA 152

Shtojca nr. 1 – DEKLARATA PUBLIKE TË KRIIK PËRGJATË PROCESIT ZGJEDHOR 152

Shtojca nr. 1.1 – DEKLARATË - Vizita e sotme e Zëvendës/Ndihmës Sekretarit të Shtetit të SHBA-ve, moment madhor për zgjidhjen e duhur e vizionare të së ardhmes demokratike të vendit 153

Shtojca nr. 1.2. - DEKLARATË - Ruajtja e paanësisë dhe integritetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, rëndësi jetike për funksionimin e shtetit demokratik e ligjor 154

Shtojca nr. 1.3 – DEKLARATË - Procesi i regjistrimit të kandidatëve, po ngre pikëpyetje mbi integritetin e procesit të ardhshëm zgjedhor 156

Shtojca nr. 1.4 - QENDRIM PUBLIK - 30 Qershori si dështim i klasës politike dhe kërcënim ndaj demokracisë 158

Shtojca nr. 2 – Vendimmarrja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 164

Shtojca nr. 3 - Zbatueshmëria e Planit të Veprimit të miratuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve 211

Shtojca nr. 4 - Lirimet dhe emërimet në trupën e Komisioneve Zonale të Administrimit të Zgjedhjeve 213

Shtojca nr. 5 - Tabela e ndryshimeve të vendndodhjeve të Qendrave të Votimit 218

Shtojca nr. 6 - Kërkesat Ankimore të Shqyrtuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve 221

Shtojca nr. 7 - Kërkesë Paditë e Shqyrtuara nga Kolegji Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë 226

Shtojca nr. 8 - Minutazhi i paraqitur në Raportet e BMM për Fushatën Zgjedhore 237

Shtojca nr. 9 – Financimi dhe Raportimi Financiar i Partive Politike për Fushatën Zgjedhore 240

Shtojca nr. 10 - Numri i Bashkive ku kandidoi çdo subjekt 242

Shtojca nr. 11 - Numri i votave dhe mandateve të çdo subjekti zgjedhor 242

Shtojca nr. 12 - Numri i votave të vlefshme për mandat në Këshillin Bashkiak për çdo bashki 248

Shtojca nr. 13 - Diferencat mes dy tabelave zyrtare mbi numrin e votave të vlefshme për këshillat bashkiakë 248

Shtojca nr. 14 - Vëzhgues dhe përfaqësues te mediave të akredituar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve 250

Shtojca nr. 15 - Konstituimi i Këshillave Bashkiake 251

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Konteksti Politik që parapriu 30 Qershorin 2019-të

Procesi i 30 qershorit 2019 për qeverisjen vendore erdhi pas një përshkallëzimi radikal të debatit politik. Një debat politik që arriti majat me dorëheqjen *en block* të mandateve parlamentare të Partisë Demokratike dhe Lëvizjes Socialiste për Integrim. Një hap më tej i këtij bojkoti politik ishte dhe bojkotimi i forcave opozitare ndaj vetë procesit zgjedhor për qeverisjen vendore. Vendim ky që e shndërroi procesin zgjedhor në një proces efektivisht monopartiak dhe si të tillë fiktiv.

Ky kontekst u rëndua akoma dhe më shumë më ndërhyrjen institucionale të Presidentit të Republikës, i cili dekretoi një datë të dytë për mbajtjen e procesit zgjedhor. Një përpjekje kjo e argumentuar nga Presidenti si një mundësi për t'i dhënë frymëmarrje dialogut politik, por që u konsiderua akt antikushtetues nga Partia Socialiste, drejtuese e ekzekutivit. Kjo qasje u ndoq edhe administrata zgjedhore, e cila nuk e njohu aktin dekretues të Presidentit. Një çështje kjo, tashmë, e ankimuar në Gjykatën Kushtetuese, e cila ende nuk ka marrë vendim.

Monitorimi i një përvoje zgjedhore jo të zakonshme

Një proces zgjedhor i vendosur në kontekstin e përshkruar përbëri një dilemë në këndvështrimin e monitorimit nga vëzhguesit vendas. Kjo dilemë qendronte ndërmjet konsideratës së përgjithshme që çdo proces zgjedhor meriton vëmendje dhe në anën që vetë vëzhgimi përbënte një legjitimim të këtij procesi zgjedhor.

KRIIK më anë të aksionit të tij dhe këtij dokumenti u mundua ta zhvendoste angazhimin e tij jashtë kësaj dileme. Në konsideratën e KRIIK, procesi i 30 Qershorit u vlerësua si një "përvojë laboratorike" për të vlerësuar sjelljen institucionale dhe tërë mekanizmin ligjzbatues në Shqipëri.

Në këtë qasje, vetë ky dokument nuk përbën një Raportim të zakonshëm për një proces të zakonshëm zgjedhor.

Metodologjia e ndjekur shkon përtej rregullsisë së monitorimit të procesit zgjedhor, si një përpjekje për të matur kapacitetin institucional për një proces zgjedhor me integritet.

Dokumenti reflekton angazhimin e KRIIK për të ndjekur në qasje "audituese" të të tërë "fillit të kuq" të procesit zgjedhor.

Konkluzioni i një përvoje 30 vjeçare

Procesi i 30 Qershorit 2019, passolli mandatimin e qeverisjes vendore të re me përkatësi tërësisht të Partisë Socialiste. Një proces ky i ligjshëm[1], por për të cilin nuk është e mundur

1 Mbetet për t'u pritur vendimmarrja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

të vlerësohet sesi u realizua shprehja e vullnetit të lirë e demokratik. Kjo për shkak se, ndër të tjera, rezultoi realisht një proces gati tërësisht pa garim duke përbërë kështu *de facto* një emërim politik të qeverisjes vendore.

Në vijueshmëri të monitorimit të kryer për rreth një dekadë, në konsideratën e KRIIK, **ky proces zgjedhor shënoi përmbylljen e një vijueshmërie sjelljeje të klasës politike vendase dhe institucioneve zgjedhore.**

Dy kritikat madhore ndaj demokracisë shqiptare në përpjekjen shtetformuese kanë qenë në raport me atë se sa rotacioni demokratik përmirëson qeverisjen dhe së dyti se sa institucionet janë të pavarura ndaj presionit politik.

Së pari, ajo që konsiderohej një demokraci me periodicitet autokratik me këtë proces zgjedhor mori shfaqje të plotë.

Së dyti, ashtu si argumentojnë gjetjet e këtij raporti, mori shfaqje të plotë sesa institucionet ligjzbatuese janë zgjatime dhe instrumente thelbësisht partiake.

Precedentët institucionalë kryesorë

Kodi Zgjedhor i 2008-ës, jo vetëm prej KRIIK dhe organizatave të tjera vendase, por edhe prej misioneve vëzhguese ndërkombëtare është vlerësuar në thelbin e tij si i pranueshëm dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare. Megjithatë, prej një dekade ky Kod është veshur në vijimësi me keq-lexime të vullnetshme në zbatim dhe me sjellje institucionale partizane ose jo-profesionale.

Mangësitë që mbart ky Kod në rregullimet që kryen, janë përdorur sipas interesit politik të ditës dhe mos-zbatimi i tij është kryer sipas dakordësive të ngushta bi-partizane. Gjendje kjo e mbartur e tillë në vazhdimësi qëllimisht edhe nëpërmjet mos-adresimit të problematikave në proceset e reformave zgjedhore, duke zgjedhur gjithmonë kryerjen e korrektimeve kozmetike apo duke i dështuar tërësisht këto procese reformuese të nisura.

Në vazhdën e precedentëve të tjerë negativë të vendosur përgjatë proceseve të mëparshme zgjedhore, dëmi më i parë i përvojës zgjedhore të 30 Qershorit ishte **zhbërja definitive e tërë kuadrit ligjor përkatës, institucioneve përgjegjëse dhe traditës zgjedhore sipas Kodit Zgjedhor të vitit 2008**.

Në morinë e problematikave të procesit, listohen si më flagrante:

- *Regjistrimi i subjekteve zgjedhore u krye në raste të shumta jashtë afatit ligjor, me dokumentacion të parregullt dhe jo të ligjshëm;*
- *Përzgjedhja e ekspertëve kontabël ishte e parregullt nga sa përcaktohet;*
- *Veprimtaria e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve vuajti nga mungesa e transparencës;*
- *Procesi i vetëdeklarimit të gjendjes penale të kandidatëve mbarti parregullsi;*
- *U vërejtën vonesa në shpërndarjen e materialeve zgjedhore në Qendrat e Votimit;*

- *Funksionimi i Komisioneve Zonale Zgjedhore në tërësinë e tyre ishte diskrecional;*
- *Procesi i njoftimit me shkrim i zgjedhësve u krye pas gjenerimit të listës përfundimtare të zgjedhësve;*
- *Problematikat e ngritura nga raportet e auditëve mbi gjendjen e Listës së Zgjedhësve mbështetur mbi Regjistrin e Gjendjes Civile nuk u morën në konsideratë nga KQZ;*
- *Policia e Shtetit qendroi pasive në rastet e pengimit të votimit në Qendrat e Votimit;*
- *U evidentuan raste moskthimi të fondeve parazgjedhore nga subjektet zgjedhore dhe të cilat nuk u penalizuan;*
- *U evidentuan raste të përdorimit të parregullt të fondeve zgjedhore;*
- *U evidentuan raste të dorëzimit të raporteve financiare jashtë afatit;*

Më e rëndësishmja, me këtë "proces zgjedhor" u **zhbë edhe mekanizmi i kundër-balancimit politik, praktikisht bi-partizan[2], në mbarëvajtjen zgjedhore.** Mekanizëm i imponuar deri më tani nga establishmenti politik si e vetmja alternativë për mbarëvajtjen normale të një procesi zgjedhor, pavarësisht se sërish nga ky establishment këto procese zgjedhore janë anatemuar si jo demokratike. Një mekanizëm ky tejet problematik dhe i kritikuar, pasi mënjanon aktorët e tretë politikë apo civilë nga administrimi, ankimimi apo investimi institucional në funksion të përmirësimit të integritetit të proceseve zgjedhore.

Precedenti politik

Në mënyrë paradoksale, vlerësohet se edhe **procesi i 30 Qershorit 2019 mbarti një "dakortësi" bi-partizane të rradhës. Kjo "dakordësi" rezultoi të amputonte të vetmen siguresë të mbetur në proceset zgjedhore për të qenë demokratike**, që ishte kundër-balancimi politik. Pasi u arrit për dekada të monopolizohej procesi zgjedhor nga bi-partizanizmi në administrimin e tij dhe në "çertifikimin" e rezultatit, me standardin e ri të vendosur, procesi u mundësua të jetë tashmë edhe krejt unilateral.

Nëse deri më tani marrëveshjet bi-partizane ishin kritikuar si jo-gjithëpërfshirëse, jo-transparente, anti-institucionale dhe anti-ligjore, me **këtë precedent edhe dakordësia bi-partizane u mënjanua si domosdoshmëri.**

Me procesin e 30 Qershorit, në shoqërinë shqiptare u imponua mënjanimi i tërë aspiratave demokratike përballë rrezikut të krizës që thellohet gjithmonë e më shumë.

Në kontekstin e një shoqërie pa mekanizma mbrojtës, si shoqëria civile dhe institucione të forta, dakordësia bi-partizane nga e anatemuar do jetë zgjidhja më e dëshirueshme përballë krizave që kërcënojnë në horizont. **Në këtë kontekst të dhënë, demokracia shqiptare duket se është bjerrur në moment ekzistencial**.

Mekanizmi kushtetues i Republikës së Shqipërisë në thelbin e tij duket tashmë i pajetë, sepse pas 30 Qershorit **rotacioni mekanik zgjedhor, po orientohet drejt një rotacioni mirëfilltazi autokratik, me një "biletë dyshe" qeverisje qendrore-vendore së bashku.** Projektimi shtetformues i një demokracie liberale kushtetuese banalizohet kështu në një

2 Mosplotësimi i vakancave të anëtarësisë së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

dyluftim elektoral ku "fituesi i merr të gjitha". Situatë kjo në të cilën bien tërë parimet e një demokracie kushtetuese si kontroll dhe balancë, transparenca vendimmarrëse, llogaridhënia ndaj qytetarëve, ligjzbatimi, e të tjera si këto.

Qeverisja vendore dhe qytetarët

Marrëdhënia kushtetuese e qeverisjes vendore me atë qendrore, në vijimësi të qeverisjes së vendit është de-natyruar. Ilustruese për këtë de-natyrim kushtetues, është përfshirja e të dy pushteteve në proceset zgjedhore të njëri-tjetrit duke përcaktuar qendrimet e Kryebashkiakëve dhe i përfshirë ata sipas skalioneve përkatëse politike.

Pas 30 Qershorit, kjo mbivendosje e të dy pushteteve u rëndua duke e shndërruar qeverisjen vendore në një zgjatim të qeverisjes qendrore. Përpjekjet disa vjeçare për forcimin e kësaj qeverisje, që kërkonin ta sillnin sa më afër qytetarit dhe larg debatit politik, si më e fundit Reforma Administrative-Territoriale apo të tjera, tanimë duket se janë nul.

Vertikalizimi i pushtetit pa prezencë opozitare, në kontekstin vendas të ligjzbatimit dhe sjel**ljes institucionale, paraqet një rrezik shumë të lartë për qeverisjen vendore.** Mbetet në vullnetin e të mandatuarve të rinj të qeverisjes vendore dhe në rolin e aktorëve vendorë, sigurimi i transparencës dhe gjithëpërfshirjes në vendimmarrjen vendore. Nga ana tjetër, përballë këtij vertikalizimi pushteti dhe një opozite të angazhuar në një konflikt në rend madhor, problematikat e përditshme të jetesës së qytetarëve në nivel mikro, rrezikojnë të mbeten të pazëshme dhe të pambështetura politikisht.

I. HYRJE

Në vazhdimësi të misionit të tij në përpjekje të forcimit të integritetit të proceseve zgjedhore, Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK Albania) ka ndjekur në vazhdimësi, që prej përmbylljes së aksionit të vëzhgimit të zgjedhjeve parlamentare 2017 thuajse të gjitha proceset institucionale, ligjore e politike që kanë lidhje të drejtpërdrejtë apo indirekt me procesin zgjedhor, përfshirë këtu reformën e tentuar zgjedhore, ndaj së cilës mbetet i përkushtuar maksimalisht, por edhe procese të tjera më rendësi, e sidomos krizën e thellë politike që po kalon vendi tashmë prej më shumë se një viti. Qëndrimet e KRIIK mbi këto zhvillime janë bërë në vazhdimësi publike nëpërmjet deklaratave apo qëndrimeve publike.

Procesin e Zgjedhjeve Vendore të vitit 2019, KRIIK ka nisur ta monitorojë në tërësi që prej momentit të shpalljes së datës së zgjedhjeve nga Presidenti i Republikës, më 5 Nëntor 2018.

Ky Raport Monitorimi përmbledh vëzhgimin e bërë gjatë gjithë periudhës deri më datën 28 shkurt 2020 dhe pason publikimin përpara ditës së zgjedhjeve të tre Deklaratave nga KRIIK mbi zhvillimet politike dhe institucionale që i paraprinë dhe afektuan procesin zgjedhor të 30 qershorit 2019, si dhe publikimin pas zgjedhjeve të një Dokumenti të katërt, i quajtur Qendrim Publik, nëpërmjet të cilit u dhanë konsideratat në nivel politik mbi tërë procesin zgjedhor të zhvilluar[3].

Përpos ndjekjes në vazhdimësi të elementëve kontekstualë politikë e institucionalë, vëzhgimi i elementëve teknikë të procesit u fokusua në sjelljen dhe vendimmarrjen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe Kolegjit Zgjedhor, në sjelljen dhe ligjzbatueshmërinë e administratës së KQZ-së, Komisioneve Zonale të Administrimit Zgjedhor, institucioneve dhe aktorëve të tjerë të përfshirë si dhe në monitorimin në tërësi të përgatitjes dhe publikimit të listave të zgjedhësve.

KRIIK angazhoi 90 vëzhgues afatgjatë[4], një për çdo zonë të administrimit zgjedhor të vendit dhe nuk angazhoi vëzhgues afatshkurtër në qendra votimi gjatë ditës së zgjedhjeve.

Vëzhgimi i elementëve teknikë të procesit dhe dokumentimi i hapave administrativë plotëson kuadrin e vëzhgimit të situatës institucionale dhe politike, duke mundësuar një pamje më të qartë dhe vlerësim më të saktë të ligjzbatueshmërisë dhe sjelljes institucionale përgjatë këtij procesi, në të gjithë elementët e vet dhe në raport me të gjithë aktorët e përfshirë.

Në kontekstin e një krize politike të paprecedentë dhe të një situate të jashtëzakonshme, nisur edhe nga precedentët e rinj të krijuar nga sjellja partizane,

3 - *"Vizita e sotme e Zëvendës/Ndihmës Sekretarit të Shtetit të SHBA-ve, moment madhor për zgjidhjen e duhur e vizionare të së ardhmes demokratike të vendit"*, Deklaratë, datë 08.04.2019.
- *"Ruajtja e paanësisë dhe integritetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, rëndësi jetike për funksionimin e shtetit demokratik e ligjor"*, Deklaratë, datë 06.05.2019.
- *"Procesi i regjistrimit të kandidatëve, po ngre pikëpyetje mbi integritetin e procesit të ardhshëm zgjedhor"*, Deklaratë, datë 17.05.2019.
- *"30 Qershori si dështim i klasës politike dhe kërcënim ndaj demokracisë"*, Qendrim Publik, datë 23.08.2019.
Dokumentet e plota i gjeni në Shtojca nr. 1 – Deklarata publike të KRIIK përgjatë procesit zgjedhor, ose në faqen e internetit të KRIIK: www.kriik.al .

4 Vëzhguesit e filluan angazhimin konkret të tyre në javën përpara ditës së zgjedhjeve dhe e mbyllën atë pas përfundimit të veprimtarisë së KZAZ-së përkatëse. Ndërkohë një pjesë e tyre kanë ofruar në vazhdimësi angazhimin e tyre vullnetar që prej shpalljes së datës së zgjedhjeve muaj më parë.

e njëanshme politike dhe nga vendimmarrja joligjore e KQZ-së për regjistrimin e subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve, përpos precedentëve negativë të vendosur në proceset e mëparshme zgjedhore, KRIIK, pas publikimit të dy deklaratave referuar dy vendimmarrjeve joligjore, **vendosi të ridimensiononte planin e parashikuar për publikimin e gjetjeve përgjatë aksionit të këtij vëzhgimi.**

Praktika e mëparshme e publikimeve të shpeshta apo e ndërmarrjes së kontakteve të drejtpërdrejta, përgjatë monitorimit të ecurisë së procesit zgjedhor me synim nxitjen, mbështetjen apo edhe paralajmërimin e aktorëve institucionalë për përmbushjen e detyrimeve të tyre ligjore, u konsiderua e pavend dhe e pavlerë në kontekstin e krijuar të një radikalizimi qëndrimesh politike dhe institucionale në rritje.
Ndaj, u vendos reduktimi i serisë së publikimeve me gjetjet e dala nga monitorimi, si dhe i konsideratave e daljeve publike në media, qoftë për ditën e zgjedhjeve apo edhe pas saj, duke hequr dorë nga skema standarde e monitorimit të një procesi të rregullt zgjedhor.

Në këtë mënyrë KRIIK e limitoi publikimin e gjetjeve të tij vetëm në dy Dokumente:

- ***Dokumenti i parë*** u bë publik më datë 23 gusht 2019 menjëherë pas mandatimit dhe konstituimit të 61 këshillave të rinj bashkiakë dhe marrjes së detyrës prej 60 kryebashkiakëve të rinj. Ky dokument (Qendrim Publik) i titulluar *"30 Qershori si dështim i klasës politike dhe kërcënim ndaj demokracisë",* mblodhi konsideratën në nivel politik të KRIIK rreth zhvillimeve politike, sjelljes institucionale e ligjore të evidentuar përgjatë gjithë ecurisë së procesit të 30 qershorit, si dhe praktikave të krijuara e dinamikave të sjelljeve institucionale e ligjzbatimit të Kodit Zgjedhor prej miratimit të tij në dhjetor 2008.

Nëpërmjet Qëndrimit Publik, KRIIK bëri vlerësimin e tij për procesin e Zgjedhjeve për Organet e Qeverisjes Vendore të 30 qershorit 2019, duke deklaruar, ndër të tjera, se:
"Procesi i 30 Qershorit 2019, i konsideruar "Zgjedhje" apo "Votime", ka passjellë tanimë mandatimin e qeverisjes vendore të re, pavarësisht se është e pamundur të vlerësohet si një proces zgjedhor ku u evidentua shprehja e vullnetit të lirë e demokratik. Kjo për shkak se, ndër të tjera, u shënua një administrim totalisht i njëanshëm politik me shkelje jo të pakta ligjore, si dhe rezultoi realisht një proces gati tërësisht pa garim duke përbërë kështu de facto një emërim politik të qeverisjes vendore."

- ***Dokumenti i dytë*** është ky Raport Monitorimi i cili, përpos elementëve të tjerë, përfshin në mënyrë të plotë komponentin e financimit të fushatës zgjedhore të subjekteve elektorale pjesëmarrës në procesin e 30 qershorit.

Në ndryshim nga monitorimi që iu bëhet elementëve të tjerë përbërës të një procesi zgjedhor, procesi i financimit, kontrollit dhe auditimit të fushatave zgjedhore monitorohet fare pak dhe gëzon një vëmendje të ulët e shpesh nën një dakordësi akaparimi politik të problematikave që mund të përmbajë.

Afatet e stërzgjatura kohore të parashikuara për përmbylljen e procesit të deklarimit, auditimit dhe kontrollit e tejkalojnë me rreth gjashtë muaj datën e publikimit të rezultateve zgjedhore si dhe të raporteve monitoruese çertifikuese nga organizmat e rëndësishëm si OSBE/ODIHR, duke i lënë sërish në hije problematikat që mund të përmbajë ky proces.
Procesi i financimit të fushatave zgjedhore të subjekteve elektorale është një komponent thelbësor, i cili potencialisht mund të nulizojë edhe vetë rezultatin zgjedhor, në varësi të gravitetit të problematikave të hasura dhe shkeljeve të kryera.

Nisur edhe nga fakti i miratimit prej KQZ-së në prill 2019 të disa elementëve proceduralë shtesë për rritjen e transparencës së financimit të fushatave zgjedhore të partive politike, çka përbën edhe një nga objektivat kryesorë të punës monitoruese të vetë organizatës, KRIIK vendosi ta zgjasë periudhën e monitorimit deri në plotësimin e afatit ligjor të parashikuar për dorëzimin e raporteve të auditëve financiarë dhe paraqitjen e opinionit të KQZ-së mbi këtë aspekt të fushatës.

Financimi i fushatave elektorale si dhe i tërë aktivitetit të partive politike është një çështje thelbësore jo thjesht për përmbushjen e standardeve ndërkombëtare në raport me një proces elektoral, por sepse, në një terren me nivel të lartë të korrupsionit dhe krimit të organizuar, trajtimi i duhur i tij përbën një çështje jetike për frenimin e rrezikut të kapjes së pushteteve dhe të vetë shtetit.

Publikimi i Raportit dhe i gjetjeve veçanërisht mbi këtë komponent gjykohet se do të mund të japë një ndihmesë edhe për vetë KQZ-në në procesin e kontrollit dhe verifikimit mbi raportimet e bëra, sikundër e ngarkon ligji, proces që në fakt duhet të ishte mbyllur, si rregull, brenda datës 26 janar 2020. Duke konsideruar edhe mundësinë që administrata t'i referohet dispozitës duke bërë përllogaritjen e afatit me momentin e dorëzimit të raporteve të auditimit (dhe jo të monitorimit sikundër citohet), ky afat orientues shkon deri më datë 16 shkurt 2020.

Nga ana tjetër, zgjatja e periudhës së monitorimit dhe e publikimit të gjetjeve të këtij raporti, mundëson një lexim më të drejtë të problematikave të paraqitura. Kjo pasi bëhet e mundur që në këtë periudhë të përfshihen, ndër të tjera, publikimi më datë 11 tetor 2018 i Opinionit të Venecias rreth dekretit të Presidentit për shfuqizimin e dekretit të mëparshëm të tij që caktonte datën 30 qershor si datë zgjedhjesh, si dhe vendimi i Këshillit Europian i datës 18 tetor 2019 për çeljen ose jo të negociatave për anëtarësim të Shqipërisë në Bashkimin Europian, momente këto të cilat priteshin të mbartnin ngarkesa të forta politike, në krizën ende të pazgjidhur e të rënduar politike në vend.

Në gjykimin e KRIIK, gjetjet e këtij Raporti Monitorimi meritojnë të marrin vëmendjen e duhur të maturisë së klasës politike dhe të institucioneve vendimmarrëse, pa doza suplementare të debatit aktual politik.

Marrja në konsideratë dhe leximi me objektivitet i gjendjes që sjell Raporti mbi sjelljen institucionale dhe zbatimin e ligjit prej institucioneve dhe aktorëve të përfshirë, si dhe shqyrtimi me seriozitet i çështjeve që përmban, paraqitet si nevojë imediate.
Adresimi i duhur dhe i drejtpërdrejtë i tyre në një proces të vërtetë, të thelluar dhe shumëdimensional të Reformës Zgjedhore, pas arritjes më parë të dakordësisë politike në elementët madhorë, përbën aktualisht një domosdoshmëri jetike për procesin shteformues dhe të ardhmen e demokracisë në vend.

Raporti paraqet gjithashtu një sërë rekomandimesh, të cilat synojnë adresimin e gjendjes dhe përmirësimin e integritetit të zgjedhjeve në vend[5].

Lidhur me sa më sipër, KRIIK, parashikoi që gjetjet e këtij Raporti Monitorimi, që mbulojnë një periudhë relativisht të gjatë **prej 5 Nëntorit 2018 – 28 Shkurt 2020**, t'i bënte publike në javën e dytë të Marsit, kur edhe parashikohej që të publikohej prej Këshillit Politik paketa e dakordësuar politikisht për Reformën Zgjedhore.

5 KRIIK mbetet i angazhuar në vazhdimësi me vendimmarrësit dhe forcat politike për advokimin e këtyre rekomandimeve apo për të tjera të nevojshme në varësi të situatave që mund të krijohen.

Ndërkohë, bëhet me dije se KRIIK ka paraqitur në vazhdimësi të gjitha rekomandimet e mëparshme të tij dhe ato të dala gjatë këtij monitorimi pranë Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore, si dhe aktorëve politikë kryesorë.

Në kushtet e fillimit të pandemisë së COVID-19 dhe të shpalljes së Gjendjes së Fatkeqësisë Natyrore, **publikimi i këtij Raporti po bëhet në fund të muajit Qershor 2020**, ndërkohë që periudha e mbuluar nga monitorimi mbetet po e njëjta.

Publikimi i gjetjeve të këtij Raporti, përkon edhe me depozitimin në Komisionin e Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore të paketës së amendimeve në zbatim të marrëveshjes politike të 5 qershorit 2020, e cila, sipas angazhimit më të fundit të Këshillit Politik do të depozitohet në Kuvendin e Shqipërisë më datë 30 qershor 2020.

Dakordësimi i Këshillit Politik dhe finalizimi i këtij drafti të parë, hap rrugën për diskutimin në nivelin teknik tashmë në Komisionin Parlamentar si dhe diskutimin e çështjeve të tjera të mbetura për t'u adresuar në Këshillin Politik.

Në këtë aksion vëzhgimi, veçanërisht përsa i përket vëzhgimit të KZAZ-ve dhe situatës në nivel lokal, KRIIK bashkëpunoi me 9 organizata lokale me eksperiencë në vëzhgimin e zgjedhjeve, të cilët angazhuan burimet e veta në ndihmë të aksionit të vëzhgimit, si dhe aktivistët e tyre si vëzhgues afatgjatë:

"Forumi Civil Selenicë"; Qendra "Lëvizja Rinore për Demokraci"- Pukë; "Qendra e Këshillimit të Grave dhe Shërbimeve Sociale Kukës"- Kukës; Qendra Këshillimore për Njerëzit me Aftësi të Kufizuar"- Shkodër; "Qendra Rinore Vlorë" (QRV) – Vlorë; Qendra "Të gjithë së bashku për Integrimin e Romëve" (TIRC); "Qendra e Zhvillimit të Shoqërisë Civile" – Durrës; "Qendra e Zhvillimit të Shoqërisë Civile" – Korçë; Shoqata "Për Mbrojtjen e të Drejtave të Gruas Fshatare dhe Qytetare"- Berat.

KRIIK gjen rastin të falënderojë përzemërsisht për mbështetjen Ambasadën e Zvicrës në Shqipëri.

II. KONTEKSTI POLITIK DHE INSTITUCIONAL

Zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të 30 Qershorit 2019 u mbajtën në një klimë politike ekstremisht të polarizuar dhe konfliktuale, e cila u reflektua dukshëm në aktivitetin e institucioneve të vendit duke shkaktuar madje edhe konfliktualitet institucional mes tyre.

Nëpërmjet një veprimi të paprecedentë në gati 30 vite të demokracisë shqiptare, gjatë së cilës janë regjistruar disa herë raste të bojkotimit të përkohshëm të punimeve të parlamentit nga forcat opozitare, më 21 shkurt 2019 shumica e deputetëve të zgjedhur nga listat e Partisë Demokratike (PD) dhe Lëvizjes Socialiste për Integrim (LSI) dorëzuan mandatin e deputetit në Kuvendin e Shqipërisë.

Në vazhdim të kësaj lëvizjeje, këto dy forca politike së bashku me parti të tjera jashtëparlamentare tashmë të quajtura si "opozita e bashkuar", organizuan dhjetë protesta kombëtare në Tiranë, si dhe një numër protestash lokale, në disa prej të cilave u vërejtën episode dhune, tentativa për të hyrë me forcë në institucione e akte vandalizmi ndaj tyre, si dhe përplasje fizike mes policisë dhe protestuesve. Protesta më të vogla u organizuan edhe në nivel lokal gjatë periudhës së fushatës për Zgjedhjet e 30 qershorit, veçanërisht përgjatë aktiviteteve elektorale në të cilat merrte pjesë Kryeministri z. Rama.

Që prej nisjes së këtyre protestave opozita kërkoi dorëheqjen e qeverisë dhe të Kryeministrit Rama si dhe krijimin e një qeverie tranzitore e cila të organizojë zgjedhjet e parakohshme parlamentare në vend. Argumentet bazë të përdorura prej saj lidhen me blerjen e votave dhe presionin mbi zgjedhësit nga maxhoranca aktuale në zgjedhje, lidhjet e qeverisë me krimin e organizuar, korrupsionin dhe pandëshkueshmërinë, si dhe me situatën e vështirë ekonomike të vendit.

Aksioni i opozitës jashtëparlamentare dhe i mbështetësve të saj vazhdoi në vijimësi në nivel lokal e qendror, duke u përshkallëzuar më tej, sidomos pas diegies së të gjitha afateve kohore që do të mundësonin përfshirjen e opozitës në procesin zgjedhor të 30 qershorit.

Tentativat për bashkëbisedim me qëllim zgjidhjen e krizës mes palëve ishin sporadike dhe jo serioze, ku palët ndër të tjera nuk hoqën dorë nga kushtet paraprake që ia vendosnin kundërshtarit, ndërkohë që situata vazhdonte të mbetej në një ngërç madhor.

Në këtë klimë tensioni, refuzimi i partive të opozitës për t'u regjistruar si subjekte zgjedhore në garë dhe më pas edhe braktisja fare e procesit, solli që administrimi i procesit të ishte i njëanshëm, pasi tërë piramida e administrimit parashikohet të ketë për bazë balancimin politik pozitë-opozitë, ose më saktë Parti Socialiste – Parti Demokratike.

Nga ana tjetër, Zgjedhjet Lokale 2019 përbënin një proces shumë të rëndësishëm për demokracinë dhe shtetin ligjor në Shqipëri, ndërkohë që vendi i kishte hyrë reformave të thella radikale.

Reforma në Drejtësi në zbatim kishte dhënë një seri rezultatesh dhe pasojash, përfshirë largimin nga sistemi i drejtësisë, vullnetarisht apo të hequr, të një numri jo të vogël gjykatësish e prokurorësh.

Për pasojë Shqipëria po hynte në një proces zgjedhor me një Gjykatë Kushtetuese dhe Gjykatë të Lartë jo-funksionale dhe me një Prokuror të Përgjithshëm që zëvendësohej përkohësisht nga një Prokurore e Përkohshme prej më tepër se

një viti e gjysmë[6]. Po ashtu ky proces zgjedhor pritej të ishte me ndikim mjaft të rëndësishëm edhe në lidhje me të ardhmen e integrimit Europian të vendit, pasi më 18 Tetor 2019 Këshilli Europian do të vendoste për hapjen ose jo të negociatave për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian.

Pavarësisht një procesi të reformës zgjedhore të nisur që në tetor 2017, vendi hyri në procesin zgjedhor të 30 qershorit me një Kod Zgjedhor të pandryshuar.
Megjithatë sikundër është pranuar edhe në proceset e mëparshme zgjedhore prej vëzhguesve vendas dhe ndërkombëtarë, kuadri ligjor në fuqi e mundëson mbajtjen dhe zhvillimin e një procesi zgjedhor me standarde.

Vetëm tre javë përpara datës së zgjedhjeve të 30 Qershorit, u shënua një ngërç tjetër i paprecedentë institucional dhe kushtetues, pasi Presidenti i Republikës, më datë 10 Qershor 2019 argumentoi dhe nxori një Dekret[7] i cili shfuqizonte Dekretin e 5 Nëntorit 2018, nëpërmjet të cilit data 30 qershor ishte shpallur si datë për mbajtjen e zgjedhjeve lokale.
Mazhoranca nga ana e saj deklaroi se nuk e njihte Dekretin e 10 qershorit. Ndërsa, Kuvendi i Shqipërisë ngriti një Komision Hetimor Parlamentar për të hetuar mbi ligjshmërinë e Dekretit, ndërkohë që kërkoi edhe opinionin e Komisionit të Venecias mbi këtë çështje, në mungesë të Gjykatës Kushtetuese e cila ka tagrin të shprehet mbi (mos)kushtetueshmërinë e akteve ligjore.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) vazhdoi përgatitjet për Zgjedhjet e 30 Qershorit duke e injoruar Dekretin e Presidentit, por pa marrë një vendim formal në lidhje me këtë, megjithëse çështja u ngrit nga Kryetari i Komisionit dhe u diskutua në mbledhjen e datës 10 qershor 2019.

Në 13 Qershor, Kuvendi i Shqipërisë miratoi një Rezolutë ku inkurajonte Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe institucionet e tjera të vazhdonin përgatitjet për procesin zgjedhor tanimë të nisur, çka u përdor si argument prej katër nga pesë anëtarët e KQZ-së për të vijuar procesin zgjedhor dhe për ta konsideruar Dekretin e 10 Qershorit të Presidentit si një akt absolutisht të pavlefshëm[8].
Ndërkohë, më datë 27 Qershor, Presidenti firmosi Dekretin nr. 11211[9], me anë të të cilit caktoi datën 13 Tetor si datën e Zgjedhjeve Lokale[10].
Ky Dekret dhe kjo datë, u injorua nga mazhoranca, ndërkohë që nuk mori as njohje zyrtare dhe as mbështetje nga opozita jashtëparlamentare.

Në një situatë relativisht të tensionuar, sidomos në bashkitë që drejtoheshin nga Kryetarë të zgjedhur prej PD-së dhe LSI-së, përgjatë periudhës korrik – gusht 2019 u mblodhën 61 Këshillat e rinj Bashkiakë të dalë nga Procesi Zgjedhor i 30 Qershorit 2019, si dhe bënë betimin e marrjen e detyrës edhe 60 Kryetarët e rinj të Bashkive.

6 Prokurori i ri i Përgjithshëm, i zgjedhur me mandat të plotë shtatë vjeçar, u zgjodh me datë 5 dhjetor 2019.

7 Dekret nr. 11199, datë 10 qershor 2019, i Presidentit të Republikës së Shqipërisë, *"Për shfuqizimin e Dekretit nr. 10928, datë 05.11.2018 të Presidentit të Republikës "Për caktimin e datës së zgjedhjeve për Organet e Qeverisjes Vendore".* Vendimi për shpalljen e këtij Dekreti u bë me dije që më datë 8 qershor 2019, pak orë përpara se të fillonte protesta e 10 kombëtare e Opozitës së Bashkuar e cila kishte deklaruar se do të radikalizonte qëndrimin e saj në këtë protestë të fundit. Presidenti i Republikës *"në vlerësim të të gjithë rrethanave, fakteve, dhe të informacioneve të sigurisë ë cilësinë e Kreut të Shtetit se, më datë 8 qershor mund të provokohej një konflikt destabilizues me pasoja për jetën, dhe shëndetin e qytetarëve, sigurinë publike dhe rendin kushtetues në vend"*, si dhe *"i bindur se mbrojtja e parimeve kushtetuese* është më e rëndësishme se çdo afat ligjor, si Kreu i Shtetit dhe duke iu për mbajtur betimit për t'i shërbyer rua-jtjes me çdo kusht të stabilitetit, paqes sociale dhe unitetit kombëtar" deklaroi se kishte *"vendosur të shfuqizoj Dekretin nr.10928, datë 05.11.2018 për zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore më datë 30 qershor 2019".*

8 Shih Vendimin nr. 836, datë 13.06.2019 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve "*Për shqyrtimin e kërkesës të Partisë Uniteti Kombëtar për çregjistrimin nga zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019*".

9 Dekret nr. 11211, datë 27 qershor 2019, i Presidentit të Republikës së Shqipërisë, "*Për caktimin e datës së zgjedhjeve për Organet e Qeverisjes Vendore.*"

10 Dekreti 11211, i datës 27 Qershor 2017 nuk është botuar në Fletoren Zyrtare.

III. KUADRI LIGJOR DHE SISTEMI ZGJEDHOR

Mbajtja e zgjedhjeve rregullohet, kryesisht, nga Kodi Zgjedhor[11], i miratuar në vitin 2008 dhe amenduar dy herë në vazhdim, për herë të fundit në vitin 2015[12]. Kodi Zgjedhor përshkruan sistemin zgjedhor, rregullon administrimin e zgjedhjeve, regjistrimin e subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve, regjistrimin e zgjedhësve, fushatën zgjedhore, mbulimin mediatik të fushatës, financimin e subjekteve zgjedhore, shpalljen e rezultateve, si dhe procesin e ankesave dhe apelimeve. Të tjera ligje që rregullojnë aspekte të caktuara apo afektojnë mbajtjen e zgjedhjeve janë Kushtetuta; Ligji për Partitë Politike; Ligji për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike, i njohur si Ligji i Dekriminalizimit; Ligji mbi mediat audiovizuale; Kodi Penal, në kapitullin Vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve; Kodi i Procedurës Administrative, i cili rregullon veprimtarinë administrative të KQZ-së, etj. Kuadri ligjor parësor plotësohet nga udhëzimet dhe vendimet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe vendimet e Kolegjit Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

Gjykata Kushtetuese me një vendimmarrje të saj të datës 7 maj 2013 e ka përjashtuar veten nga shqyrtimi i çështjeve zgjedhore, duke hequr dorë nga detyrimi i saj për sigurimin e procesit të rregullt dhe të drejtave kushtetuese, çka është një veprim i kritikuar nga vëzhguesit vendas (KRIIK/KVV) e ata ndërkombëtarë (ODIHR[13]), si dhe për të cilën është rekomanduar kthimi i saj në përmbushje të funksionit që i njeh Kushtetuta e Republikës .

Zgjedhjet e 30 qershorit 2019 u mbajtën me një Kod Zgjedhor të pandryshuar prej vitit 2015, pavarësisht disa përpjekjeve të pasuksesshme për reformimin e tij në dy procese radhazi të Reformës Zgjedhore, i dyti ende në vazhdim. Në gjykimin e KRIIK, përpjekjet për të amenduar kuadrin ligjor zgjedhor kanë vuajtur në vazhdimësi nga mungesa e vullnetit të klasës politike për t'i adresuar problematikat e vërejtura duke i shqyrtuar ato në tërësi dhe në themel, si dhe nga mungesa e transparencës dhe përfshirjes domethënëse të aktorëve të interesuar dhe me ekspertizë, veçanërisht të atyre vendas.

Klasa politike të vazhdojë pa e vonuar më , procesin për një Reformën Zgjedhore të thellë dhe strukturore të kuadrit ligjor zgjedhor, proces i cili duhet të bazohet në parimet e transparencës së plotë dhe të sigurojë një gjithëpërfshirje reale të aktorëve të interesuar dhe atyre me ekspertizë, vendas apo ndërkombëtarë.

IV.1. Dekretimi i datës së zgjedhjeve dhe ngërçi institucional që pasoi

Sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Presidenti i Republikës cakton datën e zgjedhjeve për organet e pushtetit vendor[14]. Presidenti e ushtroi këtë

11 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, miratuar me Ligjin nr.10019, datë 29.12.2008 dhe ndryshuar me ligjin nr.74/2012, datë 19.07.2012 dhe ligjin nr. 31/2015, datë 02.04.2015.

12 Ligjin nr.74/2012, datë 19.07.2012 dhe Ligjin nr. 31/2015, datë 02.04.2015.

13 Raporti Përfundimtar, Misioni i OSBE/ODIHR për vëzhgimin e Zgjedhjeve Parlamentare 23 qershor 2013. Rekomandimi 25; *"Gjykata Kushtetuese duhet të mos refuzojë në mënyrë të papërshtatshme juridiksionin për rishikimin e vendimeve të Kolegjit Zgjedhor dhe të vendimeve të parlamentit për shkeljen e garancive kushtetuese të procesit të rregullt ligjor; ligji duhet të parashikojë afate të përshpejtuara për paraqitjen dhe gjykimin e kërkesave që kanë lidhje me zgjedhjet në Gjykatën Kushtetuese".*

14 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë Neni 92, pika gj "Presidenti ushtron edhe këto kompetenca: cak-

kompetencë më datë 5 nëntor 2018, duke caktuar datën e Zgjedhjeve për Organet e Qeverisjes Vendore të vitit 2019 më datë 30 qershor, me Dekretin nr. 10928[15]. Me rritjen e tensionit politik në vend, më datë 8 Qershor 2019, kur po bëhej më e qartë se nuk do të mund të kishte më një marrëveshje politike të minutës së fundit mes maxhorancës dhe opozitës që të zgjidhte ngërçin politik dhe të mundësonte pjesëmarrjen e partive më të mëdha opozitare në zgjedhje, si dhe nisur edhe nga rrethana të tjera[16] që lidheshin me radikalizimin e mundshëm të situatës gjatë protestës së dhjetë kombëtare të opozitës së bashkuar, në po atë ditë, vetëm pak orë përpara fillimit të saj, Presidenti njoftoi publikisht se kishte vendosur të shfuqizonte dekretin që kishte caktuar datën 30 qershor si datë të zgjedhjeve. Dy ditë më vonë, ditën e hënë më datë 10 qershor 2019, Presidenti i Republikës shpalli personalisht Dekretin nr. 11199[17], me anë të të cilit shfuqizonte Dekretin nr. 10928 për caktimin e datës së zgjedhjeve, nëpërmjet një konference për shtyp ku renditi të gjitha arsyet dhe argumentet për këtë hap të ndërmarrë.

Ky Dekret i Presidentit të Republikës e vendosi procesin zgjedhor në një ngërç kushtetues dhe institucional. Presidenti i Republikës dhe opozita e konsiderojnë Dekretin e 10 Qershorit detyrues për institucionet që kanë për detyrë të administrojnë procesin zgjedhor dhe se ky Dekret mund të ankimohet vetëm në Gjykatën Kushtetuese, e cila aktualisht është jo-funksionale dhe, bazuar në këtë argumentim, i konsiderojnë Zgjedhjet e 30 Qershorit të paligjshme. Ndërkohë, për qeverinë dhe maxhorancën parlamentare Dekreti i 10 Qershorit është nul dhe duhet konsideruar inekzistent, qëndrim i shprehur edhe në Rezolutën e Parlamentit të datës 13 qershor[18], duke qenë se Kushtetuta nuk i njeh të drejtën Presidentit të Republikës *të zhdekretojë* zhvillimin e zgjedhjeve.

Institucioni i Presidencës shpjegoi publikisht aktin dhe përpos argumenteve të tjerë, solli në mbështetje të këtij akti të Presidentit precedentët e vitit 2011 dhe 2017, kur presidentët Moisiu dhe Nishani, përkatësisht, kishin nxjerrë dekrete të ngjashme, për shtyrjen e datës së zgjedhjeve. Ndërkohë, kundërargumenti i sjellë nga maxhoranca ishte se në të dyja këto raste, shtyrja e datës së zgjedhjeve është kryer pas një marrëveshjeje politike mes maxhorancës dhe opozitës, dhe vetëm pasi Kuvendi i Shqipërisë ka kryer amendimet ligjore përkatëse që lejonin një akt të tillë. Gjithashtu, argumenti ligjor i sjellë nga maxhoranca është se në rastin e 30 qershorit, shtyrja e datës së zgjedhjeve nuk ishte e mundur duke qenë se, sipas Kodit Zgjedhor, data 30 Qershor është data e fundit për mbajtjen e zgjedhjeve[19] dhe mbajtja e tyre në periudhën e radhës zgjedhore, e cila nis në 15 shtator[20] do të sillte qëndrimin në detyrë të të zgjedhurve vendorë në largim përtej mandatit të tyre 4 vjeçar.

Një grup prej 55 deputetësh të Kuvendit kërkuan më 17 qershor nisjen e procedurave për shkarkimin e Presidentit[21] dhe për këtë Kuvendi i Shqipërisë ngriti një Komision të Posaçëm Hetimor Parlamentar[22] për të hetuar ligjshmërinë e veprimeve të Presidentit me shpalljen e Dekretit të 10 Qershorit 2019. Ky Komision

ton datën e zgjedhjeve për Kuvendin, për organet e pushtetit vendor dhe për zhvillimin e referendumeve."

15 Dekret nr. 10928, datë 05.11.2018 të Presidentit të Republikës *"Për caktimin e datës së zgjedhjeve për Organet e Qeverisjes Vendore."*

16 Shih footnote nr. 3, tek *"III. Konteksti politik dhe institucional"*.

17 Dekret nr. 11199, datë 10 qershor 2019, i Presidentit të Republikës së Shqipërisë, *"Për shfuqizimin e Dekretit nr. 10928, datë 05.11.2018 të Presidentit të Republikës "Për caktimin e datës së zgjedhjeve për Organet e Qeverisjes Vendore""*.

18 Rezolutë *"Mbi aktin e Presidentit të Republikës për shfuqizimin e Dekretit nr. 10928 "Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore"*, datë 13.06.2019, e Kuvendit të Shqipërisë.

19 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 8 *"Zgjedhjet e përgjithshme për Kuvendin apo për njësitë e qeverisjes vendore zhvillohen njëherësh në të gjithë territorin e vendit brenda periudhës që shtrihet nga 15 marsi deri më 30 qershor ose nga 15 shtatori deri më 30 nëntor. Bëjnë përjashtim nga ky rregull rastet e parashikuara në pikat 3, 4, 5 dhe 6 të nenit 9 të këtij Kodi"*.

20 Po aty.

21 Kuvendi i Shqipërisë, Kërkesë për shkarkimin e Presidentit të Republikës nga një grup deputetësh.

22 Shih faqen e Komisionit në faqen e Kuvendit të Shqipërisë.

Hetimor vazhdon të jetë në detyrë dhe nuk ka ende asnjë konkluzion, megjithëse Opinioni i Komisionit të Venecias[23], i kërkuar prej Kuvendit të Shqipërisë, lidhur me këtë çështje është bërë publik që më datë 11 tetor 2019.

IV.2. Sistemi zgjedhor

Kryetarët e bashkive dhe anëtarët e këshillave bashkiakë zgjidhen me votim të drejtpërdrejtë nga shtetasit me të drejtë vote me banim në territorin e bashkisë përkatëse. Kryetari i bashkisë zgjidhet drejtpërdrejt dhe nominalisht nga zgjedhësit, sipas një sistemi maxhoritar (i pari fiton), ndërkohë që anëtarët e këshillave bashkiakë zgjidhen sipas një sistemi proporcional rajonal bazuar në lista shumë-emërore të mbyllura, të paraqitura nga partitë politike të regjistruara për të marrë pjesë në zgjedhje paraprakisht, ose si kandidatë të mbështetur nga grupe zgjedhësish. Zonat zgjedhore, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, përputhen me territorin e bashkisë përkatëse.

Zgjedhjet zhvillohen me një raund të vetëm, ndërkohë që kuadri ligjor nuk kushtëzon asnjë minimum pjesëmarrjeje në mënyrë që zgjedhjet të konsiderohen të vlefshme. Mungesa e një raundi të dytë, e kombinuar me pjesëmarrjen e ulët në votime në zgjedhjet e 30 qershorit 2019, ngre pikëpyetje mbi nivelin e legjitimitetit të kryetarëve të zgjedhur në tërësi e veçanërisht të disa bashkive, të cilët janë zgjedhur me votat e një numri shumë të ulët të zgjedhësve të zonës përkatëse[24].

Zgjedhësit votojnë në fletë votimi të ndryshme për kandidatin për kryetar dhe për subjektet zgjedhore që kanë paraqitur kandidatë për këshillin bashkiak. Kryetar i bashkisë zgjidhet kandidati që merr numrin më të lartë të votave, ndërkohë që mandatet për këshillin e bashkisë ndahen sipas një sistemi proporcional, sipas metodës së mesatares më të madhe[25]. Partitë politike të cilat marrin më pak se 3% të votave në një bashki apo koalicionet që marrin më pak se 5% nuk përfshihen në ndarjen e mandateve.

Në kuadër të filozofisë së ndërtimit të një pushteti vendor sa më pranë qytetarit dhe veçanërisht pas reformës administrativo-territoriale, nevojitet që të rritet legjitimiteti dhe forca e kryetarit të bashkisë si qytetari i parë i komunitetit pavarësisht logos partiake që e propozoi apo mbështeti. Në këtë kuptim nevojitet të vendoset në Kodin Zgjedhor që zgjedhja e kryetarit të bashkisë të bëhet sipas sistemit maxhoritar me dy raunde.

IV.2.1. Mekanizmi i shpërndarjes së mandateve për këshillin bashkiak

Mekanizmi i shpërndarjes së mandateve për këshillat bashkiakë është identik me atë për zgjedhjen e deputetëve në zgjedhjet parlamentare. Kjo konsiderohet nga KRIIK të jetë jo në përputhje me aspiratat e Reformës Administrative Territoriale të vitit 2014, një nga qëllimet kryesore të së cilës ishte sjellja e qeverisjes vendore më pranë qytetarëve dhe forcimi i demokracisë lokale. Pavarësisht ndryshimeve

23 *"...Për më tepër, zgjedhjet vendore nuk kanë të njëjtin status kushtetues si zgjedhjet parlamentare. Ekspertët thonë se edhe nëse Kuvendi do të përcaktonte seriozitetin e shkeljeve, kjo nuk duhet domosdoshmërisht të çojë në shkarkim, duke marrë parasysh fuqinë e Seancës Plenare të Kuvendit për të marrë parasysh qëllime të tjera kushtetuese, siç janë ruajtja e kontrolleve dhe ekuilibrave dhe stabilitetit në vend. Nëse Kuvendi do të vendoste në favor të shkarkimit, në fund do t'i takonte Gjykatës Kushtetuese, e cila aktualisht nuk funksionon, të konfirmojë nëse vendimet e Presidentit janë shkelje "serioze" që do të justifikonin shkarkimin e tij. ..."* Komunikatë për shtyp e Këshillit të Europës mbi Opinionin e Komisionit të Venecias datë 11.10.2019.

24 P.sh. në Bashkinë Shkodër kandidati fitues mori mbështetjen e 10% të zgjedhësve të regjistruar, në Bashkinë Kavajë kandidati fitues mori mbështetjen e 11.7% të zgjedhësve të regjistruar, në bashkinë Kamëz kandidati fitues mori mbështetjen e 10.1% të zgjedhësve të regjistruar.

25 Mandatet ndërmjet koalicioneve parazgjedhore shpërndahen sipas metodës D'Hondt, ndërsa ndërmjet partive politike brenda koalicioneve sipas metodës Sainte-Laguë.

madhore që kjo reformë solli, mekanizmi i zgjedhjes së vendimmarrësve lokalë nuk u amendua, çka përbën një qasje jo koherente, në raport me qëllimin e Reformës.

Përpos sa më sipër, mekanizmi i shpërndarjes së mandateve në vetvete, përmban së paku, dy probleme në reflektimin e vullnetit të zgjedhësve, probleme të cilat janë analizuar më parë nga KRIIK edhe në raport me zgjedhjet parlamentare. Problemi i parë ka të bëjë me votat e humbura të zgjedhësve të cilët votojnë për një subjekt zgjedhor i cili nuk e kalon pragun ligjor[26] dhe problemi i dytë me disavantazhimin e subjekteve zgjedhore të cilat hyjnë në zgjedhje më vete ndaj atyre që hyjnë si pjesë e koalicioneve parazgjedhore[27]. Kjo pasi një parti e cila garon më vete i duhet të kalojë pragun ligjor prej 3% për të marrë mandatin e parë, ndërkohë që për partitë që garojnë si pjesë e koalicioneve parazgjedhore pragu minimal ligjor eliminohet automatikisht nëse koalicioni përkatës kalon pragun. Në këtë mënyrë, çdo alternativë e re apo parti me numër të ulët votash do të jetë më e motivuar të krijojë koalicione parazgjedhore me parti që kanë një numër të lartë votash që të rrisë shanset të përfaqësohet. Sistemi aktual dizavantazhon dhe dekurajon partitë e reja të cilat zgjedhin të marrin pjesë në zgjedhje të pa përfshira në koalicione parazgjedhore.

Ndërkohë, sistemi i listave të mbyllura për këshillat bashkiakë, i shoqëruar me mungesën e demokracisë së brendshme në partitë politike shqiptare, ka shpënë në qendërzim të sistemit zgjedhor në duart e lidership-it të partive politike, çka dëmton akoma më tepër demokracinë e brendshme dhe, si rrjedhim, edhe shfaqjen e rrymave të mendimit ndryshe brenda tyre. Të gjithë faktorët më sipër kanë shpënë në një situatë ku partitë politike, veçanërisht ato me një numër më të lartë mbështetësish, kanë monopolizuar skenën politike, duke i ngushtuar alternativat e zgjedhësve në pak alternativa partish "të mëdha" si dhe në emra të paracaktuar nga lidership-i i partisë.

Mekanizmi i shpërndarjes së mandateve apo edhe vetë sistemi zgjedhor duhet të rishikohet në integral*, kombinuar me ndryshime në Ligjin për Partitë Politike dhe mënyrën e administrimit të procesit zgjedhor, apo edhe të tjera, me qëllim forcimin dhe garantimin e përfaqësimit real të qytetarëve, hapjen e sistemit dhe nxitjen e forcave apo alternativave të reja politike, garantimin e barazisë në garë si dhe forcimin e demokracisë së brendshme të partive politike.*

Vendosja e një minimumi pjesëmarrjeje në rastin e zgjedhjeve lokale, në mënyrë që ato të konsiderohen të vlefshme mund të konsiderohej, duke qenë se do të rriste legjitimitetin e të zgjedhurve vendorë, por edhe do të shërbente si një siguri shtesë për evitimin e proceseve zgjedhore në mungesë të pluralizmit real.

26 Konkretisht, në Zgjedhjet e 30 Qershorit, numri i votave të humbura (votat e humbura janë përllogaritur si totali i votave të vlefshme për një subjekt të dhënë zgjedhor në ato bashki ku ky subjekt ka marrë 0 mandate) është 3.8%. Akoma më shqetësuese bëhet kjo situatë nëse konsiderohet se ka bashki në të cilat kjo shifër shkon deri në 10%, si në bashkitë Has dhe Këlcyrë.

27 Konkretisht: Në zgjedhjet e 30 qershorit, partitë që morën pjesë të përfshira në koalicione parazgjedhore morën 95.18% të votave dhe 96.79% të mandateve në këshillat bashkiakë, subjektet zgjedhore të cilat nuk u përfshinë në koalicione parazgjedhore morën 4.56% të votave dhe 3.09% të mandateve dhe kandidatët e pavarur morën 0.26% të votave dhe 0.12% të mandateve.
Ndërkohë, nëse përqindja e votave të humbura (shih shënimin nr. 24 më sipër) për partitë që garuan si pjesë e koalicioneve parazgjedhore është vetëm 2.8% (20.369/725.186), për partitë që kanë garuar jashtë koalicioneve përqindja e votave të humbura është 20.6% (7.145/34.696).
Kostoja e një mandati *(kostoja e mandatit përllogaritet si numri i votave ndaj mandateve të fituara për një subjekt të dhënë zgjedhor apo zonë zgjedhore)* për këshilltar është dukshëm më i lartë për partitë që garojnë më vete ndaj atyre që garojnë si pjesë e koalicioneve parazgjedhore. Kostoja mesatare e një mandati në zgjedhjet e 30 qershorit ishte 470,6 vota për mandat (761.848 vota të vlefshme/1.619 mandate, në rang vendi). Për partitë që kanë garuar si pjesë e koalicioneve parazgjedhore kostoja mesatare e mandatit është 462,79 vota për mandat, shumë pranë mesatares kombëtare. Ndërkohë, për partitë jashtë koalicioneve parazgjedhore është 639,9 vota për mandat, dukshëm më e lartë.

IV.3. Infrastruktura zgjedhore

Infrastruktura mbështetëse në proceset zgjedhore, përfshirë përcaktimin e vendndodhjeve të Komisioneve Zonale të Administrimit Zgjedhor, qendrave të votimit, apo Vendeve të Numërimit të Votave, e shoqëruar me kërkesat dhe kriteret përkatëse për këto vendndodhje ngrihet ad-hoc për çdo proces zgjedhor, bazuar në një mekanizëm që përcakton kritere, afate kohore, dhe ndërveprim mes një numri institucionesh qendrore e lokale. Volumi i madh i përgatitjeve për të ndërtuar një strukturë të tillë me ndërveprimin e një numri institucionesh është konsideruar në vazhdimësi nga KRIIK si një menaxhim jo i mirë burimesh dhe energjish.

Në procesin për Zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të 30 Qershorit, pas Dekretit të Presidentit të datës 10 qershor, kjo problematikë ishte akoma më e theksuar, si pasojë e mosbashkëpunimit dhe kërkesës së bashkive të drejtuara nga përfaqësues të opozitës jashtëparlamentare për lirimin e mjediseve, që ishin nën administrimin e qeverisjes lokale, në të cilat KZAZ-të apo KQV-të ushtronin aktivitetin e tyre. Mosbashkëpunim i cili arriti të nxiste edhe sulme ndaj një numri KZAZ-sh, me pasoja deri në shkatërrimin e materialeve zgjedhore dhe fletëve të votimit[28]. Kjo situatë e tensionuar e vendosi administratën zgjedhore nën stres dhe vështirësi të konsiderueshme, si pasojë e nevojës për të ndryshuar vendndodhjen e KZAZ-ve apo VNV-ve deri në momentin e fundit, madje edhe në ditën e zgjedhjeve[29]. Nga ana tjetër, këto ndryshime mund të kenë shkaktuar konfuzion tek zgjedhësit në lidhje me vendndodhjen e qendrave të votimit, pasi ka pak gjasa që komisionet e nivelit të dytë të kenë patur mundësi të njoftojnë në kohë dhe në mënyrë efektive qytetarët për vendndodhjet e reja të qendrave të votimit në një afat kaq të ngushtë kohor, sidomos për ato të ndryshuara gjatë ditës së zgjedhjeve.

Rekomandohet që legjislacioni të parashikojë vendndodhje të përhershme të mjediseve ku trupat e administratës zgjedhore të kryejnë aktivitetin e tyre, vendndodhje që mund të rifreskohet në vijimësi nga administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, sipas mundësive në terren. Kjo qasje do të rriste operativitetin e administratës së KQZ-së për pajisjen në kohë të komisioneve me infrastrukturën dhe shërbimet e nevojshme apo edhe kryerjen e kontrollit fizik të ambienteve ku do të ushtrojnë funksionin këto trupa.

IV.4. Përgatitja e Listës së Zgjedhësve

Regjistrimi i zgjedhësve në Shqipëri është pasiv, listat e zgjedhësve gjenerohen në bazë të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile, duke mos kërkuar angazhim të zgjedhësve për t'u regjistruar. Përjashtim nga kjo përbëjnë zgjedhësit mbi 100 vjeç ditën e zgjedhjeve, të cilët eliminohen nga Lista e Zgjedhësve dhe përfshihen në të vetëm bazuar në kërkesën e vetë këtyre të fundit. Ky trajtim i diferencuar ndaj zgjedhësve përtej një pragu moshor, vlerësohet të përbëjë diskriminim moshor negativ.

Saktësimi i Listës Përfundimtare të Zgjedhësve kalon në tri hapa: 1. publikim ciklik (çdo 30 ditë) të listave paraprake të zgjedhësve; 2. njoftim me shkrim të zgjedhësve mbi numrin dhe adresën e qendrës përkatëse të votimit dhe 3. korrigjim administrativ dhe gjyqësor i listave paraprake.

28 KZAZ nr. 6 Bashkia Vau i Dejës, KZAZ nr. 2 Bashkia Shkodër.

29 Në mbledhjen e vetme të mbajtur nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në datë 30 Qershor u mor vetëm një vendim, për ndryshimin e vendndodhjes për tetë qendra votimi, gjashtë në Bashkinë Shkodër (ZAZ nr. 3) dhe 2 në Bashkinë Berat. Vendimi nr. 937, datë 30.06.2019 i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve "*Për dhënie autorizimi për ndryshimin e vendndodhjeve të disa QV-ve, për Zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore, të datës 30 qershor 2019.*"

Përtej hapave të mësipërm, pas publikimit të Listës Finale të Zgjedhësve 40 ditë përpara ditës së zgjedhjeve, zgjedhësit që figurojnë me pasaktësi në përbërësit e tyre zgjedhorë, që nuk figurojnë të regjistruar në listën e zgjedhësve të zonës së qendrës së votimit të vendbanimit të tyre, apo nuk figurojnë fare në listat e zgjedhësve të bashkisë ku kanë vendbanimin, kanë mundësinë të votojnë me vendim gjyqësor duke paraqitur kërkesë në gjykatën e rrethit gjyqësor deri ditën e premte, 24 orë përpara datës së zgjedhjeve.

IV.5. Aktet nënligjorë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Sipas Kodit Zgjedhor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) në bazë dhe për zbatim të ligjit, mund të nxjerrë vendime dhe udhëzime[30]. Pas miratimit të Kodit Zgjedhor të vitit 2008, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka miratuar së paku 49 nënakte normative ose ndryshime aktesh normative[31]. Një problematikë që vlen të vendoset në dukje është miratimi, në disa raste, i akteve me karakter udhëzues si vendime. Një pjesë e tyre janë miratuar në momente kur trupa e KQZ-së ka operuar me numër të kufizuar anëtarësh[32]. KRIIK vëren se ende nuk ka patur ndonjë përpjekje nga ana e KQZ-së për të korrigjuar këtë, megjithëse ky shqetësim është ngritur edhe më parë. Gjithashtu, problematik vazhdon të mbetet mospublikimi i nëntë prej këtyre nënakteve, tetë prej të cilëve ende në fuqi, në Fletoren Zyrtare. Për më tepër, pesë prej tyre e lidhin shprehimisht hyrjen në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare, duke ngritur kështu pikëpyetje për zbatueshmërinë e tyre ligjore. Po ashtu, për pesë nënakte normative të publikuara në Faqen e Internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve mungojnë lidhjet për materialet shoqëruese.

IV.6. Drejtësia zgjedhore

Drejtësia zgjedhore përfshin si procesin e ankesave dhe apelimeve të subjekteve zgjedhore, ashtu edhe cenimin e së drejtës për të zgjedhur, përfshi shqyrtimin e korrupsionit zgjedhor dhe cenimin e vullnetit të zgjedhësve. Në këtë sistem, si rrjedhojë, përfshihen jo vetëm institucionet që shqyrtojnë çështjet me objekt zgjedhor, por edhe të tjera institucione, si gjykatat e zakonshme apo institucionet hetimore si Prokuroria.

IV.6.1. Penalizimi i veprave që cenojnë zgjedhjet

Kreu X i Kodit Penal[33] trajton veprat penale që cenojnë lirinë dhe integritetin e proceseve zgjedhore. Në amendimet që i janë bërë këtij akti në vite është zgjeruar numri i kundërvajtjeve penale që cenojnë zgjedhjet. Amendimet më të fundit të Kodit Penal në lidhje me veprat penale që cenojnë zgjedhjet u kryen më 22 Maj 2017, pas marrëveshjes së 18 Majit 2017 mes drejtuesit të Partisë Demokratike, z. Lulzim Basha dhe Kryeministrit z. Edi Rama, marrëveshje mbi bazën e së cilës

30 Aktet me karakter normativ të miratuar nga kjo trupë kanë fuqi mbi të gjithë territorin e vendit, kanë fuqi mbi të gjithë dhe formalisht *"hyjnë në fuqi pas botimit të tyre në Fletoren Zyrtare, përveç rasteve kur rrethanat diktojnë hyrjen e menjëhershme në fuqi, ndërsa aktet e tjera hyjnë në fuqi menjëherë"* (pika 5, neni 23 i Kodit Zgjedhor).

31 11 janë miratuar formalisht si vendime, 6 udhëzime janë aktualisht të shfuqizuar dhe 11 udhëzime janë aktualisht të amenduar.

32 Për shkak të ngërçit politik, trupa e KQZ-së ka funksionuar dhe marrë vendime vetëm me katër anëtarë nga pesë të nevojshëm për të miratuar aktet me karakter normativ (gjatë procesit zgjedhor të vitit 2013 dhe 2019).

33 Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, Ligji nr. nr. 7895, datë 27.1.1995 (ndryshuar me ligjet nr. 8175, datë 23.12.1996; nr. 8204, datë 10.4.1997; nr. 8279, datë 15.1.1998; nr. 8733, datë 24.1.2001; nr. 9017, datë 6.3.2003; nr. 9030, datë 13.3.2003; nr. 9086, datë 19.6.2003; nr. 9188, datë 12.2.2004; nr. 9275, datë 16.9.2004; nr. 9686, datë 26.2.2007; nr. 9859, datë 21.1.2008; nr. 10 023, datë 27.11.2008; nr. 23/2012, datë 1.3.2012; nr. 144, datë 2.5.2013; nr. 98, datë 31.7.2014; nr. 176/2014, datë 18.12.2014; nr. 135/2015, datë 5.12.2015; nr. 82/2016, datë 25.7.2016; nr. 36/2017, datë 30.3.2017; nr. 89/2017, datë 22.5.2017; dhe me vendimet e Gjykatës Kushtetuese: nr. 13, datë 29.5.1997; nr. 46, datë 28.8.1997; nr. 58, datë 5.12.1997; nr. 65, datë 10.12.1999; nr. 11, datë 2.4.2008; nr. 19, datë 1.6.2011; nr. 47, datë 26.7.2012 dhe nr. 9, datë 26.2.2016).

Partia Demokratike u regjistrua dhe mori pjesë në Zgjedhjet Parlamentare të vitit 2017, të cilat i kishte bojkotuar deri në atë moment. Amendimet e Kodit Penal të majit 2017 shndërruan shumë kundërvajtje penale në vepra penale, duke rënduar dhe sanksionet për to.

Por efektshmëria e rëndimit të këtyre masave nuk është vlerësuar në asnjë moment, ndërkohë që cenuesit e proceseve zgjedhore, në pjesën dërrmuese nuk janë dënuar. Veçanërisht procedurat e denoncimit, vlerësohen si një problematikë madhore. Mungesa e një procedure efektive e shoqëruar nga kultura e pandëshkueshmërisë ka ndërtuar në perceptimin publik kultin e pandëshkueshmërisë, i cili gjithmonë e më shumë po kërkon një sipërmarrje të jashtëzakonshme për t'u ndryshuar.

Kuadri ligjor duhet të parashikojë një mekanizëm hetimi efektiv, aktualisht inekzistent, dhe një procedure efektive denoncimi ndaj fenomeneve që cenojnë lirinë dhe integritetin e proceseve zgjedhore.

IV.6.2. Sistemi i ankimim-apelimeve

Sistemi i ankesave dhe apelimeve zgjedhore mbështetet në gjykimin administrativ, i cili përfshin Komisionet Zonale të Administrimit Zgjedhor dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe në gjykimin gjyqësor, të kryer nga Kolegji Zgjedhor, e cila është një trupë gjyqësore e ngritur specifikisht për ankimimet zgjedhore dhe funksionon pranë Gjykatës së Apelit të Rrethit Tiranë. Në gjykimin e KRIIK, ky mekanizëm është defaktorizuar nga njëri proces zgjedhor në tjetrin për shkak të precedentëve të krijuar. Zgjedhjet Lokale të 30 Qershorit ishin momenti i fundit në këtë defaktorizim të mekanizmit të ankimimeve dhe apelimeve.

Lidhur me këtë mekanizëm, në vazhdën e shqetësimeve të ngritura më parë, tri janë problematikat që evidentohen si më të fortat nga KRIIK: 1. Mungesa e parimit të precedentit, i cili është shfaqur në inkoherencë vendimmarrëse, sidomos në gjykimin gjyqësor; 2. mbivendosje e kompetencave dhe e roleve në marrëdhëniet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Kolegjit Zgjedhor dhe Gjykatës Kushtetuese dhe 3. mospërcaktim i saktë i të drejtave dhe instrumenteve ligjorë të palëve për t'iu drejtuar këtij mekanizmi.

Kuadri ligjor është i paqartë se cilat janë objektet, subjektet apo rrethanat e legjitimuara për t'iu drejtuar kësaj gjykate, si dhe kufijtë e tagrave të vendimmarrjes së kësaj gjykate në raport me procesin zgjedhor. Procesi i zgjedhjeve parlamentare të 2017-ës krijoi precedentin ndërsa procesi i zgjedhjeve lokale të 30 qershorit 2019 e shëndoshi akoma më tej, në mënyrë të veçantë, elementin e parë, pamundësinë për aktorë që nuk janë subjekte zgjedhore në një proces të caktuar, për të ankimuar, duke qenë se konsiderohen se nuk kanë një interes të drejtpërdrejtë në procesin zgjedhor. Kjo vlen edhe për aktorë që janë subjekte zgjedhore por që nuk mund të ankimojnë çështje ndaj të cilave nuk kanë interes të drejtpërdrejtë. Ky gjykim është i mangët dhe e sheh të drejtën shumë ngushtësisht. Një proces zgjedhor është një proces i cili afekton gurin e themelit të një demokracie dhe si i tillë, në thelb, çdo qytetar i vendit ka interes të drejtpërdrejtë në të dhe interesat e të gjithë qytetarëve preken nga padrejtësia gjatë këtij procesi. Veçanërisht një subjekt zgjedhor (forcë politike) nuk mund të delegjitimohet në një nga misionet dhe elementët themelorë të saj, investimi dhe interesi për një proces të ndershëm, të barabartë e të lirë zgjedhor që duhet t'iu ofrohet qytetarëve.

Është i nevojshëm përcaktimi dhe lejimi i subjekteve zgjedhore për të patur të drejta në procesin e ankimimit referuar vendimmarrjes së administratës zgjedhore apo edhe elementëve në tërësi *që prekin integritetin e procesit zgjedhor, përtej një interesi të drejtpërdrejtë përfitues të këtyre subjekteve. Madje kjo e drejtë duhet të shtrihet edhe ndaj grupimeve qytetare dhe atyre politike që nuk janë pjesë e procesit zgjedhor.*

IV.7. Financat e subjekteve zgjedhore

Financat e subjekteve zgjedhore gjatë fushatave zgjedhore dhe ato të partive politike gjatë periudhës vjetore kontrollohen nëpërmjet një mekanizmi i cili parashikon qoftë vetë-deklarim të subjekteve zgjedhore / partive politike ashtu edhe kontroll të pavarur të tyre, kontroll i cili kryhet nga auditë të licencuar, të kontraktuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Ky mekanizëm teorikisht përpiqet të sigurojë vetëm saktësinë e mbajtjes së rekordeve financiare nga partitë politike dhe subjektet e tjera zgjedhore, por praktikisht dështon që të garantojë evidentimin real të të ardhurave dhe shpenzimeve të kryera. Kuadri ligjor për veprimtarinë financiare të subjekteve zgjedhore, përpos moszbatueshmërisë së ligjit, vuan edhe prej mos parashikimit të instrumenteve realë ligjorë, mos adresimit tërësor apo adresimit minimal të problematikave të rëndësishme.

Këtu përmenden mungesa e rregullimeve për sa i përket shpenzimeve të kryera nga personat e tretë apo e ashtuquajtura "fushata hije", rrethi tejet i ngushtë i konfliktit të interesit për donatorët, apo mospërkufizimi ligjor i koncepteve bazike si ai i zyrave zgjedhore, degëve partiake, vullnetarizmit politik apo i fushatës së parakohshme. Me amendimet e kryera ndaj Ligjit "Për Partitë Politike" në seancën e jashtëzakonshme të Kuvendit të datës 22 Maj 2017, mekanizmi i kontrollit u pasurua dhe me një instrument të ri. Ndryshimet ligjore parashikuan që, në funksion të vlerësimit të kostove të fushatave zgjedhore, KQZ-ja emëron ekspertë financiarë në monitorimin e veprimtarisë elektorale të subjekteve.

Gjithashtu, është për t'u vlerësuar vullneti i KQZ-së, i cili brenda tagrave dhe hapësirave që lejon legjislacioni aktual, në prill të vitit 2019[34] ndërmori miratimin e tre akteve të tjera nënligjore, të cilat konsistuan në përcaktimin e rregullave të veçanta për depozitimin, publikimin, kontrollin dhe verifikimin e raporteve financiare, shqyrtimin dhe administrimin e tyre, si dhe sanksionet për mosrespektimin e kritereve ligjore prej subjekteve politike. Megjithatë edhe në përmirësimet e bëra vërehen sërish mangësi. Kuadri rregullator ngarkon me detyrime subjektet zgjedhore, ndërkohë që detajimet e bëra kanë për referim partitë politike, duke krijuar pabarazi në trajtimin e subjekteve të tjera zgjedhore (kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, kandidatët për kryetarë të bashkive) si dhe paqartësi në procesin e vetëdeklarimit dhe auditimit të tyre.

Eksperienca e zgjedhjeve parlamentare të 25 qershorit 2017 dhe atyre lokale të 30 qershorit 2019 tregoi se ky mekanizëm, megjithë përmirësimet e bëra, mbetet në tërësi jo-funksional dhe dështon të garantojë transparencë të plotë mbi çështjen.

Për procesin zgjedhor të 30 Qershorit, KQZ-ja vendosi që ekspertët financiarë që do të monitoronin shpenzimet e fushatës zgjedhore të subjekteve zgjedhore do të kryenin edhe auditimin e shpenzimeve të po të njëjtëve subjekte zgjedhore. Në gjykimin e KRIIK, ky veprim i ndërmarrë prej KQZ-së, duke u bazuar në argumentin se në këtë mënyrë thjeshtohet veprimtaria e ekspertëve financiarë, është i pajustifikueshëm dhe i kundërligjshëm.

Ligji përcakton jo pa qëllim dy momente të ndryshme kohore se kur zgjidhen dhe emërohen ekspertët financiarë dhe ekspertët kontabël (apo auditët financiarë), respektivisht përpara fillimit të fushatës zgjedhore dhe pas publikimit të rezultateve zgjedhore.
Nga ana tjetër, me këtë vendimmarrje riskohet ulje e transparencës pasi jepet mundësia e kaparimit të mospërputhjeve në raportet e deklaruara. Raportet e

34 Udhëzimi nr. 1 datë 11.04.2019 *"Për procedurën e kontrollit dhe verifikimit të financimeve dhe shpenzimeve të partive politike dhe fushatës zgjedhore"*; Vendimi 152 datë 11.04.2019 *"Për miratimin e formateve të standardizuara të raportit të auditimit të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike gjatë vitit kalendarik, për fushatën zgjedhore dhe raportit të monitorimit të fushatës zgjedhore"*; Vendimi 153 datë 11.04.2019 *"Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr.1, datë 31.05.2017 "Për përdorimin e materialeve propagandistike dhe vendet për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore""*.

monitorimit të fushatës dhe ato të auditimit të shpenzimeve të fushatës për zgjedhjet e vitit 2017 përmbanin mospërputhje dhe kontradikta[35] në paraqitjen e shifrave.

Kryerja e raportimeve të ndryshme prej ekspertëve të ndryshëm financiarë mundëson një kontroll të dyfishtë si dhe lejon kryqëzimin e të dhënave.

Kontraktimi i të njëjtit ekspert për të kryer të dy proceset, veçanërisht në kushtet kur mungojnë mekanizma të tjerë për të bërë transparencë apo kontrolle shtesë, hoqi kontrollin e dyfishtë që garantonte ligji më parë duke ulur, për rrjedhojë, transparencën ndaj financave të fushatës.

Në gjykimin e KRIIK, kjo vendimmmarje nuk u bë me qëllim lehtësimin e punës së ekspertëve, por për lehtësimin e pozitës së partive politike dhe më konkretisht të mbulimit të mangësive që mund të evidentoheshin më qartë nga kryqëzimi i tre raporteve, raportit të partisë, të ekspertit financiar dhe të auditit. Nga ana tjetër bashkimi i dy funksioneve tek i njëjti individ-ekspert rrit automatikisht presionin politik për akaparim të problematikave të mundshme të vërejtuara.

IV.8. Reformimi i kuadrit ligjor zgjedhor

Problematikat e vërejtura në vijimësi të proceseve zgjedhore dhe dështimi i procesit të reformave zgjedhore të vitit 2016, 2017 dhe 2018 e bëjnë të një rëndësie jetike amendimin e kuadrit ligjor zgjedhor.

Në përvojën e deritanishme Shqipëria vuan nga pamundësia për të zhvilluar një proces të mirëfilltë reformimi të kuadrit ligjor. Një proces amendimi që nevojitet të jetë integral në tematikat që përfshin, gjithëpërfshirës në aktorët pjesëmarrës dhe transparent në procesin e diskutimeve.

Në të gjitha proceset reformuese të nisura apo të tentuara pas zgjedhjeve parlamentare 2013, është kërkuar si domosdoshmëri, së pari arritja e një vizioni të dakordësuar politiko-institucional i dalë nga një proces i gjerë dialogu, i cili të shërbejë si hartë e amendimeve ligjore, duke zhvilluar më pas procesin e konsultimit me aktorë të ndryshëm mbi teknikalitetet e nevojshme.

Pikërisht kjo qasje vazhdon të paraqitet si mangësia madhore e proceseve reformuese, që në çdo rast ka rezultuar duke nulizuar mundësinë për amendime të shëndetshme dhe për mbajtjen e proceseve zgjedhore me integritet.

Zhvillimi i një procesi të mbyllur, jo transparent, në mungesë totale të një procedure përcaktuese të rregullave të lojës mbi të cilën funksionon dhe zhvillohet procesi reformues, i çuar dhe i filluar në limitet kohore në dispozicion, i zhvilluar shpesh në situata tejet të polarizuara apo kriza ciklike të vetëshkaktuara, është bërë praktikë e sjelljes së dy forcave kryesore politike, e cila e sjellë në këtë mënyrë dhe në këtë shtrat të ndërtuar konteksti, imponon dhënien e besimit të qytetarëve

35 Në qoftë se i referohemi të dhënave përfundimtare të kostimit të fushatës zgjedhore të vitit 2017 për 5 partitë parlamentare, rezulton se totali i shpenzimeve të deklaruara në raportin e auditimit financiar është i ndryshëm nga totali i shpenzimeve të deklaruara në raportin e monitorimit financiar për 4 subjekte nga 5 të tilla që morën mandate në kuvendin e Shqipërisë. Konkretisht, totali i shpenzimeve të fushatës zgjedhore të *Partisë Socialiste* sipas raportit të auditit financiar është 100,884,855 lekë, ndërkohë që sipas raportit të monitorimit financiar është 114,483,155 lekë; totali i shpenzimeve të fushatës zgjedhore të *Partisë Demokratike* sipas raportit të auditit financiar është 97,218,466 lekë, ndërkohë që sipas raportit të monitorimit financiar është 96,716,436 lekë; totali i shpenzimeve të fushatës zgjedhore të *Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim* sipas raportit të auditit financiar është 71,826,809 lekë, ndërkohë që eksperti që ka realizuar monitorimin financiar shprehet se nga monitorimi i dokumentacionit financiar dhe i raporteve të shpenzimeve të përgatitura nga subjekti zgjedhor LSI, nuk ka transparencë të plotë në raportimin e shpenzimeve të kryera në zyrat elektorale dhe aktivitetet elektorale, e për pasojë në burimet e financimit të tyre.

për tejkalimin e krizës së rradhës dhe për përmbylljen e përmirësimit të kuadrit ligjor në funksion të organizimit të një procesi garantues ndaj vullnetit të tyre.

Përvoja e deritanishme, veçanërisht në dy proceset e fundit zgjedhore, ka konsumuar tashmë besimin e dhënë ndaj vullnetit politik në raport me administrimin e procesit zgjedhor.

Ky vullnet i përbashkët i forcave kryesore politike, dikur përcaktues për pranimin e për rrjedhojë "çertifikimin" e procesit dhe të rezultatit duke de-legjitimuar vendimmarrjen institucionale, arriti të shndërrohej më pas edhe si vullnet administrues i procesit zgjedhor në zbatim të marrëveshjes politike të majit 2017.

Prej krijimit të këtij precedenti në procesin zgjedhor të vitit 2017, ku vullneti politik i dyanshëm dhe i domosdoshëm pozitë-opozitë u vetëmjaftua dhe imponua si i mjaftueshëm për të administruar dhe çertifikuar një proces zgjedhor, me procesin e realizuar të 30 qershorit 2019, tashmë ky vullnet vetëmjaftohet t'i kryejë këto procese edhe në një mënyrë totalisht të njëanshme, vetëm nga mazhoranca e rradhës.

IV. ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE

V.1. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

V.1.1. Trupa e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) është një trupë e përhershme kolegjiale, e cila, përveç administrimit të zgjedhjeve, ushtron edhe të tjera funksione si: miraton kufijtë e zonave të administrimit zgjedhor, propozon numrin e mandateve për çdo zonë zgjedhore, kujdeset për trajnimin e komisioneve zgjedhore të nivelit të dytë dhe të tretë, mbikëqyr financat e subjekteve zgjedhore, etj.[36]

Trupa e Komisionit mbështetet në aktivitetin e vet nga një administratë e përhershme, anëtarët e së cilës kanë statusin e nëpunësit civil, ndërkohë që gjatë proceseve zgjedhore punësohet staf shtesë në një numër që KQZ-ja e konsideron të nevojshëm.

Anëtarët e KQZ-së zgjidhen nga Kuvendi i Shqipërisë me propozimin e partive politike të shumicës dhe pakicës parlamentare, sipas një formule dhe procedure që garanton balancimin politik të kësaj trupe, për një mandat gjashtë vjeçar.

Kryetari zgjidhet nga Kuvendi bazuar në konkurrim të hapur nga kandidatura jo-politike për një mandat katër vjeçar[37].

Marrëveshja politike e 18 Majit 2017, një muaj përpara zgjedhjeve parlamentare të 25 qershorit 2017, vendosi të bënte ndërrimin e vendeve midis Kryetarit të KQZ-së të zgjedhur nga kandidatura jopolitike (të paktën sipas asaj që përcakton fryma dhe procedura e ligjit) me një prej anëtarëve të KQZ-së të propozuar nga partia e dytë opozitare.

Kjo vendimmarrje cenoi rëndë frymën dhe praktikën institucionale e ligjore, si dhe zhbëri përfundimisht aspiratën për pavarësi të Trupës së KQZ-së, sipas reformës zgjedhore të vitit 2012.

36 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 21 *"Kompetencat e KQZ-së"*.

37 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 14 *"Zgjedhja e anëtarëve të KQZ-së"* dhe Neni 15 *"Zgjedhja e Kryetarit të KQZ-së"*.

Më datë 11 tetor 2018 përfundoi mandati i katër prej anëtarëve[38] të trupës së KQZ-së.

Dy prej anëtarëve të cilëve iu mbaroi mandati ishin zgjedhur me propozim të Partisë Demokratike (PD), një me propozim të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI) dhe një me propozim të Partisë Socialiste (PS).

Kjo e fundit, ushtroi të drejtën e propozimit të dy emrave të tjerë për pozicionin e anëtarit në trupën e KQZ-së. Për rrjedhim u emëruan[39] dy anëtarë, njëri prej të cilëve, z. Bledar Skënderi, u rizgjodh.

Partia Demokratike nuk e ka ushtruar ende këtë të drejtë, në vazhdim edhe të qëndrimit të saj politik[40].

Mospropozimi i kandidatëve për anëtarë të KQZ-së prej Partisë Demokratike shpuri në një situatë ku Zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të 30 Qershorit u administruan nga një trupë jo e plotë, por e përbërë nga vetëm pesë anëtarë[41], përfshirë Kryetarin, situatë e cila vazhdon edhe aktualisht.

V.1.1.1. Qëndrimi i trupës së KQZ në lidhje me dekretin e Presidentit të Republikës të datës 10 qershor 2019

Pas shpalljes së Dekretit nga vetë Presidenti i Republikës në mëngjesin e datës 10 qershor[42], nëpërmjet një konference për shtyp, me anë të të cilit

38 Përfundoi mandati i Anëtarëve të KQZ-së: z. Bledar Skënderi, zj. Vera Shtjefni, z. Hysen Osmanaj dhe z. Gëzim Veleshnja.

39 Kuvendi i Shqipërisë me Vendimin nr. 111/2018, datë 01.11.2018 zgjodhi si anëtare të KQZ-së, zj. Rezarta Bitri dhe me Vendimin nr. 112/2018, datë 01.11.2018 zgjodhi si anëtar të KQZ-së, z. Bledar Skënderi.

40 Në qëndrimet publike të bëra më pas nga drejtuesit e PD-së është bërë me dije arsyeja e refuzimit pasi PS ka shfrytëzuar në mënyrë të padrejtë të drejtën për të propozuar dy anëtarët e KQZ-së, duke bërë që "de facto" PS të ketë 4 anëtarë të propozuar prej saj në Komision. Po ashtu, ky qendrim ka ardhur edhe si pasojë e qëndrimit të mazhorancës për mos përfundimin e hetimeve të dosjeve penale, ku përfshihen zyrtarë të lartë të mazhorancës në korrupsion zgjedhor, referuar zgjedhjeve të pjesshme lokale në Dibër në 11.09.2016 dhe zgjedhjeve të përgjithshme parlamentare të 25.06.2017, çështje këto që janë ende në hetim nga organi i prokurorisë.
KRIIK thekson se prej ndryshimeve të ligjit zgjedhor për përbërjen dhe mënyrën e zgjedhjes së anëtarëve të KQZ-së në reformën zgjedhore të vitit 2012, është vërejtur se në zbatim të këtyre dispozitave ligjore dy partitë e mëdha, PS e PD, kanë patur qasje të ndryshme. - Partia Demokratike përgjithësisht i ka qëndruar linjës së balancimit politik të KQZ-së duke mbështetur kompozimin e KQZ-së si reflektim i njëkohshëm me konfiguracionin e partive politike pozitë-opozitë në Parlament. (Sillet në vëmendje se më datë 15.04.2013, Kuvendi bëri ndërrimin e anëtarit të KQZ-së z. Ilirjan Muho i propozuar në tetor 2012 nga LSI, në atë kohë si partia e dytë parlamentare e mazhorancës qeverisëse, me z. Klement Zguri të propozuar nga Partia Republikane, si partia e dytë tashmë e mazhorancës qeverisëse, duke qenë se 2 muaj përpara zgjedhjeve të 23 qershorit 2013, në 1 prill 2013, LSI doli nga koalicioni qeveritar dhe u rreshtua në opozitë në koalicion me Partinë Socialiste për garën zgjedhore të 23 qershorit 2013. Megjithatë, PD e legjitimoi shkarkimin e z. Ilirjan Muho si kandidaturë e miratuar në kundërshtim me ligjin, pasi më 2003 ndaj tij ka patur një procedim disiplinor, gjë që e bënte kandidaturën e tij të papërshtatshme për anëtar të KQZ-së. *"pas mesditës demokratët ndryshuan objektin e kërkesës së tyre, duke lëvizur nga parimi për balancimin e KQZ-së, te procedimi disiplinor që Muho, sipas tyre, ka marrë gjatë ushtrimit të detyrës si gjyqtar në vitin 2003 dhe, si i tillë, pengohet nga kodi zgjedhor të ushtrojë detyrën si anëtar i KQZ"*.
- Ndërkohë Partia Socialiste përgjithësisht i ka qëndruar frymës së funksionimit të një KQZ-je me anëtarë të pavarur duke iu referuar emërimit sipas propozimeve të forcave politike pozitë-opozitë në momentin e parë të ndërtimit të KQZ-së (në tetor 2012), ushtrimin në mënyrë të plotë të mandatit nga anëtari i zgjedhur i KQZ-së pavarësisht pozicionimit në parlament të forcës politike që e pati propozuar, si dhe zëvendësimin e tij me kandidatë të propozuar sipas konfiguracionit pozitë-opozitë të partive politike në momentin e mbarimit të mandatit të anëtarit të KQZ-së.

41 - Kryetari i KQZ-së, z. Klement Zguri, është zgjedhur me vendimin nr. 78/2017 datë 22.05.2017 të Kuvendit të Shqipërisë, për kohën e mbetur të mandatit të ish-Kryetarit z. Denar Biba. Mandati i tij përfundon në datën 03.11.2020.
- Zëvendëskryetari i KQZ-së, z. Denar Biba, është zgjedhur anëtar i KQZ-së me vendimin nr. 79/2017 datë 22.05.2017 të Kuvendit të Shqipërisë, si propozim i Partisë Republikane, me mandat plotësues, duke zëvendësuar z. Klement Zguri. Mandati i mbetur përfundon në datën 29.01.2021. Më pas, më datë 02.06.2017, z. Biba është zgjedhur zëvendëskryetar i KQZ-së me vendim nr. 354 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- Z. Bledar Skënderi është zgjedhur anëtar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me vendimin nr. 112/2018 të Kuvendit të Shqipërisë, pas propozimit nga Partia Socialiste e Shqipërisë. Mandati i tij përfundon në 30.10.2024.
- Znj. Rezarta Bitri është zgjedhur anëtare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me vendimin nr. 111/2018 të Kuvendit të Shqipërisë, pas propozimit nga Partia Socialiste e Shqipërisë. Mandati i saj përfundon në 30.10.2024.
- Znj. Edlira Jorgaqi është zgjedhur anëtare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me vendimin nr. 103/2015 të Kuvendit të Shqipërisë, pas propozimit nga Partia Socialiste e Shqipërisë. Mandati i saj përfundon në 04.12.2021.

42 Dekret nr. 11199, datë 10 qershor 2019, i Presidentit të Republikës së Shqipërisë, *"Për shfuqizimin e Dekretit nr. 10928,*

shfuqizohej dekreti që caktonte 30 qershorin si datë të zgjedhjeve lokale dhe dërgimit të tij zyrtarisht pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, dy anëtarë të Komisionit, përkatësisht nënkryetari z. Biba dhe anëtari z. Skënderi, thirrën një mbledhje të KQZ-së, po atë ditë[43].

Në hapje të saj Kryetari i KQZ-së z. Zguri njoftoi mbërritjen zyrtarisht të Dekretit pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve duke deklaruar se kishte gjetur vështirësi[44] në zbatimin e kërkesës që përmbante Dekreti.
Ai parashtroi qëndrimin e tij duke deklaruar se procesi përgatitor për mbajtjen e zgjedhjeve në datën 30 qershor duhej të ndërpritej, pasi tashmë dekreti i Presidentit e anulonte datën e zgjedhjeve.
Pas bërjes publike të qëndrimit të tij, Kryetari i KQZ-së u largua nga mbledhja.

Katër anëtarët e tjerë[45] të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, deklaruan një qëndrim të kundërt me kryetarin në lidhje me Dekretin e Presidentit, duke e konsideruar këtë të fundit si një akt administrativ absolutisht të pavlefshëm, e që për rrjedhim nuk mund të merrej në konsideratë nga KQZ-ja. Ndaj ajo duhet të vazhdonte punën në funksion të përgatitjes së procesit zgjedhor për zgjedhjet.

---

datë 05.11.2018 të Presidentit të Republikës "Për caktimin e datës së zgjedhjeve për Organet e Qeverisjes Vendore". Dekreti u shpall nga vetë Presidenti i Republikës nëpërmjet një Konference për Shtyp të nisur në ora 8.00 të mëngjesit.

43 Mbledhja u njoftua ditën e hënë datë 10 qershor, rreth orës 10.57 nëpërmjet një email-i zyrtar nga zyra e shtypit e KQZ-së, në të cilën njoftohej se ajo do të mbahej në orën 12.00, ndërkohë që nuk jepej asnjë informacion mbi rendin e ditës të parashikuar për t'u shqyrtuar. Pak para se të fillonte mbledhja, zëdhënësja e KQZ-së njoftoi se mbledhja ishte shtyrë për në ora 14.00. Rreth orës 12.10 ky njoftim u bë zyrtarisht edhe nëpërmjet aplikacionit Whatsapp, por sërish nuk njoftohej asnjë pikë e rendit të ditës që ishte parashikuar të trajtohej në atë mbledhje.

44 Mbledhje e KQZ-së, datë 10.06.2019, Kryetari z. Klement Zguri *"... Unë mendoj se KQZ-ja, unë personalisht por besoj edhe kolegët e mi, duhet t'i bindemi, një dekreti. Të njëjtën gjë kemi bërë edhe kur doli dekreti për të vendosur datën e zgjedhjeve, ... të njëjtën gjë duhet të bëjmë edhe tani. Nuk dua të gjykoj kompetencat e Presidentit, unë nuk jam Gjykatë Kushtetuese. ... Për mua Dekreti i Presidentit është detyrues dhe më duhet që të respektoj vullnetin e tij. Ndërkohë vihem edhe përballë një vështirësie tjetër. ... Kërkesa ime për t'ia dërguar këtë dekret subjekteve zgjedhore, refuzohet. ... Respektimi i ligjeve dhe hierarkisë duhet të jetë ajo që duhet të na orientojë. ... Në këtë kuptim unë nuk e gjej me vend se mundem qetësisht të drejtoj këtë mbledhje të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. ... Në këtë paqartësi të madhe që ka përfshirë vendin tonë, unë jam i detyruar të çohem dhe ndoshta kolegët e mi mund ta vazhdojnë mbledhjen".* Citim nga regjistrimi video i mbledhjes, ora 14:08:45 – 14:16:17.

45 Mbledhja e KQZ-së, datë 10 qershor 2019:
- Zv/Kryetari z. Denar Biba: "... Ky Dekret i dytë, i cili shfuqizon dekretin e nëntorit, për zhvillimin e zgjedhjeve në datën 30 qershor, është një akt administrativ absolutisht i pavlefshëm, në kuptim të nenit 108 të Kodit të Procedurave Administrative ... . Praktikisht dekreti i sotëm bie ndesh me parimin e ligjshmërisë të parashikuar nga neni 4 i Kodit të Procedurave Administrative, ... ai ka diskrecion të caktojë vetëm një datë brenda periudhës zgjedhore, por jo të shkojë përtej kësaj periudhe dhe akoma më keq, sikundër ka ndodhur sot të mos caktojë fare një datë zgjedhjesh. ... Sipas nenit 1 të Kushtetutës, qeverisja bazohet në një sistem zgjedhjesh të lira, të barabarta, të përgjithshme dhe periodike, pra çdo katër vjet, kurse sipas nenit 109 organet përfaqësuese dhe ekzekutive të njësive bazë të qeverisjes vendore zgjidhen çdo 4 vjet. Shfuqizimi i dekretit që përcaktonte datën 30 qershor 2019 si datë për zgjedhjet e organeve vendore është një shkelje e hapur dhe flagrante e parashikimeve të mësipërme kushtetuese dhe ligjore, duke lënë Shqipërinë pa datë zgjedhjesh dhe praktikisht pa proçes zgjedhor. Për këtë arsye në respekt të nenit 110 të Kodit të Procedurave Administrative, akti administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk sjell asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse është konstatuar ose jo si i tillë, ai konsiderohet se nuk ekziston. Çdo subjekt publik apo privat, që ndesh një akt të tillë, nuk i nënshtrohet rregullave të tij dhe nuk e merr parasysh gjatë veprimtarisë së tij. Në respekt të gjithë sa parashtrova më lart, kolegët me siguri do të thonë fjalët e tyre, unë vlerësoj që KQZ ka detyrimin të vijojë me organizimin e zgjedhjeve të datës 30 qershor ... ." Citim nga regjistrimi video i mbledhjes ora 14:16:24 – 14:22:49.
- Anëtarja zj. Rezarta Bitri: "... dhe nëse sot ne kemi një akt i cili është nul, nuk prodhon asnjë pasojë ligjore, nuk ka një efekt juridik, sigurisht që vendimmarrja jonë duhet të jetë e prirur nga ruajtja e seriozitetit të punës sonë, nga ruajtja e ligjshmërisë së vendimmarrjes sonë. ... Në asnjë dispozitë kushtetuese dhe ligjore nuk ka një kompetencë të shprehur të Presidentit të Republikës, i cili të anulojë apo të shtyjë datën e zgjedhjeve. ... Jam tërësisht dhe qartësisht e bindur që nga pikëpamja juridike është një akt nul, pa asnjë pasojë, dhe si i tillë nuk na pengon për të vazhduar më tej procesin e administrimit zgjedhor". Citim nga regjistrimi video i mbledhjes, ora 14:24:20 – 14:31:06.
- Anëtari z. Bledar Skënderi: "...dhe unë jam shumë dakord me kolegët, e konsideroj dekretin e Presidentit një akt nul, ... ne të vazhdojmë për të garantuar zhvillimin e këtyre zgjedhjeve në datë 30 qershor". Citim nga regjistrimi video i mbledhjes, ora 14:31:13 – 14:33:31.
- Anëtarja zj. Edlira Jorgaqi: " ...akti/dekreti për anulimin e datës së zgjedhjeve i dalë në këtë kohë është absolutisht i pavlefshëm, sepse është akt haptazi i paligjshëm, sepse organi përkatës në këtë rast ka ushtruar një kompetencë që ligji nuk ja njeh shprehimisht. ... Jemi në kushtet e një akti administrativ absolutisht të pavlefshëm. ... Për të gjitha sa më sipër KQZ duhet të vijojë punën drejt zgjedhjeve të datës 30 qershor, duke vijuar edhe me shqyrtimin dhe miratimin e akteve, ...". Citim nga regjistrimi video i mbledhjes, ora 14:33:33 – 14:38:17..

Pavarësisht debateve dhe diskutimeve të zhvilluara nga anëtarët e KQZ-së në lidhje me Dekretin e Presidentit, në këtë mbledhje nuk u kërkua dhe nuk u morr një vendim formal nga Komisioni, ku ai të shprehej mbi ligjshmërinë ose jo të Dekretit, zbatimin ose jo të tij, e më pas të vendoste për vijimin e procesit zgjedhor bazuar në një akt të shkruar.

Të gjitha mbledhjet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në vazhdim, që kishin të bënin me përgatitjen e procesit zgjedhor u thirrën nga anëtarët e tjerë të trupës[46].

Kryetari i KQZ-së nuk mori pjesë vetëm në mbledhjen e mëpasshme më datë 12 qershor, të thirrur prej anëtarëve të KQZ-së, por në mbledhjet e tjera në vazhdim mori pjesë, gjithnjë duke bërë publik qëndrimin e tij se nuk do të votonte *"pro"* për asnjë akt administrativ që kishte të bënte me procesin zgjedhor të datës 30 qershor 2019, me përjashtim të vendimeve për akreditimin e vëzhguesve apo gazetarëve, për të cilat deklaroi se do të votonte gjithmonë *"pro"*, me arsyetimin se procesi do të duhej të vëzhgohej nga sa më shumë organizma, në mënyrë që të rritej transparenca e tij.

Dekreti i Presidentit të Republikës nr. 11199 datë 10 qershor 2019, i cili shfuqizonte Dekretin që caktonte 30 qershorin si datë të zgjedhjeve lokale, u publikua në Fletoren Zyrtare të datës 11 qershor 2019[47].

Ky argument u përdor sërish nga Kryetari i KQZ-së për të sjellë në vëmendje të anëtarëve të tjerë të Komisionit ligjshmërinë e dekretit të Presidentit të Republikës.

V.1.1.2. Qëndrimi i trupës së KQZ-së në lidhje me dekretin e Presidentit të Republikës të datës 27 qershor 2019

Me datë 27 qershor 2019, Presidenti i Republikës miratoi Dekretin nr. 11211, me anë të të cilit shpallte datën 13 tetor 2019 si datë të re të zgjedhjeve lokale[48].

Qëndrimi dhe linja e arsyetimit të trupës së KQZ-së, mbetën të njëjtë edhe ndaj këtij Dekreti.

Në parashtrimet e tyre katër anëtarët e KQZ-së deklaruan[49] se KQZ-ja duhet të vazhdonte punën për përgatitjen e procesit zgjedhor, qëndrim i mbështetur tashmë edhe në rezolutën[50] e Kuvendit të Shqipërisë si dhe në vendimin e Kolegjit Zgjedhor[51].

---

46 Bazuar në Nenin 22, pika 1 të Kodit Zgjedhor *"Mbledhjet e KQZ-së thirren nga Kryetari ose të paktën nga dy anëtarë të KQZ-së"*.

47 Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë nr. 84 datë 11 qershor 2019.

48 Presidenti i Republikës, Dekreti Nr. 11211 datë 27.06.2019 *"Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore"*

49 *Mbledhja e KQZ-së, datë 27 qershor 2019: - Anëtarja zj. Rezarta Bitri: "... Ajo që është më e rëndësishme është që sot kemi një vendim gjyqësor ... . sot kemi vetëm një detyrim, të zbatojmë një vendim gjyqësor i cili është i formës së prerë, dhe si i tillë besoj që nuk ka nevojë për komente të mëtejshme". Citim nga regjistrimi video i mbledhjes, ora 18:17:52 – 18:19:49.*
- Anëtarja zj. Edlira Jorgaqi: "Konkretisht jemi në kushtet e ekzekutimit të vendimit të një Gjykate, i detyrueshëm për t'u zbatuar. ... është detyrë e padiskutueshme e KQZ të zbatojë udhërimet e Kolegjit Zgjedhor". Citim nga regjistrimi video i mbledhjes, ora 18:19:55 – 18:20:49.
- Anëtari z. Bledar Skënderi: "... Nga nëntë muajshi e mbrapa, Presidenti i Republikës nuk ka më asnjë lloj tagri të shtyjë, të anullojë, të çdekretojë, të verë datë tjetër, nuk ka më asnjë lloj tagri. ... Janë shpërndarë gjithë fletët e votimit në të gjitha KZAZ-të, në të gjithë Shqipërinë. Çdo gjë është gati. Ditën e diel qytetarët të venë të votojnë, ...". Citim nga regjistrimi video i mbledhjes, ora 18:23:15 – 18:24:21.
- Zv/Kryetari z Denar Biba: "... Gjithë kjo që po ndodh në Shqipëri është një përballje e madhe midis rregullit dhe pazarit. Ose do t'i qëndrojmë ligjeve dhe shtetit të së drejtës, ...(), ose do kthehemi në një situatë parashtetërore, ku do t'i zgjidhim mosmarrëveshjet përmes pazareve, ... Data 30 qershor është ditë shumë e rëndësishme për shqiptarët. Nuk do të shkojnë të votojnë, sepse me patjetër do të kenë kandidatët më të mirë, në fakt në disa bashki do të kenë vetëm një kandidat, fatkeqësisht. Do të shkojnë aty për të treguar se janë pro kushtetutës dhe ligjit, për të respektuar ligjin, shtetin e së drejtës dhe jo pazaret politike". Citim nga regjistrimi video i mbledhjes, ora 18:31:06 – 18:34:57.

50 Rezoluta e Kuvendit

51 Kolegji Zgjedhor, Vendimi nr. 12 datë 24.06.2019.

Ky i fundit i marrë në shqyrtim të kërkesës ankimore[52] të Partisë së Unitetit Kombëtar, në përmbajtje të të cilit merret në shqyrtim dekreti i Presidentit dhe arsyetohet se data 30 qershor është një datë e ligjshme, ndërkohë që ky tagër i njihet Gjykatës Kushtetuese, ndërsa Kolegji Zgjedhor e ka të përcaktuar fushën-objekt të marrjes në shqyrtim prej tij.

Kryetari[53] i KQZ-së, në vazhdimësi të qëndrimit të mëparshëm të tij për zbatimin e dekreteve të Presidentit prej KQZ-së, iu bëri thirrje sërish anëtarëve të tjerë që të reflektonin dhe të pranonin zbatimin e dekretit të ri.

Dekreti nr. 11211 i Presidentit të Republikës për caktimin e datës 13 Tetor si datë për mbajtjen e Zgjedhjeve Lokale nuk është publikuar ende në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë, edhe pse publikimi i Dekretit të Presidentit të Republikës është i detyrueshëm nga ligji[54].

Tre subjekte politike[55] të opozitës së bashkuar që deklaruan publikisht se njohin Dekretin e Presidentit të Republikës që cakton datën 13 tetor si datë të zgjedhjeve lokale, më datën 2 gusht 2019, dorëzuan në KQZ kërkesën "Për fillimin e procedurave për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 13.10.2019".

Pas kësaj kërkese kryetari i KQZ-së thirri mbledhjen e KQZ-së në datën 3 gusht 2019 me rend dite: «Për shqyrtimin e kërkesës paraqitur nga Partia Republikane e Shqipërisë, Partia Agrare Ambjentaliste e Shqipërisë dhe Partia Lëvizja Socialiste për Integrim "Për fillimin e procedurave për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 13.10.2019"".

Në datën dhe orën e njoftuar për këtë mbledhje ishte i pranishëm vetëm kryetari, ndërsa mungonin katër anëtarët e tjerë të KQZ-së, të cilët megjithëse ishin njoftuar, deklaruan, nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të KQZ-së "se ata ishin me leje të zakonshme".
Në kushtet e mungesës së kuorumit, Kryetari i KQZ-së e mbylli mbledhjen pa bërë asnjë koment.

Asnjë prej këtyre tre subjekteve zgjedhore nuk e shfrytëzoi të drejtën e dhënë nga ligji për t'iu drejtuar Kolegjit Zgjedhor për mosmarrje vendimi nga ana e KQZ-së.
Në mbledhjet në vazhdim, kjo kërkesë nuk u soll më në vëmendje prej KQZ-së.

52 Partia e Unitetit Kombëtar (PUK), paraqiti në KQZ kërkesën me objekt *"Për çregjistrim nga zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 Qershor 2019 dhe heqjen e emrit nga fletët e votimit, të Partisë Uniteti Kombëtar"*. Kërkesa u mor në shqyrtim dhe u rrëzua nga KQZ-ja në mbledhjen e zhvilluar po me datë 13.06.2019 me vendimin nr. 836 të KQZ-së. PUK e apeloi këtë vendim të KQZ-së, më datë 14.06.2019 në Kolegjin Zgjedhor.

53 *Kryetari i KQZ-së z. Klement Zguri: "Jemi në një situatë absurdi. ... Meqë po përmendet vendimi i gjykatës. Kush ishte objekti? Një subjekt zgjedhor donte të çregjistrohej nga fleta e votimit. Kjo ishte kërkesa e subjektit dhe kjo u trajtua në Kolegj. ... Ky dekret ka dy orë që ka dalë. Kujt vendimi gjykate i vajti ky dhe u trajtua? ... Janë zgjedhësit, qytetarët shqiptarë që duhet të votojnë të qetë, të qartë, pa këto tensionet ... që vijnë jo për shkakun e tyre ....., por për shkak të një konflikti kaq të madh politik që është ndërmjet palëve. ... unë do t'ju bëj thirrje kolegëve që ndoshta mund të reflektojnë në qëndrimin e tyre për të pranuar Dekretin e Presidentit si të tillë". Citim nga regjistrimi video i mbledhjes, ora 18:24:26 – 18:31:04.*

54 Ligji nr. 78/2014, datë 10.7.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e qendrës së botimeve zyrtare"*, Kreu III *"Botimi në fletoren zyrtare dhe në buletinin e njoftimeve zyrtare"*, Neni 6 *"Fletorja Zyrtare"*, pika 2 germa b *"Në Fletoren Zyrtare botohen: b) dekretet e Presidentit të Republikës së Shqipërisë;"*.

55 Partia Republikane e Shqipërisë (PRSH), Partia Agrare Ambjentaliste e Shqipërisë (PAA) dhe Partia Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI).

V.1.2. Vendimmarrja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Pas dekretimit të datës së zgjedhjeve prej Presidentit të Republikës, me datë 5 Nëntor 2018[56], KQZ-ja nisi punën për përgatitjen e procesit të ardhshëm zgjedhor me miratimin e planit të veprimit.

Në lidhje me administrimin e këtij procesi, KQZ zhvilloi 81 mbledhje dhe miratoi 914 vendime[57], nga të cilat tre vendime për ndryshim udhëzimesh[58] dhe një udhëzim[59].

Përpos përgatitjes dhe administrimit të procesit zgjedhor, nga muaji shkurt deri në maj të vitit 2019 KQZ-ja ka vazhduar paralelisht edhe me procedurat për plotësimin e vakancave të krijuara në Kuvendin e Shqipërisë për shkak të dorëzimit të mandateve nga deputetët e PD dhe LSI, si edhe, verifikimin, në kuadrin e ligjit të dekriminalizimit, për disa kandidate që duhet të zëvendësonin vakancat e krijuara në këshillat bashkiakë.

Votimi në lidhje me vendimet administrative rutinë ishte 5-0[60], ndërkohë që lidhur me çështjet e regjistrimit të kandidateve dhe listave për anëtarë të këshillave bashkiakë, regjistrimit të komisionerëve të propozuar nga PD dhe LSI në KZAZ votimi ishte i ndarë në bllok në 4 me një, ku kjo e fundit ishte e kryetarit të KQZ-së.

V.1.2.1. Ceremonialiteti i mbledhjeve dhe sjellja e trupës

Përgjithësisht konstatohet se seancat e mbledhjeve kanë respektuar ceremonialitetin dhe pjesëmarrja e pesë anëtarëve të trupës ka qenë e plotë thuajse në të gjitha mbledhjet. Megjithatë, shpesh është vërejtur se trupës i ka munguar kolegjialiteti dhe dialogu i ndërsjelltë midis anëtarëve.

Sjellja midis anëtarëve të trupës dhe gjuha e përdorur, në veçanti midis kryetarit e zv/kryetarit e sidomos pas debatit mbi Dekretin e Presidentit të datës 10 qershor, ishte shpesh e papërshtatshme dhe jashtë toneve korrekte institucionale.

Në tërësi, sjellja e KQZ-së vazhdoi të reflektonte ndasinë midis trupës dhe administratës.

Gjatë mbledhjeve evidentohej qartazi se anëtarët e KQZ-së, në pjesën më të madhe të rasteve, njiheshin aty me materialet e mbledhjes dhe dukej se asnjë konsultim apo diskutim paraprak nuk ishte bërë midis hallkave të institucionit në adresim të çështjeve dhe problematikave të hasura.

---

56 Dekret nr. 10928, datë 05.11.2018 i Presidentit të Republikës *"Për caktimin e datës së zgjedhjeve për Organet e Qeverisjes Vendore"*.

57 Nga totali prej 1106 vendimesh të marra gjatë periudhës prej dekretimit të datës së zgjedhjeve deri në shpalljen e rezultatit përfundimtar, 195 vendime kanë qenë jo të lidhura me procesin zgjedhor të 30 qershorit. Konkretisht 12 vendime për verifikim të kandidatëve zëvendësues në këshillat bashkiakë, 133 vendime për shpallje moszgjedhshmërie si deputet në kuvend dhe 46 vendime për dhënie mandati të deputetit në Kuvendin e Shqipërisë. Për më shumë shih Shtojca nr. 2 – Vendimmarrja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

58 Vendimin nr. 22 datë 01.02.2019 i KQZ-së "*Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr.2, datë 29.01.2013 "Për caktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit dhe afatet për publikimin e listave të kandidatëve*".
Vendimin nr. 127 datë 04.04.2019 i KQZ-së "*Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr. 4, datë 19.02.2013 "Për procedurat e përzgjedhjes dhe trajnimit të shtetasve që mund të emërohen kryesisht nga KQZ për plotësimin e vakancës së krijuar në KZAZ dhe KQV*".
Vendimin nr. 153 datë 11.04.2019 i KQZ-së "*Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 1, datë 31.05.2017 "Për përdorimin e materialeve propagandistike dhe vendet për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore*"".

59 Udhëzimi nr. 1 datë 11.04.2019 "*Për procedurën e kontrollit dhe verifikimit të financimeve dhe shpenzimeve të partive politike dhe fushatës zgjedhore.*"

60 Deri në datën 10 qershor 2019, pas së cilës, Kryetari i KQZ-së votoi kundër për të gjithë aktet, përveç atyre që kishin të bënin me akreditimin e vëzhguesve apo gazetarëve.

Madje, në disa raste është konstatuar një sjellje intimiduese dhe jo etike ndaj zyrtarëve të lartë të administratës, ndërkohë që ata paraqisnin përpara trupës çështjet për t'u trajtuar sipas rendit të parashikuar të ditës.

Kjo mënyrë të sjelluri dhe të trajtuari në raport me çështjet dhe administratën, e konstatuar edhe në procese të mëparshme zgjedhore, është jokorrekte dhe aspak në përmbushje të përgjegjësive të marra përsipër, në frymën dhe gërmën e ligjit dhe betimit të bërë përpara përfaqësuesve të popullit.

Trupa e KQZ-së është trupa që drejton, organizon dhe mban përgjegjësi për të gjithë organizimin dhe zhvillimin e procesit, duke patur në dispozicion të saj tërë administratën e KQZ-së.

Angazhimi i trupës është i parashikuar me kohë të plotë për të siguruar funksionimin e institucionit si i tërë në mënyrë organike në të gjitha hallkat, për të ndjekur dhe përballur së bashku tërë sfidat dhe problematikat që hasen.
Trupa e KQZ-së nuk është parashikuar nga ligjvënësi si një trupë e veçuar, me angazhim të pjesshëm, e cila vihet në dijeni të problematikave të institucionit vetëm atëherë kur është e nevojshme vendimmarrja formale e saj. Apo në këtë vendimmarrje, ajo të mjaftohet vetëm në paraqitjen që bën administrata apo edhe të limitohet vetëm në alternativat që kjo e fundit propozon gjatë mbledhjeve, përkundrazi.

Koha në dispozicion për shqyrtim të çështjeve dhe reflektim mbi vendimmarrjen, vetëm gjatë seancës së mbledhjeve është në tërësi e pamjaftueshme për të debatuar e rrahur mendimet për përballimin e duhur të problematikave dhe mirëmenaxhimin e tërë procesit zgjedhor.

Këtë përgjegjësi të lartë ligji dhe parlamenti ia ka deleguar pikërisht anëtarëve të kësaj trupe, dhe jo nëpunësve civilë të administratës.

V.1.2.2. Problematika të vërejtura

Kodi Zgjedhor parashikon që anëtarët e KQZ-së duhet të jenë të paanshëm në vendimmarrjet dhe gjykimet e tyre, por, ashtu si në proceset e mëparshme zgjedhore, në sjelljen dhe qëndrimet e anëtarëve të trupës vazhdoi e u reflektua anësi politike, në përputhje me qëndrimet publike të forcave politike prej nga ata janë propozuar.
Madje, mund të thuhet se në këtë proces u evidentuan sjellje të paprecedenta të anëtarëve të trupës, duke u perceptuar dukshëm në mënyrë të njëanshme, sjellje kjo e vërejtur sidomos tek katër anëtarët e trupës, përjashto Kryetarin e KQZ-së.
Më poshtë paraqiten disa nga vendimmarrjet më problematike të KQZ-së, si vendimmarrje ekstraligjore apo në shkelje të ligjit që KQZ-ja ka ndërmarrë, në gjykimin e KRIIK.

Vendimmarrjet paraqiten në rendin kohor të ndodhjes së tyre dhe paraqiten shkurtimisht, pasi ato janë trajtuar me gjerësisht në sesionet përkatëse sipas kategorizimit të çështjes:

a) Dhënia e mandatit të deputetit jo me shumicë të cilësuar

Në procesin e vendimmarrjes të KQZ-së për zëvendësimin dhe dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit pasues në listën shumëemërore të subjektit PD dhe LSI, në plotësim të vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë, u vërejt se për 16 prej tyre nuk u respektua detyrimi për miratimin e vendimit me shumicë të cilësuar prej pesë votash *"pro"*. Mandati për këta 16 deputetë u dha me një votim të thjeshte vetëm me 4 vota *"pro"*.
Shih për më shumë sesionin: *V.1.6. Plotësimi i vakancave në Kuvend, pas dorëzimit të mandateve nga deputetët e PD dhe LSI*

b) Regjistrimi i partisë "Bindja Demokratike" si subjekt zgjedhor

Më datë 27 prill 2019, KQZ-ja në shkelje flagrante të ligjit mori vendimin e për regjistrimin e subjektit "Partia Bindja Demokratike".

Ky vendim i KQZ-së, përveçse ishte në shkelje të hapur të afatit të përcaktuar nga Kodi Zgjedhor, ishte edhe në kundërshtim me praktikën ligjore të ndjekur nga vetë ajo në Zgjedhjet Parlamentare 2013, në Zgjedhjet Vendore 2015, me praktikën dhe vendimmarrjen e Kolegjit Zgjedhor të vitit 2013, si dhe në kundërshtim edhe me vetë qëndrimin e saj të shprehur në Deklaratën për Shtyp të datës 4 janar 2019.

Theksohet se kjo vendimmarrje shënoi për herë të parë në historikun e vendimmarrjeve *ekstraligjore* të KQZ-së, një vendimmarrje në bllok, në heshtje dhe pa asnjë diskutim apo dhënie argumenti.

Shih për më shumë sesionin: *VII.1. Regjistrimi i partive politike*

c) Regjistrimi i kandidatëve me vërtetim nga Kuvendi

KQZ-ja regjistroi 25 kandidatë të mbështetur nga partitë përkatëse politike duke u bazuar në vërtetimin e lëshuar prej Kuvendit të Shqipërisë se deputetë përfaqësues të këtyre partive mbështetëse e zotëronin mandatin e deputetit të paktën 6 muajt e fundit, sipas parashikimeve në Kodin Zgjedhor.

Ky vërtetim i lëshuar prej Kuvendit të Shqipërisë ishte i pavërtetë, pasi vetë KQZ-ja ishte institucioni që iu kishte dhënë mandatin këtyre deputetëve vetëm disa ditë më parë.

Shih për më shumë sesionin: *VII.2.1. Regjistrimi i kandidatëve me vërtetim nga Kuvendi*

d) Mosbalancimi i anëtarësisë së KZAZ-ve sipas konfiguracionit shumicë-pakicë të parlamentit

KQZ-ja në vendimmarrjen e saj për rrëzimin e kërkesës së PD-së dhe LSI-së për caktimin e anëtarëve të KZAZ-ve, kreu një lexim formal që ia lejon Kodi Zgjedhor duke ia njohur subjektit zgjedhor atributin për të propozuar anëtarësinë e KZAZ-ve.

Nga ana tjetër, duke patur parasysh se Kodi Zgjedhor njeh forcat parlamentare që në kundërbalancim ndërtojnë dhe sigurojnë procesin zgjedhor, KQZ-ja nuk ftoi subjektet zgjedhorë parlamentarë të propozonin anëtarësinë e munguar të KZAZ-ve për ato zona ku kishte garim kandidaturash, duke marrë në shqyrtim dhe amenduar vendimin nr. 18 datë 01.02.2019 të saj, duke shënuar kështu një sjellje me dy standarde.

Shih për më shumë sesionin: *V.2.1.1. Refuzimi i listave të PD dhe LSI për anëtarë dhe sekretarë të KZAZ-ve*

e) Ngritja e Bordit të Monitorimit të Medias

BMM-ja përveçse u ngrit nga KQZ-ja më datë 28 maj, në shkelje ekstreme të afatit ligjor, por, lidhur me procedurën e ndjekur për ngritjen e kësaj trupe evidentohet edhe një sjellje tjetër e paligjshme e anëtarëve të KQZ-së, si dhe e administratës së KQZ-së.

Rezulton se asnjë prej katër emrave të propozuar nga katër anëtarët e KQZ-së, përjashto Kryetarin, nuk figuronte si kandidaturë e propozuar nga ndonjë organizatë e shoqërisë civile që operon në fushën e medias, ndërkohë që katër anëtarët e trupës deklarojnë zyrtarisht të kundërtën, ashtu sikundër edhe zyrtarët e lartë të administratës së KQZ-së.

Shih për më shumë sesionin: *V.1.7.3. Ngritja e Bordit të Monitorimit të Mediave*

f) Kontraktimi i të njëjtit eskpert financiar për dy funksione të ndryshe monitorimi

KQZ-ja, pavarësisht se ligji përcakton dy momente të ndryshme kohore se kur zgjidhen dhe emërohen ekspertët financiarë dhe ekspertët kontabël (apo auditët financiarë), vendosi që eksperti financiar që do të monitoronte shpenzimet e fushatës zgjedhore të një subjekti zgjedhor do të kryente edhe auditimin e shpenzimeve të po të njëjtit subjekt.

Kontraktimi i të njëjtit ekspert për të kryer të dy proceset, veçanërisht në kushtet kur mungojnë mekanizma të tjerë për të bërë transparencë apo kontrolle

shtesë, hoqi kontrollin e dyfishtë që garantonte ligji më parë duke ulur, për rrjedhojë, transparencën ndaj financave të fushatës.
Shih për më shumë sesionin*: IV.7. Financat e subjekteve zgjedhore*

g*) Mosveprimi i KQZ-së për shkeljet alarmante*
të pretenduara në menaxhimin e RKGJC

KQZ-ja, pas vënies në dijeni nga raportimi i një prej auditëve teknicienë se administrimi dhe përpunimi i bazës së të dhënave të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGJC) bëhej jo në përputhje me kërkesat teknike dhe administrative të legjislacionit në fuqi, vetëm e përcolli raportin e auditëve në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, duke mos iu kërkuar shpjegime institucioneve përgjegjëse mbi shqetësimet e ngritura, sikundër Kodi Zgjedhor e ngarkon.

Ky qëndrim i mbajtur, në një situatë kur informimi ndaj publikut mbi ecurinë e procesit të hartimit dhe korrigjimit të listave ishte inekzistent, kompromenton akoma më shumë rolin e KQZ-së.
Shih për më shumë sesionin: *VIII.2. Problematika të evidentuara nga auditët teknicienë*

h) Tjetërsimi i vendimmarrjes së KQZ-së pa e rimarrë në shqyrtim rastin

KQZ-ja, përpos pranimit të kërkesave për akreditim vëzhguesisht jashtë afatit ligjor të parashikuar, më datë 21 qershor 2019 vendosi me votim unanim refuzimin e një kërkese të tillë, pasi organizata kërkuese nuk i plotësonte kriteret ligjore.
Ky vendim refuzimi, ndryshe nga sa u vendos në seancën e mbledhjes, u pasqyrua si i miratuar në njoftimin e mbledhjes që KQZ-ja shpërndau për mediat, si dhe në vendimin e publikuar në faqen zyrtare të internetit.
Shih për më shumë sesionin: *XIV. VËZHGUESIT*

V.1.3. Transparenca e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Mbledhjet e KQZ-së janë të hapura për mediat dhe publikun si dhe transmetohen në kohë reale në faqen e internetit të institucionit. Njoftimet lidhur me thirrjen e mbledhjeve, rendin e ditës si dhe vendimmarrjen e marrë publikohen në faqen e internetit si dhe iu shpërndahen me anë të postës elektronike medias dhe aktorëve të tjerë të interesuar (organizma vendase apo të huaja, parti politike, etj.)
Përpos përmirësimit në disa aspekte lidhur me transparencën e veprimtarisë së KQZ-së, ka ende vend për përmirësim të mëtejshëm dhe për një angazhim e vullnet më të plotë të KQZ-së për përmbushjen e detyrimeve ligjore të parashikuara në funksion të *dhe* për realizimin e një transparence maksimale.

Zgjedhjet e 30 Qershorit vunë në pah problematika të cilat janë evidentuar dhe më parë, ndërkohë që u shënuan disa përvoja të tjera që e dëmtuan imazhin e KQZ-së dhe shënuan hapa pas lidhur me transparencën që duhet të ofrohet.

V.1.3.1. Publikimi i materialeve paraprake të mbledhjeve

Rregullorja e KQZ-së parashikon se për çdo mbledhje të thirrur së bashku me njoftimin e mbledhjes duhet të publikohen në faqen e internetit edhe materialet paraprake të saj[61].

Ky detyrim ligjor jo në çdo rast është respektuar.

61 Rregullore *"Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve"* Neni 19, pika *2 "Në çdo rast së bashku me njoftimin për mbledhjen, në faqen e KQZ-së në internet, publikohen edhe materialet e mbledhjes".*

Për mbledhjet e zhvilluara deri në muajin maj 2019 ka patur një publikim të pjesshëm të tyre në faqen e internetit, ndërkohë që nga gjysma e dytë e muajit maj 2019 e në vazhdim, deri në fund të periudhës që mbulon ky raport, këto materiale nuk janë publikuar për asnjë mbledhje[62].

Materialet paraprake të mbledhjeve iu vendosen në dispozicion përfaqësuesve të partive politike dhe vëzhguesve të huaj në mënyrë të rregullt.

Ndërkohë, kjo nuk ndodh ndaj vëzhguesve vendas në tërësi dhe as atyre "të akredituar" pranë këtij institucioni.

Vëzhguesve të KRIIK këto materiale iu janë vendosur në dispozicion pjesërisht dhe pas kërkesave të përsëritura verbale në vazhdimësi për çdo mbledhje.

V.1.3.2. Publikimi i vendimeve

Kodi Zgjedhor përcakton se vendimet e KQZ-së duhet të publikohen në faqen e internetit të institucionit brenda 24 orëve nga marrja e tyre[63].

Në shumicën e rasteve publikimi i vendimeve është kryer disa ditë pas këtij afati, ndërkohë që vlerësohet se vetëm rreth 20% e vendimeve u publikuan brenda afatit ligjor[64] të parashikuar.

Theksohet se 32 vendime të marra gjatë procesit zgjedhor figurojnë se u publikuan në faqen zyrtare të internetit më datë 14 tetor 2019, pra së paku tre muaj më pas.

Shqetësues mbetet mospublikimi ende i 46 vendimeve të tjera të marra gjatë këtij procesi.

Akoma më shqetësues mbetet fakti se në rendin numëror të njëpasnjëshëm të radhitjes së vendimeve në faqen e internetit, evidentohen kapërcime dhe lënie të numrave bosh[65].

Këto numra nuk përkojnë me asnjë vendim të KQZ-së edhe pas numërtimit apriori të 46 vendimeve ende të papublikuara, apo edhe pas përqasjes së numrit rendor të arritur në vendimmarrjen e fundit me totalin e vendimeve të marra gjatë mbledhjeve të ndjekura në çdo seancë apo të publikuara nëpërmjet njoftimeve të shtypit të shpërndara nga vetë KQZ-ja.

Lidhur me këtë aspekt, ngrihen pikëpyetje të forta se si dhe përse administrata e KQZ-së ka lënë vende bosh në numërtimin e vendimeve të KQZ-së.

V.1.3.3. Transmetimi viziv në kohë reale i mbledhjeve të KQZ-së dhe aksesueshmëria e tyre në vazhdim

Mbledhjet e KQZ-së transmetohen në kohë reale në faqen e internetit të institucionit nëpërmjet përdorimit të shërbimit të kanalit YouTube, i cili ofron midis të tjerash edhe shërbimin e arkivimit të videove me akses të lirë për publikun.

62 Për më shumë shih Shtojca nr. 2 – Vendimmarrja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

63 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 24 *"Vendimmarrja në KQZ"* pika 3 *"Çdo vendim i KQZ-së zbardhet brenda 24 orëve nga marrja e tij. Jo më pak se dy ekzemplarë origjinalë të vendimit ose, sipas rastit, edhe të udhëzimit të KQZ-së, mbahen në arkivin e KQZ-së"*.

64 Për më shumë në lidhje me vendimet e KQZ shih Shtojca nr. 2 – Vendimmarrja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

65 Numrat 123; 124; 752; 753; 754; 755; 848; 938; 952; 958; etj.

Kjo praktikë e ndjekur nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për transmetimin në kohë reale të mbledhjeve, ashtu edhe për arkivimin e videove të mbledhjeve, është vlerësuar si mjaft pozitive në procesin e shkuar zgjedhor.

KQZ-ja ka përdorur dy kanale të ndryshme në YouTube për këtë qëllim. Nga qershori i vitit 2017, deri me datë 6 maj 2019, mbledhjet e KQZ-së transmetoheshin në kohë reale në faqen e KQZ-së dhe ishin lehtësisht të aksesueshme, në çdo kohë në vazhdim, në kanalin e YouTube të quajtur "KQZ CEC"[66].

Ndërkohë prej 7 maj 2019, mbledhjet e KQZ-së nisën të transmetohen në një kanal YouTube i cili ishte përdorur prej këtij institucioni më parë *(hapur në vitin 2016)*, i quajtur "Komisioni Qendror i Zgjedhje Tiranë"[67].

Me vënien në funksionim të këtij kanali të ri, u ndryshua edhe praktika e deriatëhershme e transparencës së ofruar.

Mbledhja që transmetohet është e aksesueshme vetëm "live" gjatë zhvillimit të saj, dhe ndonjëherë deri në momentin e fillimit të një mbledhjeje të re. Pas kësaj materiali video i mbledhjes së re zëvendëson të mëparshmen, e cila fshihet apo bëhet e pamundur për t'u aksesuar prej publikut.

Pamundësia e aksesimit në një kohë të mëvonshme të një mbledhje të caktuar, zhbëri tërë praktikën pozitive të mëparshme të pasjes në dispozicion të publikut të gjerë, por edhe të vetë anëtarëve të KQZ-së, administratës apo aktorëve të tjerë të interesuar, të një arkive video të të gjithë vendimmarrjes së KQZ-së, sjelljes së anëtarëve, artikulimit, interpretimit dhe qendrimit të mbajtur në raport me çështje dhe problematika të ndryshme, etj[68].

Moslejimi i aksesit të publikut në arkivën e videove, në konsideratën e KRIIK, duket se është një veprim i qëllimshëm për të kufizuar transparencën dhe aksesin e publikut.

Për më tepër, theksohet se kjo praktikë u konstatua të nisë menjëherë pasi KRIIK publikoi një Deklaratë[69], më datë 6 maj 2019, në të cilën kritikohej qëndrimi i KQZ-së për regjistrimin e Partisë Bindja Demokratike si subjekt zgjedhor në kundërshtim me ligjin.

Në Deklaratë, për efekt të vërtetimit lirisht prej publikut të provave të sjella, bëheshin referime në regjistrimin video të mbledhjes së datës 27 prill 2019, për sjelljen e KQZ-së, mungesën e koherencës dhe për pasaktësitë në informacionin që administrata e KQZ-së i ofronte trupës së Komisionerëve.

Menjëherë pas publikimit të Deklaratës, në arkivën e kanalit të Youtube "KQZ/CEC" u konstatua se nuk ekzistonin më videot e regjistruara të mbledhjeve të datës 27.04.2019, si dhe të datave 16.04.2019, 18.04.2019, 23.04.2019 dhe 25.04.2019, duke lënë si video të fundit atë të mbledhjes së datës 11.04.2019.
Pas kësaj gjithë transmetimi live i mbledhjeve në vazhdim u transferua në kanalin tjetër të YouTube "Komisioni Qendror i Zgjedhjeve Tiranë".

66 Shih kanalin KQZ CEC. Aktualisht në këtë kanal janë të ruajtura 113 mbledhje, e para e transmetuar në 14 qershor 2017 dhe e fundit në 11 prill 2019.

67 Shih kanalin Komisioni Qendror i Zgjedhjeve Tiranë .

68 Klikimi mbi videot e transmetuara më parë çon në video të cilat janë private, dmth të aksesueshme vetëm nga administratori i kanalit të KQZ-së në YouTube (shih p.sh.. videon e mbledhjes së KQZ-së të datës 27 prill 2019). Kalimi i videove private në platformën YouTube është një parametër i cili mund të ndryshohet lirisht nga përdoruesit dhe jo një kufizim i platformës. Për më tepër që, sikundër përmendet më sipër, KQZ-ja e ka patur më parë praktikën e mbajtjes së një arkive publike, lirisht të aksesueshme për publikun dhe në çdo kohë. Madje, kjo arkivë është e aksesueshme për publikun edhe në momentin e publikimit të këti raporti.

69 KRIIK, Deklarata e datës 6 maj 2019 "*Ruajtja e pavarësisë dhe integritetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, rëndësi jetike për funksionimin e shtetit demokratik dhe ligjor*". Shih footnote nr. 7 dhe nr. 11 për citimet nga arkiva video e KQZ-së.

Praktika e kufizimit të aksesit për publikun në arkivën video të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është në kundërshtim të hapur me frymën e transparencës që ky institucion duhet të tregojë.

KQZ-ja nxitet dhe duhet të bëjë publike të gjitha videot në arkivën e kanalit në YouTube, si dhe të lejojë aksesin e lirë prej publikut të gjerë me synim rritjen e transparencës mbi: ecurinë e procesit, mënyrën e administrimit dhe performancën e institucionit qendror të administrimit, procesin e vendimmarrjes së KQZ-së, sjelljen ligjore, institucionale dhe profesionale të trupës së KQZ-së dhe të administratës së saj.

Theksohet se arkiva video, apo edhe audio, etj, janë një e drejtë e sanksionuar për informacion e çdo qytetari, i cili mund t'i kërkojë lirisht ato, thjesht nëpërmjet një kërkese me shkrim. Në këtë këndvështrim, hapja e kësaj arkive është një standard i kërkuar dhe që duhet të manifestohet edhe në aspekte të tjera të vendimmarrjes së KQZ-së dhe organeve të tjera në varësi, pa qenë e domosdoshme për t'u investuar prej aktorëve me kërkesa zyrtare.
Vetëm një qasje e tillë transparence, respekton dhe nxit besimin e qytetarëve tek ky institucion kaq i rëndësishëm, e rrjedhimisht tek aftësitë dhe mënyra e organizimit të procesit të administrimit të votës dhe vullnetit të qytetarëve.

V.1.3.4. Përdorimi i teknologjisë së informacionit për rritjen e transparencës

Në këto zgjedhje, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve evidentoi një performancë më të ulët në krahasim me zgjedhjet e mëparshme, lidhur me përdorimin e asaj që quhet Sistemi Integral për Menaxhimin e Informacionit të Zgjedhjeve, një platformë informatike e integruar e nisur prej vitit 2011 dhe e përmirësuar gjatë çdo procesi zgjedhor të ndodhur, duke mundësuar më shumë transparencë dhe informacion për publikun, por edhe më shumë lehtësi për menaxhimin e tërë procesit për vetë administratën e KQZ-së.

Në këto zgjedhje nuk u publikua një version i ri i aplikacionit për smartphone "Voto 2017", i cili ishte një risi e mirëpritur në zgjedhjet 2017, pasi përveçse u mundësonte qytetarëve të gjenin qendrën e votimit në smartphone, mundësonte edhe denoncime në kohë reale nga telefoni, si dhe edukimin e zgjedhësve dhe ndjekjen e rezultateve në kohë reale.

Po ashtu, edhe harta interaktive online për qendrat e votimit, sikundër ndodhi në rastin e Zgjedhjeve Parlamentare të vitit 2017[70], nuk u vendos në dispozicion të qytetarëve këtë proces zgjedhor.

V.1.3.5. Aksesi në materialet e publikuara në faqen e internetit

Një pjesë e konsiderueshme e materialeve të publikuara në faqen e KQZ-së, si raportet e ekspertëve financiarë për financat e partive politike dhe të fushatës, raportet e monitorimit të fushatës, apo edhe rezultatet e zgjedhjeve vendosen në dispozicion të publikut në formate të cilët janë të vështirë për t'u përpunuar nga makinat në mënyrë automatike (p.sh. vendosen fotografi të dokumentave të konvertuara në formatin "pdf").

Kjo gjë e vështirëson shumë përpunimin e pavarur të këtyre të dhënave për qëllime krahasimore monitoruese, studimore, apo edhe për përpunimin dhe përgatitjen e informacioneve më të lehta dhe të kuptueshme prej publikut të gjerë.

70 Harta interaktive me qendrat e votimit të vitit 2017 është ende e aksesueshme online, por nuk është rifreskuar me të dhëna.

Nxitet publikimi i sa më shumë të dhënave në lidhje me proceset zgjedhore në format të hapur[71], ndërkohë që theksohet se ky proces nuk kërkon asnjë kosto apo burime njerëzore shtesë nga ana e institucionit.
Një gjë e tillë do të rriste transparencën në mënyrë të konsiderueshme *jo vetëm mbi ecurinë e procesit zgjedhor, por edhe ndaj vetë veprimtarisë së administratës së këtij institucioni.*

V.1.3.6. Transmetimi i rezultateve

Procesi i pasqyrimit dhe i transmetimit të rezultateve paraprake në kohë reale, është një praktikë pozitive e nisur prej vitit 2009, prej aktorëve të shoqërisë civile dhe prej vetë KQZ-së[72], e cila është përdorur më pas gjatë çdo procesi zgjedhor.

Sikundër përvoja ka treguar, realizimi i duhur i këtij procesi jo vetëm informon në kohë reale, dinamikën e lëvizjes së rezultateve paraprake që vijnë drejtëpërdrejtë nga procesi i numërimit, por, gjithashtu, mund të konsiderohet si një valvul sigurie për frenimin apo minimizimin e ndikimit të vullneteve të paligjshëm ndaj ecurisë normale të procesit, duke lehtësuar jo pak tërë procesin e numërimit dhe të shpalljes së rezultateve, nga tensioni dhe presioni politik.

Në fillim të ditës së votimit më datë 30 qershor 2019, u njoftua nga zëdhënësja e KQZ-së, se faqja test e cila do të bënte transmetimin e rezultateve paraprake ishte në testim gjatë ditës dhe do të ishte gati në fillim të procesit të numërimit.

Kjo faqe filloi të bëhej aktive në fillim të procesit të numërimit[73], por gjatë ditës së hënë, një ditë pas zgjedhjeve, publikimi pati probleme, duke u shkëputur për disa orë.

Konstatohet se përvoja e fituar në përdorimin e teknologjisë së informacionit për menaxhimin e këtij procesi publikimi gjatë zgjedhjeve të mëparshme, në këtë proces nuk u përdor siç duhet duke lënë shumë për të dëshiruar mbi nivelin e transparencës së ofruar.

Mënyra e administrimit së këtij procesi shënoi një zhvillim negativ në përvojën e krijuar si dhe ulje të transparencës së institucionit. Kjo sjellje la shteg dhe nxiti opinione spekulative në publikun e gjerë, duke nxitur një qendrim mosbesues të qytetarëve ndaj administrimit të procesit.

V.1.3.7. Mospërputhjet në publikimin e pjesëmarrjes në votime dhe të rezultateve zgjedhore

Mospërputhja e shifrave në lidhje me pjesëmarrjen në zgjedhje gjatë ditës së votimit, rezultoi një problematikë që nxiti reagime të shumta publike dhe akuza nga opozita se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve po manipulonte të dhënat e pjesëmarrjes në zgjedhje në mënyrë fiktive.

---

71 Të dhëna: text, csv, etj.

72 Për herë të parë, KQZ-ja, në Zgjedhjet Parlamentare të 28 qershorit 2009 filloi dhe zbatoi aplikimin e shpalljes në kohë reale të rezultateteve paraprake nga procesi i numërimit të votave.
Po ato Zgjedhje, u aplikua me sukses edhe projekti "Rezultatet direkte të Zgjedhjeve", një bashkëpunim i ECA / KRIIK (Agjensia për Drejtimin e Zgjedhjeve (ECA) dhe organizata KRIIK Albania), mbështetur nga USAID, i cili bazohej sërish në marrjen dhe transmetimin në kohë reale të rezultateve prej grupeve të numërimit të votave dhe KZAZ-së.
Përvoja pozitive e shënuar dhe mirëpritja e kësaj risije prej publikut të gjerë dhe prej vetë aktorëve politikë dhe institucionalë, ndikoi në përmirësimin e ndjeshëm të përdorimit të kësaj metodologjie nga KQZ-ja në procesin zgjedhor të rradhës, të Zgjedhjeve Lokale të 8 majit 2011.

73 Faqja e internetit "test" paraqiti disa grafikë gjatë ditës së zgjedhjeve, ndërkohë që procesi i votimit ishte ende në vazhdim, çka nxiti spekulime nga disa media se rezultati i zgjedhjeve ishte i manipuluar dhe paracaktuar. Kjo situatë evidentoi më së paku neglizhencë dhe mungesë profesionalizimi nga ana e stafit të KQZ-së në lidhje me një çështje shumë të ndjeshme për opinionin publik, veçanërisht në kontekstin ku po zhvilloheshin këto zgjedhje.

Kjo mospërputhje, sipas KQZ-së, erdhi si pasojë e marrjes së informacionit me anë të thirrjeve telefonike, vështirësive të hasura dhe pasaktësisë në dhënien e shifrave prej KQV-ve dhe KZAZ-ve[74].

Llogaritja e pjesëmarrjes së votuesve, sipas KQZ-së, ishte bërë duke u bazuar në të dhënat që KQV-të kishin përcjellë në qendrën e të dhënave pranë KQZ-së. Ndërkohë, referuar raportimeve të vëzhguesve të KRIIK në KZAZ, në një pjesë të konsiderueshme ishin këto të fundit që raportuan shifrat e pjesëmarrjes së votuesve.

Në proceset zgjedhore pararendëse, KQZ-ja ka publikuar disa herë gjatë ditës së zgjedhjeve përqindjen e pjesëmarrjes në fasha të caktuara orare, duke u bazuar në komunikimin me Komisionet Zonale të Administrimit të Zgjedhjeve.

Në datën 30 qershor 2019, KQZ-ja bëri dy deklarata gjatë procesit të votimit në lidhje me pjesëmarrjen[75] dhe një deklaratë të tretë tri orë pas përfundimit të procesit të votimit[76].

Sipas deklarimeve të bëra, të gjitha shifrat mbi pjesëmarrjen e votuesve të publikuara në këto deklarata ishin marrë në rrugë telefonike prej QV-ve dhe jo nëpërmjet sistemit elektronik të KQZ-së, pas hedhjes në të rezultateve të Qendrave të Votimit prej KZAZ-ve, sikurse është bërë në zgjedhjet e mëparshme[77].

Në mbledhjen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të datës 4 korrik 2019, e cila ishte mbledhja e parë e zhvilluar pas përfundimit të procesit të votimit dhe numërimit, trupa e KQZ-së diskutoi në lidhje me situatën e krijuar për shkak të përqindjes së diskutueshme të pjesëmarrjes në votime.

Kryetari i KQZ-së, pas parashtrimit të situatës nëpërmjet shifrave konkrete[78], propozoi që të kishte një hetim administrativ, për të patur një tablo më të qartë mbi gjithë ç'kishte ndodhur.

Gjithashtu, ai propozoi që të mblidheshin në KQZ të gjitha procesverbalet e Qendrave të Votimit.

Kjo kërkesë nuk u aprovua nga pjesa tjetër e trupës së KQZ[79], pavarësisht faktit

74 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Deklaratë e datës 1 korrik 2019 dhe Njoftim për Shtyp, Sqarim për Opinionin Publik, datë 6 korrik 2019.

75 Deklaratë e KQZ, datë 30 qershor 2019, ora 11.00: *"Deri tani pjesëmarrja në votime është: 12%. Kjo është një e dhënë paraprake, e cila ndryshon në bazuar në informacionin që Qendrat e Votimit kanë përcjellë në qendrën e të dhënave në KQZ"*. Ndërkohë, pjesëmarrja sipas Deklaratës së datës 30 qershor, ora 16.00 u deklarua se ishte 15.5%.

76 Deklaratë e KQZ, datë 30 qershor, ora 22.00: *"Sipas të dhënave të raportuara nga Qendrat e Votimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, pjesëmarrja është 21.6%"*.

77 Deklaratë e Kryetarit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve Klement Zguri datë 1 korrik 2019: *"Zgjedhjet e kaluara raportimi është bërë nga qendrat e votimit në sistemin elektronik dhe të dhënat nuk janë transmetuar me telefon siç edhe ndodhi këtë vit. Kjo gjë rrit pasaktësinë lidhur me saktësinë e shifrave të transmetuara"*.

78 Mbledhja e KQZ-së, datë 4 korrik 2019, Kryetari z. Klement Zguri deklaron: "*Për të mbështetur propozimin tim që KQZ-ja duhet të nisë një hetim administrativ kryesisht, nisem nga disa fakte që kanë krijuar problemin ne fjalë. Kemi deklaratën e orës 11.00 të KQZ, pjesëmarrja në votime thotë 12%. Ndërkohë kam tabelat në faqen e KQZ-së, ora 11.00 thotë pjesëmarrja është 6.19%, gati gjysma. Ndërkohë në shifrat e deklaratës të orës 13.00 përqindja është 11.65 % (akoma nuk ka kapur shifrën në reagimin që KQZ bëri në orën 11.00). Ndërkohë, deklarata e zëdhënëses të KQZ, e orës 22.00, 3 orë pasi ka përfunduar procesi, thotë 21.6%. Është e habitshme, më thonë që këtu paskemi dy informacione, njëri sipas Anës (Drejtoresha e Drejtorisë së Komisioneve Zgjedhore) dhe tjetri sipas DTI-së (Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit), se kisha dëgjuar ndonjëherë këtë histori. Rezultati sipas Anës 21.83% sipas DTI-së 24,12%. Jemi në të njëjtën orë që kishim deklaratën 21.6%. Aktualisht që flasim është 24.12%. Kur unë këtu jam i paqartë mendoni publiku sa i paqartë është*".

79 Mbledhja e KQZ-së, datë 4 korrik 2019, zv. Kryetari Z. Denar Biba deklaron: "*Ndryshe nga të gjitha herët e tjera, këtë radhë në fokus u vendos pjesëmarrja dhe jo rezultati. E gjitha kjo është pjesë e një teatri me një synim të qartë për të delegjitimuar këto zgjedhje. Rezultatet në mënyrë konstante është thënë se janë paraprake. Në zgjedhjet e 2017 në orën 20.00 kur u mbyllën qendrat e votimit rezultati i deklaruar nga KQZ-ja një milion e njëqind e shtatëdhjetë e ca mijë ndërkohë që lista finale ka deklaruar një milion e gjashtëqind e ca mijë. Pra një diferencë prej gati 500.000. Kjo nuk i bëri ato zgjedhje të pavlefshme. Unë jam pro që hetimi të fillojë që në krye të herës, që në vitin 2018 kur u largua drejtori i IT së këtij institucioni dhe mbeti vakant për shumë kohë dhe nuk e dimë pse nuk u mbush ky vend. Që nga momenti kur drejtori që u largua tha që programi softëare i vitit 2017 nuk është i përshtatshëm për zgjedhjet lokale, por për zgjedhjet kombëtare. Pra duhej një program i ri. Disa problematika janë të KQZ disa nuk janë të KQZ, për t'i thënë gjërat ashtu siç duhet. Le të bëhet hetimi e le të dalë*

se në parim ishin të gjithë dakord për të zhvilluar një hetim administrativ, në funksion të qartësimit të mëtejshëm të situatës.
Në tërësinë e çështjes, edhe sot mbetet ende e paqartë mënyra se si u mblodhën, përpunuan dhe u publikuan të dhënat mbi pjesëmarrjen në zgjedhje nga administrata e KQZ-së.

Rregullorja e brendshme e këtij institucioni nuk përmban parashikime specifike lidhur me këtë çështje, ndërkohë që bazuar në Udhëzimin e KQZ-së për funksionimin e Qendrës së Votimit[80], sekretari i KQV-së ka për detyrë të njoftojë çdo tri orë KZAZ-në në lidhje me pjesëmarrjen në votim deri në atë çast.

Një mospërputhje tjetër që evidentohet midis publikimeve zyrtare në faqen e internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, lidhet me shifrat e publikuara në dy tabela të ndryshme që paraqesin rezultatet e procesit zgjedhor të 30 qershorit 2019.

Tabela përmbledhëse e rezultateve[81] ka një diferencë prej 70 votash përsa i përket numrit të votave të vlefshme për këshillat bashkiakë, në krahasim më tabelën tjetër që paraqet votat e vlefshme për çdo parti politike në çdo bashki[82].
Nga krahasimi i bërë rezultojnë diferenca në rezultatet e paraqitura për 21 nga 36 partitë politike që kishin paraqitur lista për këshillat bashkiakë[83].

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet t'i kushtojë vëmendje maksimale transparencës në të gjitha fazat e procesit zgjedhor, në mënyrë që të nxisë dhe forcojë besimin e publikut dhe të gjithë forcave politike mbi mirëadministrimin e procesit zgjedhor.
Përpos përmbushjes së plotë dhe në kohë të detyrimeve ligjore aktuale, duhet të adoptohen mekanizma shtesë që të garantojnë rritje të mëtejshme të transparencës, të tilla si: ofrimi i të dhënave të hapura, hapja për publikun e arkivës video të mbledhjeve të KQZ-së, publikimi i regjistrimeve video nga tavolinat e numërimit, publikimi i menjëhershëm i vendimeve të komisioneve zonale të nivelit të dytë dhe atij të tretë, etj.
Në konsideratë duhet marrë edhe transmetimi video në kohë reale i procesit të numërimit (përfshi mjediset e KZAZ-ve dhe tavolinat e numërimit), apo edhe i procesit të votimit.
Me përjashtim të këtij të fundit, gjithë proceset e sipërcituara realizohen tashmë si shërbime të kontraktuara nga KQZ-ja, me fonde publike, vetëm se ato mbeten informacione të vështira për t'u aksesuar nga aktorët e interesuar, ndërsa mbeten të mbyllura për qytetarët dhe publikun e gjerë.

---

gjithçka, unë jam pro tij".
Anëtari i KQZ-së, z. Bledar Skënderi deklaron: "*Doja të përmendja disa shifra, për vëmendje të publikut. Në zgjedhjet e vitit 2017 informacioni i dhënë nga KQZ vetëm për 46.55 % të QV-ve pjesëmarrja ishte 45.17%. Mbasi është miratuar rezultati i përgjithshëm i zgjedhjeve, mesatarja përqindja doli 47.83%. Pra 2.66% marzhi i gabimit. Në këto zgjedhje ne morëm informacion paraprak, 21.6% e kemi nxjerrë ne ditën e zgjedhjeve. Sot përqindja në shkallë vendi është 22.9%, pra 1.3% më shumë se informacioni që kemi deklaruar në datë 30 qershor. Pra dy herë më pak marzh gabimi se para dy vitesh*".
Anëtarja e KQZ-së, zj. Rezarta Bitri deklaron: "*Jam absolutisht pro që hetimi administrativ të kryhet, por do doja të kisha një panoramë më të plotë se si do realizohet dhe ku do bazohet*".
Anëtarja e KQZ-së Zj. Edlira Jorgaqi deklaron: *"Në lidhje me hetimin duhet të paraqitet konkretisht baza ligjore ku e mbështesni, shkeljen konkrete, normën e ligjit që është shkelur, ku do hetohet konkretisht. Gjithçka duhet konkrete, jo hetim në ajër dhe bllokojmë procesin".*

80 Udhëzimi nr. 2/2015 i KQZ-së, datë 04.03.2015 *"Për mënyrën e ngritjes, organizimit dhe funksionimit të qendrës së votimit"* Neni 12, pika 4, germa I: *"Sekretari i KQV-së .... njofton KZAZ-në çdo tre orë pas orës së hapjes së votimit, për numrin e zgjedhësve që kanë votuar deri në atë moment".*

81 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Zgjedhje Vendore 2019 – Tabela Përmbledhëse.

82 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Zgjedhje Vendore 2019 - Të dhëna për Votat e Vlefshme për Këshill ne Rang Vendi.

83 Shtojca nr. 13 - Diferencat mes dy tabelave zyrtare mbi numrin e votave të vlefshme për këshillat bashkiakë.

V.1.4. Ndryshimi i emrit të Kryetarit të Partisë Socialdemokrate në fletën e votimit

Në datën 31 maj 2019, subjekti zgjedhor Partia Socialdemokrate e Shqipërisë (PSD) paraqiti në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për ndryshimin e emrit të kryetarit të partisë në fletën e votimit për zgjedhjet e 30 qershorit. Kërkesa bazohej në dorëheqjen e kryetarit të Partisë Socialdemokrate z. Skënder Gjinushi në datën 15 maj dhe vendimin e këshillit të partisë të marrë më datë 31.05.2019 për emërimin e z. Ëngjëll Bejtja si kryetar i përkohshëm[84] deri në mbajtjen e kongresit të PSD-së.

Në mbledhjen e datës 06.06.2019 të KQZ-së, kjo kërkesë e subjektit zgjedhor u kundërshtua vetëm nga Kryetari i KQZ-së z. Zguri duke argumentuar se ligji nuk e lejon një gjë të tillë, madje KQZ-ja në raste të ngjashme kishte refuzuar çdo ndryshim të mëvonshëm pas regjistrimit të subjekteve zgjedhore, si p.sh.. kërkesat për dorëheqje të kandidatëve, pasi ata ishin regjistruar si të tillë.

Ndërkohë, sipas zv/kryetarit z. Biba dhe anëtares zj. Bitri, kjo situatë ishte e ndryshme në krahasim me rastet e mëparshme dhe duke qenë se nuk kishte ndalime specifike ligjore në lidhje me këtë çështje dhe meqënëse fletët e votimit ende nuk ishin printuar, ndryshimi mund të kryhej. Kërkesa u miratua me katër vota pro, ndërkohë që Kryetari i KQZ-së votoi kundër.

Kodi Zgjedhor përcakton se regjistrimi i partive politike si subjekte zgjedhore kryhet bazuar mbi një vërtetim të lëshuar nga gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë[85], vërtetim i cili përmban edhe emrin e kryetarit të partisë. Kërkesa e Partisë Socialdemokrate për ndryshimin e emrit të kryetarit të Partisë u depozitua në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 3 qershor 2019 dhe gjykata vendosi[86] për pranimin e kërkesës në datën 6 qershor, në të njëjtën datë në të cilën u mbajt edhe mbledhja e KQZ-së[87].

Në vendimin e KQZ-së për pranimin e kërkesës së PSD-së citohet se "... në momentin e miratimit të përmbajtjes së fletës së votimit, gjendja faktike dhe juridike e Partisë Socialdemokrate ka ndryshuar, kryetari i koptuar i partisë tashmë është z. Engjell Bejtja, pasi z. Skënder Gjinushi ka dhënë dorëheqjen[88]."

---

84 Sipas materialeve paraprake të mbledhjes së datës 06.06.2019, rezulton se:
- Z. Skënder Gjinushi, me një shkresë me datë 15.05.2015 me Nr. 1998 Prot të Partisë Socialdemokrate, drejtuar Këshillit Drejtues Kombëtar të saj deklaron se: *"... Kam nderin dhe detyrimin të bëj të njohur përpara jush, vendimin tim të marë sot me datë 15.05.2019, për të dhënë dorëheqjen e parevokueshme nga posti i Kryetarit të Partisë Socialdemokrate, për shkak të kandidimit tim, me 24.05.2019, pranë Asamblesë së Akademisë së Shkencave, për funksionin e Kryetarit të asaj Akademie. ..."*
- Z. Gëzim Musabelliu, Sekretar i Përgjithshëm i PSD, në emër të Këshillit Drejtues Kombëtar me shkresën me Nr.2001Prot të PSD-së datë 31.05.2019, të protokolluar pranë KQZ-së me Nr.5031Prot, datë 31.05.2019, i kërkon KQZ-së zëvendësimin e emrit të z. S. Gjinushi me emrin e personit të kooptuar z. Engjëll Bejtaj. Në kërkesë deklarohet se: *"... Ju bëjmë me dije se me dt.15.05.2019 z. Skënder Gjinushi ka dhënë dorëheqjen e parevokueshme nga posti i Kryetarit të Partisë, për rrjedhojë, ky Këshill në bazë të Statutit të Partisë, ka ngarkuar me këtë detyrë deri në zhvillimin e Kongresit Zgjedhor zv/kryetarin z. Engjëll Bejtaj. ..."*

85 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 64, pika 2 germa a *"Për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor për çdo lloj zgjedhjeje, një parti politike duhet të paraqesë në KQZ: a) vërtetimin që partia është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë;"*.

86 Sipas vërtetimit me Nr.1613/1Prot datë 06.06.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të lëshuar nga Kancelari i kësaj Gjykate rezulton se:
- Vendimi i Këshillit Drejtues Kombëtar i PSD-së për zëvendësimin e kryetarit të partisë mban Nr.2003Prot datë 31.05.2019, pra një numër protokolli të mëvonshëm nga ai i paraqitjes së kërkesës pranë KQZ-së.
- Ky vërtetim në fund të tij mban shënimin *"Ky vendim nuk ka marrë formë të prerë"*.

87 Në njoftimin zyrtar në faqen e internetit të KQZ-së për rendin e ditës të mbledhjes së datës 6 qershor ora 18.00, çështja për ndërrimin e emrit të kryetarit të PSD-së nuk figuron. Po ashtu, nuk figuron edhe në e-mail-in zyrtar të dërguar nga zyra e shtypit të KQZ-së, megjithëse është i orës 16.40 dhe njofton mbledhjen e orës 18.00. E njëjta gjë, edhe në njoftimin e shpërndarë nëpërmjet aplikacionit ëhatsapp vetëm 25 minuta përpara fillimit të mbledhjes. Vetëm në njoftimin e dytë të nisur nëpërmjet aplikacionit ëhatsapp në orën 18.10 kjo çështje figuron në rendin e ditës.

88 Vendim nr. 827, datë 06.06.2019 i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Ky arsyetim nuk është i saktë, duke qenë se Kryetar i ri i Partisë mund të konsiderohej z. Bejtja vetëm pasi vendimi i Gjykatës së Tiranës të kishte marrë formë të prerë dhe vërtetimi i Gjykatës lidhur me gjendjen juridike të PSD-së të përcaktonte emrin e kryetarit të ri të zgjedhur, vërtetim i cili në rastin më të mirë mund të lëshohej vetëm pas kalimit të 15 ditëve, pra më datë 22 qershor, gjithmonë në qoftë se ky vendim i gjykatës nuk do të apelohej në Gjykatën e Apelit.

Qëndrimi i katër anëtarëve të KQZ-së u shfaq dukshëm në kundërshtim me ligjin, praktikën e mëparshme të KQZ-së si dhe nën influencë politike. Ky vendim i KQZ-së duket se u morr për t'i paraprirë mospërdorimit në opinionin publik nga zërat kritikë të faktit se z. Gjinushi ishte zgjedhur Kryetar i Akademisë së Shkencave (ASH) që me datë 24 maj 2019[89], ndërkohë që zyrtarisht do të figuronte edhe si Kryetar i Partisë Socialdemokrate jo vetëm në fletën e votimit më datë 30 qershor, por edhe në rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve që u shpallën më pas më datë 27 korrik 2019. Kjo situatë e paligjshme nuk duhej të ushqente zërat kritikë, të cilët tashmë i kërkonin Presidentit të Republikës për të mos e dekretuar[90] z. Gjinushi si Kryetar të Akademisë së Shkencave, pikërisht për këtë papajtueshmëri.

V.1.5. Procesi i dekriminalizimit

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka një rol kyç në mbrojtjen dhe garantimin e mirëfunksionimit demokratik të Kuvendit dhe organeve të qeverisjes vendore nga ndikimi apo pjesëmarrja në politikëbërje dhe/ose vendimmarrje i personave të zgjedhur ose që kandidojnë për deputetë apo në organet e qeverisjes vendore, të cilët janë dënuar apo ndaj të cilëve janë marrë masa sigurie, ose janë dënuar me vendim jopërfundimtar për kryerjen e krimeve, sipas parashikimeve të Ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen apo ushtrojnë funksione publike"[91] *(i ashtuquajturi ligji i dekriminalizimit)*, si dhe të Vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë[92].

Ky proces nisi të kryhej prej KQZ-së, përsa i takon sferës së saj të veprimit, menjëherë pas miratimit të ligjit ndaj të gjithë të zgjedhurve në Kuvend dhe në organet e qeverisjes vendore e më pas ndaj të gjithë kandidatëve për deputet të regjistruar në zgjedhjet e përgjithshme parlamentare të vitit 2017. Procesi zgjedhor i 30 qershorit shënon aplikimin për herë të parë të këtij ligji ndaj kandidatëve të regjistruar në një proces të përgjithshëm zgjedhor për organet e qeverisjes vendore.

V.1.5.1 Ecuria e procesit të dekriminalizimit deri më datë 30 qershor 2019

Aktiviteti i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, përgjatë vitit 2018 e deri në dekretimin e datës së zgjedhjeve prej Presidentit të Republikës u përqendrua kryesisht në funksionet që rrjedhin nga Ligji "Për garantimin e integritetit të personave që

89 Kryetari i PSD-së z. Gjinushi ishte prej kohësh anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (ASH) dhe ishte kandidaturë e vetme për t'u zgjedhur si Kryetar i saj. Ndërkohë që referuar ligjit dhe rregullores së ASH-së, nuk lejohet anëtarësia në ASH në qoftë se je anëtar i një force politike. Akademia e Shkencave prej më shumë se një viti është në diskutime të forta edhe në opinionin publik lidhur me mënyrën e funksionimit dhe të organizimit të saj dhe lidhur me ligjin e ri tashmë të miratuar në mënyrë unilaterale nga maxhoranca socialiste. Zgjedhjet e shumë diskutuara për Kryetar të ASH-së u shpallën më datë 26.02.2019 dhe u zhvilluan më datë 24.05.2019. Në këto zgjedhje u zgjodh z. Skënder Gjinushi, si kandidaturë e vetme, megjithëse figuronte ende zyrtarisht si Kryetar i Partisë Socialdemokrate të Shqipërisë.

90 Dekreti nr. 11223, datë 12.07.2019, i Presidentit të Republikës së Shqipërisë *"Për refuzimin e emërimit të akademikut Skënder Gjinushi si Kryetar i Akademisë së Shkencave"*

91 Ligji nr. 138/2015 datë 17.12.2015*"Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"*, Neni 10 *"Veprimet e organeve kompetente kur verifikohen kushtet e ndalimit"*.

92 Vendimi nr. 17/2016, datë 04.03.2016 i Kuvendit të Shqipërisë, *"Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike""*, Kreu V *"Procedura e Realizimit të verifikimit"*.

zgjidhen, emërohen apo ushtrojnë funksione publike". Si rezultat i vendimmarrjes së KQZ-së, u shpall përfundimi i parakohshëm i mandatit të deputetit për dy deputetë të Kuvendit të Shqipërisë, z. Gledion Rehovica[93] dhe z. Aqif Rakipi[94].

Për këto dy vendimmarrje, në faqen zyrtare të internetit të KQZ-së, deri më sot vazhdojnë të figurojnë të publikuara vetëm vendimet e shkurtuara në lidhje me këto dy çështje. Të dy ish deputetët e ankimuan vendimin e KQZ-së pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e cila në përfundim të gjykimeve, la në fuqi vendimet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Gjithashtu, gjatë periudhës janar 2018 deri në maj 2019 KQZ-ja kreu verifikimin e formularit të vetëdeklarimit për 94 kandidatë të listave shumëemërore nga 40 Këshilla Bashkiakë nëse kishte dhëna që hynin në sferën e ndalimit sipas parashikimeve të ligjit të dekriminalizimit nr.138/2015. Nëpërmjet 28 vendimeve të marra, KQZ-ja autorizoi Këshillat Bashkiakë përkatës për vazhdimin e procedurave për dhënien e mandatit të këshilltarit kandidatëve në plotësim të vakancave të krijuara.

V.1.5.2. Ecuria e procesit të verifikimit të kandidatëve në funksion të zgjedhjeve të 30 qershorit

Me synim rakordimin më të mirë të punës dhe ndërveprimit me Prokurorinë e Përgjithshme veçanërisht përsa i takon verifikimeve të të dhënave të kandidatëve në funksion të ligjit të dekriminalizimit, në datën 12 mars 2019 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nënshkroi me këtë institucion një memorandum bashkëpunimi.

Në zbatim të procedurave të parashikuara të verifikimit të vetëdeklarimeve të kandidatëve për organet e qeverisjes vendore, KQZ-ja bashkëpunoi ngushtë dhe përgjithësisht në mënyrë efikase me Zyrën e Gjendjes Civile dhe Zyrën e Gjendjes Gjyqësore, pavarësisht afateve të ngushta kohore dhe numrit relativisht të madh të kandidatëve të paraqitur për regjistrim.

Si rrjedhojë e këtij procesi verifikimi, iu refuzua kërkesa për të kandiduar një kandidati për kryetar bashkie[95] si dhe 11 kandidatëve për anëtarë të këshillave bashkiakë, të cilët ishin paraqitur nga 10 subjekte politike[96].

Procesi i verifikimit dha rezultate edhe gjatë vendimmarrjes në Kolegjin Zgjedhor lidhur me shpërndarjen e mandateve për anëtarët e këshillave bashkiakë. Kolegji Zgjedhor refuzoi dhënien e mandatit për dy kandidatë fitues[97] për shkak të

93 Vendimi nr. 3, datë 05.01.2018 i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, "*Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të prokurorisë së përgjithshme për funksionarin publik z. Gledjon Rehovica, me detyrë deputet i Kuvendit të Shqipërisë, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike*".

94 Vendimi nr. 4, datë 05.01.2018 i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, "*Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të prokurorisë së përgjithshme për funksionarin publik z. Aqif Rakipi, me detyrë deputet i Kuvendit të Shqipërisë, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike*".

95 Z. Dhionisios Alfred Petro Beleri, kandidat për Kryetar Bashkie në Himarë.

96 Partia Komuniste, Partia Kristian Demokrate, Partia Bindja Demokratike, Partia Ora e Shqipërisë, Partia e Reformave Demokratike Shqiptare, Partia Socialiste e Shqipërisë, Partia e Gjelbër, Partia Ardhmëria Shqiptare, Partia Aleanca Demokristiane dhe Partia Socialiste e Moderuar.

97 Kolegji Zgjedhor, Vendimi nr. 19 datë 22.07.2019. Lidhur me shpërndarjen e mandateve për Këshillin e Bashkisë Ura Vajgurore, Qarku Berat, thuhet se: *"Kandidati i parë i listës së Partisë Socialdemokrate të Shqipërisë, Z. Ramadan Baho, është deklaruar fajtor me vendim te formës se prerë për veprën penale të mashtrimit parashikuar nga neni 143/2 a i KP. Vepra penale "Mashtrim", parashikuar nga neni 143, paragrafi 2 i K.P e dhe koha e dënimit me 4 (katër) vjet burgim përfshihet, në fushën e ndalimit të ushtrimit të funksionit, të parashikuar të nenit 2, pika 1, germa "c" e ligjit nr. 138/2015. Ky shtetas përfshihet brenda periudhës së ndalimit të përcaktuar në nenin 4 të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".*
Kolegji Zgjedhor, Vendimi nr. 66 datë 27.06.2019. lidhur me shpërndarjen e mandateve për Këshillin e

përfshirjes së tyre në sferën e ndalimit të kandidimit për shkak të dekriminalizimit.

Është për tu theksuar se njëra nga vendimmarrjet e Kolegjit Zgjedhor, konkretisht ajo për z. Ramadan Baho, lidhet me një dënim të cilin kandidati e kishte deklaruar në formularin e vetëdeklarimit[98] të depozituar pranë KQZ-së.

Është e paqartë se si administrata e KQZ-së, për listën e Partisë Socialdemokrate, kandidati i parë i së cilës është z. Baho, ka deklaruar se "asnjëri prej tyre nuk ka deklaruar të dhëna që ka të bëj me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015" duke konstatuar më pas se "nga verifikimi i të dhënave vetëm në formularët e vetëdeklarimit për personat e shënuar në listët shumemërore të dhënat e tyre nuk përbëjnë kusht për mosregjistrimin si kandidatit për këshillin e bashkisë, sipas ligjit nr. 138/2015"[99].

Ky fakt ngre pikëpyetje mbi kujdesin dhe seriozitetin e ushtruar nga administrata e KQZ-së, e cila ka detyrim ligjor verifikimin me kujdes të çdo formulari vetëdeklarimi dhe shqyrtimin e veprave penale të deklaruara, nëse ka, dhe nëse ato hyjnë në sferën e ndalimit të ligjit të dekriminalizimit.

V.1.5.2.1. Dorëzimi dhe publikimi i formularëve të vetëdeklarimit

Sipas udhëzimit të KQZ[100] dhe Vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë[101], formularët e vetëdeklarimit, depozitohen në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, nga subjekti politik që propozon kandidatët për kryetarë bashkie apo për anëtarë të këshillave bashkiakë.

Referuar udhëzimit të KQZ-së formulari i vetëdeklarimit, duhet të plotësohet në mënyrë të qartë me kompjuter dhe të nënshkruhet në çdo fletë nga kandidati. Përmbushja e këtij detyrimi ligjor për mënyrën e plotësimit të formularit siguron shmangien e gabimeve të mundshme në shkrim apo lexim, si dhe heqjen e mundësisë për të shtuar apo korrigjuar të dhëna në një kohë të mëvonshme. Në këtë mënyrë sigurohet mos fillimi i një procesi verifikimi mbi bazën e të dhënave të pasakta, e për rrjedhojë edhe mos përfundimi i tij në konkluzione të pasakta.

Bashkisë Has, Qarku Kukës, thuhet se: *"... duke qene se kushtet për ndalim e moskandidimit verifikohen pas shtypjes së fletëve të votimit dhe para shpalljes së rezultateve, referuar ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritet të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", nenit 10, pika 1, germa c/iv, Kolegji Zgjedhor shpall fitues nga lista shumemërore kandidatin vijues në renditje dhe në përputhje me kuotën gjinore, si dhe shpall faktin e moskandidimit dhe moszgjedhshmërisë për kandidatin z. Jahir Ismail Cahani. Kolegji Zgjedhor shpall fitues nga lista shumemërore e Partisë Aleanca Demokratike e Shqipërisë, kandidatin për anëtar në Këshillin Bashkiak Has, me numër rendor 02."*

98 Formulari i vetëdeklarimit i z. Ramadan Baho.

99 Vendimi nr. 597, datë 19.05.2019 i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, *"Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatëve të listave shumemërore për Këshillat Bashkiak, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019". (numri rendor 45 në Lidhjen 1* të vendimit).

100 Udhëzimi nr.2, datë 29.01.2013 i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, "*Për caktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit dhe afatet për publikimin e listave të kandidatëve*", ndryshuar me Vendimin nr.44 datë 17.02.2017 *"Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 2, datë 29.01.2013 "Për caktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit dhe afatet për publikimin e listave të kandidatëve"* dhe Vendimin nr.22 datë 01.02.2019 *"Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 2, datë 29.01.2013 "Për caktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit dhe afatet për publikimin e listave të kandidatëve ".*

101 Vendimi nr. 17/2016, datë 04.03.2016 i Kuvendit të Shqipërisë, "*Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"*".

Nga monitorimi i bërë rezultoi se, në kundërshtim me këtë detyrim ligjor, 15 prej kandidatët[102] për kryetarë bashkie kanë dorëzuar në KQZ formularë vetëdeklarimi të plotësuar me shkrim dore.
Sa i përket plotësimit të formularëve të vetëdeklarimit të kandidatëve për anëtarë të Këshillave Bashkiakë, të cilët dorëzohen në KQZ prej subjekteve zgjedhore që i propozojnë, nga një këqyrje jo sistematike, rezulton se 32 parti politike[103] kanë dorëzuar në KQZ së paku një formular të plotësuar me shkrim dore.

Ndërkohë lidhur me 4 partitë e tjera të mbetura (nga 36 që morën pjesë në zgjedhje), rezulton se formularët e vetëdeklarimit për kandidatët e dy prej tyre[104] nuk janë të aksesueshme në faqen e internetit të KQZ-së, ndërsa ato të dy partive të tjera[105] rezultojnë se janë të plotësuara në mënyrë korrekte me kompjuter, megjithëse në disa prej formularëve, në pjesën e dytë të tyre, shënjimi i kuadrateve është bërë me shkrim dore.

Të gjithë formularët e vetëdeklarimit të kandidatëve për organet e qeverisjes vendore janë të publikuar në faqen e internetit të KQZ-së[106].

Megjithatë, ende në momentin e publikimit të këtij raporti, formularët e vetëdeklarimit të kandidatëve të Partisë Aleanca e Maqedonasve për Integrim Europian për anëtarë të Këshillit Bashkiak në Pustec dhe të kandidatëve të Partisë së Pajtimit Kombëtar Shqiptar për anëtarë të Këshillit Bashkiak në Kukës, rezultojnë të jenë të paaksesueshëm, megjithëse administrata e KQZ-së është vënë në dijeni prej muajsh për këtë problematikë.

102 - Kandidatja e Partisë Socialiste (Koalicioni ASHE) znj. Majlinda Bufi, Bashkia Roskovec; - Kandidati i Partisë Komuniste z. Jashar Elezi, Bashkia Belsh; - Kandidatët e Partisë Bindja Demokratike: Z. Edison Hasanaj, Bashkia Tropojë; z. Arben Pohumi, Bashkia Shijak; z. Bledar Sinella, Bashkia Kavajë; z. Edmond Piroli, Bashka Kurbin; z. Fatjon Feka, Bashkia Kolonjë; z. Gëzim Malka, Bashkia Tepelenë; z. Ilir Balla, Bashkia Bulqizë; z. Marildo Hodaj, Bashkia Selenicë; z. Pjerin Spathari, Bashkia Malësi e Madhe; z. Robert Brahaj, Bashkia Mallakastër; z. Salvador Kaçaj, Bashkia Lezhë; znj. Valbona Mezini, Bashkia Vlorë; z. Ylber Gjeta, Bashkinë Kamëz.

103 Partia Aleanca Arbnore Kombëtare, Ardian Gjoka, kandidat për Këshillin e Bashkisë Tiranë; Partia Aleanca Demokratike Shqiptare, Donika Qafa, kandidate për Këshillin e Bashkisë Tiranë; Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë, Erald Gjoka, kandidat për Këshillin e Bashkisë Tiranë; Partia Aleanca Kuq e Zi, Frederik Ruço, kandidat për Këshillin e Bashkisë Tiranë; Partia Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane, Bashkim Hasa, kandidat për Këshillin e Bashkisë Librazhd; Partia Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet, Ridvan Hajdini, kandidat për Këshillin e Bashkisë Himarë; Partia Ardhmëria Shqiptare, Klaudja Traja, kandidate për Këshillin e Bashkisë Durrës; Partia Balli Kombëtar, Violeta Marku, kandidate për Këshillin e Bashkisë Tiranë; Partia Bashkimi Liberal Demokrat, Mario Goga, kandidat për Këshillin e Bashkisë Tiranë; Partia Bindja Demokratike, Fabian Topollari, kandidat për Këshillin e Bashkisë Tiranë; Partia Demokracia e Re Europiane, Isa Toskaj, kandidat për Këshillin e Bashkisë Pukë; Partia Demokracia Sociale, Enver Manoku, kandidat për Këshillin e Bashkisë Devoll; Partia Demokrate për Integrim e Prosperitet, Arbër Cakaj, kandidat për Këshillin e Bashkisë Tropojë; Partia Fryma e Re Demokratike, Andi Seferi, kandidat për Këshillin e Bashkisë Tiranë; Partia e Gjelbër, Keida Ushtelenca, kandidate për Këshillin e Bashkisë Tiranë; Partia e Reformave Demokratike Shqiptare, Bardhyl Karabrahimi, kandidat për Këshillin e Bashkisë Tiranë; Partia e të Drejtave të Mohuara, Rilina Vata, kandidate për Këshillin e Bashkisë Tiranë; Partia G99, Odeta Shehi, kandidate për Këshillin e Bashkisë Tiranë; Partia Kombëtare Konservatore Albania, Arben Boci, kandidat për Këshillin e Bashkisë Pukë; Partia Komuniste e Shqipërisë, Liri Elezi, kandidat për Këshillin e Bashkisë Belsh; Partia Kristian Demokrate, Gerold Doce, kandidat për Këshillin e Bashkisë Tiranë; Partia Lëvizja Punëtore Shqiptare, Tahir Tahiraj, kandidat për Këshillin e Bashkisë Tropojë; Partia Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen, Jorgo Kosta, kandidat për Këshillin e Bashkisë Finiq; Partia Ora e Shqipërisë, Klajdi Terpollari, kandidat për Këshillin e Bashkisë Tiranë; Partia për Liri Demokraci dhe Etikë, Nazlie Domi, kandidate për Këshillin e Bashkisë Kukës; Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve, Arbesa Duraku, kandidate për Këshillin e Bashkisë Kukës; Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve, Syrja Xhako, kandidat për Këshillin e Bashkisë Këlcyrë; Partia Socialdemokrate e Shqipërisë, Maksi Vlashi, kandidat për Këshillin e Bashkisë Himarë; Partia Socialiste e Moderuar, Lorenc Peti, kandidat për Këshillin e Bashkisë Tiranë; Partia Socialiste e Shqipërisë, Albina Nanaj, kandidate për Këshillin e Bashkisë Tiranë; Partia Socialpunëtore Shqiptare, Themistokli Prifti, kandidat për Këshillin e Bashkisë Himarë; Partia Unitetit Kombëtar, Edmond Gjinari, kandidat për Këshillin e Bashkisë Himarë.

104 Partia Aleanca e Maqedonasve për Integrim Europian, lista shumëemërore e kandidatëve për këshillin e Bashkisë Pustec dhe Partia e Pajtimit Kombëtar Shqiptar lista shumëemërore e kandidatëve për këshillin e Bashkisë Kukës.

105 Partia Personat me Aftësi të Kufizuar, lista shumëemërore e kandidatëve për këshillin e Bashkisë Pogradec; Partia Emigracioni Shqiptar, lista shumëemërore e kandidatëve për këshillin e Bashkisë Këlcyrë.

106 Formularët e dekriminalizimit të kandidatëve për organet e qeverisjes vendore, Zgjedhjet Lokale 2019.

V.1.5.2.2. Procesi i dekriminalizimit pas përfundimit të zgjedhjeve të 30 qershorit

Procesi i verifikimit dhe i autorizimit të Këshillave Bashkiake për zëvendësimin e vakancave në përbërje të tyre, ka vijuar edhe pas konstituimit të këshillave të rinj bashkiakë të dalë pas procesit zgjedhor të 30 qershorit 2019. Në 5 mbledhje të zhvilluara pas shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve, KQZ-ja, pas verifikimit të bërë, shqyrtoi dhe miratoi 4 projektvendime nëpërmjet të cilave, autorizoi 43 këshilla bashkiakë për zëvendësimin e 103 anëtarëve të tyre, vendet e të cilëve i ishin njoftuar KQZ-së si vende vakante. Vlen të theksohet se në vetëm gjashtë muaj nga momenti i konstituimit të Këshillave Bashkiakë, këto ndryshime janë bërë në rreth 70 % të këshillave bashkiakë.

Në raport me ligjin e dekriminalizimit dhe përshtatshmërinë e figurave të kryetarëve të rinj të zgjedhur, Partia Demokratike ka denoncuar gjatë kësaj periudhe 6 Kryetarë të Bashkive[107], duke i akuzuar ata se nuk mund të ushtrojnë funksione publike, pasi përfshihen në sferën e ndalimit të ligjit.

Denoncimet janë shoqëruar me fakte të pretenduara dhe i janë referuar për hetime të thelluara Prokurorisë së Përgjithshme.

Kjo e fundit ka kërkuar zyrtarisht prej KQZ-së kopje të formularëve të vetëdeklarimit për të gjithë kryetarët e akuzuar dhe, deri më tani, ka njoftuar përfundimin e hetimeve vetëm për njërin prej tyre, kryetarin e bashkisë Vorë.

V.1.5.2.2.1. Kandidati për Kryetar i Bashkisë Shkodër

Pas shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve, Partia Demokratike bëri publike të dhëna lidhur me ndalimin për kandidim në kuadër të ligjit të dekriminalizimit, për kryetarin e zgjedhur të Bashkisë Shkodër, z. Valdrin Pjetri. Sipas këtyre të dhënave z. Pjetri figuron "i dënuar me burg në Itali për trafik droge" ndaj si i tillë atij i "ndalohet nga ligji i dekriminalizimit të ushtrojë funksion publik"[108].

Në formularin e vetëdeklarimit[109] të dorëzuar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, rezulton se nuk janë deklaruar faktet e pretenduara nga Partia Demokratike. Nga ana tjetër, edhe pas verifikimit të kryer prej KQZ-së, mbi bazën e të dhënave të marra nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, z. Pjetri nuk figuron të jetë në kushtet e ndalimit të kandidimit.

Në vendimin e KQZ-së[110], ndryshe nga praktika e ndjekur në vendimmarrje të ngjashme, nuk përmendet fakti nëse është dërguar kërkesë e më pas nëse është marrë ose jo përgjigje prej Zyrës së Gjendjes Civile.

Pas publikimit të akuzave të sipërpërmendura, në datë 15 gusht 2019, përpara se të kryente betimin dhe të merrte zyrtarisht mandatin e kryetarit të bashkisë, z. Pjetri u tërhoq nga marrja e mandatit.

Pas situatës së krijuar, Prefekti i Qarkut Shkodër i ka dërguar letër zyrtare Presidentit të Republikës ku e njofton për konstituimin e Këshillit Bashkiak Shkodër, zgjedhjen e kryetares së tij, si dhe për paraqitjen e dorëheqjes së z. Pjetri nga mandati i kryebashkiakut e rrjedhimisht krijimin e vendit vakant të Kryetarit të Bashkisë Shkodër[111].

107 Bashkia Shkodër, Bashkia Vorë, Bashkia Mat, Bashkia Vau Dejës, Bashkia Mallakastër dhe Bashkia Librazhd.

108 Deklaratë e Partisë Demokratike, datë 13 gusht 2019 *"Valdrin Pjetri i dënuar me burg në Itali për trafik droge, ndalohet nga ligji i dekriminalizimit të ushtrojë funksion publik"*.

109 Formulari i Vetëdeklarimit të Z. Valdrin Pjetri.

110 Vendimi nr. 354, datë 15.05.2019 i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, *"Për regjistrimin e kandidatit për kryetar të Bashkisë Shkodër të propozuar nga koalicioni "Aleanca për Shqipërinë Europiane" z. Valdrin Luigj Pjetri për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2019"*.

111 Shkresa me Nr.4/62prot, dt. 21.08.2019 e Prefektit të Qarkut Shkodër z. Çesk Millja me lëndë *"Njoftim për*

Legjislacioni parashikon dekretimin e datës së zgjedhjeve nga Presidenti i Republikës brenda 48 orësh nga data e njoftimit. Kjo situatë nxori edhe njëherë në pah ngërçin politik e institucional si dhe përplasjet institucionale në kontekstin e së cilës u krye procesi i 30 qershorit, ashtu sikundër u vu në ngërç[112] tërë mekanizmi ligjor e institucional i parashikuar për zgjidhjen e situatës kur ka një vend vakant të Kryetarit të Bashkisë.

Aktualisht Bashkia Shkodër vazhdon të drejtohet nga kryetarja e zgjedhur në vitin 2015, znj. Voltana Ademi, e cila do të ushtrojë detyrën deri në betimin e kryetarit pasardhës[113].

V.1.5.2.2.2. Kryetari i Bashkisë Vorë

Formulari i vetëdeklarimit[114] të kandidatit për Kryetar të Bashkisë Vorë z. Agim Kajmaku u verifikua nga KQZ-ja përpara regjistrimit të tij si kandidat për Kryetar të Bashkisë Vorë.

Nga verifikimi i bërë rezultoi se z. Kajmaku nuk kishte deklaruar asnjë të dhënë që t'a përfshinte atë në sferën e ndalimit të kandidimit, bazuar kjo në përgjigjen e Zyrës së Gjendjes Gjyqësore sipas së cilës ai rezultonte i padënuar. Ndërkohë që në kohën e marrjes së vendimit Zyra e Gjendjes Civile nuk i kishte kthyer ende përgjigje KQZ-së.

Në këto kushte KQZ-ja vendosi[115] autorizimin e KZAZ-së nr. 26 në Bashkinë Vorë që të kryente regjistrimin e kandidatit të propozuar prej Koalicionit Aleanca për Shqipërinë Europiane.

Pas marrjes së detyrës prej kryebashkiakut Kajmaku, Partia Demokratike bëri publike disa akuza[116] që e përfshinin atë në sferën e ndalimit të ushtrimit të detyrës për shkak të ligjit të dekriminalizimit. Partia Demokratike iu drejtua gjithashtu me një letër zyrtare[117] Prokurorisë së Përgjithshme ku i kërkonte hetim të thelluar për rastin. Z. Kajmaku reagoi publikisht[118] duke mohuar çdo akuzë të ngritur ndaj tij.

Pas kryerjes së hetimeve, Prokuroria e Përgjithshme i dërgoi një shkresë zyrtare[119] Partisë Demokratike ku i njoftonte përfundimin e hetimeve[120] për kryetarin e Bashkisë së Vorës.

---

konstituimin e këshillit bashkiak Shkodër". Shih shkresën e publikuar tek gazeta *"Shqiptarja.com".*

112 Prefekti, i cili njeh të rregullt procesin e 30 qershorit, njofton Presidentin e Republikës, për të iniciuar dekretimin prej tij të datës së zgjedhjeve të pjesshme në Bashkinë Shkodër. Presidenti, që nuk e njeh atë proces, kishte dekretuar tashmë datën 13 tetor 2019 si datë për zgjedhje të përgjithshme lokale, ndërkohë që ky dekret nuk është botuar në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

113 Ligji Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"*, Neni 60 *"Mandati i kryetarit të bashkisë"*, pika *"4. Ushtrimi i mandatit të kryetarit të bashkisë fillon në çastin kur bën betimin dhe përfundon kur bën betimin kryetari pasardhës."*

114 Formulari i Vetëdeklarimit të z. Agim Kajmaku

115 Vendimi nr. 470, datë 17.05.2019 i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, *"Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për kryetar Bashkia Vorë, z. Agim Kajmaku në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".*

116 Deklaratë e Partisë Demokratike datë 27.08.2019 e publikuar në faqen zyrtare të internetit të PD-së: *"PD publikon dokumentin e ri nga sistemi TIMS. Jorgo Toto, i arrestuar në Greqi në 2003 dhe në kërkim sot e kësaj dite, është Agim Kajmaku i Bashkisë së Vorës".*

117 Kërkesë nr. 125 Prot. Datë 20.08.2019, lënda *"Kërkesë për verifikim të pastërtisë së figurës së shtetasit Agim Kajmaku alias Jorgo Toto"*, të publikuar në portalin *"Realstory".*

118 Reagimi i z. Agim Kajmaku datë 22 gusht 2019 i publikuar në faqen e internetit të televizionit kombëtar *"TopChannel": "Po, kam ndryshuar emrin! Po, kam zbatuar ligjin dhe e kam deklaruar kudo e kurdo! Jo, nuk kam qenë asnjëherë i dënuar!".*

119 Shkresa nr.2193/69Prot datë 28.10.2019, Lënda *"Dërgohet vendimi për miratimin e rezultateve të verifikimit".*

120 *"... Nga verifikimet e kryera nga ana jonë rezulton se shtetasi Agim Kajmaku dhe Jorgo Toto është i njëjti person. Ky fakt konfirmohet nga gjurmët daktiloskopike dhe është pohuar nga vetë personi në formularin e vetëdeklarimit. Konstatohet se subjekti deklarues Agim Kajmaku (Jorgo Toto), përfshihet në përcaktimet e pikës*

Sipas verifikimeve të kryera rezultoi se z. Kajmaku ka kryer veprën penale "Qarkullim i monedhave të falsifikuara" në shtetin grek, vepër e cila nuk përfshihet në sferën e ndalimit të kandidimit në kuptim të nenit 2 të ligjit 138/2015 të dekriminalizimit.

Por nga ana tjetër rezulton se z. Kajmaku ka bërë deklarime të pavërteta, pasi në formularin e vetëdeklarimit iu është përgjigjur me "jo" çdo pyetje të seksionit mbi të dhënat e gjendjes gjyqësore të tij, duke mos deklaruar as nisjen e procedimit penal dhe as arrestimin e tij në flagrancë nga policia e shtetit grek, ndërkohë që, sipas Prokurorisë, ai ka patur dijeni të plotë për këto fakte. Sa më sipër përbën shkak për përjashtimin e tij nga pozicioni i funksionarit publik[121].

Prokuroria e Përgjithshme iu drejtua me shkresë zyrtare Komisionit Qendror të Zgjedhjeve duke i vënë në dispozicion rezultatet e këtij hetimi, pasi është KQZ-ja e cila duhet të vendosë nëse duhet t'i ndërpritet ose jo mandati kryetarit të bashkisë Vorë.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve morri në shqyrtim rastin në mbledhjen e datës 1 nëntor 2019, ku vendosi me vota unanime të shpallte të pavlefshëm mandatin e rrjedhimisht përfundimin e parakohshëm të tij për Kryetarin e Bashkisë Vorë z. Agim Kajmaku.

Pas vendimit të KQZ-së për përfundimin e parakohshëm të mandatit të z. Kajmaku, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e shpalli atë në kërkim pasi po e hetonte si të dyshuar për kryerjen e veprave penale "falsifikimi i formularëve" neni 190 i Kodit Penal që lidhet me deklarimet e rreme të tij në formularin e vetëdeklarimit, si edhe për veprat penale "shpërdorim detyre" neni 248 i Kodit Penal dhe "kryerje e funksionit pas dhënies fund të tij" neni 249 i Kodit Penal[122]. Aktualisht z. Kajmaku vazhdon të jetë në kërkim dhe procesi gjyqësor ndaj tij vazhdon në mungesë[123].

Edhe për Bashkinë Vorë nuk ka ende sot një datë për zhvillimin e zgjedhjeve, pasi mekanizmi i parashikuar për zhvillimin e zgjedhjeve të pjesshme në rastet kur ndërpritet mandati i Kryetarit të Bashkisë është në ngërç, duke bërë që Bashkia Vorë drejtohet nga zëvendëskryetari i saj.

Madje, nuk dihet se kur mund të zhvillohen Zgjedhjet e Pjesshme[124] Lokale në Vorë, që do të mundësonin drejtimin e komunitetit të kësaj bashkie nga një individ i zgjedhur, ashtu sikundër parasheh Kushtetuta e vendit, dhe jo nga një individ i emëruar sikundër po ndodh.

---

3 germa ç, Kreu III-të i Vendimit 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë. ..."

121 Ligji 138/2015 datë 17.12.2015*"Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen emërohen apo ushtrojnë funksione publike"* dhe Vendimi 17/2016 datë 04.03.2016 i Kuvendit të Shqipërisë *"Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në Ligjin 138/2015"*, Kreu III-të, pika 3 germa ç: *"Pasqyrimi i të dhënave të pavërteta, të paplota dhe të pasakta në të passjell përjashtimin e menjëhershëm dhe në çdo kohë nga kandidimi/zgjedhja/emërimi apo nga funksioni publik".*

122 Këto vepra i referohen vendimmarrjes së z. Kajmaku ditën e fundit të ushtrimit të tij të detyrës për të shkarkuar dy zv/kryetarët e Bashkisë Vorë zj. Laureta Omeri dhe z. Hekuran Brahimi dhe emëruar z. Gentian Picari, Drejtorin e tij të Kabinetit. Sipas prokurorisë kjo vendimmarrje është protokolluar me fraksion sikur është bërë më datë 31 Tetor 2019, ndërkohë që sipas saj kjo *"tregon se të gjitha fraksionet në këtë protokoll janë shtuar ditën e nesërme pasi nuk kanë qenë akoma të dalë këta urdhra"*, pra ditën kur atij i është ndërprerë mandati prej KQZ-së. Për më shumë shih artikullin e publikuar në *"Gazetën Panorama".*

123 Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë i mbylli hetimet më datë 20 janar 2020 duke e marrë të pandehur z. Kajmaku. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e kaloi për gjykim dosjen në ngarkim të Agim Kajmakut si edhe ndaj tre ish-vartësve të tij. Për më shumë shih artikullin e publikuar në faqen e internetit të televizionit *"A2CNN"*: *https://a2news.com/2020/02/18/kalon-per-gjykim-ceshtja-ndaj-agim-kajmakut-3-akuza-te-ngritura-ndaj-tij/*

124 Dekretimi i Zgjedhjeve të Pjesshme Lokale në Vorë është i lidhur me Zgjedhjet e Përgjithshme Lokale të 30 qershorit, ligjshmëria dhe legjitimeti i të cilës, pritet të vendoset nga Gjykata Kushtetuese, pasi Presidenti i Republikës në përplasje me Parlamentin e vendit nuk e njeh këtë proces. Nga ana tjetër Gjykata Kushtetuese është vetë në ngërç, pasi ajo vazhdon të jetë ende e paplotë në anëtarësinë e saj në mënyrë që të ketë mundësinë të shqyrtojë dhe marrë vendime. Jo vetëm kaq, por ende nuk ka një datë specifike dhe nuk dihet se kur mund të plotësohet të paktën kuorumi i kërkuar prej 6 anëtarësh, i cili do të mundësojë marrjen e vendimeve prej saj, ndërkohë që në kohën e publikimit të këtij raporti Gjykata Kushtetuese ka vetëm 4 anëtarë.

V.1.5.2.2.3. Kryetari i Bashkisë Vau Dejës

Formulari i vetëdeklarimit[125] të kandidatit për Kryetar të Bashkisë Vau i Dejës z. Mark Babani nuk ka të deklaruar asnjë të dhënë që t'a përfshijë atë në sferën e ndalimit të kandidimit.

Pas përfundimit të procesit të verifikimit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vendosi[126] autorizimin e KZAZ nr. 6 në Bashkinë Vau i Dejës që të kryente regjistrimin e kandidatit të propozuar prej Koalicionit Aleanca për Shqipërinë Europiane.

Në datën 10 shtator 2019 Partia Demokratike i kërkoi Prokurorisë[127] verifikimin e kryetarit të Bashkisë Vau i Dejës, duke i vënë në dispozicion të gjithë informacionin që disponon, pasi dyshohet se ai ka fshehur ndalime, dënime dhe dëbime nga Italia dhe Maqedonia e Veriut.
Deri më tani, nuk ka asnjë prononcim publik nga Prokuroria e Përgjithshme lidhur me këtë çështje.

V.1.5.2.2.4. Kryetari i Bashkisë Mat

Kandidati për kryetar i Bashkisë Mat, z. Agron Malaj, u regjistrua si i tillë nga KZAZ nr. 16 që mbulon këtë bashki, pas verifikimit dhe autorizimit me vendimin përkatës[128] nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Në formularin e vetëdeklarimit[129] të dorëzuar në KQZ z. Malaj ka deklaruar një dënim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat[130].
Pas verifikimit të bërë, KQZ-ja konstatoi se të dhënat e deklaruara nuk përbënin kusht për mosregjistrimin e tij si kandidat në referim të dispozitave të ligjit 138/2015.

Në datën 16 janar 2020, Partia Demokratike nëpërmjet një deklarate publike[131] njoftoi se i kishte kërkuar zyrtarisht Prokurorisë së Përgjithshme verifikimin e të kaluarës së z. Malaj, me detyrë kryetar i Bashkisë Mat, pasi, sipas saj, ai ndodhet në kushtet e ndalimit për të kandiduar në një funksion publik, pikërisht për shkak të veprës penale të deklaruar në formularin e vetëdeklarimit[132], dhe jo për shkak të ndonjë dënimi tjetër të fshehur.

125 Formulari i Vetëdeklarimit të z. Mark Babani

126 Vendimi nr. 446, datë 16.05.2019 i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, *"Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për kryetar Bashkia Vau Dejës, z. Mark Babani në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"*.

127 Deklaratë e Partisë Demokratike e publikuar në faqen e saj zyrtare të internetit më datë 10.10.2019 *"PD kërkon verifikim edhe për Mark Babanin. "Është i ndaluar/dënuar/dëbuar në Itali dhe Maqedoni. Ka fshehur edhe 3 identitete të tjera""*.

128 Vendimi nr. 366, datë 15.05.2019 i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, *"Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për Kryetar Bashkia Mat, z. Agron Rufat Malaj në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike""*.

129 Formular i Vetëdeklarimit të z. Agron Malaj.

130 Vendimi nr. 57 datë 7.10.1999, për armëmbajtje pa leje parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal. Sipas këtij vendimi z. Malaj është dënuar me 10 muaj burgim.

131 Deklaratë e Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë Demokratike z. Gazment Bardhi, e publikuar në faqen zyrtare të internetit të PD-së.

132 Shkresa drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme nr. 6 datë 16.01.2020, e publikuar në faqen zyrtare të internetit të PD-së.

Nga shqyrtimi i çështjes, konstatohet se KQZ-ja në verifikimin e rastit është mjaftuar vetëm në një lexim të përciptë nëse numërtimi i paragrafit në përmbajtje të nenit 278, mbi bazën e të cilit është marrë vendimi i Gjykatës së Rrethit Mat, përputhet apo jo me numërtimin e paragrafëve të këtij neni që parashikohen në nenin 2, pika 1/a të ligjit nr. 138/2015 të dekriminalizimit.

Si pasojë, duke mos vërejtur përputhje të numërtimit të neneve, KQZ-ja ka vendosur lejimin e kandidimit për z. Agron Malaj.

Neni 2 i ligjit 138/2015 të dekriminalizimit parashikon se ligjvënësi ndalon kandidimin e personave të cilët kanë kryer veprime që përbëjnë vepër penale sipas parashikimeve të një sërë neneve, ndër të cilat përfshihen edhe veprat penale që parashikohen në nenin "278 paragrafin e parë, të pestë e të gjashtë".

Përmbajtja e paragrafit të pestë të nenit 278, në kohën e miratimit dhe hyrjes në fuqi të ligjit 138/2015, përputhet në përmbajtje me përmbajtjen e nenit 278/2 sipas Kodit Penal të viti 1999, mbi bazën e të cilit është dënuar z. Malaj.

Nga ana tjetër ligji 138/2015, i miratuar më datë 17.12.2015 hyri në fuqi më datë 07.01.2016.
Ndërkohë ndryshimet e nenit 278 të Kodit Penal, të cilat shtuan dy paragrafë, duke e çuar paragrafin e pestë në diskutim në të shtati, u miratuan nga Parlamenti më datë 05.12.2015 por hynë në fuqi më datë 30.01.2016.
Pra sikundër evidentohet lehtë, z. Malaj, është dënuar për kryerje të një veprimi që parashikohet dhe futet në sferën e ndalimit të ligjit 138/2015 në momentin e miratimit dhe hyrjes në fuqi të tij.

Ndryshimet e mëvonshme të referencës mbi nenin, nuk e zhbëjnë faktin e kryerjes së veprës prej z. Malaj, vepër e cila përcaktohet si pjesë e veprave të parashikuara në gërmën a, të pikës 1 të nenit 2 *"Ndalimi për kandidim dhe për t'u zgjedhur në një funksion të lartë publik"* të ligjit 138/2015.

Në këto kushte, në gjykimin e KRIIK, mandati i tij duhet të ndjekë parashikimin e bërë nga dispozita e nenit 4 *"Periudha e ndalimit të kandidimit, zgjedhjes apo ushtrimit të një funksioni të zgjedhur ose të emëruar",* pika 1 e ligjit 138/2015 i cili parashikon se *"Për personat që parashikohen në shkronjën "a", të pikës 1, të nenit 2, të këtij ligji, ndalimi për kandidim, zgjedhje apo ushtrim të mandatit zgjat gjatë gjithë jetës".*

Nuk ka ende asnjë prononcim publik nga Prokuroria e Përgjithshme, në lidhje me këtë çështje.

V.1.5.2.2.5. Kryetari i Bashkisë Mallakastër

Në formularin e vetëdeklarimit[133] të kandidatit për kryetar të Bashkisë Mallakastër z. Ismailaj, nuk është deklaruar asnjë e dhënë për procedime, gjykime apo dënime të tij.

Edhe pas verifikimit paraprak nga KQZ-ja, z. Ismailaj rezultoi se është i padënuar nga gjykatat shqiptare, çka reflektohet në vendimmarrjen e saj për autorizimin e KZAZ nr. 61 Bashkia Mallakastër për regjistrimin e kandidatit të propozuar nga Koalicioni Aleanca për Shqipërinë Europiane.

Në datën 10 janar 2020, Partia Demokratike në një deklaratë publike[134], njoftoi se kryetari i Bashkisë Mallakastër figuron i dënuar në shtetin grek e për rrjedhim i

133 Formulari i Vetëdeklarimit të z. Qerim Ismailaj.

134 Deklaratë e Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë Demokratike, Gazment Bardhi.

ndalohet ushtrimi i funksioneve publike për shkak të përfshirjes në sferën e ligjit të dekriminalizimit.

Kryetari i Bashkisë Mallakastër, në një reagim publik pas denoncimeve të PD, theksoi se ka jetuar si emigrant ekonomik në shtetin grek, por nuk ka dijeni për asnjë vendim të gjykatave të këtij shteti për të[135].

Edhe për këtë çështje nuk ka ende asnjë prononcim publik nga Prokuroria e Përgjithshme

V.1.5.2.2.6. Kryetari i Bashkisë Librazhd

Në formularin e vetëdeklarimit[136] të kandidatit për kryetar të Bashkisë Librazhd z. Gurra, prej tij nuk është deklaruar asnjë e dhënë për procedime, gjykime apo dënime.

Edhe pas verifikimit paraprak nga KQZ-ja, z. Gurra rezulton se është i padënuar nga gjykatat shqiptare, çka reflektohet në vendimmarrjen e saj[137] për autorizim e KZAZ nr. 52 Bashkia Librazhd për regjistrimin e tij si kandidat për kryetar të kësaj bashkie.

Në ndryshim nga rastet e sipërpërmendura, të cilat janë denoncuar dhe bërë publike prej Partisë Demokratike, denoncimi për përfshirjen e z. Gurra në sferën e ndalimit të kandidimit për shkak të ligjit të dekriminalizimit, e bëri Lëvizja Qytetare Sopoti, nëpërmjet një kallëzimi[138] drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme.

Nuk ka ende një prononcim publik prej këtij institucioni për kallëzimin e kryer.

V.1.6. Plotësimi i vakancave në Kuvend, pas dorëzimit të mandateve nga deputetët e PD dhe LSI

Pas dorëzimit të mandateve nga forcat politike Partia Demokratike (PD) dhe Partia Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI) dhe njoftimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve prej Kuvendit të Shqipërisë për krijimin e këtyre vakancave, KQZ nisi procedurat e nevojshme për zëvendësimin e vakancave. Ky proces filloi në datën 4 mars 2019 dhe përfundoi në datën 30 maj 2019.

Gjithsej u krye zëvendësimi i 39 mandateve[139] nga 57 të tilla të mbetura vakante në Kuvend, ndërkohë që 133 individë të përfshirë në listat e kandidatëve për deputetë në zgjedhjet parlamentare të vitit 2017, refuzuan të merrnin mandat në Kuvend, duke mos iu përgjigjur kërkesës së KQZ për të dorëzuar formularin e vetëdeklarimit apo duke e njoftuar këtë të fundit për vendimin e tyre për mospranimin e mandatit.

Si rrjedhojë e këtij procesi, aktualisht Kuvendi i Shqipërisë ka 122 deputetë[140] nga 140 të parashikuar në Kushtetutë, duke qenë se listat e deputetëve të paraqitur nga partitë politike për Zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2017 shteruan.

135 Reagimi i z. Ismailaj datë 10.01.2020 *(Top-channel.tv)*

136 Formulari i Vetëdeklarimit të Z. Kastriot Gurra.

137 Vendim nr. 476 datë 17.05.2019 ""Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për kryetar Bashkia Librazhd, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

138 Kallëzim drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme nga Lëvizja qytetare Sopoti. "*Ai në vitin 2008 ka qenë në hetim nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan për procedimin penal nr. 944, vepra penale "Falsifikim i vulave i stampave ose formularëve, parashikuar nga neni 190 i Kodit Penal, neni 188 Kodi Procedurës Penale".*

139 23 mandate nga lista e PD dhe 16 mandate nga lista e LSI.

140 Lista e deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë sipas qarqeve.

Në rezultante, përtej faktit që kjo e bën legjitimitetin e Kuvendit aktualisht të diskutueshëm, pasi Kushtetuta citon se Kuvendi përbëhet nga 140 deputetë[141], kjo situatë sjell edhe një problem madhor përfaqësimi. Referuar shifrave të listave të zgjedhësve të vitit 2017 dhe numrit të mandateve në Kuvend, 18 deputetët e munguar në Kuvend, aktualisht lenë pa përfaqësim përafërsisht 440.000 zgjedhës shqiptarë[142].

Gjithashtu problematik dhe jokorrekt rezultoi edhe procedura e zëvendësimit të deputetëve nga Kuvendi i Shqipërisë dhe roli inaktiv dhe jo korrekt që luajti KQZ-ja në zhvillimin e këtij procesi.

Kushtetuta e Shqipërisë përcakton se deputeti përfaqëson popullin dhe nuk lidhet me asnjë mandat detyrues[143]. Në rastin e heqjes dorë nga mandati, në ushtrim të së drejtës së tij të njohur nga Kushtetuta[144], sipas Kodit Zgjedhor[145], deputeti duhet t'a bëjë këtë deklarim personalisht përpara Komisionit përkatës në Kuvend, procedurë e cila nuk u ndoq dhe as nuk u zbatua sipas këtyre parashikimeve për zëvendësimin e deputetëve. Kuvendi me këtë procedurë të ndjekur evidentohet edhe në mospërmbushje të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, e konkretisht të nenit 13 "Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin", nëpërmjet të cilit ngarkohet posaçërisht ky Këshill me detyrën e shqyrtimit të të gjitha çështjeve të vlefshmërisë së mandatit të deputetit sipas nenit 70 të Kushtetutës.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nga ana tjetër mbajti një qëndrim indiferent ndaj kësaj procedure jo korrekte për dorëzimin e mandateve, të ndjekur nga Kuvendi i Shqipërisë.

Gjithashtu, në këtë proces vendimmarrjeje të KQZ-së për zëvendësimin dhe dhënie të mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit pasues në listën shumëemërore të subjektit PD dhe LSI, në plotësim të vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë, u vërejt se për 16 prej tyre[146] nuk u respektua detyrimi për miratimin e tyre me shumicë të cilësuar prej pesë votash.

Neni 24 i Kodit Zgjedhor njeh dhënien e mandateve sipas neneve 162 dhe 163 kur votojnë "pro" jo më pak se 5 anëtarë të KQZ-së. Ndërkohë neni 164 parashikon kushtet për ndërprerjen e mandatit të fituar sipas neneve 162 dhe 163[147], si dhe zëvendësimin e vakancës me vendim të KQZ-së, e cila automatikisht nënkupton përsëritjen e procedurës për përcaktimin e mandateve nominale për çdo parti politike, në bazë të renditjes së kandidatëve në listën e depozituar prej saj në KQZ.

141 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 65, pika 1, *"Kuvendi përbëhet nga 140 deputetë, të zgjedhur me sistem proporcional me zona zgjedhore shumemërore."*

142 Nëse pjesëtojmë numrin e zgjedhësve në listë në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2017 me numrin e deputetëve të Kuvendit (3.452.324/140) rezulton se cdo deputet përfaqëson përafërsisht 24.600 zgjedhës. Pra, 18 deputetët e munguar përfaqësojnë më tepër se 440.000 zgjedhës.

143 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë neni 70, pika 1.

144 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë neni 71, pika 2, gërma b. *"2. Mandati i deputetit mbaron ose është i pavlefshëm, sipas rastit: b) kur heq dorë nga mandati;"*

145 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë Neni 164 *"Ndërprerja e mandatit dhe zëvendësimi i vakancës"*, pika *"1. Mandati i deputetit, i fituar sipas neneve 162 dhe 163 të këtij Kodi, ndërpritet vetëm për shkaqet e parashikuara në nenin 71 të Kushtetutës. Nuk përbëjnë shkak për ndërprerje të mandatit marrëveshjet apo deklaratat paraprake individuale apo kolektive për heqje dorë nga mandati. Në rastin e shkronjave "a" dhe "b" të pikës 2 të nenit 71 të Kushtetutës, deputeti deklaron në mënyrë publike përpara komisionit përkatës të Kuvendit refuzimin për të bërë betimin ose heqjen dorë nga mandati. Në këtë rast Kuvendi, jo më vonë se 30 ditë, njofton KQZ-në për krijimin e vakancës."*

146 15 mandate të Partisë Demokratike me vendimet: nr. 45 dt. 11.03.2019; nr. 61 dhe 62 dt. 12.03.2019; nr. 90 dt. 27.03.2019; nr. 125 dt. 04.04.2019; nr. 136 dhe 137 dt. 09.04.2019; nr. 185, 186 dhe 187 dt. 23.04.2019; nr.254 dt. 08.05.2019; nr. 305 dhe 306 dt. 14.05.2019; nr. 341 dt. 15.05.2019; nr. 437 dt. 16.05.2019; si dhe 1 mandat të LSI-së me vendimin nr. 86, dt. 20.03.2019.

147 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë Neni 163 *"Ndarja e mandateve brenda koalicionit"*, pika *"5. Menjëherë pas përfundimit të procedurave për ndarjen e mandateve për çdo parti politike, sipas këtij neni, KQZ-ja përcakton mandatet nominale për çdo parti politike, në bazë të renditjes së kandidatëve në listë, të depozituar sipas pikës 4 të nenit 67 të këtij Kodi, në rend zbritës, duke filluar nga numri rendor një."* Si dhe pika *"7. Shpërndarja e mandateve, sipas nenit 162 dhe këtij neni për çdo zonë zgjedhore miratohet me vendim. Vendimi nxirret për çdo zonë zgjedhore më vete. Vendimi mund të ankimohet në Kolegjin Zgjedhor, sipas procedurave të pjesës XI të këtij Kodi, nga subjektet e parashikuara në pikën 1 të nenit 124, përfshirë edhe kandidatët e listës shumemërore."*

V.1.7. Miratimi dhe zbatueshmëria e Planit të Veprimit

Plani Orientues i Veprimeve, miratohet me qëllim krijimin e një kornize udhërrëfyese, mbi të cilën do të mbështetet aktiviteti i KQZ-së për organizimin e zgjedhjeve, si dhe përcakton veprimet që duhet të ndërmarrë ky institucion referuar detyrimeve të përcaktuara nga dispozitat e Kodit Zgjedhor. Për zgjedhjet e datës 30 qershor 2019, Plani Orientues i Veprimeve, u miratua më datë 19 nëntor 2018[148].

Në ndryshim nga zgjedhjet e mëparshme[149], Plani Orientues i Veprimeve për këto zgjedhje ka qenë më i detajuar në detyra, duke qenë se përbëhet nga 82 pika. Në lidhje me zbatueshmërinë e tij, vihet re një tejkalim i afateve ligjore[150] për disa vendimmarrje[151] (shih më poshtë). Rezultoi se ky plan u respektua në 58% të tij.

V.1.7.1. Emërimi i Auditëve Teknicienë

Sipas Kodit Zgjedhor[152], Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet të emëronte jo më vonë se 30 ditë nga dekretimi i datës së zgjedhjeve, pra jo më vonë se data 4 dhjetor 2018, dy auditë teknicienë, për të mbikëqyrur procesin e hartimit të listave të zgjedhësve. Emërimi i tyre[153] u krye jashtë afatit ligjor[154], konkretisht në datat 17 dhe 26 dhjetor 2018[155].

V.1.7.2. Ngritja e Zyrave Rajonale Zgjedhore

Zyrat Rajonale Zgjedhore (ZRZ) ngrihen për të vendosur një koordinim dhe komunikim më të mirë dhe më efikas midis Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe komisioneve zgjedhore të niveleve më të ulëta, subjekteve zgjedhore dhe organeve të qeverisjes vendore, në funksion të mirëadministrimit të procesit zgjedhor. Ato kanë një funksion tërësisht mbështetës ndaj punës së administratës së KQZ-së.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, realizoi ngritjen e Zyrave Rajonale Zgjedhore me vendimin nr. 9 datë 15 janar 2019[156]. Veprimtaria e tyre rregullohet me udhëzimin nr. 1 datë 20.02.2009 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve[157]. Numri i personave të angazhuar si staf në këto zyra, gjatë këtij procesi zgjedhor, ishte 28.

---

148 Vendimi nr. 33, datë 19.11.2018 i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve *"Për miratimin e planit orientues të veprimeve të KQZ-Së për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019."*

149 Plani Orientues i Veprimeve të Zgjedhjeve Parlamentare të vitit 2017 përbëhej nga 58 pika.

150 Për më shumë, shih Shtojca nr. 3 - Zbatueshmëria e Planit të Veprimit të miratuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

151 Disa nga vendimmarrjet për të cilat u tejkaluan afatet ligjore janë: Emërimi i Auditëve teknicienë, Ngritja e Bordit të Monitorimit të Medias, Shpërndarja e fondeve për fushatën zgjedhore për partitë pjesëmarrëse në zgjedhje, etj.

152 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 61, pika 2 *"KQZ-ja, jo më vonë se 30 ditë nga dekretimi i zgjedhjeve, emëron me vendim dy auditë teknicienë për verifikimin e veprimeve në bazën e të dhënave të RKGjC-së. Të drejtën e propozimit për secilin audit teknicien e kanë respektivisht Kryetari dhe Zëvendëskryetari i KQZ-së, pas konsultimit me përfaqësuesit e partisë më të madhe të shumicës dhe asaj më të madhe të pakicës në KQZ."*

153 Z. Zamir Hoxha u propozua nga Kryetari i KQZ-së, ndërsa z. Lorenc Bako u propozuar nga zv/kryetari i KQZ-së.

154 Nënkryetari Biba e arsyetoi vonesën për propozimin e emrit të audituesit prej tij, me faktin se ishte e vështirë të gjendej dikush që i përmbushte kriteret e përcaktuara nga ligji përkundrejt masës së shpërblimit të ofruar për këtë detyrë.

155 Vendimi nr. 35, datë 17.12.2018 i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve "*Për emërimin e auditit teknicien për mbikëqyrjen e hartimit të listës së zgjedhësve, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 Qershor 2019*" dhe Vendimi nr. 38, datë 26.12.2018 i KQZ-së "*Për emërimin e auditit teknicien për mbikëqyrjen e hartimit të listës së zgjedhësve, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 Qershor 2019*".

156 Vendimi nr. 9 datë 15.01.2019 i KQZ-së "*Për ngritjen e Zyrave Rajonale Zgjedhore, caktimin e numrit të personelit dhe vendndodhjes së tyre, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.*"

157 Udhëzim Nr. 01, datë 20.02.2009 i KQZ-së "*Për organizimin dhe funksionimin e Zyrave Rajonale Zgjedhore*".

V.1.7.3. Ngritja e Bordit të Monitorimit të Mediave

Mbulimi i fushatës zgjedhore nga operatorët audiovizualë monitorohet nga Bordi i Monitorimit të Medias (BMM), i cili është një trupë e përkohshme që ngrihet prej KQZ-së për çdo zgjedhje. BMM përbëhet nga 7 anëtarë të përzgjedhur përkatësisht nga secili prej anëtarëve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe ushtron aktivitetin e tij pranë Autoritetit të Mediave Audio-Vizive (AMA).

BMM-ja ka për detyrë monitorimin e respektimit të kuadrit ligjor për fushatën zgjedhore në radion dhe televizionin publik dhe atë privat. Bordi duhet të depozitojë në KQZ raporte ditore të kohës televizive sipas mbulimit të subjekteve zgjedhore të transmetuar nga operatorët e shërbimit mediatik.

Sipas parashikimeve të Kodit Zgjedhor[158], KQZ-ja duhej ta ngrinte Bordin e Monitorimit të Medias 40 ditë përpara fillimit të fushatës zgjedhore, pra përpara datës 20 prill 2019. Theksohet se lidhur me këtë proces nuk pati asnjë njoftim apo thirrje publike nga KQZ-ja të drejtuar ndaj organizatave jofitimprurëse që operojnë në sektorin e medias, për t'i paraprirë apo për të kërkuar prej tyre përmbushjen e përgjegjësive të ngarkuara nga ligji.

BMM u ngrit nga KQZ-ja në shkelje ekstreme të afatit ligjor më datë 28 maj, vetëm tri ditë përpara nisjes së fushatës zgjedhore[159]. Mbledhja e parë e BMM-së u realizua në ambientet e AMA-s, në datën 29 maj 2019.

Në lidhje me procedurën e ndjekur nga KQZ-ja për ngritjen e kësaj trupe evidentohet një sjellje e paligjshme e anëtarëve të KQZ-së, si dhe e administratës së këtij institucioni.

Sipas parashikimeve të ligjit, organizatat të cilat operojnë në fushën e medias, njoftohen nga KQZ-ja për të propozuar jo më pak se 3 kandidatë për anëtarë të BMM-së, kandidatura të cilat duhet të depozitohen në KQZ jo më vonë se 50 ditë nga fillimi i fushatës zgjedhore, pra jo më vonë se data 10 prill 2019. Nga tërësia e kandidaturave të propozuara, çdo anëtar i KQZ-së zgjedh një nga kandidatët si anëtar të BMM-së dhe ia paraqet KQZ-së jo më vonë se data 15 prill 2019. Pas kësaj procedure merret vendimi për ngritjen e BMM-së, jo më vonë se data 20 prill 2019.

Referuar vendimit nr. 694 të KQZ-së, rezulton se të pestë anëtarët e zgjedhur si anëtarë të Bordit të Monitorimit të Medias janë propozime të një organizate të vetme[160]. Në pjesën e parashtrimit të vendimit, deklarohet se të pesë anëtarët e KQZ-së mbështesin kandidatët e propozuar nga organizata "Qendra për Informim të Hapur", ndaj i kanë paraqitur Sekretarit të Përgjithshëm të KQZ-së, më datë 27 maj 2019, kërkesat për propozimin e tyre si anëtarë të BMM-së. Gjithashtu në fund të parashtrimit deklarohet se "KQZ, nga verifikimi i dokumentacionit konstaton se personat e paraqitur për emërim si anëtarë të BMM plotësojnë kriteret[161] e përcaktuara në nenin 85/1, germa c, të Kodit Zgjedhor të ndryshuar".

Referuar materialeve paraprake të mbledhjes[162] së datës 28 maj 2019 si dhe përgjigjes zyrtare[163] të KQZ-së ndaj kërkesës së KRIIK për të patur kopje të dokumentacionit të dorëzuar në KQZ prej organizatave jofitimprurëse që operojnë në fushën e medias,

158 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 85, pika *1 "KQZ-ja, 40 ditë përpara fillimit të fushatës zgjedhore, ngre Bordin e Monitorimit të Medias, i cili ka për detyrë monitorimin e zbatimit të dispozitave të këtij Kodi për fushatën zgjedhore në radion dhe televizionin publik dhe ato private. Bordi i Monitorimit të Medias e ushtron veprimtarinë e tij në të gjithë territorin zgjedhor."*

159 Vendimi nr. 694, datë 28.05.2019 i KQZ-së *"Për ngritjen e Bordit të Monitorimit të Medias për monitorimin e fushatës zgjedhore në radion dhe televizionin publik dhe ato private".*

160 Organizata "Qendra për Informim të Hapur".

161 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 85/1, germa *"c) brenda 30 ditëve nga kërkesa e KQZ-së, secila nga këto organizata jofitimprurëse propozon jo më pak se tre kandidatë për anëtarë të bordit. Personat e propozuar duhet të jenë me profesion ose përvojë pune si gazetarë, analistë ose studiues të mediave;"*

162 Në materialet paraprake ka vetëm një shkresë të paraqitur nga "Qendra për Informim të Hapur", ku propozohen si kandidatura tre gazetarë nga të cilët vetëm njëri prej tyre, z. Artan Cena, u zgjodh anëtar i BMM-së pas propozimit nga kryetari i KQZ-së z. K. Zguri.

163 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Shkresë me lëndë: "Kthim përgjigje", me Nr. 14462/1 Prot, datë 18.10.2019.

rezulton se konstatimi për plotësimin e kritereve të përcaktuara në nenin 85/1, germa c, të Kodit Zgjedhor të ndryshuar, sikundër parashtrohet në relacionin e Drejtorisë Juridike të KQZ-së e më pas edhe në pjesën arsyetuese të vendimit, nuk është i vërtetë.

Asnjë prej katër emrave[164] që propozojnë katër anëtarët e KQZ-së z. Biba, zj. Jorgaqi, zj. Bitri dhe z. Skënderi, nuk figuron si kandidaturë e propozuar nga organizata "Qendra për informim të hapur", megjithëse në kërkesat zyrtare drejtuar sekretarit të përgjithshëm të KQZ-së anëtarët e mësipërm deklarojnë se kandidaturat e propozuara prej tyre janë përzgjedhur nga lista emërore e propozuar nga organizata në fjalë. Madje në këtë kërkesë, anëtarët e trupës së KQZ-së deklarojnë se përzgjedhja e tyre është bërë pas konsultimit të listës emërore të propozimeve për anëtarë të BMM-së të depozituara në KQZ nga organizatat jofitimprurëse dhe se propozimi i tyre është konform parashikimeve të nenit 85/1 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar.

Nga ana tjetër, figuron se të katër gazetarët e përzgjedhur si anëtarë të BMM-së nuk figurojnë fare në listën prej 13 emrash të propozuar si kandidatë nga katër organizatat që kanë depozituar listat në KQZ.

Gjithashtu, rezulton e paqartë se si organizata "Qendra për informim të hapur", është vënë në dijeni dhe i është përgjigjur kërkesës së KQZ-së, megjithëse në tejkalim ekstrem të afatit ligjor të parashikuar, pasi kjo organizatë nuk figuron në listën e organizatave jofitimprurëse të kontaktuara zyrtarisht prej KQZ-së.

V.2. Komisionet Zonale të Administrimit Zgjedhor (KZAZ)

V.2.1. Ndërtimi i KZAZ-ve dhe infrastruktura mbështetëse

Komisionet Zonale të Administrimit Zgjedhor (KZAZ) janë komisionet e nivelit të dytë që bëjnë administrimin e procesit zgjedhor në nivel lokal. Këto komisione janë të përkohshëm dhe parashikohen nga ligji me përbërje mirëfilltazi politike sipas konfiguracionit në parlament të partive politike të shumicës dhe pakicës. Kodi Zgjedhor parashikon përbërjen e tyre nga shtatë anëtarë me të drejtë vote dhe nga një sekretar[165] pa të drejtë vote.

Më 1 shkurt 2019[166], KQZ miratoi partitë politike të cilat kishin të drejtë të propozonin anëtarë për Komisionet Zonale të Administrimit Zgjedhor. Afati i fundit ligjor për depozitimin e propozimeve për anëtarë të KZAZ-ve nga partitë politike ishte data 18 mars 2019.

Vetëm Partia Socialiste e ushtroi të drejtën për të çuar emrat e komisionerëve brenda afatit ligjor, ndaj KQZ-ja shpalli thirrjen publike për aplikime[167] nga shoqëria civile për të plotësuar vendet vakante në këto komisione.

Pas administrimit të të gjitha aplikimeve dhe zbatimit të procedurave, KQZ-ja realizoi konstituimin e 90 KZAZ-ve në mbledhjen e datës 9 prill 2019. Sipas

164 Z. Dardan Malaj i propozuar nga zv/kryetari Denar Biba; Z. Ylli Pata i propozuar nga anëtarja znj. Edlira Jorgaqi; Z. Maklen Misha i propozuar nga anëtarja znj. Rezarta Bitri dhe z. Bledar Lumani i propozuar nga anëtari z. Bledar Skënderi.

165 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 29 *"Përbërja e KZAZ-së"*.

166 Vendimi nr. 18, datë 01.02.2019 i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve *"Për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarët e KZAZ-ve, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019"*. Sipas këtij Vendimi: 3 anëtarë propozohen nga PS; 2 anëtarë propozohen nga PD; 1 anëtar propozohet nga LSI; ndërsa anëtari i shtatë i KZAZ-ve do të propozohet nga PS në KZAZ-të me numër çift dhe nga PD në KZAZ-të me numër tek. Sekretari propozohet nga partia që propozon zëvendëskryetarin e KZAZ-së.

167 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Njoftim për Vende të Lira Pune, *"Për procedurat e emërimit Kryesisht nga KQZ të anëtarëve dhe sekretarëve të KZAZ-ve*, datë 19 Mars 2019.

njoftimit nga KQZ-ja[168], trajnimi i trupës së këtyre komisioneve, u realizua në datat 8 dhe 9 maj 2019.

KZAZ-të administruan procesin zgjedhor në nivelin e dytë të përbërë nga 4 anëtarë/e me të drejtë vote dhe një sekretar/e.

Nga këta 5 individë, katër ishin përfaqësues të Partisë Socialiste (PS) dhe njëri ishte përfaqësues nga shoqëria civile.
Në KZAZ-të me numër çift, PS kishte emëruar kryetarin dhe tre anëtarë, ndërsa sekretari ishte i emëruar kryesisht nga kandidaturat e shoqërisë civile. Në KZAZ-të me numër tek PS kishte emëruar zëvendëskryetarin, dy anëtarë si dhe sekretarin, ndërsa një anëtar tjetër u emërua kryesisht nga kandidatura të shoqërisë civile.
Si rrjedhim në të 90 KZAZ-të, PS zotëronte përpos shumicës edhe drejtimin e këtyre komisioneve.

Edhe në këto zgjedhje, ashtu sikundër edhe në proceset zgjedhore të mëparshme, u shënua një numër i lartë zëvendësimesh të komisionerëve të KZAZ-ve, megjithëse Partia Socialiste ishte e vetme dhe pa kundërshtar politik në administrimin e ZAZ-ve. Konkretisht, përgjatë gjithë periudhës së funksionimit të KZAZ-ve u zëvendësuan gjithsej 134 komisionerë ose 18.6 % e të gjithë trupës, nga të cilët 26 sekretarë, 5 zëvendëskryetarë dhe 102 anëtarë[169].
Nga 134 komisionerë të zëvendësuar në total, 104 ishin përfaqësues të Partisë Socialiste ndërsa 30 ishin komisionerë të emëruar kryesisht.

V.2.1.1. Refuzimi i listave të PD dhe LSI për anëtarë dhe sekretarë të KZAZ-ve

Partia Demokratike (PD) dhe Partia Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI), megjithëse nuk u regjistruan si subjekte zgjedhore për zgjedhjet e 30 qershorit, në datën 22 maj 2019 dorëzuan në KQZ propozimet e tyre për anëtarë të Komisioneve Zonale të Administrimit Zgjedhor.

PD dhe LSI nuk i dorëzuan në KQZ listat me kandidatë për anëtarë të KZAZ-ve brenda afatit ligjor të 18 marsit, sikundër parashikohet nga Kodi Zgjedhor. Por nga ana tjetër, po në zbatim të Kodit Zgjedhor[170] si dhe në zbatim të vendimit nr. 18 të KQZ-së datë 01.02.2019, atyre u njihej e drejta për t'i depozituar brenda një afati të dytë kohor, jo më vonë se 30 ditë nga dita e zgjedhjeve, pra deri më datë 31 maj 2019.

Pas shqyrtimit në mbledhjen e datës 23 maj 2019, KQZ vendosi se "Partia Demokratike dhe Partia Lëvizja Socialiste për Integrim duke mos u regjistruar në zgjedhjet e datës 30 qershor 2019 nuk përmbushin kriterin ligjor për të qenë subjekt zgjedhor në procesin zgjedhor të zgjedhjeve të datës 30 qershor 2019 dhe për pasojë nuk mund të propozojnë në këtë fazë të procesit zgjedhor anëtarë për KZAZ (e respektivisht edhe për KQV e GNV)[171]".

Vendimi u ankimua prej PD-së dhe LSI-së në Kolegjin Zgjedhor, i cili me vendimin nr. 10 datë 06.06.2019[172] vendosi të linte në fuqi vendimin e Komisionit Qendror të

168 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Njoftim për Shtyp, *"Deklaratë për trajnimin e komisionerëve të KZAZ-ve"*, datë 7 Maj 2019.

169 Për më shumë shih Shtojca nr. 4 - Lirimet dhe emërimet në trupën e Komisioneve Zonale të Administrimit të Zgjedhjeve.

170 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 29, pika 5, paragrafi 2 *"Anëtarët e emëruar kryesisht qëndrojnë në detyrë deri në emërimin e anëtarëve të propozuar nga partitë politike, sipas këtij neni. Zëvendësimi duhet të kryhet jo më vonë se 30 ditë nga dita e zgjedhjeve."*

171 Vendimi nr. 657 datë 23.05.2019 i KQZ-së *"Për shqyrtimin e kërkesës për emërimin e anëtarëve dhe sekretarëve të KZAZ-ve të propozuar nga Partia Demokratike e Shqipërisë dhe anëtarëve të KZAZ-ve të propozuar nga Lëvizja Socialiste për Integrim, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019".*

172 Vendimi Nr. 10, datë 06.06.2019 i Kolegjit Zgjedhor *"Në kuptim të nenit 145 të Kodit Zgjedhor partitë politike*

Zgjedhjeve, me arsyetimin se palët paditëse nuk gëzojnë legjitimitetin aktiv për të bërë ankim në Kolegjin Zgjedhor, në interpretim të nenit 145 të Kodit Zgjedhor, sipas të cilit këtë të drejtë e kanë subjektet zgjedhore.

Vendimi i KQZ-së për rrëzimin e kërkesës së PD dhe LSI për të propozuar komisionerë, ishte një vendimmarrje me një qasje të njëanshme dhe e paplotë në trajtimin ligjor, sipas germës dhe frymës së Kodit Zgjedhor për ndërtimin e komisioneve administruese zgjedhore të balancuara politikisht, sipas konfiguracionit politik parlamentar.

Kodi Zgjedhor e parashikon konstituimin e KZAZ-ve mbi parimin e kundërbalancimit politik të forcave parlamentare. Kësisoj, Kodi parashikon konstituimin e shtatë anëtarëve me tre anëtarë nga shumica parlamentare dhe tre anëtarë nga pakica parlamentare. Ndërsa anëtari i shtatë në gjysmën e KZAZ-ve propozohet nga partia kryesore e shumicës parlamentare dhe në gjysmën tjetër nga partia kryesore e pakicës parlamentare.

Në këtë përcaktim, Kodi tregohet evaziv në referencën ligjore të përdorur "shumicë" dhe "pakicë parlamentare", të cilat në kontekstin ligjor vendas mund të marrin lexime të ndryshme[173].
Ky përcaktim i përdorur, deformohet dhe shndërrohet në momentin e dytë që Kodi rregullon mbarëvajtjen e KZAZ-ve. Kodi Zgjedhor në brendësinë e tij, kur rregullon procedurën e shkarkim-zëvendësimit të anëtarësisë së KZAZ-ve, përdor termin "subjekt zgjedhor"[174].

Ky ndryshim termi, ndonëse tejet i gabuar në aspektin e teknikës legjislative dhe përsa tregoi eventualiteti i zgjedhjeve të 2019-ës, reflekton prerogativën mbi të cilën është ndërtuar mbarëvajtja e procesit zgjedhor.
Kodi Zgjedhor e merr të mirëqenë që forcat parlamentare kryesore, përfshihen domosdoshmërisht si subjekte zgjedhore dhe mbartin kësisoj atributin e administrimit të procesit zgjedhor.

Në këtë këndvështrim, KQZ-ja në vendimmarrjen e saj kundërthënëse të sipërpërmendur për konstituimin e KZAZ-ve, ka kryer një lexim formal që Kodi Zgjedhor ia lejon, duke ia njohur subjektit zgjedhor atributin për të propozuar anëtarësinë e KZAZ-ve.
Por, nga ana tjetër, duke iu referuar frymës së tij, gjykohet se në fakt Kodi Zgjedhor njeh forcat parlamentare që në kundërbalancim ndërtojnë dhe sigurojnë procesin zgjedhor.

---

legjitimohen ti drejtohen Kolegjit Zgjedhor duke kundërshtuar vendimmarrien e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve vetëm në rastet kur u është refuzuar kërkesa për regjistrimin si subjekt zgjedhor. Në rastin në gjykim subjektet politike palë paditëse, Partia Demokratike dhe Lëvizja Socialiste për Integrim nuk kanë paraqitur kërkesë për tu regjistruar si subjekte zgjedhore, megjithëse kanë kaluar të gjitha afatet e parashikuara në Kodin Zgjedhor për tu regjistruar si të tilla. Për pasojë, në kushtet e rrethanat konkrete, subjektet politike palë paditëse në gjykim, nuk gëzojnë legjitimitetin aktiv për të kundërshtuar veprimtarinë e palës së paditur, KQZ-së, duke u ankuar në Kolegjin Zgjedhor".

173 Mbi këtë moment evaziv të ligjit, u mbështet edhe vendimmarrja e muajit shkurt të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Në Vendimin Nr. 18, datë 01.02.2019, KQZ-ja ia njohu propozimin e tre anëtarëve të shumicës parlamentare vetëm Partisë Socialiste. Kjo, pasi KQZ-ja e konsideroi PS-në parti të vetme të shumicës parlamentare. Ndërsa propozimin e tre anëtarëve të pakicës parlamentare ia njohu përkatësisht PD-së dhe LSI-së, duke e konsideruar PSD-në, partinë e pestë parlamentare, si një forcë të katërt të pakicës parlamentare.

174 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 32 *"Shkarkimi dhe lirimi i anëtarëve dhe i sekretarit të KZAZ-së", "2. Anëtarët dhe sekretari i KZAZ-së lirohen nga detyra me vendim të KQZ-së kur: a) kanë marrëdhënie krushqie të afërt ose gjinie deri në shkallë të katërt me ndonjërin nga kandidatët që konkurrojnë në zonë; b) janë në marrëdhënie pune me ndonjërin prej kandidatëve të përfshirë në listën shumemërore të një partie apo koalicioni që konkurron në zonë; c) nuk plotësojnë më kushtet për të qenë zgjedhës; ç) nuk kanë më vendbanimin e tyre në zonën zgjedhore; d) subjekti zgjedhor që i ka propozuar kërkon zëvendësimin e tyre. 3. Anëtari dhe sekretari i KZAZ-së lirohen/shkarkohen nga detyra nga KQZ-ja, kryesisht ose me propozim të subjekteve zgjedhore, vetëm për shkaqet e parashikuara në këtë nen. Në çdo rast, kërkesa për lirim ose shkarkim duhet të përmbajë edhe argumente dhe fakte për shkeljen e pretenduar. Në rastin e parashikuar në shkronjën "d" të pikës 2 të këtij neni ky rregull nuk zbatohet dhe kërkesa pranohet në çdo rast".*

Në rezultante, në leximin e Kodit Zgjedhor që kreu KQZ-ja, sërish u faktua një sjellje me dy standarde, pasi ky institucion nuk ftoi subjektet zgjedhorë parlamentarë të propozonin anëtarësinë e munguar të KZAZ-ve për ato zona ku kishte garim kandidaturash, duke marrë në shqyrtim dhe amenduar vendimin nr. 18 datë 01.02.2019, të saj.

Administrimi i procesit zgjedhor në tërë nivelin e dytë, e më pas edhe në atë të tretë, nga një forcë e vetme politike nxori në pah më shumë se çdo proces tjetër zgjedhor mangësitë e sistemit aktual të administrimit të zgjedhjeve, i pranuar deri më sot falë bazimit të tij në bi-partizanizmin politik.
Ky proces "hodhi në erë" mekanizmin e kundër-balancimit politik, shënoi precedentin e administrimit në mënyrë totalisht të njëanshme, si dhe nxori në pah domosdoshmërinë e ndërtimit të tyre nga administratorë të pavarur nga forcat politike.

Në vazhdimësi të qëndrimeve të mëparshme *lidhur me çështjen e trupës së administrimit të procesit zgjedhor, rekomandohet me forcë ngritja* e një trupe profesionale komisionerësh zgjedhorë*, në disa hapa duke filluar, së pari, me ngritjen e komisioneve zonale të administrimit zgjedhor me individë profesionistë dhe pa asnjë lidhje me forcat politike.*

Kjo skemë administrimi, kërkon në mënyrë të domosdoshme që të shoqërohet me mekanizma mbrojtës dhe sigurues që të garantojë *se këta individë nuk do të ndëshkohen për veprimet apo mosveprimet e tyre përgjatë procesit zgjedhor, duke nxitur dhe përkrahur veç zbatimin në mënyrë shembullore të kërkesave të ligjit, në respekt të frymës së kushtetutës për të mos cenuar* në asnjë rast vullnetin e qytetarëve.

V.2.1.2. Përcaktimi i Vendeve të numërimit të Votave

Përcaktimi i Vendit të Numërimit të Votave (VNV) për çdo Zonë të Administrimit Zgjedhor (ZAZ), realizohet me vendim të KQZ-së, pas propozimeve që dërgojnë në këtë institucion Prefektët e çdo Qarku.
KQZ-ja përcaktoi adresat e vendeve të numërimit të votave në zbatim të afateve dhe procedurave ligjore të parashikuara.

Duke përdorur si arsyetim ligjor Dekretin e Presidentit Nr. 11199 të datës 10 qershor 2019[175], me anë të të cilit Presidenti i Republikës shfuqizoi dekretin për caktimin e datës së zgjedhjeve në 30 qershor, disa bashki (kryetarët e të cilave ishin zgjedhur nën siglën e PD-së apo LSI-së) kërkuan lirimin e ambienteve në varësi të tyre, të cilat ishin përcaktuar tashmë me vendim të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve si Vende të Numërimit të Votave.
Pas këtyre kërkesave dhe situatës tejet të ngarkuar politike, prefektët i kërkuan KQZ-së që të ndryshonte adresat e disa VNV-ve.

Me vendim të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, u vendos ndryshimi i vendndodhjes për 14 Vende të Numërimit të Votave[176]. Vendimet në lidhje me ndryshimin e adresave të VNV-ve u morën prej KQZ-së nga data 22 qershor deri në datën 28 qershor 2019.

175 Dekreti Nr. 11199, datë 10 qershor 2019 i Presidentit të Republikës *"Për shfuqizimin e Dekretit nr. 10928, datë 05.11.2018 të Presidentit të Republikës "Për caktimin e datës së zgjedhjeve për Organet e Qeverisjes Vendore"*.

176 Ndryshimi i Vendit të Numërimit të Votave të ZAZ nr. 44 Bashkia Peqin; Ndryshimi i Vendit të Numërimit të Votave të ZAZ nr. 4 Bashkia Shkodër; Ndryshimi i Vendit të Numërimit të Votave të ZAZ nr. 5 Bashkia Shkodër; Ndryshimi i Vendit të Numërimit të Votave të ZAZ nr. 6 Bashkia Vau Dejës; Ndryshimi i Vendit të Numërimit të Votave të ZAZ nr. 2 Bashkia Shkodër; Ndryshimi i Vendit të Numërimit të Votave të ZAZ nr. 3 Bashkia Shkodër; Ndryshimi i Vendit të Numërimit të Votave të ZAZ nr. 53 Bashkia Përrenjas; Ndryshimi i Vendit të Numërimit të Votave të ZAZ nr. 9 Bashkia Tropojë; Ndryshimi i Vendit të Numërimit të Votave të ZAZ nr. 42 Bashkia Kavajë; Ndryshimi i Vendit të Numërimit të Votave të ZAZ nr. 16 Bashkia Mat; Ndryshimi i Vendit të Numërimit të Votave të ZAZ nr. 67 Bashkia Pogradec; Ndryshimi i Vendit të Numërimit të Votave të ZAZ nr. 85 Bashkia Selenicë; Ndryshimi i Vendit të Numërimit të Votave të ZAZ nr. 87 Bashkia Delvinë; Ndryshimi i Vendit të Numërimit të Votave të ZAZ nr. 11 Bashkia Kukës.

Ndonëse Kodi Zgjedhor, nuk parashikon afate eksplicite kohore për ndryshimin e vendndodhjes së VNV-ve[177], ai përcakton një afat të fundëm, të paktën 10 ditë përpara ditës së zgjedhjeve që ambientet e VNV-ve duhet të vihen në dispozicion të KZAZ-së përkatëse[178].

Gjithashtu, ligji parashikon vendosjen e selive të KZAZ-ve, QV-ve dhe VNV-ve, për aq sa është e mundur në ambiente publike. Si praktikë, në proceset e mëparshme zgjedhore, KZAZ-të dhe VNV-të janë vendosur në ambiente publike.
Pas ndryshimeve të sipërpërmendura, në kushtet e një situate aspak të zakonshme, disa VNV[179] u vendosën në ambiente private.

V.2.2. Aktiviteti i Komisioneve Zonale të Administrimit Zgjedhor

Nisur nga ndërtimi i komisioneve në mënyrë të njëanshme me anëtarë të PS-së, padobishmëria e vëzhgimit të mënyrës së vendimmarrjes dhe kufizimi në kohë i periudhës së vëzhgimit, u ndërtua një metodologji për të vëzhguar aktivitetin e Komisioneve Zonale të Administrimit Zgjedhor (KZAZ) në mënyrë të herë pas hershme, duke u fokusuar mbi sjelljen dhe vendimmarrjen e tyre, duke përdorur, kryesisht, si burim informacioni vetë komisionerët e KZAZ-ve.

KRIIK angazhoi nëntëdhjetë vëzhgues afatgjatë të cilët ndoqën me prioritet punën e KZAZ-ve në dy ditët që paraprinë ditën e zgjedhjeve[180], gjatë ditës së zgjedhjeve dhe përgjatë procesit të numërimit të votave, deri në përfundimin e numërimit dhe përpilimit të tabelave përmbledhëse të rezultateve për zonën zgjedhore/bashkinë përkatëse.
Përveç vëzhgimit të drejtpërdrejtë të sjelljes së këtyre komisioneve gjatë këtyre ditëve, u synua të mblidheshin dhe publikoheshin të gjitha vendimet e marra[181] nga KZAZ-të përgjatë gjithë periudhës së funksionimit të tyre për Zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të 30 qershorit 2019.

U konstatua se në shumë raste komisionerët e KZAZ-ve nuk u treguan bashkëpunues apo të gatshëm për të ofruar informacion ndaj vëzhguesve, sidomos lidhur me dhënien e kopjeve të vendimmarrjeve të KZAZ-së, e cila është një e drejtë e përcaktuar qartësisht në Kodin Zgjedhor[182] dhe në udhëzimet e KQZ-së.
Në pjesën dërrmuese të tyre, kjo mungesë bashkëpunimi u justifikua me volumin e lartë të punës, apo me mungesën e sekretarit të KZAZ-së në momentin e vizitave nga vëzhguesit.

177 Në nenet 93 dhe 94 të Kodit Zgjedhor, përcaktohet vetëm afati i caktimit të vendndodhjes së VNV-ve, që është jo më vonë se 40 ditë përpara ditës së zgjedhjeve.

178 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 94 *"Vendndodhja dhe përgatitja e Vendeve të Numërimit të Votave"*, Pika 1, paragrafi 2 *"Vendet e Numërimit të Votave vihen në dispozicion të KZAZ-ve jo më vonë se 10 ditë para ditës së zgjedhjeve. KZAZ-ja jo më vonë se 5 ditë para ditës së zgjedhjeve fton për njohje të Vendit të Numërimit të Votave subjektet zgjedhore dhe anëtarët e KQV-ve".*

179 Vendi i Numërimit të Votave të ZAZ nr. 6, Bashkia Vau Dejës, u caktua në ndërtesën "Dodani"; Vendi i Numërimit të Votave të ZAZ nr. 11, Bashkia Kukës, u caktua në ambientet "Bufe Verandë" e ish-Hotel Drinit; Vendi i Numërimit të Votave të ZAZ nr. 9, Bashkia Tropojë, u caktua në ambientin "Euro Bushi" në pronësi të z. Bekim Hajdarmataj; Vendi i Numërimit të Votave të ZAZ nr. 17, Bashkia Klos, ishte vendosur më herët në ambient privat.

180 E premte, datë 28 qershor dhe e shtunë, datë 29 qershor 2019.

181 Në synimin e KRIIK, transparenca si kryefjala e një procesi zgjedhor, është e rëndësishme të karakterizojë veçanërisht nivelin e dytë të administrimit zgjedhor, pra KZAZ-të, për shkak të mjaft specifikave në funksionalitet dhe kompetenca. Në procesin zgjedhor të viti 2017, një nismë e tillë, rezultoi e pasuksesshme megjithëse u kërkua në mënyrë të shpeshtë ndërhyrja e vetë KQZ-së, u kontaktua zyrtarisht dhe në mënyrë të drejtëpërdrejtë në formë shkresore dhe nëpërmjet vëzhguesve afatgjatë të atashuar pranë tyre. Ajo çka u evidentua në pjesën më të madhe të KZAZ-ve, ishte vullneti hermetik i dakordësuar nga të gjithë anëtarët e KZAZ-ve të të gjitha partive politike për të mos bërë transparencë mbi vendimmarrjet e tyre, në kundërshtim të hapur me ligjin.

182 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 34 *"Detyrat e sekretarit të KZAZ-së"*, *"Sekretari i KZAZ-së kryen këto detyra: e) regjistron në protokoll vendimet e KZAZ-së dhe ua përcjell ato menjëherë subjekteve të interesuara; ë) u jep subjekteve zgjedhore ose personave të tretë, pa pagesë dhe brenda 24 orëve nga paraqitja e kërkesës, kopje të vërtetuara të vendimeve të KZAZ-së ose procesverbaleve të mbledhjeve të tyre;"*

Një pjesë e KZAZ-ve u shprehën se nuk i kishin në dispozicion në mënyrë të menjëhershme informacionet e kërkuara ose ofronin informacion të përafërt, i cili është ri-konsideruar për besueshmërinë e ulët të paraqitur. Të tilla informacione janë numri i mbledhjeve që kishte kryer KZAZ-ja, numri i vendimeve të marra prej saj[183], numri i komisionerëve apo anëtarëve të grupeve të numërimit gra, numri i komisionerëve të qendrave të votimit të trajnuar, numri i komisionerëve të patrajnuar, numri i qendrave të votimit që kanë patur problematika të ndryshme gjatë ditës së zgjedhjeve, etj.[184].

Në disa prej KZAZ-ve vendimet janë marrë vetëm pjesërisht dhe në disa nuk është arritur të merret asnjë vendim.
Në disa raste, arsyeja e shprehur nga komisionerët për mosvendosjen në dispozicion në vendimeve ka qenë mungesa e kohës, në të tjera, ata i kanë lejuar vëzhguesit të këqyrin vendimet, por nuk kanë pranuar që t'i pajisnin ata me kopje të tyre dhe as që t'i fotografonin ato.
Madje, në disa raste ekstreme, komisionerët janë shprehur se vëzhguesit nuk kanë të drejtë t'i shohin vendimet e KZAZ-së, pasi këtë të drejtë e ka vetëm KQZ-ja.

Arsyet për mosvendosjen në dispozicion të vendimeve dhe sjellja e komisionerëve ndaj të drejtave të vëzhguesve ka qenë e ndryshme në KZAZ të ndryshme, çka ngre pikëpyetje jo thjesht mbi njohjen e kuadrit ligjor apo edhe trajnimin e tyre, por mbi arsyet e paraqitjes së një vullneti mohues kategorik për të dhënë kopje të vendimmarrjeve të tyre apo edhe informacion të detajuar mbi to, edhe pasi atyre iu është bërë me dije se ky është një detyrim i qartë që i 'ua ngarkon ligji.

Ky i kuptuar i mangët dhe jo-koherent i legjislacionit në lidhje me të drejtat e vëzhguesve konstatohet për të disatën herë nga KRIIK, edhe në lidhje me të tjera faza të procesit zgjedhor (si p.sh. faza e marrjes në dorëzim të materialeve zgjedhore, gjatë së cilës, shpesh, vëzhguesit vendorë apo edhe ata ndërkombëtarë nuk lejohen të hyjnë në ambientet e VNV-së, në kundërshtim flagrant të Kodit Zgjedhor).

Nga ana tjetër, kjo qasje është në linjë edhe me qëndrimin e vetë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, i cili nuk vendos në mënyrë pro-aktive në dispozicion të vëzhguesve jo-politikë vendas materialet paraprake të mbledhjeve, por i vendos ato vetëm në dispozicion të vëzhguesve ndërkombëtarë dhe përfaqësuesve të partive politike.

V.2.2.1. Grupet e Numërimit të Votave

Procesi i numërimit të votave u realizua në 90 Vende të Numërimit të Votave nga 864 Grupe të Numërimit të Votave (GNV).

Sipas vendimit të KQZ-së[185], grupet e numërimit të votave përbëheshin nga 4 anëtarë, dy anëtarë të propozuar nga Partia Socialiste dhe dy anëtarë të përzgjedhur nga KZAZ-ja me short, nga anëtarët e emëruar kryesisht të KQV-ve në ZAZ-në përkatëse.

Kodi Zgjedhor[186] përcakton afatin prej 10 ditësh përpara ditës së zgjedhjeve, pra

183 Numri i vendimeve të marra, të raportuara nga anëtarët e KZAZ-ve varion nga 7 në rreth 280.

184 Në një numër të KZAZ-ve informacioni i ofruar ndaj vëzhguesve në lidhje me këtë pikë ka qenë i ndryshëm në momente të ndryshme kohore apo të komisionerit të pyetur. Në të tjera raste, numri i raportuar i vendimeve të mara nuk është i besueshëm, duke qenë se është shumë i ulët, në raport me numrin e vendimeve që duhet të marrë një KZAZ gjatë një procesi normal.

185 Vendimi nr. 865, datë 25.06.2019 i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, *"Për ngritjen e Grupeve të Numërimit të Votave për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 30 qershor 2019"*.

186 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 95, pika 1 *"Për numërimin e votave në rang ZAZ-je, me vendim të KZAZ-së, 10 ditë para ditës së votimit, caktohen Grupe Numërimi të Votave"*.

20 qershor 2019, për ngritjen e GNV-ve, ndërkohë që vendimi i KQZ për ngritjen e tyre mban datën 25 qershor 2019.

Nga vëzhgimi i bërë, raportohet se konstituimi i GNV-ve u krye përtej afatit ligjor në çdo KZAZ, madje në disa raste edhe ditën e diel. Për rrjedhojë të kësaj situate, trajnimi i tyre u realizua me vonesë, madje në disa KZAZ vetëm disa minuta përpara fillimit të procesit të numërimit.

Ky ka qenë një problem i pranishëm edhe në zgjedhjet e mëparshme, por u bë edhe më evident në këto zgjedhje, pasi anëtarët e GNV-ve të emëruar në këto zgjedhje, ose së paku dy prej tyre, nuk kishin eksperienca të mëparshme në këtë funksion, duke qenë se nuk ishin përfaqësues të partive politike.

V.2.2.2. Komisionet e Qendrave të Votimit

Procesi i votimit u organizua në 5,416 Qendra Votimi (QV)[187], nga të cilat 19 ishin QV të posaçme[188], 334 QV të vendosura në ambiente private me vendim të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe 5,063 QV në ambiente publike.
Krahasuar me zgjedhjet e vitit 2017[189], në këto zgjedhje kishte një numër më të lartë qendrash votimi.

Komisionet e Qendrave të Votimit (KQV) duhet të ishin konstituuar deri më datë 10 qershor 2019[190]. Përbërja e KQV-ve reflekton atë të KZAZ-së, në juridiksionin e së cilës ato funksionojnë.

Referuar situatës së krijuar në lidhje më përbërjen e komisioneve të administrimit zgjedhor, të të gjitha niveleve, KQZ nëpërmjet njoftimeve publike bëri thirrje për shprehje interesi nga qytetarë që ishin të gatshëm të ushtronin detyrën e anëtarit të KQV-së.

Pasi administroi gjithë aplikimet, KQZ-ja filloi në datën 12 qershor 2019 vendimmarrjen në lidhje me miratimin e listave shumë-emërore të shtetasve që mund të emëroheshin kryesisht anëtarë të KQV-ve[191] për një pjesë të bashkive dhe vijoi një procedurë të tillë deri në datën 29 qershor 2019[192].
Nga sa parashtrohet edhe më sipër, është evidente se afati ligjor i parashikuar për konstituimin e Komisioneve të Qendrave të Votimit nga KZAZ-të përkatëse, nuk u respektua.

Komisionet e Qendrave te Votimit, përbëheshin nga 4 anëtarë, 3 përfaqësues të Partisë Socialiste dhe një përfaqësues i shoqërisë civile.

187 Në faqen e internetit të KQZ-së figurojnë 5,402 QV, ndryshe nga sa paraqitet në publikimin final të KQZ-së.

188 QV në: - burgjet: Burrel - QV 09382, 302 - QV 1967, 313 - QV 19671, Kosovë - QV 25651, Bënçë Klasa e edukimit - QV 43831, Rrogozhinë - QV 22241, Drenovë - QV 37071, - IEVP: Shënkoll - QV 07481, Durrës - QV 14222, "Ali Demi" - QV 1690, Peqin - QV 22732, Patos - QV 30793, Elbasan - QV 2391, Shtëpia e të Moshuarve - QV 1680; - Paraburgimin: Sarandë - QV 4678, Vlorë - QV 4451; si dhe QV 06371 Shtëpia e Oficerëve, QV 3433 Parangoi Dyshnik, QV 12921 Fushë Krujë Blloku nr.1.

189 Dita e Zgjedhjeve të 25 Qershorit 2017 u administrua nga 5,362 Komisione të Qendrave të Votimit, 4,952 e të cilave ishin vendosur në ambiente publike, 389 në ambiente private dhe 21 QV ishin të vendosura në ambiente të institucioneve të posaçme.

190 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë Neni 36 *"Përbërja e KQV-së"*, pika *"2. Në çdo rast emërimi i anëtarëve dhe sekretarit bëhet jo më vonë se 20 ditë përpara ditës së zgjedhjeve"*.

191 Vendimi nr. 831, datë 12.06.2019 *"Për miratimin e listave emërore të shtetasve të cilët mund të emërohen kryesisht anëtarë të KQV-ve për zgjedhjet për në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019"* i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

192 Vendimi nr. 928, datë 29.06.2019 *"Për miratimin e listës emërore të shtetasve të cilët mund të emërohen kryesisht anëtarë të KQV-ve për zgjedhjet për në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019"* i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Emërimi në limite kohore, mungesa e eksperiencave të mëparshme si komisionerë, por edhe mungesa e trajnimit, ishin elementë që ndikuan jopozitivisht në punën e Komisioneve të Qendrave të Votimit.

Trajnimet e anëtarëve të KQV-ve u realizuan gjatë javës së fundit të fushatës zgjedhore. Nga vëzhgimi i bërë u vërejt se pjesëmarrja në to ishte e ulët, për shkak edhe të emërimit të vonuar të anëtarëve të KQV-ve.

Përsa i përket caktimit të vendndodhjes së Qendrave të Votimit, ligji parashikon se në 40 ditët e fundit para ditës së zgjedhjeve, ndryshimi i tyre nuk mund të bëhet, përveçse për shkak të forcave madhore dhe me autorizim nga KQZ-ja.
Megjithatë, edhe gjatë këtij procesi zgjedhor, ndryshimi i adresave të QV-ve ka qenë mjaft i shpeshtë, dhe i shtrirë deri në ditën e zgjedhjeve.
Në total u ndryshua vendndodhja e 286 QV-ve, ndryshime që u bënë përgjatë periudhës nga data 3 deri në datën 30 qershor 2019[193].

Shpërndarja e materialeve zgjedhore në një pjesë të madhe të QV-ve, u realizua me vonesë dhe pas përfundimit të afatit ligjor.
Më problematike ishin QV-të në qarkun Shkodër, pasi Bashkia Shkodër i kishte mbyllur të gjitha mjediset në varësi të saj, të përcaktuara më parë si qendra votimi. I gjithë procesi i shpërndarjes së materialeve zgjedhore në Bashkinë Shkodër dhe Vau i Dejës u realizua në orët e vona të natës të datës 29 qershor dhe me ndërhyrjen e forcave të policisë.

VI. INSTITUCIONE TË TJERA TË PËRFSHIRA NË PROCESIN ZGJEDHOR

Përveç administratës zgjedhore, në përgatitjen e procesit zgjedhor përfshihen një sërë institucionesh të tjera, me detyra dhe role të ndryshme.

Përgjatë procesit të vëzhgimit dhe komunikimit institucional me këto institucione është vërejtur kryesisht një mosreagim nga ana e tyre si dhe mungesë transparence. Kjo pasi një pjesë e mirë e tyre ose iu janë përgjigjur në mënyrë të paplotë kërkesave të bëra, ose nuk iu janë përgjigjur fare, në shkelje të plotë të Ligjit për Informimin Publik, si dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave i cili përforcon akoma më shumë dhe iu jep "pozitë të privilegjuar" në marrjen e informacionit organizatave që vëzhgojnë zgjedhjet dhe që janë të akredituara nga KQZ-ja.

VI.1. Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil dhe Task-Forca e ngritur nga Këshilli i Ministrave për monitorimin e përdorimit të administratës dhe burimeve shtetërore në fushatë

Në datë 25 prill 2019, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil (KMSHC) iu dërgoi institucioneve të administratës shtetërore një shkresë orientuese për mënyrën e organizimit të procesit të monitorimit të sjelljes së nëpunësve civilë gjatë fushatës zgjedhore.
Në zbatim të kësaj shkrese dhe të legjislacionit përkatës[194] çdo institucion kishte detyrimin të ngrinte Grupin e Punës për Monitorimin e Sjelljes së Nëpunësve Civilë gjatë Fushatës Zgjedhore, të miratonin Rregulloren e këtij grupi pune, si dhe t'i raportonin gjetjet Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

193 Për më shumë shih Shtojca nr. 5 - Tabela e ndryshimeve të vendndodhjeve të Qendrave të Votimit.

194 Ligji nr. 152/2013 datë 30.05.2013 (i ndryshuar) *"Për nëpunësin civil"*, Ligji nr. 9131 datë 09.03.2003 *"Për rregullat e etikës në administratën publike"*, Ligji nr. 90/2012 datë 27.02.2012 *"Për Organizmin dhe funksionimin e administratës shtetërore"*, etj.

Përveç ngritjes së grupeve të monitorimit në institucione dhe raportimit tek Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, Këshilli i Ministrave miratoi më datë 10 maj 2019 Vendimin "Për mbikëqyrjen e përdorimit të burimeve të administratës publike në fushatën zgjedhore"[195], referuar të cilit u ngrit një Task-Forcë me qëllim koordinimin e procesit të monitorimit.

Task-Forca drejtohej nga zv. Kryeministri dhe kishte në përbërje të saj 6 ministra dhe drejtuesit e 4 institucioneve[196].

Monitorimi i përcaktuar në këtë vendim, përfshinte jo vetëm përdorimin e burimeve shtetërorë në fushatën zgjedhore, por edhe sjelljen dhe përfshirjen e drejtpërdrejtë ose jo, të nëpunësve të administratës shtetërore.

Veprimtaria e Task-Forcës, pavarësisht se do të duhej të ishte transparente dhe gjithëpërfshirëse, nuk u reflektua e tillë.

Nga informacione dytësorë në dispozicion të KRIIK[197], ka të dhëna për një mbledhje të kryer nga Task-Forca, më datën 19 qershor 2019, e cila citohet të ketë qenë mbledhja e dytë, ndërkohë që sipas VKM-së për ngritjen e saj, ajo duhej të mblidhej rregullisht, por jo më pak se një herë në javë[198].

Gjithashtu, nga komunikimi verbal me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, vëzhguesve të KRIIK iu është konfirmuar se ky institucion nuk është thirrur ndonjëherë në mbledhjet e task-forcës.

Deri në momentin e publikimit të këtij raporti, Task-Forca nuk ka nxjerrë një raport publik në lidhje me veprimtarinë e vet, ndërkohë që nuk ka një përgjigje zyrtare nga ana e saj mbi kërkesën e bërë nga KRIIK për numrin e mbledhjeve dhe një kopje të procesverbaleve të tyre.

KRIIK iu drejtua me kërkesë zyrtare, në datë 31 korrik 2019, të gjitha ministrive dhe institucioneve të përfshira në Task-Forcë si dhe ministrive të tjera të Qeverisë Shqiptare (17 institucione në total)[199], duke kërkuar kopje të dokumentacionit[200] që duhej të ishte nxjerrë prej tyre në funksion dhe zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave apo Urdhrit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

---

195 Vendimi nr. 283 datë 10.05.2019 "*Për marrjen e masave dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore, gjatë procesit zgjedhor për zgjedhjet vendore për vitin 2019*".

196 Për koordinimin e procesit të monitorimit, sipas Vendimi nr. 283 datë 10.05.2019, u krijua Task-Forca që drejtohej nga Zëvendëskryeministri dhe kishte në përbërje: Ministrin e Brendshëm; Ministrin e Mbrojtjes; Ministrin e Financave dhe Ekonomisë; Ministrin e Arsimit, Sportit dhe Rinisë; Ministrin e Drejtësisë; Ministrin e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin; Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave; Drejtorin e Departamentit të Administratës Publike; Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit; Drejtorin e Parandalimit dhe Pastrimit të Parave, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.
Në mbledhjet e Task-Forcës ftohen të marrin pjesë: Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil; Avokati i Popullit; një përfaqësues nga Prokuroria e Përgjithshme; një përfaqësues nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

197 Informacioni citohet nga një memo e dërguar Ministres së Drejtësisë, zj. Etilda Gjonaj, në datë 8 korrik 2019 nga Grupi i Monitorimit i ngritur pranë Ministrisë së Drejtësisë, memo e cila përfshihet në përgjigjen zyrtare të kthyer nga Ministria e Drejtësisë për KRIIK. Kjo referencë, është e vetmja e gjetur nga KRIIK në lidhje me mbledhje të kryera prej Task-Forcës. Sipas memos, mbledhja e datës 19 qershor 2019 është mbledhja e dytë e Task-Forcës, por nuk ka informacion se kur është kryer mbledhja e parë. Gjithashtu, në raportin e Ministrisë së Bujqësisë, dërguar KRIIK në përgjigje të kërkesës për informacion, citohet një mbledhje e kryer nga Task-Forca, por pa cituar datën në të cilën kryer, ndërkohë që vetë raporti në dispozicion është pa datë.

198 Vendimi nr. 283 datë 10.05.2019 *"Për marrjen e masave dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore, gjatë procesit zgjedhor për zgjedhjet vendore për vitin 2019*", pika 24.

199 Ministria e Financave, Ministria e Mbrojtjes , Ministria e Arsimit, Ministria e Drejtësisë, Ministria Marrëdhënieve me Parlamentin, Ministria e Brendshme, Ministria e Kulturës, Ministria e Turizmit, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Infrastrukturës, Ministria e Bujqësisë, Ministria e Jashtme, Këshilli i Ministrave, Drejtoria e Parandalimit të Pastrimit të Parave, Policia e Shtetit, Drejtoria e Administratës Publike dhe Prokuroria e Përgjithshme.

200 Kopje të raportit/eve të paraqitura prej institucionit përkatës pranë Task-Forcës, Kopje të raporteve të brendshme të institucionit, Kopje të Urdhrit për ngritjen e grupit të monitorimit/inspektimit, Listën emërore të funksionarëve të institucionit të përfshirë në këtë grup.

Dhjetë prej këtyre institucioneve kanë kthyer përgjigje[201], ndërkohë që shtatë ende jo, pavarësisht tejkalimit të çdo afati ligjor, dhe në kundërshtim të hapur me Ligjin për të Drejtën e Informimit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dërguar si përgjigje nga institucionet që u përgjigjën, konstatohet se disa prej tyre janë jo të plota, duke qenë se kanë dërguar vetëm urdhrin për ngritjen e grupit të monitorimit dhe kanë injoruar pjesën tjetër të kërkesave[202].

Raportet dhe informacionet shtesë të dërguara, rezultojnë të kenë përmbajtje me nivele të ndryshme detajimi.
Vërehet se raportet nuk kanë një strukturë të përcaktuar, por përdorin formate të ndryshme raportimi, pavarësisht se të gjitha janë në zbatim të të njëjtave dispozita ligjore.

Konstatohet se në asnjë prej raporteve të dërguara nuk rezultojnë shkelje të rregullave dhe nuk raportohen masa të marra ndaj ndonjë nëpunësi.

Aktiviteti i Task-forcës për monitorimin e përdorimit të administratës dhe burimeve shtetërore në fushatën zgjedhore, një eksperiencë pozitive e nisur në vitin 2017, por e penguar në efektet e saj institucionalisht, e risjellë në procesin zgjedhor të 2019, por sërish e lënë në inefikasitet, duket se përbën një mekanizëm të fortë të cilit politika dhe pushteti i druhet.
Lind nevoja që modeli i saj të përmirësohet dhe të rregullohet në mënyrë solide, që të mund të garantojë funksionalitet të vërtetë e efikas, si dhe të sigurojë një transparencë të plotë ndaj publikut.

VI.2. Ministria e Brendshme

Ministria e Brendshme është një nga institucionet që ka një rol shumë të rëndësishëm në procesin zgjedhor. Jo vetëm në kuadër të garantimit të sigurisë publike dhe mbarëvajtjes në tërësi të procesit, por edhe në procesin e hartimit dhe saktësimit të listave të zgjedhësve.

Një ditë pas dekretimit të datës së zgjedhjeve prej Presidenti të Republikës, zv/Ministri i Brendshëm nxori Udhëzimin përkatës[203] për hartimin e listave të zgjedhësve.
Bazuar në këtë udhëzim, të gjitha zyrat e gjendjes civile në bashkëpunim me Kryetarët e Bashkive, ndërmorën për më shumë se gjashtë muaj një proces verifikimi dhe saktësimi të listave, proces i cili mbyllet me hartimin e listës finale të zgjedhësve 40 ditë përpara ditës së zgjedhjeve, pra më datë 21 maj 2019.

Ministria e Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (DPGJC), ndryshe nga proceset zgjedhore të mëparshme, nuk publikuan asnjë të dhënë zyrtarisht mbi ecurinë e procesit, përveç njoftimit, të bërë më datë 25 maj 2019 në faqen e internetit të Ministrisë, mbi publikimin e listës finale të zgjedhësve[204].

201 Ministria e Financave, Ministria e Mbrojtjes , Ministria e Drejtësisë, Ministria e Kulturës, Ministria e Turizmit, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Infrastrukturës, Ministria e Bujqësisë, Policia e Shtetit, Drejtoria e Administratës Publike.

202 - Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministria e Infrastrukturës kanë dërguar vetëm urdhrat për ngritjen e grupit të punës për monitorimin e sjelljes së nëpunësve civilë gjatë fushatës zgjedhore dhe rregulloren e këtij grupi pune, por jo raportet e grupit të punës; - Ministria e Shëndetësisë ka dërguar kopje të urdhrit për ngritjen e grupit të monitorimit dhe të rregullores së tij si dhe listëprezencat nga punonjësit e Ministrisë, por jo raportin e dërguar tek Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

203 Udhëzimi nr. 295/1 datë 6.11.2018 "*Për procedurat e hartimit të listave të zgjedhësve për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019*", Fletore Zyrtare nr. 169/2018.

204 Ministria e Brendshme: Publikohet Lista Përfundimtare e Zgjedhësve, për zgjedhjet vendore të 30 qershorit.

Edhe lidhur me këtë publikim, mbetet e paqartë nëse lista finale e zgjedhësve është publikuar në datën e njoftimit, pra katër ditë më vonë se afati i fundëm ligjor i parashikuar, apo lista është publikuar në kohë dhe njoftimi në faqen e Ministrisë është bërë me katër ditë vonesë[205].

Një moment shumë i rëndësishëm në tërë procesin zgjedhor është njoftimi me shkrim i qytetarëve, njoftim i cili përmban "qendrën e votimit, vendndodhjen dhe adresën e saj, si dhe numrin rendor të zgjedhësit në listën e zgjedhësve të qendrës së tij të votimit". Zgjedhësi ose një anëtar i familjes së tij duhet të firmosë për marrjen e njoftimit.

Kuadri ligjor ngarkon Ministrin e Brendshëm për t'iu shpërndarë fondin e nevojshëm financiar Bashkive për realizimin e këtij procesi, madje ngarkon që nëpërmjet Udhëzimit të hartuar, Kryetari i Bashkisë të raportojë për përmbushjen e këtij detyrimi[206].

Edhe në këtë proces, sikundër edhe në proceset e mëparshme, rezultoi se Ministri i Brendshëm nuk përmbushi plotësisht kërkesat e Kodit Zgjedhor.
- Në udhëzimin e miratuar nuk parashikohet asnjë mekanizëm raportimi mbi këtë proces.
- Gjithashtu, modelet e njoftimit të miratuara, nuk përmbanin hapësirë të përcaktuar ku qytetari të konfirmojë (duke nënshkruar) marrjen e njoftimit me shkrim, sikundër kërkohet nga Kodi Zgjedhor.
- Edhe përsa i përket fondeve të shpërndara për realizimin e procesit të njoftimit me shkrim të zgjedhësve, një pjesë e bashkive që i kanë kthyer përgjigje kërkesës së KRIIK, raportojnë për lëvrim të fondit në mes të muajit shkurt, ndërkohë që periudha e parashikuar nga Kodi Zgjedhor për të kryer njoftimin ishte prej datës 4 dhjetor 2018 deri më datë 2 shkurt 2019.

Situata bëhet akoma më shqetësuese, kur faktohet se procesi i njoftimit me shkrim është vendosur të bëhet pas gjenerimit të listës finale të zgjedhësve, pra pas datës 21 maj 2019, në kundërshtim të hapur me tërë mekanizmin e parashikuar për këtë proces korrigjimi dhe njoftimi nga Kodi Zgjedhor.
Ky fakt i është bërë me dije KRIIK nga disa bashki në komunikimin zyrtar të patur, por është evidentuar edhe zyrtarisht në komunikimin që një nga auditët teknicienë ka patur me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile (DPGJC)[207], ku rezulton kjo e fundit që ka dhënë këtë orientim të gabuar.

Në zbatim të dispozitave të Ligjit të ashtuquajtur të dekriminalizimit[208] dhe Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm Nr. 225, datë 11.05.2016, DPGJC në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, duhet të evidentojnë dhe heqin nga lista e zgjedhësve shtetasit që nuk mund të ushtrojnë të drejtën e votës për shkak të kryerjes së veprave penale specifike të parashikuara.

Gjithashtu edhe lidhur me këtë proces, bazuar në raportimet e të dy auditëve teknicienë të kontraktuar prej Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, u vërejt një mungesë koordinimi ndërmjet institucioneve.

Në përfundim, KRIIK evidenton faktin shqetësues se Ministria e Brendshme dhe

205 Raportet e auditëve teknicienë të kontraktuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve citojnë se lista finale e zgjedhësve është publikuar brenda afateve ligjore.

206 Neni 52 "Njoftimi me shkrim i zgjedhësve", pika 4.

207 Në Raportin e audituesit Zamir Hoxha *"Mbi verifikimin e veprimeve në bazën e të dhënave të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile"*, pasqyrohet se në përgjigje të një email-i zyrtar të dërguar më datë 30 Maj 2019, ku është kërkuar informacion mbi njoftimin me postë të qytetarëve nga ana e njësive vendore dhe raportimet e tyre n.q.s. ka pasur, DPGJC thekson që me gjenerimin e listës përfundimtare te zgjedhësve, DPGJC, mori masat për gjenerimin e njoftimit te zgjedhësve për çdo njësi administrative / bashki.

208 Ligji nr. 138/2015 datë 17.12.2015 *"Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"*

DPGJC-ja nuk ka kthyer asnjë përgjigje ndaj dy shkresave zyrtare të dërguara, ku kërkohej informacion në lidhje me ecurinë e procesit të korrigjimit dhe publikimit të listave të zgjedhësve.
Gjithashtu, kjo Ministri nuk iu përgjigj as kërkesës lidhur me zbatimin e detyrave që rrjedhin nga Vendimi i Këshillit të Ministrave për monitorimin e veprimtarisë së institucioneve në fushatë, pavarësisht tejkalimit të çdo afati ligjor sipas Ligjit për të Drejtën e Informimit. [209]

Kjo mungesë e thellë transparence qoftë në raport me sjelljen e duhur institucionale pro-aktive, qoftë në raport me mosdhënien e asnjë informacioni, në shkelje të ligjit të informimit dhe VKM së posaçme, ngre pikëpyetje jo të vogla mbi tërë ecurinë e procesit të kryer prej Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe Ministrisë së Brendshme.

VI.3. Prefekturat

Në zbatim të kuadrit ligjor[210] dhe në përmbushje të detyrave të ngarkuara lidhur me procesin zgjedhor, prefektët propozojnë objektet në nivel qarku, të cilat do të shërbejnë si Vende të Numërimit të Votave (VNV).
Ky proces u realizua konform ligjit nga Prefektët, të cilët bënë propozimet e tyre në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Pas Dekretit të Presidentit Nr. 11199 të datës 10 qershor 2019, me anë të të cilit Presidenti i Republikës shfuqizoi dekretin për caktimin e datës së zgjedhjeve të 30 qershorit, disa bashki (kryetarët e të cilave ishin zgjedhur nën siglën e PD-së apo LSI-së) kërkuan lirimin e ambienteve në varësi të tyre, të cilat ishin përcaktuar me vendim të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve si Vende të Numërimit të Votave.

Kjo situatë, krijoi një ngërç në ecurinë e procesit. Pas kësaj shtatë prefektë[211] i kërkuan zyrtarisht Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që të caktonte si vende të numërimit të votave disa ambiente të tjera.

VI.4. Bashkitë

Bashkitë, si Njësi të Qeverisjes Vendore, përfshihen në procesin zgjedhor nëpërmjet publikimit të listave të zgjedhësve, njoftimit me shkrim të zgjedhësve, si dhe përcaktimit të qendrave të votimit në ambiente të përshtatshme sipas kritereve ligjore brenda territorit përkatës.

Përsa i përket publikimit të ekstrakteve të listave të zgjedhësve, nga monitorimi në mënyrë të pjesshme dhe jo sistematike të këtij procesi prej vëzhguesve të KRIIK, rezultoi se disa bashki[212] patën probleme me publikimin në kohë të çdo ekstrakti të përbërësve zgjedhorë.

Njoftimi me shkrim i zgjedhësve për zgjedhjet e 30 qershorit 2019, ishte një proces i cili duhet të kryhej prej ekipeve të ngarkuara nga Bashkia në periudhën 4 dhjetor 2018 deri më 2 shkurt 2019.

209 Shkresat janë dërguar më datë 11 qershor 2019 dhe 29 korrik 2019.

210 Ligji nr. 107/2016 "*Për Prefektin e Qarkut*".

211 Prefekti i Qarkut Kukës, Prefekti i Qarkut Vlorë, Prefekti i Qarkut Elbasan, Prefekti i Qarkut Shkodër, Prefekti i Qarkut Korçë, Prefekti i Qarkut Dibër dhe Prefekti i Qarkut Tiranë.

212 Bashkia Elbasan, Bashkia Librazhd, Bashkia Peqin, Bashkia Malësi e Madhe, Bashkia Shkodër, Bashkia Durrës, Bashkia Korçë, Bashkia Selenicë, etj.

Nga 61 bashki, vetëm 30 i kthyen përgjigje kërkesës zyrtare të KRIIK në lidhje me mbarëvajtjen e këtij procesi[213], në kundërshtim të hapur me Ligjin për të Drejtën e Informimit.

Referuar informacioneve të dhëna nga disa bashki[214], në përgjigje të shkresës së KRIIK, evidentohet se ka mosnjohje të kuadrit ligjor në lidhje me procesin e njoftimit me shkrim të zgjedhësve, pasi janë shprehur se ky proces kryhet pasi të gjenerohet lista finale e zgjedhësve.

VI.5. Gjykatat

Kandidati i shpallur si fitues i procesit zgjedhor për Kryetar Bashkie, prej Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) ose Komisionit Zonal të Administrimit Zgjedhor (KZAZ), në zbatim të Ligjit "Për vetëqeverisjen vendore" i kërkon Gjykatës së Rrethit Gjyqësor që të shprehet lidhur me ligjshmërinë e mandatit të dhënë.

Në përfundim të zgjedhjeve të 30 qershorit 2019, mandatet e Kryetarëve të Bashkive u verifikuan nga 22 Gjykata të Rrethit Gjyqësor në vend. Procesi i verifikimit të mandateve nga Gjykatat, nisi në datën 11.07.2019 dhe përfundoi në datën 31.07.2019. Në rezultante të këtij procesi, u vu re se Gjykatat e Rrethit u shprehën me tre lloje të ndryshme vendimesh në lidhje me të njëjtin objekt.

VI.5.1. Verifikimi i mandatit të kryebashkiakes së zgjedhur të Durrësit nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës

Vendimi nr. 11-2011-4127, datë 17.07.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, vendosi rrëzimin e kërkesës së kërkueses Valbona Sako për vërtetimin e mandatit të Kryetarit të Bashkisë Durrës, me argumentin se Partia Bindja Demokratike u regjistrua jashtë afateve ligjore nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, si pjesëmarrëse në procesin zgjedhor të datës 30 qershor 2019, element i cili i bënte disa vendime të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, akte administrative absolutisht të pavlefshme[215].

Megjithëse në dispozitivin e vendimit citohej se Gjykata ku mund të bëhej ankimim, ishte Gjykata e Apelit Durrës, subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, vendosi që të ridepozitonte të njëjtën kërkesë, me të njëjtin objekt, sërish tek Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës.
Nëpërmjet një gjykimi tjetër, për të njëjtën çështje por me një tjetër kërkues, Gjykata vendosi verifikimin e mandatit të Kryetares së Bashkisë Durrës.

213 Bashkia Berat, Bashkia Kuçovë, Bashkia Skrapar, Bashkia Poliçan, Bashkia Dibër, Bashkia Mat, Bashkia Bulqize, Bashkia Durrës, Bashkia Shijak, Bashkia Elbasan, Bashkia Cërrik, Bashkia Belsh, Bashkia Patos, Bashkia Roskovec, Bashkia Lushnjë, Bashkia Mallakastër, Bashkia Gjirokastër, Bashkia Libohovë, Bashkia Përmet, Bashkia Këlcyre, Bashkia Dropull, Bashkia Korçë, Bashkia Maliq, Bashkia Devoll, Bashkia Pustec, Bashkia Kukës, Bashkia Kurbin, Bashkia Pukë, Bashkia Konispol, Bashkia Delvinë.

214 Bashkia Bulqizë, Bashkia Berat, Bashkia Cërrik, Bashkia Dibër, Bashkia Konispol, Bashkia Libohovë, Bashkia Lushnjë, Bashkia Poliçan.

215 Vendimi nr. 11-2019-4127 datë 17.07.2019: *"... bazuar në nenin 9 të ligjit "Për Partitë Politike", në nenin 64 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë , në nenet 108, 109 dhe 110 të Kodit të Procedurave Administrative, konstaton si akte absolutisht të pavlefshme aktet e mëposhtme:*
1- Vendimin nr. 230, datë 27.04. 2019 të KQZ-së, Për regjistrimin e subjektit zgjedhor "Partia Bindja Demokratike" për Zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 30.06.2019.
2- Vendimin nr. 660, date 27.05.2019 të KQZ-së, Për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatët për Kryetar Bashkia Durrës për Zgjedhjet për organet e Qeverisjes Vendore të datës 30.06.2019.
3- Vendimin nr. 944, datë 05.07.2019 të KQZ-së, Për nxjerrjen e rezultatit të votimit për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Durrës, Qarku Durrës, në zgjedhjet vendore të datës 30.06.2019".

Në këtë rast, arsyetimi[216] i përdorur i rigjykimit ishte se, në kuptim të ligjit, kjo ishte një çështje që përveç objektit nuk kishte asgjë të njëjtë me gjykimin e mëparshëm, e për më tepër që vendimi parë i dalë prej tij nuk ka marrë ende formë të prerë.

VI.5.2. Verifikimi i mandatit të kryebashkiakut të zgjedhur të Vorës nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë

Në vendimin e datës 15 Korrik 2019 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, vendosi të shpallë moskompetencë lëndore për shqyrtimin e kërkesës së Kryetarit të Bashkisë Vorë me objekt vërtetimin e mandatit të tij si Kryetar i Bashkisë Vorë, i zgjedhur nga Koalicioni Aleanca për Shqipërinë Europiane. Kjo Gjykatë ia delegoi kompetencën Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ndërkohë që parashikonte se ankimim kundër këtij vendimi mund të bëhej pranë Gjykatës së Lartë[217].

Partia Socialiste ndoqi të njëjtën rrugë sikurse me mandatin e kryetares së Bashkisë Durrës, duke depozituar një kërkesë të re në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, nga ri-shqyrtimi i së cilës u vendos verifikimi i mandatit të Kryetarit të bashkisë Vorë[218].

Të dyja këto vendime, ishin të ndryshme nga vendimet e gjykatave të tjera në vend, të cilat vendosën verifikimin e mandateve të kryetarëve të bashkive të zgjedhur në 30 qershor 2019.

Këto tre lloje vendimesh të marra, si dhe referuar edhe vendimeve të tjera të Gjykatave të marra në shqyrtim nga KRIIK, ngrenë shqetësimin për leximin e ndryshëm që gjykata bën, shpesh bazuar në kontekstet e krijuara , si dhe përdorur bazë të ndryshme ligjore.

VI.5.3. Kërkesat në lidhje me përfshirjen në listat e zgjedhësve

Shtetasit shqiptarë, të cilët nuk janë të përfshirë në listën përfundimtare të zgjedhësve, kanë të drejtë të bëjnë kërkesë në gjykatë dhe me vendim të kësaj të fundit të mund të votojnë pranë Qendrës së Votimit të tyre.

Nga informacioni i përcjellë nga Gjykatat e Rrethit Gjyqësor, rezulton se në tre gjykata[219] ka patur kërkesa nga shtetas të cilët nuk figuronin në listën finale të zgjedhësve.

---

216 Vendimi nr. 11-2019-4197 datë 19.07.2019: *"Neni 451/a i K.Pr.Civile, i cili rregullon edhe parimin e "gjësë së gjykuar" dhe jurisprudencës së Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese mbi gjënë e gjykuar, e njëjta çështje nuk mund të gjykohet sërish nga një gjykatë tjetër nëse plotësohen njëherazi këto kushte: - çështja i referohet të njëjtave palë; - çështja ka të njëjtin objekt kërkimi; - çështja ka të njëjtin shkak ligjor; - vendimi i gjykatës mbi çështjen është i formës së prerë. Mjafton të mos plotësohet njëri nga këta elementë që të mos ndodhemi përpara "gjësë së gjykuar". Në rastin në shqyrtim rezulton që veç objektit të kërkimit (vërtetimi i mandatit të zj. Valbona Sako si Kryetare e Bashkisë Durrës), asnjë prej elementëve të tjerë të mos plotësohet".*

217 Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë: *"Gjykata bazuar në nenet 61/1 e 62 të Kodit të Procedurës Civile, nenit 60(1), të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", si dhe nenin 72 të ligjit nr.49/2012 "Për organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative", i ndryshuar, vendosa: Shpalljen e moskompetencës lëndore për shqyrtimin e çështjes me nr.10727 akti, dt. Regj 11.07.2019, me kërkues Agim Kajmaku".*

218 KRIIK nuk disponon një kopje të këtij vendimi, pasi gjykata e Tiranës refuzoi t'a vinte në dispozicion me arsyetimin se, referuar ligjit *"Për mbrojtjen e të dhënave personale"*, këto vendime kërkojnë miratimin e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, arsyetim i cili është totalisht i pabazuar në ligj.

219 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet 4 kërkesa; Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë 2 kërkesa dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë 78 kërkesa.

Në pesë gjykata[220] ka patur kërkesa për të votuar nga individë të cilët ishin duke vuajtur dënimin pranë Institucioneve të Ekzekutimit të Veprave Penale (IEVP). Për të gjitha këto çështje gjykatat përkatëse janë shprehur me vendime.

Në të dhëna e mësipërme nuk përfshihet informacion nga pesë[221] Gjykata, të cilat refuzuan t'i përgjigjen kërkesës së KRIIK për të informuar mbi këto çështje.

VI.5.4. Vendimmarrja e gjykatave në lidhje me vepra penale që lidhen me zgjedhjet

Nga shqyrtimi i informacionit të përcjellë nga Gjykatat e Rretheve Gjyqësore rezulton se dy gjykata[222] në vend janë shprehur me vendime në lidhje me vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve, në zbatim të neneve të Kodit Penal[223].
Theksohet se procedimet penale në lidhje me këto çështje janë iniciuar nga Prokuroria.

VI.6. Policia e Shtetit

Për shkak të situatës tejet të tensionuar politike, të shoqëruara me protesta kombëtare dhe lokale të organizuara apo të mbështetura prej opozitës së bashkuar, angazhimi i Policisë së Shtetit, ka qenë në prezencë të shtuar përgjatë gjithë periudhës, nga muaji shkurt 2019 kur filluan protestat e opozitës e në vazhdim[224], sidomos në ditën e zgjedhjeve.

Sipas Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, gjatë ditës së zgjedhjeve u angazhuan në terren 7.779 forca policie, dhe gjithë trupa e policisë së shtetit ka qenë në gatishmëri 100% nga dita e premte deri në përfundimin e procesit të numërimit.

Gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, për shkak të protestave të organizuara nga opozita pati dëmtime të KZAZ-ve në 14 qytete[225], ndërkohë që ditën e zgjedhjeve u regjistruan 2 incidente, njëri në qytetin e Durrësit[226] dhe një tjetër në Klos[227].

220 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër 15 kërkesa; Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës 8 kërkesa; Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë 118 kërkesa; Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier 23 kërkesa; Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat 7 kërkesa.

221 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec.

222 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat e cila ka vlerësuar masën e arrestit për 10 shtetas dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës e cila ka vlerësuar masën e arrestit për 15 shtetas.

223 Në Kreun X të "Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë", Neni 325-332, përcaktohen 10 vepra penale që cenojnë lirinë dhe integritetin e zgjedhjeve të lira: *Pengimi i subjekteve zgjedhore; Falsifikimi i materialit zgjedhor dhe rezultateve të zgjedhjeve; Dëmtimi me dashje i materialit zgjedhor; Shkelja e fshehtësisë së votimit; Votimi më shumë se një herë ose pa u identifikuar; Dhënia e shpërblimeve dhe e premtimeve; Detyrimi për pjesëmarrje në veprimtari politike; Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje; Pengimi i zgjedhësit; Braktisja e detyrës nga anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve; Shkelja e së drejtës së zgjedhjes; Shpërdorimi i autoritetit ushtarak*.

224 Përgjatë kësaj periudhe janë proceduar penalisht 316 shtetas, nga të cilët 79 u arrestuan, 92 janë në kërkim dhe 145 të tjerë u proceduan në gjendje të lirë. Gjithashtu gjatë protestave të këtyre muajve u dëmtuan 60 punonjës policie.

225 Berat, Kavajë, Kamëz, Vorë, Lezhë, Shkodër, Vau-Dejes, Mat, Klos, Bulqizë, Dibër, Tropojë, Pogradec, Devoll.

226 Në datën 30 qershor 2019 një qytetar ka hyrë në qendër votimi armatosur. Ky person u arrestua.

227 Në datën 30 qershor në qytetin e Klosit, pranë një qendre votimi ka patur konflikt të dhunshëm midis 5 personave, të cilët u shpallën në kërkim.

Ngrihet shqetësimi për mosreagim të policisë lidhur me pengimin e zhvillimit të votimit në disa qendra votimi të ZAZ nr. 2.

Nga monitorimi i bërë rreth moszhvillimit të procesit zgjedho r në 9 qendra votimi në ZAZ nr. 2, Qarkun Shkodër dhe nga investigimi i bërë më pas, për aq sa ka qenë i mundur, evidentohet mosreagim dhe mospërmbushje e detyrës së Policisë së Shtetit në Qarkun Shkodër në vënien përpara përgjegjësisë së autorëve të cilët penguan zhvillimin e procesit zgjedhor në këto qendra votimi, duke privuar nga e drejta e zgjedhjes 4491shtetasve.

VI.7. Prokuroria

Prokuroria e Përgjithshme nënshkroi një memorandum bashkëpunimi me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve në datën 12 mars 2019, me synim një bashkëpunim dhe bashkërendim më të mirë të punës midis dy institucioneve.
Në kuadër edhe të këtij memorandumi, Prokuroria e Përgjithshme nxori Udhëzimin nr. 3 datë 21.06.2019[228] *"Mbi masat administrative dhe procedurale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm në periudhën para dhe pas zgjedhjeve",* qëllimi i të cilit përfshin jo vetëm verifikimin e integritetit të kandidatëve, por edhe rritjen e efektivitetit të hetimeve dhe ndjekjes penale ndaj autorëve të veprave penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik.

Deri në datën 29 qershor, numri i përgjithshëm i çështjeve të regjistruara për vepra penale që prekin zgjedhjet e lira në funksion të fushatës së zgjedhjeve vendore të datës 30 qershor 2019, ishte 12 procedime penale me 75 persona të arrestuar/ndaluar[229].

Ndërkohë, gjatë datës 30 Qershor 2019, deri në përmbyllje të procesit të votimit, nga Prokuroritë pranë Gjykatave të Rretheve Gjyqësore dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, rezulton se numri i përgjithshëm i çështjeve të regjistruara për vepra penale që prekin zgjedhjet e lira në funksion të fushatës së zgjedhjeve vendore të datës 30 qershor 2019, ishte 3 procedime penale me 2 persona të arrestuar[230].

228 Udhëzim i Përgjithshëm nr. 3, datë 21.06.2019 i Prokurorit të Përgjithshme *"Mbi masat administrative dhe procedurale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm në periudhën para dhe pas zgjedhjeve"*

229 - Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan ka regjistruar 2 procedime me 7 persona të arrestuar nga policia gjyqësore për veprat penale *"Organizimi dhe pjesëmarrja në grumbullime e manifestime të paligjshme"*, "*Pengimi i qarkullimit të mjeteve të transportit*" dhe "*Pengimi i subjekteve zgjedhore*", si dhe 1 person në hetim për veprën penale "*Thirrje publike për veprime të dhunshme*"; - Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër ka regjistruar 3 procedime me 21 persona të arrestuar për veprën penale "*Shkatërrimi me zjarr i pronës*", "*Dëmtimi me dashje i materialeve zgjedhore*" dhe "*Kundërshtimi i punonjësit të policisë*"; - Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë ka regjistruar 1 procedim penal me 7 persona të arrestuar dhe 2 të ndaluar për veprën penale "*Dëmtimi me dashje i materialit zgjedhor*", "*Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik*", "*Organizimi dhe pjesëmarrja në grumbullime e manifestim të paligjshme*"; - Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka regjistruar 1 procedim me 3 persona të arrestuar për veprën penale "*Dëmtimi me dashje i materialit zgjedhor*"; - Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat ka regjistruar 1 procedim penal në ngarkim të 10 personave për kryerjen e veprave penale "*Dëmtimi me dashje i materialit zgjedhor*", "*Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik*", *"Organizimi dhe pjesëmarrja në grumbullime e manifestim të paligjshme"* dhe "*Prishja e qetësisë publike*"; - Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë ka regjistruar 1 procedim penal me 6 persona të arrestuar dhe 2 në hetim për veprat penale "*Shkatërrimi i pronës*" dhe "*Organizimi dhe pjesëmarrja në grumbullime e manifestime të paligjshme*"; - Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec ka regjistruar 1 procedim penal me 2 persona të arrestuar për veprën penale "*Pengimi i subjekteve zgjedhore*"; - Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër ka regjistruar 1 procedim me 12 persona të arrestuar për veprën penale "*Dëmtimi me dashje i materialit zgjedhor*", "*Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik*"; - Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier ka regjistruar 1 procedim penal në ngarkim të 4 personave për veprën penale "*Dëmtimi me dashje i materialit zgjedhor*". .

230 - Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, ka regjistruar 1 procedim penal në ngarkim të 1 personi të arrestuar për kryerjen e veprave penale "*Dëmtimi me dashje i materialit zgjedhor*", "*Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje*", si dhe "*Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit*"; - Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka regjistruar 1 procedim penal në ngarkim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 639 datë 22.05.2019[231] i referoi Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, rastin e z. Bledar Sinella[232] regjistruar nga KZAZ nr. 42 Bashkia Kavajë si kandidat për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pas kërkesës të z. Bledar Sinella, i cili pretendonte se nuk kishte firmosur asnjë deklaratë, formular apo dokumentacion tjetër në kuadër të regjistrimit të tij si kandidat, u ndodh përballë mundësisë së kryerjes së një vepre penale, e konkretisht asaj për falsifikim të vulave stampave ose formularëve[233].

Duke mos qenë organi kompetent për të hetuar mbi vërtetësinë e dokumentacionit të paraqitur, dhe konkretisht formularit të vetëdeklarimit, KQZ-ja vendosi t'ia referonte çështjen Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Pavarësisht këtij referimi dhe ndonëse nuk pati asnjë prononcim nga Prokuroria, kandidati në fjalë, mbeti i përfshirë si kandidat në fletën e votimit për kryetar të Bashkisë Kavajë.

VII. REGJISTRIMI I SUBJEKTEVE ZGJEDHORE

Subjekt zgjedhor është çdo parti politike apo koalicion partish politike, të cilat regjistrohen si të tilla, sipas rregullave të përcaktuara në ligj në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe paraqesin kandidatë.
Gjithashtu, subjekt zgjedhor janë edhe kandidatët për kryetar bashkie si dhe kandidatët e pavarur, të cilët nuk mbështeten nga partitë politike, por nga një grup zgjedhësish, dhe i nënshtrohen procedurave të regjistrimit në KQZ apo KZAZ, të përcaktuara në Kodin Zgjedhor.

Për Zgjedhjet e 30 Qershorit 2019, u regjistruan në KQZ 42 parti politike nga të cilat vetëm 36[234] figuruan në fletën e votimit (duke qenë se pjesa tjetër nuk regjistroi asnjë kandidat apo listë kandidatësh). Nga këto parti politike, 27 prej tyre u grupuan në dy koalicione parazgjedhore[235].

---

të 1 personi të arrestuar i dyshuar për kryerjen e veprës penale "*Dëmtimi me dashje i materialit zgjedhor*", mbetur në tentativë; - Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat ka regjistruar 1 procedim penal pa autor për veprën penale të "*Shkatërrimit të pronës me eksploziv*".

231 Vendimi nr. 639 datë 22.05.2019 i KQZ-së *"Për shqyrtimin e kërkesës së tërheqjes nga kandidimi për kryetar të Bashkisë Kavajë z. Bledar Sinella, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019"* i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

232 Në datë 21.05.2019 në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve është protokolluar shkresa me nr.4088 prot., dhe lëndë *"Shprehje vullneti për të mos kandiduar dhe njoftim për tërheqje nga kandidimi"*. Z. Bledar Sinella, referuar kërkesës për tërheqje nga kandidimi ndër të tjera pretendon se nuk ka paraqitur asnjë dokument të nënshkruar prej tij pranë KZAZ nr. 42 Kavajë dhe as në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

233 Kodi Penal, neni 190 *(Ndryshuar me ligjin nr.9188, datë 12.2.2004, neni 6; shtuar me ligjin nr.9275, datë 16.9.2004, neni 15; shfuqizuar me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 47, datë 26.7.2012, pjesa që parashikon dënimin me gjobë si dënim kryesor): "Falsifikimi ose përdorimi i vulave, i stampave apo i formularëve të falsifikuar ose paraqitja e rrethanave të rreme në këto të fundit, që u drejtohen organeve shtetërore, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në katër vjet. Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë apo ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet. Kur falsifikimi bëhet nga personi që ka për detyrë hartimin e tyre, dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet".*

234 Partia Bindja Demokratike; Partia Balli Kombëtar; Partia Bashkimi Liberal Demokrat; Partia Aleanca Kuq e Zi; Partia Ora e Shqipërisë; Partia e Emigracionit Shqiptar; Partia Komuniste e Shqipërisë; Partia për Personat me Aftësi të Kufizuar; Partia Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane; Partia Aleanca Arbnore Kombëtare; Partia Demokracia Sociale; Partia Kristian Demokrate; Partia Lëvizja Punëtore Shqiptare; Partia e Pajtimit Kombëtar Shqiptar; Partia e Gjelbër; Partia G99; Partia e Reformave Demokratike Shqiptare; Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë; Partia Socialpunëtore Shqiptare; Partia Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet; Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve; Partia Demokrate Për Integrim e Prosperitet; Partia Aleanca Demokratike Shqiptare; Partia Socialiste e Moderuar; Partia Ardhmëria Shqiptare; Partia e Unitetit Kombëtar, Partia Socialdemokrate e Shqipërisë; Partia e të Drejtave të Mohuara; Partia Socialiste e Shqipërisë; Partia Aleanca e Maqedonasve për Integrim Europian; Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve të Shqipërisë; Partia Kombëtare Konservatore Albania; Partia për Liri Demokraci dhe Etikë; Partia Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen; Partia Demokracia e Re Europiane; Partia Fryma e Re Demokratike.

235 Koalicioni "Aleanca për Shqipërinë Europiane" regjistruar nga KQZ me vendimin nr. 251 datë 07.05.2019 dhe Koalicioni "Shpresa për Ndryshim" regjistruar nga KQZ me vendimin nr. 273 datë 10.05.2019.

Ndërkohë u regjistruan dhe garuan edhe 16 kandidatë të pavarur, nga të cilët 6 kandidatë për kryetar bashkie dhe 10 kandidatë për anëtar të këshillave bashkiakë. Pra në total për këto zgjedhje u regjistruan dhe garuan 52 subjekte zgjedhore.

VII.1. Regjistrimi i partive politike

Koalicioni Aleanca për Shqipërinë Europiane përbëhej nga 21 parti politike[236] ndërsa Koalicioni Shpresa për Ndryshim përbëhej nga gjashtë parti politike[237]. Nëntë parti politike[238] garuan në mënyrë të pavarur jashtë koalicioneve.

Ndërsa gjashtë parti politike[239], pavarësisht se u regjistruan në fillim të procesit në KQZ, nuk dërguan asnjë kandidat për konkurrim, duke mos u shndërruar kështu në subjekte zgjedhorë garues, e rrjedhimisht as pjesë e fletës së votimit.

Në lidhje me regjistrimin e subjekteve zgjedhore, Kodi Zgjedhor parashikon kritere dhe afate, të cilat jo në çdo rast u aplikuan me rigorozitet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Një shqetësim madhor në këto zgjedhje ishte regjistrimi i subjektit zgjedhor Bindja Demokratike në shkelje flagrante të ligjit[240].

Më datë 27 prill 2019, KQZ-ja mori vendimin për regjistrimin e kësaj partie si subjekt zgjedhor[241].
Ky vendim është në shkelje të hapur të Kodit Zgjedhor, i cili përcakton se partitë politike, në mënyrë që të regjistrohen si subjekte zgjedhore duhet të dorëzojnë "vërtetimin që partia është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë[242]".

Në kundërshtim me këtë dispozitë, siç citohet në Vendimin e KQZ-së për regjistrimin e Bindjes Demokratike, KQZ-ja e regjistroi këtë parti bazuar në një vërtetim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku thuhej se Gjykata "ka vendosur regjistrimin si person juridik të Partisë "Bindja Demokratike" në regjistrin e partive politike".

Në Vendim, gjithashtu, citohet se ky vendim i Gjykatës nuk është i formës së prerë.
Jo vetëm kaq, por në rastin e regjistrimit të subjektit "Partia Bindja Demokratike" vendimi i regjistrimit në Gjykatë[243] është marrë dy ditë pas kalimit të afatit të regjistrimit të subjekteve zgjedhore, pra më datën 25 prill 2019.

236 Partia Aleanca Arbnore Kombëtare, Partia Demokracia Sociale, Partia Kristian Demokrate, Partia Lëvizja Punëtore Shqiptare, Partia e Pajtimit Kombëtar Shqiptar, Partia e Gjelbër, Partia G99, Partia e Reformave Demokratike Shqiptare, Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë, Partia Socialpunëtore Shqiptare, Partia Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet, Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve, Partia Demokrate për Integrim e Prosperitet, Partia Aleanca Demokratike Shqiptare, Partia Socialiste e Moderuar, Partia Ardhmëria Shqiptare, Partia e Unitetit Kombëtar, Partia Socialdemokrate e Shqipërisë, Partia e të Drejtave të Mohuara, Partia Socialiste e Shqipërisë dhe Partia Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane.

237 Partia Demokracia e Re Europiane, Partia Balli Kombëtar, Partia Bashkimi Liberal Demokrat, Partia Aleanca Kuq e Zi, Partia Ora e Shqipërisë dhe Partia e Emigracionit Shqiptar.

238 Partia Fryma e Re Demokratike, Partia Komuniste e Shqipërisë, Partia për Personat me Aftësi të Kufizuar, Partia Aleanca e Maqedonasve për Integrim Europian, Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve të Shqipërisë, Partia Kombëtare Konservatore Albania, Partia për Liri Demokraci dhe Etikë, Partia Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen dhe Partia Bindja Demokratike.

239 Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar, Partia Zgjidhja, Partia Ligj dhe Drejtësi, Partia Lista e Barabartë, Partia Shqipëria e Re dhe Partia Aleanca Popullore.

240 Më datë 6 maj 2019, KRIIK publikoi Deklaratën *"Ruajtja e paanësisë dhe integritetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, rëndësi jetike për funksionimin e shtetit demokratik e ligjor"*, në të cilën trajtohej edhe kjo çështje.

241 Vendim nr. 230 datë 27.04.2019 i KQZ-së *"Për regjistrimin si subjekt zgjedhor, Partia "Bindja Demokratike" për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019".*

242 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 64 *"Regjistrimi i partive politike në zgjedhje"* pika 2, germa a *"Për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor për çdo lloj zgjedhjeje, një parti politike duhet të paraqesë në KQZ: a) vërtetimin që partia është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë; ...".*

243 Regjistruar me vendimin nr. 513 datë 25.04.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ky vendim i KQZ-së, përveçse është në shkelje të hapur të afatit të përcaktuar nga Kodi Zgjedhor, është edhe në kundërshtim me praktikën ligjore të ndjekur nga vetë ajo në Zgjedhjet Parlamentare 2013[244] dhe në Zgjedhjet Vendore 2015[245], njëkohësisht edhe me praktikën dhe vendimmarrjen edhe të Kolegjit Zgjedhor të vitit 2013[246], për mosregjistrimin e subjektit zgjedhor, vendimi i regjistrimit në Gjykatë të së cilit, në afatin e përcaktuar nga Kodi Zgjedhor, nuk ka marrë ende formë të prerë.

Megjithëse Kryetari i KQZ-së z. Zguri solli në vëmendje të anëtarëve këtë shqetësim, katër anëtarët e tjerë të KQZ-së, jo vetëm nuk e morën në konsideratë praktikën e vendosur, por në mënyrë të paprecedentë nuk zhvilluan asnjë diskutim apo parashtrim të qëndrimit të tyre dhe "në bllok" votuan "pro" regjistrimit të subjektit, përkundrejt votës "kundër" të Kryetarit të KQZ-së.

Ky qëndrim rezultoi i kundërt edhe me qëndrimin e vetë KQZ-së të shprehur në Deklaratën për Shtyp[247] të datës 4 janar 2019, ku deklarohej se për shkak edhe të kritikave nga misionet vëzhguese ndërkombëtare[248], KQZ-ja do të ishte e vendosur këtë herë që të mos mirëkuptonte dhe as të toleronte vonesat në aplikimin për regjistrim të subjekteve zgjedhore.

Regjistrimi i Bindjes Demokratike si subjekt zgjedhor, përveçse ishte në kundërshtim të plotë me ligjin dhe me precedentët e vendosur nga vetë KQZ-ja, ngriti dyshime të forta lidhur me motivet politike që qëndronin prapa "kësaj tolerance" nga ana Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Nga vëzhgimi në tërësi i këtij procesi zgjedhor, me përvojën edhe të vëzhgimit të proceseve të mëparshme, vërehet në tërësi një sjellje jo korrekte e partive politike në raport me respektimin dhe zbatimin e germës dhe frymës së tërë kuadrit ligjor, e nxitur kjo edhe nga sjellja tolerante dhe mosndëshkueshmëria e tyre në disa raste, prej KQZ-së në radhë të parë, e ndikuar kjo e fundit drejtpërdrejtë prej vullnetit politik të forcave kryesore politike, prej të cilëve vetë trupa e KQZ-së edhe është propozuar.

Në këtë këndvështrim, janë vërejtur neglizhenca apo toleranca lidhur me mosrespektimin e elementëve formalë dhe përmbajtësorë përgjatë tërë procesit zgjedhor, duke filluar që nga depozitimi i formularëve të vetë-deklarimit, paplotësia e CV-ve të depozituara të kandidatëve, paraqitja e listave të kandidatëve për anëtarë të Këshillave Bashkiakë, e deri tek raportimi financiar që bëhet prej tyre.

---

244 Vendimi nr. 241 datë 19.04.2013, i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve *"Për regjistrimin si subjekt zgjedhor të "Partia Civile e Shqipërisë" për zgjedhjet për Kuvendin të datës 23.06.2013"* dhe Vendimi Nr. 279 datë 03.05.2013 *"Për shqyrtimin e kërkesës së Partisë Civile për rishikimin e vendimit të KQZ-së nr. 241, datë 19.04.2013 "Për mosregjistrimin si subjekt zgjedhor i "Partia Civile e Shqipërisë", për zgjedhjet për Kuvendin të datës 23.06.2013".*

245 Vendimi nr. 158 datë 16.04.2015 i KQZ-së *"Për shqyrtimin e kërkesës së "Partisë Shkodra 2015" për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 21.06.2015".*

246 Kolegji Zgjedhor i Gjykatës së Apelit Tiranë, Vendimi nr. 3, datë 27.04.2013.

247 Deklaratë për Shtyp e KQZ-së datë 04.01.2019: *"Afati ligjor për regjistrimin e partive politike për këto zgjedhje mbaron më datë 21 prill, kurse për regjistrimin e koalicioneve zgjedhore në KQZ mbaron më datë 1 maj. Regjistrimi bëhet si gjithmonë pranë KQZ-së. Nëse partitë politike nuk respektojnë afatin e parë, ato nuk do të kenë mundësi të marrin pjesë në zgjedhjet e datës 30 qershor 2019. Nëse nuk respektojnë afatin e dytë, ato nuk mund të konkurrojnë si koalicione zgjedhore. Në të shkuarën KQZ -ja është kritikuar nga misionet vëzhguese ndërkombëtare për regjistrimin e subjekteve zgjedhore përtej afateve ligjore, ndaj është veçanërisht e vendosur këtë herë që të mos mirëkuptojë dhe as tolerojë vonesat në aplikimin për regjistrim. KQZ-ja u bën thirrje që sot partive politike që të organizohen në kohë për plotësimin dhe depozitimin e dokumentacionit të regjistrimit".*

248 Raporti Përfundimtar i Misionit të OSBE/ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve për Kuvendin të 25 qershorit 2017, *"I. Përmbledhje"*, faqe nr. 2: *"Ndonëse përfshirës në një shkallë të gjerë, procesi i regjistrimit të kandidatëve u ndesh me zbatimin përzgjedhës dhe jo të njëjtë të ligjit dhe, në disa raste, u mbështet në marrëveshjen politike dhe jo në ligj".*

Nën këtë qasje, nga një vëzhgim i bërë në shqyrtim të akteve të regjistrimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për partitë politike pjesëmarrëse në këto zgjedhje, sipas statutit dhe vendimmarrjes së depozituar në gjykatë prej organeve drejtuese partiake përkatëse dhe duke patur parasysh datën 21 prill 2019, afatin e regjistrimit të partive në KQZ, si afat për përllogaritjen e mandatit ligjor të përfaqësimit, figuron se:

- 9 parti politike[249] i kanë Kryetarët brenda afatit të vlefshëm të mandatit të tyre të përfaqësimit, sipas përcaktimeve në statutin përkatës;

- 5 parti politike[250] konsiderohet se i kanë Kryetarët brenda afatit të vlefshëm të mandatit të tyre të përfaqësimit, megjithëse nuk rezulton një mandat i kufizuar në vite, i përcaktuar shprehimisht në statutin përkatës *(në këtë rast është përllogaritur si afat i vlefshëm mandati 7-vjeçar si afati më i gjatë kohor i evidentuar në tërë listën e paraqitur të partive)*;

- 9 parti politike[251] i kanë Kryetarët jashtë mandatit të tyre të përfaqësimit,

249 - Partia Bindja Demokratike, kryetari aktual zyrtarizuar pas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të datës 25.04.2019;
- Partia e Reformave Demokratike Shqiptare, Kryetari aktual zyrtarizuar pas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të datës 15.03.2019;
- Partia Personat me Aftësi të Kufizuar, Kryetari aktual zyrtarizuar pas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të datës 27.06.2018;
- Partia Aleanca Kuq e Zi, Kryetarja aktuale zyrtarizuar pas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të datës 19.12.2017;
- Partia Ora e Shqipërisë, kryetari aktual ri-zyrtarizuar pas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të datës 23.11.2017;
- Partia Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane, Kryetari aktual zyrtarizuar pas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të datës 20.09.2017;
- Partia Kombëtare Konservatore Albania, Kryetari aktual zyrtarizuar pas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të datës 20.02.2017;
- Partia Kristian Demokrate e Shqipërisë, Kryetari aktual ri-zyrtarizuar pas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të datës 14.01.2016;
- Partia Lëvizja Punëtore Shqiptare, Kryetari aktual zyrtarizuar pas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të datës 27.04.2015;

250 - Partia G99, Kryetari zyrtarizuar pas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë më 01.04.2016;
- Partia FRD, Kryetari zyrtarizuar pas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë më 20.04.2015;
- Partia Aleanca Demokratike, Kryetari zyrtarizuar pas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë më 22.05.2014;
- Partia Socialiste e Shqiperisë, depozitimi i fundit në Gjykatë më 2013. Sipas statutit të PS, i publikuar në faqen zyrtare të internetit, ndryshuar më 2016, mandati i Kryetarit të partisë konsiderohet i rinovuar në momentin që ai/ajo zgjidhet kryeministër. Por këto ndryshime nuk figurojnë që të jenë pasqyruar pranë Gjykatës. *Për më shumë shih HYPERLINK "https://issuu.com/partiasocialiste/docs/1._statuti_dhe_rregulloret..._e_p_" Statuti i PS-së, Neni 40, pika 5;*
- PKSH, Kryetari zyrtarizuar pas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë më 17.12.2012

251 - Partia Demokrate për Integrim dhe Prosperitet, Kryetari aktual zyrtarizuar pas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të datës 01.04.2015, pavarësisht se statutin e partisë përcaktohet shprehimisht se mandati i kryetarit të partisë është 2 vjet;
- Partia e të Drejtave të Mohuara, Kryetari aktual zyrtarizuar pas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të datës 10.04.2013, pavarësisht se në statutin e partisë përcaktohet shprehimisht se mandati i kryetarit të partisë është 3 vjet;
- Partia Socialiste e Moderuar, Kryetari aktual zyrtarizuar pas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të datës 28.01.2011, i cili është edhe vendimi i regjistrimit të kësaj partie në Gjykatë, pavarësisht se në statutin e partisë përcaktohet shprehimisht se mandati i kryetarit të partisë është 4 vjet;
- Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë, Kryetari aktual zyrtarizuar pas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të datës 07.12.2010, pavarësisht se në statutin e partisë përcaktohet shprehimisht se mandati i presidentit të partisë është 3 vjet;
- Partia Aleanca e Maqedonasve për Integrim Europian, Kryetari aktual zyrtarizuar pas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të datës 10.07.2009, pavarësisht se në statutin e partisë përcaktohet shprehimisht se mandati i kryetarit të partisë është 4 vjet; *(me datë 11.10.2019, depozitohen ndryshime në Gjykatë për zgjedhjen e Kryetarit të ri z. Vasil Steriovski)*;
- Partia Balli Kombëtar, Kryetari aktual zyrtarizuar pas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të datës 16.02.2004, pavarësisht se në statutin e partisë përcaktohet shprehimisht se mandati i kryetarit të partisë është 4 vjet;
- Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtoreve të Shqipërisë, Kryetari aktual zyrtarizuar pas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të datës 10.06.2002, i cili është edhe vendimi i regjistrimit të kësaj partie në Gjykatë, pavarësisht se në statutin e partisë përcaktohet shprehimisht se mandati i kryetarit të partisë është 4 vjet;
- Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigranteve, Kryetari aktual zyrtarizuar pas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të datës 18.02.2002, i cili është edhe vendimi i regjistrimit të kësaj partie në Gjykatë, pavarësisht se në statutin e partisë përcaktohet shprehimisht se mandati i kryetarit të partisë është 4 vjet;

sipas përcaktimeve në statutin përkatës;

- 13 parti politike[252] konsiderohet se i kanë Kryetarët jashtë afatit të vlefshëm të mandatit të tyre të përfaqësimit, megjithëse nuk rezulton një mandat i kufizuar në vite, i përcaktuar shprehimisht në statutin përkatës *(në këtë rast është përllogaritur si afat i vlefshëm mandati 7-vjeçar si afati më i gjatë kohor i evidentuar në tërë listën e paraqitur të partive)*;

Theksohet se Kryetarët e Partive Politike kanë mandatin për të regjistruar dhe përfaqësuar subjektin e tyre politik, kur ky mandat përfaqësimi është brenda afatit të vlefshmërisë së tij, sipas statutit dhe vendimmarrjes së depozituar në gjykatë prej organeve drejtuese partiake përkatëse.
Për rrjedhojë, në rastin e një qasje pro-aktive të KQZ-së për të siguruar integritetin e procesit zgjedhor si dhe të ofertës elektorale të paraqitur, 22 prej partive politike (dy grupimet e fundit) nuk duhet të lejoheshin të regjistroheshin për të marrë pjesë në procesin zgjedhor, përsa kohë funksionimi i tyre nuk është konform kritereve kushtetuese dhe ligjore, të cilat bëjnë të mundur përcaktimin e këtyre subjekteve juridike jofitimprurëse, si Parti Politike.

KQZ-ja nxitet të marrë një rol proaktiv ndaj partive politike, në përmbushje të parimit të barazisë përpara ligjit, përputhjes me parimet demokratike[253] që ato duhet të reflektojnë, si dhe integritetit moral dhe politik që ato duhet të përcjellin[254], në kuadër edhe të sigurimit të integritetit të procesit zgjedhor dhe të ofertës elektorale që paraqitet për qeverisjen e popullit dhe vendit.

- Partia Demokracia e Re Europiane, Kryetari aktual zyrtarizuar pas Vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Kasacionit të datës 06.02.1997, i cili është edhe vendimi i regjistrimit të kësaj partie, pavarësisht se në statutin e partisë përcaktohet shprehimisht se mandati i kryetarit të partisë është 7 vjet;

252 - Partia Aleanca Arbnore Kombëtare, Kryetari aktual zyrtarizuar pas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të datës 17.12.2010, i cili është edhe vendimi i regjistrimit të kësaj partie në Gjykatë;
- Partia për Liri Demokraci dhe Etikë, Kryetari aktual zyrtarizuar pas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të datës 25.03.2010, i cili është edhe vendimi i regjistrimit të kësaj partie;
- Partia Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet, Kryetari aktual zyrtarizuar pas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të datës 03.03.2009, i cili është edhe vendimi i regjistrimit të kësaj partie në Gjykatë;
- Partia e Gjelbër, Kryetari aktual zyrtarizuar pas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të datës 30.01.2008;
- Partia Socialdemokrate e Shqipërisë, Kryetari i së cilës në momentin e regjistrimit, ka qenë z. Skënder Gjinushi, i ri-zyrtarizuar pas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të datës 16.05.2005;
- Partia Bashkimi Liberal Demokrat, Kryetari aktual ri-zyrtarizuar pas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të datës 13.04.2005;
- Partia Demokracia Sociale, Kryetari aktual zyrtarizuar pas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të datës 07.05.2003, i cili është edhe vendimi i regjistrimit të kësaj partie në Gjykatë;
- Partia Ardhmëria Shqiptare, Kryetari aktual zyrtarizuar pas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të datës 15.11.2002, i cili është edhe vendimi i regjistrimit të kësaj partie në Gjykatë;
- Partia Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen, Kryetari aktual zyrtarizuar pas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të datës 10.06.2002, i cili është edhe vendimi i regjistrimit të kësaj partie;
- Partia Emigracioni Shqiptar, Kryetari aktual zyrtarizuar pas Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë të datës 16.07.1998, i cili është edhe vendimi i regjistrimit të kësaj partie;
- Partia e Pajtimit Kombëtar, Kryetari aktual zyrtarizuar pas Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë të datës 24.12.1997, i cili është edhe vendimi i regjistrimit të kësaj partie;
- Partia SocialPunëtore e Shqipërisë, Kryetari aktual zyrtarizuar pas Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë të datës 04.03.1992, i cili është edhe vendimi i regjistrimit të kësaj partie;
- Partia e Unitetit Kombëtar, Kryetari aktual zyrtarizuar pas Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë të datës 15.03.1991, i cili është edhe vendimi i regjistrimit te kësaj partie;

253 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Pjesa e Parë *"Parime themelore"*, Neni 9, pika 1 *"Partitë politike krijohen lirisht. Organizimi i tyre duhet të përputhet me parimet demokratike"*;
Ligji 8580 datë 17.2.2000 *"Për partitë politike"*, i ndryshuar, Neni 4 *"Partitë politike, në veprimtarinë për arritjen e qëllimeve të tyre, përdorin vetëm mjete dhe metoda demokratike"* dhe neni 7 *"Ndalohet regjistrimi i një partie në rastet kur: a) organizimi i saj i brendshëm është në kundërshtim me parimet demokratike dhe, veçanërisht, me parimet vijuese: ndërtimi nga poshtë lart i partisë, zgjedhjet e brendshme demokratike për forumet e partisë, e drejta e shprehjes së mendimit nga çdo anëtar, liria e hyrjes dhe e daljes së tyre nga partia, e drejta e çdo anëtari për të zgjedhur e për t'u zgjedhur; ...".*

254 Po aty, Neni 2 *"Partitë politike marrin pjesë në formimin e vullnetit politik të popullit në të gjitha fushat e jetës publike dhe kryesisht nëpërmjet: a) ndikimit në krijimin e opinionit publik dhe të edukatës politike; b) nxitjes së pjesëmarrjes aktive të shtetasve në jetën politike dhe evidencimin e aftësimit të shtetasve për të marrë përsipër përgjegjësi publike; ..."*

VII.2. Regjistrimi i kandidatëve

Çdo parti politike e regjistruar si subjekt zgjedhor në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve mund të propozojë kandidatë për kryetar të bashkisë apo anëtarë të këshillave bashkiake.

Përpos partive politike, kandidatët mund të propozohen edhe nga Koalicionet Zgjedhore, të regjistruara paraprakisht në KQZ.
Gjithashtu, ligji i njeh të drejtën çdo qytetari, që plotëson kriteret ligjore të përcaktuara në nenin 70 të Kodit Zgjedhor, të kandidojë si kandidat i mbështetur nga zgjedhësit.

Procesi i regjistrimit të kandidatëve për kryetar të Bashkive, realizohet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për bashkitë të cilat kanë në territorin e tyre më shumë se një ZAZ, dhe nga vetë KZAZ-ja në bashkitë ku territori i bashkisë përputhet me atë të ZAZ-së[255].

Konkretisht, për zgjedhjet e datës 30 qershor 2019, kandidatët për kryetarë të bashkive dhe listat e kandidatëve për anëtarë në këshillat bashkiakë, në 51 bashki u regjistruan nga KZAZ-të dhe për 10 bashkitë më të mëdha u regjistruan nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve[256].

Çdo individ, i paraqitur si kandidat/e për Kryetar/e të Bashkisë apo anëtar/e në Këshillin Bashkiak, dorëzoi pranë KQZ-së formularin e vetëdeklarimit (dekriminalizimit), si dhe iu nënshtrua procesit të verifikimit, në zbatim të ligjit 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave zgjidhen, emërohen apo ushtrojnë funksione publike", i cili realizohet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në bashkëpunim më Zyrën e Gjendjes Civile dhe Zyrën e Gjendjes Gjyqësore.

Të gjithë formularët e vetëdeklarimit, pasi u verifikuan, u skanuan dhe publikuan në faqen e internetit[257] të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Pas verifikimeve të kryera nga KQZ-ja, për një kandidat[258] për kryetar bashkie u refuzua kërkesa për kandidim, pasi ishte në kushtet e ndalimit të kandidimit në zbatim të ligjit 138/2015. Vendimi i KQZ-së u ankimua në Kolegjin Zgjedhor, i cili e la atë në fuqi[259].
Kandidimi iu refuzua edhe 11 kandidatëve[260] për anëtarë në Këshillat Bashkiakë.

Në ecurinë e procesit të verifikimit, rezultuan dy kandidatë[261] që u lejuan të kandidonin, por nuk e morën mandatin, pasi rezultatet e verifikimit, ndonëse me vonesë i kategorizuan ata të përfshirë në sferën e ndalimit të kandidimit, sipas ligjit 138/2015.

---

255 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 67 "*Lista e kandidatëve të partive dhe koalicioneve të partive*", pika 3 *"Në zbatim të paragrafit të dytë, të pikës 1, dhe të paragrafit të dytë, të pikës 2, të këtij neni, kandidati për kryetar bashkie dhe listat për këshillin e bashkisë, territori i të cilave nuk mbulohet nga një KZAZ e vetme, regjistrohen në KQZ"*.

256 Tiranë, Durrës, Elbasan, Shkodër, Lezhë, Kamëz, Lushnjë, Fier, Vlorë dhe Korçë.

257 Formularët e vetëdeklarimit të të gjithë kandidatëve që garuan në këto zgjedhjet mund t'i gjeni këtu .

258 Vendim nr. 516 datë 17.05.2019 i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, "*Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetë deklarimit të kandidatit për kryetar në Bashkinë Himarë Z. Dhionisios Alfred Petro Beleri, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike*".

259 Vendimi nr. 2 datë 30.05.2019, i Kolegjit Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

260 - Z. Elidon Beqiri kandidat i Partisë Aleanca Demokratike për anëtar të Këshillit Bashkiak Këlcyrë; - Z. Altin Miftari kandidat i Partisë Komuniste për anëtar të Këshillit Bashkiak Bulqizë; - Z. Nikoll Uka kandidat i Partisë Ardhmëria Shqiptare për anëtar të Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz; - Z. Vilson Çekaj kandidat i Partisë Kristiandemokrate për anëtar të Këshillit Bashkiak Malësi e Madhe; - Z. Fatmir Veizaj kandidat i Partisë Bindja Demokratike për anëtar të Këshillit Bashkiak Mallakastër; - Z. Xhevdet Sopaj kandidat i Partisë Ora e Shqipërisë për anëtar të Këshillit Bashkiak Kukës; - Z. Nezir Ferati kandidat i Partisë së Reformave Demokratike Shqiptare për anëtar të Këshillit Bashkiak Kukës; - Z. Andon Dodani kandidat i Partisë Socialiste për anëtar të Këshillit Bashkiak Vau-Dejes; - Z. Flamur Nasufi kandidat i Partisë së Gjelbër për anëtar të Këshillit Bashkiak Gramsh; - Z. Alfred Alfredaj kandidat i Partisë Socialiste të Moderuar për anëtar të Këshillit Bashkiak Tropojë; - Z. Gjin Nika kandidat i Partisë Socialiste të Moderuar për anëtar të Këshillit Bashkiak Shkodër.

261 Për shkak të kohës së kufizuar në dispozicion, verifikimi paraprak i realizuar nga KQZ-ja në kuadër të ligjit të dekriminalizimit rezultoi të mos ishte i plotë. Gjatë vendimmarrjes në Kolegjin Zgjedhor lidhur me shpërndarjen e mandateve, z. Ramadan Baho kandidati i parë i listës së Partisë Socialdemokrate për Këshillin e Bashkisë Ura Vajgurore dhe z. Jahir Cahani kandidat i parë i listës së Partisë Aleanca Demokratike për Këshillin e Bashkisë Has, nuk e morën mandatin për shkak të evidentimit të përfshirjes së tyre në sferën e ndalimit të kandidimit.

Në Zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 30 qershor 2019, u regjistruan dhe kandiduan në total 97 kandidatë për kryetar bashkie[262] në 61 Bashki të vendit.

Në 31 bashki[263] kishte vetëm një kandidat, në 25 bashki[264] garonin dy kandidatë, në katër bashki[265] garonin tre kandidatë dhe në një bashki[266] garonin katër kandidatë.

Tre kandidatë[267], pavarësisht kërkesës së tyre për të mos qenë më pjesë e procesit, kërkesë e bërë nga ata pas regjistrimit të tyre si kandidat nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve apo nga Komisioni Zonal i Administrimit Zgjedhor, rezultuan në ditën e votimit si pjesë e fletës së votimit, e për rrjedhim edhe formalisht në garë.

Për kandidatin e Bashkisë Lezhë dhe Kavajë, KQZ-ja morri në shqyrtim kërkesën dhe u shpreh me vendim[268], duke mos lejuar çregjistrimin, ndërsa për kandidatin e Bashkisë Kamëz pavarësisht kërkesës së tij KQZ nuk u shpreh me vendim.

U konstatua se 86 nga 97 kandidatë në total, u regjistruan nga KZAZ-të, me vërtetime nga Kuvendi, pasi partitë të cilat ata përfaqësonin u konsideruan nga Kuvendi se zotëronin një mandat në Kuvendin e Shqipërisë të paktën gjashtë muajt e fundit.
Ndërsa, 5 kandidatë u regjistruan duke u bazuar në firma mbështetëse si kandidatë të pavarur dhe 6 kandidatë të tjerë u regjistruan bazuar në vërtetimin e mandatit personal apo të forcës politike që përfaqësonin në organet e zgjedhura të bashkisë përkatëse, në zgjedhjet e shkuara.

Listat e kandidatëve për anëtarë të këshillave bashkiakë, duhet të plotësojnë kriteret ligjore të parashikuara në nenin 72 të Kodit Zgjedhor.
Nga kontrolli i listave të kandidatëve për anëtarë të këshillave bashkiakë për 10 bashki, për shkak të mospërmbushjes së kritereve ligjore të parashikuara, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve refuzoi regjistrimin e 13 listave[269] të paraqitura nga 7 parti politike.

262 60 kandidatë u paraqitën nga Koalicioni "Aleanca për Shqipërinë Europiane", 3 kandidatë nga Koalicioni "Shpresa për Ndryshim", 22 kandidatë nga Partia Bindja Demokratike, 1 kandidat nga Partia Aleanca e Maqedonasve për Integrim Europian, 1 kandidat nga Partia Fryma e Re Demokratike, 1 kandidat nga Partia MEGA, 2 kandidatë nga Partia Komuniste e Shqipërisë, 1 kandidat nga Partia Kombëtare Konservatore Albania dhe 6 kandidatë të pavarur.

263 Bashkia Delvinë, Bashkia Divjakë, Bashkia Dropull, Bashkia Elbasan, Bashkia Fier, Bashkia Fushë Arrëz, Bashkia Gjirokastër, Bashkia Has, Bashkia Himarë, Bashkia Konispol, Bashkia Krujë, Bashkia Kuçovë, Bashkia Libohovë, Bashkia Librazhd, Bashkia Lushnjë, Bashkia Maliq, Bashkia Mat, Bashkia Memaliaj, Bashkia Patos, Bashkia Peqin, Bashkia Përmet, Bashkia Pogradec, Bashkia Poliçan, Bashkia Pukë, Bashkia Roskovec, Bashkia Rrogozhinë, Bashkia Shkodër, Bashkia Skrapar, Bashkia Ura Vajgurore, Bashkia Vau Dejës, Bashkia Vorë.

264 Bashkia Belsh, Bashkia Bulqize, Bashkia Cërrik, Bashkia Dibër, Bashkia Durrës, Bashkia Finiq, Bashkia Gramsh, Bashkia Kamëz, Bashkia Kavajë, Bashkia Klos, Bashkia Kolonje, Bashkia Korçë, Bashkia Kukës, Bashkia Kurbin, Bashkia Malësi E Madhe, Bashkia Mallakastër, Bashkia Mirdite, Bashkia Përrenjas, Bashkia Pustec, Bashkia Sarandë, Bashkia Shijak, Bashkia Tepelenë, Bashkia Tiranë, Bashkia Tropoje, Bashkia Vlorë.

265 Bashkia Berat, Bashkia Këlcyrë, Bashkia Selenice dhe Bashkia Lezhë.

266 Bashkia Devoll.

267 Z. Bledar Sinella kandidat i BD në Bashkinë Kavajë, Z. Salvador Kaçaj kandidat i BD në Bashkinë Lezhë dhe Z. Ylber Gjeta kandidat i BD në Bashkinë Kamëz.

268 Vendimi i KQZ nr. 638 datë 22.05.2019 *"Për shqyrtimin e kërkesës së tërheqjes nga kandidimi për kryetar të bashkisë Lezhë z. Salvador Kaçaj, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019"* dhe Vendimi i KQZ nr. 639 datë 22.05.2019 *"Për shqyrtimin e kërkesës së tërheqjes nga kandidimi për kryetar të bashkisë Kavajë z. Bledar Sinella, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019".*

269 Lista për anëtarë në Këshillin e Bashkisë Fier, Vlorë dhe Kamëz të paraqitura nga Partia Fryma e Re Demokratike; Lista për anëtarë në Këshillin e Bashkisë Elbasan, Durrës, Shkodër dhe Kamëz të paraqitura nga Partia Aleanca Demokratike; Lista për anëtarë në Këshillin e Bashkisë Korçë të paraqitura nga Partia Bashkimi Liberal Demokrat; Lista për anëtarë në Këshillin e Bashkisë Vlorë dhe Lezhë të paraqitura nga Partia Aleanca Demokristiane; Lista për anëtarë në Këshillin e Bashkisë Elbasan të paraqitura nga Partia Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane; Lista për anëtarë në Këshillin e Bashkisë Lezhë e Kamëz të paraqitura nga Partia Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet; Lista për anëtarë në Këshillin e Bashkisë Korçë të paraqitura nga Partia Balli Kombëtar.

Lidhur me kontrollin e listave në 51 bashkitë e tjera, të kryer prej KZAZ-ve, nuk u mundësua të jepej një panoramë e plotë dhe e qartë për ecurinë e procesit, kryesisht për shkak të mungesës së transparencës.

Një shqetësim që mund të artikulohet dhe të përgjithësohet ka të bëjë me mosrespektimin e kritereve të vëna lidhur me plotësimin e duhur të "jetëshkrimit të kandidatit" (CV) si dhe të "formularit të vetëdeklarimit" në kuadër të ligjit të dekriminalizimit.

Konstatohet se shpesh CV-të janë të plotësuar në fare pak elementë dhe me pak detaje, ndryshe nga sa udhëzohet, madje në mjaft raste ato janë të plotësuara me shkrim dore, duke bërë që informacioni të jetë i pakët dhe në disa raste edhe i vështirë për tu lexuar.

Paraqitja e përshkrimit jetësor të kandidatit, konsiderohet përgjithësisht prej subjekteve elektorale si një element formal i panevojshëm. Ndërkohë që një jetëshkrim i plotësuar në mënyrë të plotë dhe të qartë ndihmon në informimin e qytetarit rreth arsimimit të ndjekur, kualifikimeve të bëra, tërë përvojave dhe angazhimeve të patura qoftë në punë, qoftë në aktivitete të tjera shoqërore e politike, duke iu dhënë atyre mundësinë që të gjykojnë më mirë në momentin e votimit për kandidatin që do t'i përfaqësojë ata.

Gjithashtu, konstatohet se 15 kandidatë për kryetar bashkie si dhe të paktën 1 kandidat për secilën prej 32 partive politike, ka dorëzuar "formularin e vetëdeklarimit" të plotësuar me shkrim dore. Ky veprim, përveçse është në kundërshtim me kërkesat e ligjit dhe udhëzimin e KQZ-së, nga ana tjetër mund të ndikojë në leximin e pasaktë ose të shtrembëruar të të dhënave, duke tjetërsuar drejtpërdrejtë të gjithë procesin e verifikimit të figurës së kandidatit, që bëhet më pas.

Në total rezultoi se u paraqitën 524 lista kandidatësh për anëtarë të këshillave bashkiakë nga 36 parti politike.
Në to ishin të përfshirë si kandidatë 9.872 individë, nga të cilët 1.619 morën mandat për të qenë anëtarë të këshillave bashkiakë.
Gjithashtu, garuan për anëtarë të këshillave bashkiake dhjetë kandidatë të pavarur, dy prej të cilëve rezultuan fitues.

Në raport me plotësimin e kritereve ligjore të parashikuara nga ligji përpara dhe pas marrjes së mandatit, u evidentua një situatë në bashkinë Klos, e cila lë vend për interpretim në një qasje më të gjerë.
Në këtë bashki, një anëtar i zgjedhur[270] në këshillin bashkiak nuk e kreu betimin për shkak se ishte punonjës në këtë bashki, gjë që bie ndesh me parashikimet e Ligjit për Vetëqeverisjen Vendore[271]. Pas referimit të vakancës në KQZ, u krye procesi i zëvendësimit të tij.

Mbi këtë situatë, ngrihet së paku shqetësimi për adresimin e duhur prej institucioneve të fenomenit të konfliktit të interesit dhe zbatimit të parimit të barazisë në garë.
Më tej, situata ngre pikëpyetje të renda lidhur me arsyet e garimit të kandidatit, në kushtet kur pas fitores dhe marrjes së mandatit, parashikimet specifike ligjore nuk të lejojnë mbajtjen e tij, ose kërkohet heqja dorë prej angazhimit të mëparshëm, në rastin konkret, nga punësimi në bashki.

270 Z. Armont Sina Kandidati me nr. rendor 1 në listën për anëtarë në Këshillin e Bashkisë Klos të subjektit Partia Demokracia Sociale, morri mandatin pas vendimit të Kolegjit Zgjedhor *"Për shpërndarjen e mandateve në Këshillin e Bashkisë Klos"*.

271 Ligji nr. 139/2015 datë 17.12.2015, *"Për vetëqeverisjen vendore"*, Neni 47, pika 1, germa c, *"Funksioni i këshilltarit është i papajtueshëm me: [...] funksionin e nëpunësit të administratës së bashkisë përkatëse dhe institucioneve në varësi të saj"*.

Pa u ndalur në një analizë nëse kjo është mungesë njohurie mbi ligjin rregullues të pushtetit ku individi dhe partia e tij kërkon të përfaqësohet, apo është për arsye të tjera, në thelb tërë fabula lidhet dhe cenon integritetin e figurës së kandidatit, partisë politike të tij, ofertës elektorale të servirur qytetarit dhe mekanizmit garantues, siç është KQZ-ja.

Nisur nga sa më sipër dhe nga një përballje rastësore edhe me disa problematika të tjera, KRIIK kreu një vëzhgim sipërfaqësor mbi:

- kandidimin e të njëjtit individ si kandidat, njëkohësisht, për Kryetar të Bashkisë dhe për anëtar të Këshillit Bashkiak;
- kandidimin e më shumë se një personi nga e njëjta familje, në të njëjtin këshill bashkiak, dhe akoma më shqetësuese, edhe nga e njëjta parti politike.

Të dy situatat e paraqitura më lart shtjellohen, respektivisht ne Sesionet VII.2.2. dhe VII.2.3. më pas. Ato përbëjnë parashikime që ndalohen specifikisht nga Ligji "Për Vetëqeverisjen Vendore", specifikisht nenin 47 i tij.

Kjo qasje e kandidatëve dhe e partive politike nuk ka të bëjë me asnjë parim apo aspiratë, që në fakt duhet të jetë shtrati mbi të cilën ndërtohet oferta elektorale, përkundrazi. Ajo është shprehi e konceptit të mbyllur, klanor e deri familjar të partive politike, garimit për interesa të ngushta duke zhbërë tërë aspiratat për funksionimin e duhur të partive politike dhe për një pushtet vendor me lidhje të ngushta me *dhe* në funksion të qytetarëve, duke ndikuar kështu drejtpërdrejtë në thyerjen e besimit të qytetarëve ndaj vetë atyre, mekanizmit garantues të ngritur dhe vetë procesit zgjedhor.

Konsiderohet e nevojshme marrja në shqyrtim e respektimit të vullnetit të lirë *individual* të kandidatit *për të vazhduar ose jo garën elektorale, të paktën brenda një afati kohor më të arsyeshëm.*
Në gjykimin e KRIIK, braktisja e garës, me të mirat dhe të këqijat që mund të mbarttë si veprim politik, duhet të ketë në bazë të tij lirinë individuale dhe politike të zgjedhjes, madje edhe me qëllim të fundëm pranimin e saj si formë proteste ndaj mungesës së garancive apo të një gare të ndërtuar në mënyrë të pabarabartë.

KQZ-ja duhet të *sigurojë dhe garantojë, në maksimumin e hapësirave* q*ë lejon ligji, shmangien e konfliktin e interesit dhe manifestimin e parimit* t*ë barazisë* n*ë garë si vlerë e tërë elementëve përbërës* t*ë procesit zgjedhor.*

KQZ-ja p*ërtej kritereve* t*ë kërkuara shprehimisht nga Kodi Zgjedhor, nevojitet* t*ë shtrojë* p*ër diskutim dhe* t*ë miratojë kritere shtesë* q*ë janë konform detyrimeve ligjore* q*ë kandidatët do t'iu nënshtrohen pas fitores* s*ë mundshme* t*ë mandatit* p*ërfaqësues* p*ër atë organ* t*ë zgjedhur.*
Një frymë e tillë, tenton t*ë nxisë m*ë *shumë transparencë, informim, përkushtim dhe seriozitet qoftë prej kandidatëve, qoftë prej vetë partive politike.*

VII.2.1. Regjistrimi i kandidatëve me vërtetim nga Kuvendi

Në nenin 68 të Kodit të Zgjedhor, përcaktohen rregullat e kandidimit për kandidatët apo listat e kandidatëve të paraqitura nga partitë që nuk zotërojnë mandate në kuvend apo në këshillat bashkiakë. Ky nen parashikon specifikisht se në këto raste kandidaturat duhet të shoqërohen me nga një numër firmash mbështetëse prej jo më pak se 1% të listës së zgjedhësve të zonës ku kandidohet. Në rast se partia apo koalicioni zotëron mandat në Kuvend apo bashki, të paktën 6 muajt e fundit[272], mbledhja e firmave mbështetëse nuk është e nevojshme.

272 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 68 "*Listat mbështetëse të partive politike dhe koalicioneve*",

Nga kandidatët e regjistruar për kryetar bashkie, 86 prej tyre të propozuar nga partitë respektive apo koalicionet, u regjistruan duke u bazuar në vërtetimin e lëshuar prej Kuvendit të Shqipërisë se deputetë të këtyre partive mbështetëse e zotëronin mandatin prej 6 muajsh. Ky vërtetim iu dha edhe deputetëve të rinj, që plotësuan vakancat e lëna nga largimi i PD-së e LSI-së dhe që e morën mandatin e tyre të deputetit vetëm 1 muaj (afërsisht) përpara përfundimit të afatit të regjistrimit të kandidatëve në KQZ.

KRIIK konstatoi dhe investigoi në mënyrë të plotë një rast të regjistrimit të një kandidati për kryetar bashkie, i cili paraqiti vërtetim nga Kuvendi i Shqipërisë, ku vërtetohej se partia që e kandidonte zotëronte një mandat në Kuvendin e Shqipërisë prej 6 muajsh, gjë që nuk ishte e vërtetë[273].
Konkretisht, në mbledhjen e datës 16 maj 2019, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve regjistroi si kandidat për kryetar në Bashkinë Lezhë, z. Eduart Ndocaj të propozuar nga Partia Kombëtare Konservatore Albania.
U konstatua se ky vendim ishte marrë në shkelje të ligjit dhe procedurave të parashikuara, duke qenë se vërtetimi i lëshuar nga Kuvendi i Shqipërisë dhe ai i lëshuar nga Këshilli i Bashkisë Lezhë, me anë të të cilëve z. Ndocaj ishte regjistruar ishin të pasaktë.

Në vërtetimin e lëshuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit të Shqipërisë[274] thuhej se Deputeti Kujtim Gjuzi, i cili kishte bërë betimin si deputet më datë 8 maj 2019, kishte deklaruar se përfaqësonte subjektin "Partia Kombëtare Konservatore Albania". Gjithashtu, vërtetimi citonte se "Ai zotëron mandatin e deputetit të paktën 6 muajt e fundit, sipas parashikimeve në Kodin Zgjedhor", çka nuk ishte e vërtetë[275], pasi mandati 6 mujor i deputetit, nëse do t'i referoheshim datës së zgjedhjeve apo afatit të regjistrimit të kandidatëve, do të duhej të zotërohej prej z. Gjuzi së paku prej datës 30 dhjetor 2018[276].

Gjykimet e trupës së KQZ në lidhje me këtë çështje, ishin të ndara. Kryetari kërkoi të kishte më shumë qartësime nga Kuvendi, ndërkohë që pjesa tjetër e anëtarëve pretendoi se nuk është kompetencë e KQZ-së të diskutojë dokumentet zyrtare. Sipas tyre, vendimmarrja e KQZ-së duhej të merrej duke u mjaftuar me paraqitjen e një dokumenti zyrtar, qoftë ky gjerësisht i njohur si i pasaktë, gjë që vë në pikëpyetje rolin dhe përgjegjësinë e KQZ-së si mbikëqyrëse e tërë procesit zgjedhor.

Ligji duhet të saktësojë kriterin bazuar në të cilin partitë lirohen nga detyrimi për të mbledhur firma mbështetëse për kandidatët, duke përcaktuar qartë se si përllogaritet ky afat, në mënyrë që të eliminohet inkonsistenca në këtë drejtim dhe garantohet trajtimi i barabartë në kandidim.

---

pika 3 *"Për qëllim të këtij neni, partia politike ose koalicioni paraqet një vërtetim me shkrim, të nënshkruar nga institucioni i Kuvendit apo njësia e qeverisjes vendore, ku vërtetohet zotërimi i mandatit të paktën 6 muajt e fundit".*

273 Për më shumë detaje, shih Deklaratën *"Procesi i regjistrimit të kandidatëve, po ngre pikëpyetje mbi integritetin e procesit të ardhshëm zgjedhor"*, publikuar nga KRIIK në 17 maj 2019.

274 Nr. 13 Prot datë 13.05.2019.

275 Arsyetimi i Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit në lidhje me këtë letër është se përllogaritja e muajve të referuar në letër është bërë nga momenti i përfundimit të mandatit të Kuvendit aktual, çka është një arsyetim absurd, duke qenë se i referohet një momenti të ardhshëm në kohë, për më tepër që në një realitet të ardhshëm mandatet edhe mund të humben fare nga partia përkatëse.

276 Gjithashtu, në vërtetimin e lëshuar prej Këshillit të Bashkisë Lezhë me Nr. 4751/1 Prot datë 13.05.2019, thuhet se "mbështetur në vendimin Nr. 161 datë 03.07.2017 të Këshillit Bashkiak Lezhë, vërtetojmë se z. Petrit Ndreu është anëtar i Këshillit Bashkiak Lezhë, i propozuar nga subjekti politik, PKKA (Partia Kombëtare Konservatore Albania)". Kjo është e pasaktë pasi z. Ndreu është zgjedhur si anëtar i Këshillit Bashkiak Lezhë, i propozuar nga subjekti politik Partia Konservatore (KONS), e cila është një subjekt i ndryshëm elektoral nga Partia Kombëtare Konservatore Albania (PKKA) apo ish Partia Forca Albania. Nga ana tjetër nga kontaktet e marra, konstatohet se z. Ndreu nuk kishte bërë ndonjë deklaratë me shkrim të depozituar tek sekretari i Këshillit Bashkiak Lezhë, 6 muaj më parë ku të deklarojë përkatësinë e tij tashmë tek subjekti tjetër elektoral PKKA.

VII.2.2. Regjistrimi njëkohësisht si kandidat për Kryetar Bashkie dhe si anëtar i Këshillave Bashkiakë

Neni 63 i Kodit Zgjedhor përcakton disa nga kushtet që duhet të plotësojnë subjektet zgjedhore dhe kandidatët për t'u regjistruar në një proces zgjedhor.

Sipas kuptimit të këtij neni dhe veçanërisht të pikës 3 të tij "Kandidat është shtetasi që plotëson kushtet e parashikuara në nenet 45 dhe 69 të Kushtetutës dhe që regjistrohet si kandidat për deputet në KQZ ose si kandidat për kryetar bashkie ose për këshillat vendorë në KZAZ".
Pra, sikundër evidentohet qartë lidhëza "ose" e përdorur në këtë dispozitë nga ligjvënësi kufizon mundësitë e kandidimit vetëm për një organ të zgjedhur.

Ky përcaktim kufizues, gjithashtu është në linjë me kuptimin e ofertës elektorale në një proces zgjedhor, ku kandidati i prezantohet dhe i kërkon mbështetjen votuesit mbi bazën e platformën së tij personale/elektorale, ose si kryetar i ardhshëm i bashkisë, ose si një anëtar i ardhshëm i këshillit bashkiak.
Nga ana tjetër ky kufizim, duket se është bërë me qëllim nga ligjvënësi për të mos lejuar rritjen artificiale "të numrit të kandidatëve", duke zhbërë thelbin e vlerave që duhet të përmbajë e përcjellë një garë elektorale.

Jo vetëm kaq, por Ligji "Për Vetëqeverisjen Vendore", specifikisht në nenin 47 të tij parashikon papajtueshmëri të funksionit të këshilltarit me funksionin e kryetarit dhe zëvendëskryetarit të bashkisë.
Kjo dispozitë nuk mund të kuptohet në qasje të ngushtë e të zbatohet vetëm në rastin kur paraqitet situata ku i njëjti kandidat për të dy postet shpallet fitues e do t'i duhet të zgjedhë të mbajë vetëm njërin mandat, pasi në analizë të thelluar të rastit zhbën një sërë garancish e deri tek parimet mbi procesin zgjedhor.

Në shkelje të dispozitave ligjore të mësipërme, partitë politike lejuan dhe regjistruan të njëjtët individë si kandidatë edhe për Kryetar të Bashkisë, edhe për Anëtarë të Këshillave Bashkiakë.
U evidentuan të tillë 9 kandidatë të Partisë Bindja Demokratike (BD)[277] dhe një kandidat i Koalicionit Shpresa për Ndryshim[278].

Madje një kandidat tjetër i BD-së në bashkinë Malësi e Madhe, z. Pjerin Spathari, që ishte njëkohësisht kandidat për të dy funksionet arriti të zgjidhet anëtar në këshillin bashkiak[279].

---

277 - Abedin Oruçi, kandidat për kryetar bashkie në Kukës propozuar nga Partia Bindja Demokratike dhe kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Kukës me numër rendor 1 në listën e Partisë Bindja Demokratike;
-Edison Hasanaj, kandidat për kryetar bashkie në Tropojë propozuar nga Partia Bindja Demokratike dhe kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Tropojë me numër rendor 1 në listën e Partisë Bindja Demokratike;
- Gëzim Malka, kandidat për kryetar bashkie në Tepelenë propozuar nga Partia Bindja Demokratike dhe kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Tepelenë me numër rendor 10 në listën e Partisë Bindja Demokratike;
- Ilir Balla, kandidat për kryetar bashkie në Bulqizë propozuar nga Partia Bindja Demokratike dhe kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Bulqizë me numër rendor 1 në listën e Partisë Bindja Demokratike;
- Robert Brahaj, kandidat për kryetar bashkie në Mallakastër propozuar nga Partia Bindja Demokratike dhe kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Mallakastër me numër rendor 5 në listën e Partisë Bindja Demokratike;
- Merita Xhika, kandidate për kryetare bashkie në Cërrik propozuar nga Partia Bindja Demokratike dhe kandidate për anëtare në Këshillin e Bashkisë Cërrik me numër rendor 1 në listën e Partisë Bindja Demokratike. (Këshill, ska formularin, rregjistruar nga KZAZ);
- Ylber Gjeta, kandidat për kryetar bashkie në Kamëz propozuar nga Partia Bindja Demokratike dhe kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Kamëz me numër rendor 11 në listën e Partisë Bindja Demokratike;
- Edmond Piroli, kandidat për kryetar bashkie në Kurbin propozuar nga Partia Bindja Demokratike dhe kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Kurbin me numër rendor 1 në listën e Partisë Bindja Demokratike. (Këshill , ska formular vetëdeklarimi tek lista e këshillit, rregjistruar nga KZAZ);
- Sabri Ibrahimi, kandidat për kryetar bashkie në Gramsh propozuar nga Partia Bindja Demokratike dhe kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Gramsh me numër rendor 1 në listën e Partisë Bindja Demokratike.

278 - Hasbi Kasaj kandidat për kryetar bashkie në Këlcyrë nga Koalicioni Shpresa për Ndryshim dhe kandidat për anëtar të Këshillit Bashkiak Këlcyrë, i Partisë Emigracioni Shqiptar me numër rendor 4.

279 Sipas vendimit nr. 699 datë 28.05.2019 "*Për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatët për kryetar*

Në këtë proces evidentohet se KZAZ-të kanë vepruar në kundërshtim me ligjin, ndërkohë që edhe KQZ-ja ka ceduar në rolin e saj mbikëqyrës të procesit.

VII.2.3. Regjistrimi i kandidatëve me lidhje familjare të shkallës së parë si anëtarë të të njëjtit këshill bashkiak

Ligji 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" në nenin 47 të tij "Papajtueshmëria e funksionit të këshilltarit" **në** pik**ën** 3 **p**ërcakton se "nuk mund të jenë anëtarë të të njëjtit këshill personat e lidhur: bashkëshortë, prindër e fëmijë, vëlla e motër, si dhe vjehrri e vjehrra me nusen e dhëndrin".

Nga një faktim rastësor i një rasti dhe me pas nga një hulumtim sipërfaqësor i dokumentacionit të kandidimit[280] dhe i listave të kandidatëve për këshillat bashkiake, rezultoi se në secilën prej 33 nga partive pjesëmarrëse në zgjedhjet e datës 30 qershor 2019, vihet re së paku një rast ku kandidatët e së njëjtës parti dhe për të njëjtin këshill bashkiak, kanë lidhje familjare të shkallës së parë me njëri-tjetrin[281].

Bashkia Malësi e Madhe për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 30 qershor 2019", z. Spathari është kandidat për kryetar të Bashkisë Malësi e Madhe. Në listat e kandidatëve fitues për Këshillin e Bashkisë Malësi e Madhe, z. Pjerin Spathari rezulton të ketë marrë mandat në këtë këshill si përfaqësues i Partisë Bindja Demokratike.

280 Verifikimi është bërë nëpërmjet monitorimit të të dhënave (emër, mbiemër, atësi, amësi, vendlindje), në listat shumëemërore të kandidatëve për këshillat bashkiakë dhe në formularin e vetëdeklarimit të plotësuar prej secilit prej tyre, duke bërë krahasime dhe parë përputhjet midis tyre.

281 - Në listën shumëemërore të Partisë G99 për Këshillin e Bashkisë Tiranë, kandidati me numër rendor 11 Sokol Bani dhe kandidati me numër rendor 15 Ermal Bani janë vëllezër;
- Në listën shumëemërore të Partisë Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet për Këshillin e Bashkisë Kurbin, kandidati me numër rendor 4 Kristian Bardhi dhe kandidati me numër rendor 10 Roberto Bardhi janë vëllezër;
- Në listën shumëemërore të Partisë Demokracia Sociale për Këshillin e Bashkisë Tepelenë, kandidati me numër rendor 6 Anita Bardhi dhe kandidati me numër rendor 7 Domeniko Bardhi janë vëllezër;
- Në listën shumëemërore të Partisë së të Drejtave të Mohuara për Këshillin e Bashkisë Dibër, kandidati me numër rendor 1 Astrit Ademi, dhe kandidati me numër rendor 7 Setki Ademi janë vëllezër;
- Në listën shumëemërore të Partisë Fryma e Re Demokratike për Këshillin e Bashkisë Elbasan, kandidati me numër rendor 28 Stelina Ademi dhe kandidati me numër rendor 43 Albin Ademi janë motër e vëlla;
- Në listën shumëemërore të Partisë së Gjelbër për Këshillin e Bashkisë Devoll, kandidati me numër rendor 2 Eriola Begolli dhe kandidati me numër rendor 3 Ervis Begolli janë motër e vëlla;
- Në listën shumëemërore të Partisë Personat me Aftësi të Kufizuar për Këshillin e Bashkisë Pogradec, kandidati me numër rendor 3 Fadil Alillari, kandidati me numër rendor 6 Lindita Alillari, kandidati me numër rendor 15 Artion Alillari dhe kandidati me numër rendor 22 Armela Alillari janë një familje, përkatësisht kryefamiljari, bashkëshortja dhe fëmijët;
- Në listën shumëemërore të Partisë Bindja Demokratike për Këshillin e Bashkisë Skrapar, kandidati me numër rendor 4 Fjora Alushani dhe kandidati me numër rendor 11 Halder Alushani janë motër e vëlla;
- Në listën shumëemërore të Partisë Komuniste të Shqipërisë për Këshillin e Bashkisë Krujë, kandidati me numër rendor 21 Olsingen Babaj dhe kandidati me numër rendor 27 Armand Babaj janë vëllezër;
- Në listën shumëemërore të Partisë Aleanca Demokristiane e Shqipërisë për Këshillin e Bashkisë Vau Dejes, kandidati me numër rendor 9 Renato Bacaj dhe kandidatja me numër rendor 12 Sidorela Bacaj janë motër e vëlla;
- Në listën shumëemërore të Partisë Aleanca Demokratike Shqiptare për Këshillin e Bashkisë Tiranë, kandidati me numër rendor 3 Subi Bajrami dhe kandidati me numër rendor 23 Sadik Bajrami janë motër e vëlla. Gjithashtu në po të njëjtën listë kandidati me numër rendor 11 Myslim Bajro dhe kandidati me numër rendor 31 Fatos Bajro janë vëllezër;
- Në listën shumëemërore të Partisë Balli Kombëtar për Këshillin e Bashkisë Pogradec, kandidati me numër rendor 7 Erti Besholli dhe kandidati me numër rendor 9 Altin Besholli janë vëllezër;
- Në listën shumëemërore të Partisë Demokrate për Integrim e Prosperitet për Këshillin e Bashkisë Has, kandidati me numër rendor 2 Lindita Dauti, kandidati me numër rendor 3 Ndrigim Dauti dhe kandidati me numër rendor 9 Selman Dauti janë motër e vëlla;
- Në listën shumëemërore të Partisë Unitetit Kombëtar për Këshillin e Bashkisë Has, kandidati me numër rendor 1 Halim Dauti, kandidati me numër rendor 3 Dritan Dauti dhe kandidati me numër rendor 5 Arben Dauti janë vëllezër;
- Në listën shumëemërore të Partisë Ora e Shqipërisë për Këshillin e Bashkisë Tiranë, kandidati me numër rendor 11 Argin Çuni dhe kandidati me numër rendor 18 Françeska Çuni janë vëllezër;
- Në listën shumëemërore të Partisë Socialiste e Moderuar për Këshillin e Bashkisë Malësi e Madhe, kandidati me numër rendor 3 Santiljano Curaj dhe kandidati me numër rendor 15 Foster Curaj janë vëllezër;
- Në listën shumëemërore të Partisë Ardhmëria Shqiptare për Këshillin e Bashkisë Klos, kandidati me numër rendor 3 Dhurata Elezi dhe kandidati me numër rendor 9 Ermira Elezi janë motra;
- Në listën shumëemërore të Partisë Aleanca Arbnore Kombëtare për Këshillin e Bashkisë Klos, kandidati me numër rendor 3 Ylber Dalti dhe kandidati me numër rendor 6 Besjola Dalti janë motër e vëlla;

Ndërkohë për 3 partitë e tjera[282], verifikimi është i pamundur për shkak se formularët e vetëdeklarimit në kuadër të ligjit të dekriminalizimit, të cilët përmbajnë të dhënat e kandidatëve vazhdojnë të jenë të paaksesueshëm në faqen e internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Një situatë e tillë përligj akuza të forta mbi konceptimin dhe sjelljen e partive politike si struktura të mbyllura, klanore e familjare, në kundërshtim të hapur me rolin dhe përgjegjësitë që ato duhet të zhvillojnë në zbatim të frymës dhe germës së Kushtetutës, ligjit dhe vetë sistemit demokratik.

VIII. LISTAT E ZGJEDHËSVE

Procesi i hartimit dhe publikimit të ekstraktit të përbërësve zgjedhorë, realizohet nëpërmjet një procesi në të cilin përfshihen Ministri i Brendshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (DPGJC), 61 Bashkitë e vendit si dhe Zyrat e Gjendjes Civile (ZGJC) në çdo bashki.
Ky proces mbikëqyret në mbarëvajtjen e tij nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve bazuar në dispozitat e nenit 50 dhe 61 të Kodit Zgjedhor.

Procesi i hartimit dhe korrigjimit të Listave të Zgjedhësve ka qenë një ndër çështjet më të debatuara në vend, por që, nga njëri proces zgjedhor tek tjetri, arriti të vendosë disa standarde pozitive veçanërisht lidhur me transparencën dhe informimin periodik zyrtar të publikut mbi ecurinë e procesit përgatitor. Ashtu sikurse, nga ana tjetër, është shoqëruar në vazhdimësi me disa problematika të cilat kanë shkaktuar anomali të vogla përgjatë proceseve zgjedhore.

- Në listën shumëemërore të Partisë për Liri Demokraci dhe Etikë për Këshillin e Bashkisë Kukës, kandidati me numër rendor 24 Visjola Doda, kandidati me numër rendor 28 Lediona Doda dhe kandidati me numër rendor 30 Denada Doda janë motra;
- Në listën shumëemërore të Partisë Aleanca Kuq e Zi për Këshillin e Bashkisë Përrenjas, kandidati me numër rendor 6 Vasilika Karriqi dhe kandidati me numër rendor 12 Refete Kasa janë motra;
- Në listën shumëemërore të Partisë Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane për Këshillin e Bashkisë Fier, kandidati me numër rendor 2 Mirela Moçi dhe kandidati me numër rendor 25 Arjan Moçi janë motër e vëlla;
- Në listën shumëemërore të Partisë Bashkimi Liberal Demokrat për Këshillin e Bashkisë Has, kandidati me numër rendor 1 Sokol Dida dhe kandidati me numër rendor 9 Gani Dida janë vëllezër;
- Në listën shumëemërore të Partisë Demokracia e Re Europiane për Këshillin e Bashkisë Lezhë, kandidati me numër rendor 1 Indrit Nikjari dhe kandidati me numër rendor 15 Ermir Nikjari janë vëllezër;
- Në listën shumëemërore të Partisë së Reformave Demokratike Shqiptare për Këshillin e Bashkisë Tiranë, kandidati me numër rendor 7 Bardhyl Karabrahimi, kandidati me numër rendor 13 Marjet Karabrahimi dhe kandidati me numër rendor 15 Shefqet Karabrahimi janë vëllezër;
- Në listën shumëemërore të Partisë Kristian Demokrate për Këshillin e Bashkisë Has, kandidati me numër rendor 4 Jolinda Qerkezi dhe kandidati me numër rendor 11 Ardi Qerkezi janë motër e vëlla;
- Në listën shumëemërore të Partisë Emigracioni Shqiptar për Këshillin e Bashkisë Gramsh, kandidati me numër rendor 3 Vasil Mama dhe kandidati me numër rendor 7 Vullnet Mama janë vëllezër;
- Në listën shumëemërore të Partisë Lëvizja Punëtore Shqiptare për Këshillin e Bashkisë Vlorë, kandidati me numër rendor 2 Sindy Telka dhe kandidati me numër rendor 15 Ledion Telka janë motër e vëlla;
- Në listën shumëemërore të Partisë për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve për Këshillin e Bashkisë Kukës, kandidati me numër rendor 2 Teuta Cenaj dhe kandidati me numër rendor 9 Donald Cenaj janë motër e vëlla;
- Në listën shumëemërore të Partisë për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve të Shqipërisë për Këshillin e Bashkisë Këlcyrë, kandidati me numër rendor 7 Syrja Xhako dhe kandidati me numër rendor 13 Hikmet Xhako janë vëllezër;
- Në listën shumëemërore të Partisë Socialpunëtore Shqiptare për Këshillin e Bashkisë Tiranë, kandidati me numër rendor 1 Armand Rama dhe kandidati me numër rendor 3 Florjan Rama janë vëllezër;
- Në listën shumëemërore të Partisë Socialdemokrate të Shqipërisë për Këshillin e Bashkisë Ura Vajgurore, kandidati me numër rendor 4 Romina Ismailaj dhe kandidati me numër rendor 12 Sherli Ismailaj janë motra;
- Në listën shumëemërore të Partisë Socialiste për Këshillin e Bashkisë Shijak, kandidati me numër rendor 15 Selim Norja dhe kandidati me numër rendor 19 Barjam Norja janë vëllezër;
- Në listën shumëemërore të Partisë Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen për Këshillin e Bashkisë Sarandë, kandidati me numër rendor 17 Kristina Shendi dhe kandidati me numër rendor 21 Anamaria Shendi janë motra.

282 - Partia Aleanca e Maqedonasve për Integrim Europian ka depozituar listë me kandidatë për Këshillin Bashkiak vetëm në bashkinë Pustec; - Partia e Pajtimit Kombëtar ka depozituar listë me kandidatë për Këshillin Bashkiak vetëm në bashkinë Kukës; - Partia Kombëtare Konservatore Albania nuk ka qenë në garë si subjekt zgjedhor.

Këto anomali janë anashkaluar qëllimisht apo injoruar për shkak të rrethanave, falë dakordësisë politike dhe sistemit menaxhues e kontrollues të ngritur e të bazuar në balancimin politik PS-PD.
Ndër to , sillen në vëmendje votuesit me adresë të panjohur, njoftimi me shkrim i zgjedhësve, procesi i publikimit të ekstrakteve zgjedhore, etj., ashtu sikundër edhe paplotësia e përhershme e udhëzimit të Ministrit të Brendshëm në raport çka kërkohet nga Kodi Zgjedhor dhe roli mbikëqyrës fare formal që luan KQZ-ja.

Një ditë pas dekretimit të datës së zgjedhjeve prej Presidenti të Republikës, më datë 6 nëntor 2018, Ministri i Brendshëm nxori Udhëzimin përkatës për hartimin e listave të zgjedhësve[283].

Edhe ky Udhëzim, konstatohet se nuk parashikon në përmbajtje të tij llogaridhënien e bashkive mbi procesin e njoftimit me shkrim[284], modulin e njoftimit me hapësirën e nevojshme e të përcaktuar qartë për kundërfirmën e qytetarit të njoftuar[285], nuk përcakton qartë mënyrën e publikimit të listave[286] duke marrë në konsideratë problematikën e hasur, si dhe nuk përmban asnjë orientim lidhur më mënyrën e menaxhimit të fondit[287] në dispozicion për kryerjen e procesit të njoftimit me shkrim të zgjedhësve.

Bazuar në dispozitat e Kodit Zgjedhor si dhe në udhëzimin e mësipërm, Zyrat e Gjendjes Civile nëpër bashki, duhet të hartonin dhe publikonin ekstraktet e përbërësve zgjedhorë në mënyrë periodike çdo 30 ditë, duke filluar nga data 5 dhjetor 2019 deri më datë 21 maj 2019 kur bëhet edhe publikimi i listës finale të zgjedhësve.
Udhëzimi përmban gabime materiale[288] lidhur me afatet e publikimit të listave nga ZGJC-të nëpër bashki, ndërkohë që referuar detyrimit të Kodit Zgjedhor publikimi i ekstraktit të përbërësve zgjedhorë i përditësuar duhej të bëhej jo më vonë se datat 5 dhjetor 2018, 4 janar 2019, 3 shkurt 2019, 5 mars 2019, 4 prill 2019 dhe 4 maj 2019. Nga njoftimi i bërë publik në faqen e Ministrisë së Brendshme, rezulton se publikimi i ekstraktit është bërë në datat 04.12.2018, 03.01.2019, 01.02.2019, 01.03.2019, 29.03.2019 dhe 28.04.2019[289].

Publikimi periodik i ekstraktit të përbërësve zgjedhorë të të gjithë shtetasve që kanë vendbanim në zonat e qendrave të votimit nën juridiksionin e çdo zyre, bëhet në ambientet e zyrave të gjendjes civile ose në ambientet pranë tyre me akses të lirë për publikun, në mënyrë që të mund të konsultohen dhe kontrollohen nga vetë shtetasit, pa asnjë kufizim.

Ky proces parashikohet të shoqërohet edhe me procesin e njoftimit me shkrim

283 Udhëzimi nr. 295/1, datë 6.11.2018 *"Për procedurat e hartimit të listave të zgjedhësve për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019"* Fletore Zyrtare nr. 169/2018.

284 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 52 *"Njoftimi me shkrim i zgjedhësve"*, pika 4 *"... Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore raporton për përmbushjen e këtij detyrimi, sipas udhëzimit të ministrit që mbulon shërbimin e gjendjes civile".*

285 Po aty. Pika 4 "*Personat e ngarkuar me njoftimin e zgjedhësve i dorëzojnë njoftimin zgjedhësit personalisht ose, në mungesë të zgjedhësit, një anëtari madhor të familjes së tij, që gjendet në banesën e zgjedhësit, i cili firmos për marrjen e njoftimit. ...".*

286 Po aty. Neni 51 *"Publikimi i ekstraktit të përbërësve zgjedhorë"*, pika 4, *"... Publikimi bëhet në ambientet e zyrave të gjendjes civile ose në ambientet pranë tyre me akses të lirë për publikun".*

287 Po aty. Neni 52, pika 5 *"Shpenzimet për njoftimin, sipas këtij neni, mbulohen nga ministria që mbulon shërbimin e gjendjes civile. Fondi përkatës u shpërndahet njësive të qeverisjes vendore në raport me numrin e zgjedhësve që ka çdo njësi e qeverisjes vendore".*

288 Udhëzimi nr. 295/1 datë 6.11.2018 i Ministrisë së Brendshme, pika 12, paragrafi 2 *"Ekstraktet e përbërësve zgjedhorë me të njëjtat kritere, do të printohen dhe publikohen ne mënyrë periodike sipas përcaktimeve të Kodit Zgjedhor përkatësisht në datat 03.01.2019, 01.02.2019, 29.03.2019, dhe 28.04.2019"*

289 Shih Njoftimin e Ministrisë së Brendshme datë 25.05.2019, *"Publikohet Lista Përfundimtare e Zgjedhësve, për zgjedhjet vendore të 30 Qershorit"*

të zgjedhësve, i cili parashikohet të kryhej brenda 60 ditëve, nga data 4 dhjetor 2018 deri më datë 2 shkurt 2019.
Procesi synon të njoftojë zgjedhësit mbi saktësinë e të dhënave të përbërësve të tyre zgjedhorë si dhe numrin e qendrës së votimit ku ai do të votojë, në mënyrë që të nxisë zgjedhësit për të saktësuar të dhënat e tyre.

Pas plotësimit të këtij mekanizmi me ndryshimet e Kodit Zgjedhor të vitit 2012, tërë ky proces nuk është respektuar dhe zbatuar asnjëherë në mënyrë të plotë sikundër parashikohet në germë dhe frymë nga dispozitat e Kodit Zgjedhor, në asnjë prej proceseve zgjedhore të mbajtura prej vitit 2013 e deri më sot, por është anashkaluar qëllimisht dhe, shpesh, ka rezultuar të përdoret politikisht sipas krahut politik të kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore apo edhe maxhorancës së radhës.

Nga monitorimi i kryer prej KRIIK në mënyrë të pjesshme dhe jo sistematike rezultoi se edhe për zgjedhjet vendore të 30 qershorit, procesi i publikimit të ekstraktit të përbërësve zgjedhorë prej disa bashkive[290] në vend, u shoqërua me problematika të mos publikimit në kohë dhe jo sipas parashikimeve të Kodit Zgjedhor.

Ndryshe nga proceset e mëparshme zgjedhore, procesi i hartimit, përgatitjes, korrigjimit dhe publikimit të listave të zgjedhësve për Zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të 30 qershorit 2019 u shoqërua me një mungesë të thellë transparence.

As Ministria e Brendshme dhe as Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk bënë asnjë publikim për të informuar mbi ecurinë e procesit.
Konstatohet me shqetësim se, jo vetëm që ka munguar informacioni i ofruar në mënyrë proaktive prej institucioneve, por Ministria e Brendshme dhe DPGJC ka refuzuar t'i kthejë përgjigje dy kërkesave zyrtare nga KRIIK në lidhje me këtë proces[291], gjë që, në kontekstin e krijuar, përbën një shkelje flagrante të ligjit për të Drejtën e Informimit dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave[292].

VIII.1. Lista finale e Zgjedhësve

Njoftimi për publikimin e listës finale të zgjedhësve është publikuar në faqen e Ministrisë së Brendshme në datën 25 maj 2019[293] ndërkohë, nga raportet e auditëve teknicienë të kontraktuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për të mbikëqyrur procesin e gjenerimit të ekstrakteve zgjedhore, lista finale është publikuar në kohë[294].

Nga të dhënat e gjeneruara nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile rezultoi se në listën e votuesve ishin 3.536.015 shtetas, ndër të cilët 51% burra dhe 49% gra[295]. 132.788 nga këta ishin zgjedhës që votonin për herë të parë.

290 Bashkia Elbasan, Bashkia Librazhd, Bashkia Peqin, Bashkia Malësi e Madhe, Bashkia Shkodër, Bashkia Durrës, Bashkia Korçë, Bashkia Selenicë, etj.

291 KRIIK ka komunikuar disa herë edhe në rrugë telefonike me MB dhe DPGJC, nga të cilët është siguruar se shkresa zyrtare me informacionet e kërkuara është gati dhe do të dërgohej së shpejti.

292 Vendim nr. 238, datë 10.05.2019 i Këshillit të Ministrave, pika 21. *"Ministritë dhe institucionet/organet e varësisë t'u krijojnë vëzhguesve dhe shoqatave të regjistruara në KQZ, si vëzhguese të procesit zgjedhor, akses të plotë për të marrë informacion në lidhje me detyrimet ligjore të administratës publike në procesin zgjedhor"*.

293 Ministria e Brendshme, Publikohet Lista Përfundimtare e Zgjedhësve, për zgjedhjet vendore të 30 qershorit.

294 Raportet e Auditëve Teknicienë për listat për Zgjedhjet Vendore 2019.

295 Meshkuj 1.786.444 dhe Femra 1.749.571.

VIII.2. Problematika të evidentuara nga auditët teknicienë

Auditët teknicienë emërohen prej KQZ-së, dhe janë propozimet respektive të kryetarit dhe zëvendës kryetarit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Sipas Kodit Zgjedhor, auditët teknicienë duhet të kenë akses "...në sistemin elektronik dhe bazën e të dhënave të RKGJC-së, për të bërë të mundur leximin dhe krahasimin e përbërësve të gjendjes civile, ndryshimeve të tyre, kohën kur janë kryer këto veprime nga përdoruesit apo administratorët e sistemit, si dhe të raporteve të auditit apo çdo lloj raporti të sistemit elektronik, të cilat gjurmojnë të gjitha ndryshimet që kanë ndodhur mbi përbërësit zgjedhorë në RKGJC për periudhën që kontrollohet, duke përfshirë dhe metodologjinë se si gjenerohet ky raport. Aksesi i auditit në RKGJC në çdo rast është jo më i vogël sesa aksesi që ka Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Gjendjes Civile[296]".

Një prej auditëve teknicienë ka raportuar kufizime në akses gjatë kryerjes së detyrës[297], të tilla si lejimi për të marrë pjesë në gjenerimin e ekstraktit zgjedhor vetëm pas kërkesave të përsëritura, ndërkohë që një rast nuk i është lejuar pjesëmarrja me pretendimin se është proces i brendshëm, apo mosvendosjen në dispozicion të informacionit mbi çdo zgjedhës që ka pasur ndryshime në kodin e banesës dhe emrin e përdoruesit të Zyrës të Gjendjes Civile që ka kryer veprimin në sistem dhe datën e veprimit[298].

Auditët teknicienë kanë raportuar problematika në lidhje me mirëmbajtje e Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGJC). Gjatë raportimeve të ndërmjetme u ngrit shqetësimi se administrimi dhe mirëmbajtja e RKGJC nuk bëhej nga DPGJC në përputhje me ligjet në fuqi.

Nga referimet në raportin final, auditët teknicienë mbërritën në konkluzione totalisht të ndryshme në lidhje me këtë çështje.

Ndërsa njëri prej tyre ka mbërritur në konkluzionin se, në përgjithësi, procesi i gjenerimit të listave zgjedhore është kryer në përputhje me legjislacionin[299], dhe liston disa rekomandime me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të tij, auditi tjetër ka evidentuar një numër problemesh dhe konkludon se "administrimi dhe përpunimi i bazës së të dhënave të RKGJC është jo në përputhje me kërkesat teknike dhe administrative të legjislacionin në fuqi[300]".

---

296 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 61, pika 5 e tij.

297 Raporti i audituesit Zamir Hoxha *"Mbi verifikimin e veprimeve në bazën e të dhënave të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile"*.

298 Ndërkohë një qendrim të kundërt deklaron Ministria e Brendshme. Në Njoftimin për publikimin e Listave Përfundimtare të Zgjedhësve të datës 25 maj 2019 citohet se *"... i gjithë procesi i hartimit të Listës Përfundimtare të Zgjedhësve është kryer nën mbikëqyrjen e auditëve teknicienë të KQZ-së, të cilët kanë pasur akses të plotë në çdo etapë të këtij procesi. ..."*

299 Raport final i audituesit teknicien Lorenc Bako "Mbi auditimin e ekstrakteve të përbërësve zgjedhorë për Zgjedhjet Vendore 2019", fq. 7, *"...Vlen të theksohet gjithashtu se një nga pikat e dobëta që u evidentuan në raportet e mëparshme, e cila lidhej me mirëmbajtjen e këtij regjistri, është zgjidhur me realizimin e mirëmbajtjes me kompaninë austriake XION e cila ka implementuar RKGJC, gjë që do të çojë në rritjen e performancës dhe të sigurisë të këtij sistemi kompjuterik".*

300 Raporti i audituesit Zamir Hoxha "Mbi verifikimin e veprimeve në bazën e të dhënave të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile", fq. 15-16, *"...Siç është dokumentuar administrimi dhe përpunimi i bazës së të dhënave të RKGCJ është jo në përputhje me kërkesat teknike dhe administrative të legjislacionin në fuqi. Përveçse shkeljes të legjislacionit kjo ka pamundësuar një vlerësim të plotë të RKGJC si sistemi ku administrohen, përpunohen, mbahen të dhënat e shtetasve dhe nga ku gjëndërohet lista zgjedhore. Gjithashtu kjo ka sjellë limitime në analizat dhe vlerësimet e mundshme mbi ligjshmërinë e veprimeve te përdoruesve mbi elemente zgjedhorë duke cenuar besimin ndaj veprimeve të kryera gjatë proceset të hartimit të listave zgjedhore. Gjenerimin të ekstraktit zgjedhor, u provua që është një proces i cili kryhet nga një person i vetëm dhe totalisht jashtë sistemit të RKGJC, sistem i cili është i vetmi i njohur ligjërisht. Faza e vetme e cila përfshin RKGJC është*

Shqetësues në këtë situatë është reagimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në lidhje me këto gjetje dhe pretendime të auditëve, duke u mjaftuar vetëm me përcjelljen e raportit të auditëve në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, pa u investuar institucionalisht për të kuptuar nëse qëndrojnë ose jo pretendimet për shkeljet tejet serioze të ngritura nga auditi teknicien.
Ky qëndrim, në një situatë kur informimi ndaj publikut mbi ecurinë e procesit të hartimit dhe korrigjimit të listave ka qenë inekzistent, kompromenton akoma më shumë rolin e KQZ-së.

Madje mund të thuhet se, me këtë indiferentizëm të treguar, KQZ-ja evidentohet në mungesë të qëllimtë të ushtrimit të detyrimit të saj ligjor për të marrë shpjegime nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (DPGJC)[301].

Një qasje e tillë e bën procesin e auditimit të listave të zgjedhësve një formalitet pa përmbajtje dhe e redukton efektin tërë këtij procesi thjesht në citimin e një sërë problematikash në një raport që nuk përdoret.
Pra, konstatohet me shumë shqetësim se, nga njëri proces zgjedhor tek tjetri, procesi i auditimit të listave të zgjedhësve është larguar nga thelbi i vet dhe ka humbur funksionin.

Një problem madhor me listat e zgjedhësve, i mbartur edhe nga zgjedhjet pararendëse, ka qenë numri i lartë i zgjedhësve me adresë banimi të papërcaktuar ose me kod banimi 000, 888, apo 999.
Numri i këtyre votuesve në zgjedhjet parlamentare të vitit 2017 ka qenë 290.038.

Në ekstraktin e parë të përbërësve zgjedhorë të publikuar nga DPGJC në 4 dhjetor 2018 për zgjedhjet e 30 Qershorit ishin 284.065 qytetarë me adresë të papërcaktuar banimi.
Ky numër erdhi duke u zvogëluar[302] në ekstraktet e tjera të publikuara, dhe në listën finale të zgjedhësve ishte 727 votues.

Diferenca prej 283.338 votues ishte shumë e lartë, duke patur në konsideratë faktin që një proces i parealizuar për shumë vite me radhë dhe i evidentuar si problem në vazhdimësi, pati "zgjidhje" brenda një periudhe vetëm 6 mujore, për më tepër që procesi i njoftimit me shkrim të zgjedhësve, i cili mund të kontribuonte realisht në këtë proces, filloi vetëm pas publikimit të listës finale.

Ky ishte një problem i evidentuar edhe nga auditi teknicien Zamir Hoxha, i cili përpos evidentimit të situatës[303], referon në raportin e vet disa raste kodesh të

procedura e backup, e cila siç është evidentuar dhe në raportet e mëparshme nuk është dokumentuar dhe testuar sipas legjislacionit në fuqi, dhe në vetvete nuk është një procedure e cila lidhet direkt me procesin zgjedhor. Kryerja e të gjithë procesit të përpunimit dhe përgatitjes të ekstraktit zgjedhor në një ambient jashtë RKGJC krijon mungesë besimi dhe ka rezultuar me probleme të cilat cënojne korrektësinë e listës se zgjedhësve dhe te cilat janë evidentuara në vazhdimësi gjatë procesit te auditimit."

301 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 61 *"Mbikëqyrja e hartimit të listave të zgjedhësve nga KQZ-ja"*, pika 8 *"KQZ-ja, me kërkesën e dy anëtarëve të saj, i përcjell gjetjet dhe rekomandimet e auditëve teknicienë për Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile brenda 48 orëve, duke i kërkuar njëkohësisht shpjegime në lidhje me to".* Neni 50 *"Drejtimi metodologjik dhe mbikëqyrja e procesit të hartimit të listave"*, pika 3 *"KQZ-ja mbikëqyr procesin e hartimit të listave të zgjedhësve, administrimin e zonave të qendrave të votimit dhe numrit të zgjedhësve për çdo qendër votimi. KQZ-ja i kërkon informacion Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe njësive të qeverisjes vendore. Për shkeljet e konstatuara dhe për mosdhënie të informacionit, KQZ-ja u vendos sanksione drejtuesve të institucioneve përgjegjëse, në përputhje me këtë Kod".*

302 - Ekstrakti i datës 4 dhjetor 2018 - 284,065 zgjedhës; - Ekstrakti i datës 3 Janar 2019 – 217,961 zgjedhës; - Ekstrakti i datës 1 shkurt 2019 – 54,365 zgjedhës; - Ekstrakti i datës 2 mars 2019 – 3,069 zgjedhës; - Ekstrakti i datës 29 mars 2019 – 3.048 zgjedhës; - Ekstrakti i datës 28 prill 2019 – 841 zgjedhës; - Lista përfundimtare e zgjedhësve 727 zgjedhës.

303 Raporti i audituesit Zamir Hoxha "Mbi verifikimin e veprimeve në bazën e të dhënave të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile" fq. 9-10, *"...fakti që procesi i identifikimit të një numri kaq të madh të kodeve të banesave është realizuar në një kohë shumë të shkurtër është vlerësuar në mënyrë të vazhdueshme nga ana ime*

banesave të cilat janë absurde dhe të pamundura, si p.sh. numër shumë i lartë zgjedhësish të regjistruar në një kod banese që duket se nuk ekziston në hartë (kodi i vendosur në një lulishte), zgjedhës të regjistruar në një kod banese që i përket një fakulteti të Universitetit Fan S. Noli të Korçës, numër shumë i lartë zgjedhësish të regjistruar në banesa të vogla, etj.
Në përfundim të gjetjeve, auditi teknicien konkludon se "... ndërhyrjet e kryera për ndryshimin e elementëve zgjedhorë ku përfshihen rreth 10% e totalit të zgjedhësve dhe gjenerimi i listave me procedura manuale me ndërhyrje të personelit cenojnë rëndë besueshmërinë e listës së zgjedhësve...[304]".

Pas problematikave të cituara dhe konkluzioneve të paraqitura në raportin e auditit teknicien Hoxha, evidentohet sërish shqetësues reagimi i bërë nga disa komisionerë të KQZ-së.

Në mbledhjen e KQZ-së më datë 13 qershori 2019, Kryetari i KQZ-së i konsideroi gjetjet e auditit teknicien Hoxha si alarmante, ndërsa reagimi i disa prej komisionerëve të tjerë ishte minimizues ndaj shqetësimit të ngritur prej auditit se, me gjasë, një numër i papërcaktuar i kodeve të banesave të korrigjuara përgjatë periudhës janar-maj (rreth 10% e zgjedhësve) mund të ishte fiktiv[305].

Gjithashtu, nga auditët teknicienë, është evidentuar si problem përfshirja në lista e shtetasve të cilët në datën e zgjedhjeve janë 100 vjeç ose më shumë.
Përgjatë publikimit të ekstrakteve[306], në proceset e mëparshme zgjedhore, ky numër ka ardhur vazhdimisht me trend në ulje, sikundër është edhe e natyrshme të ndodhë, ndërkohë që në listën finale të zgjedhësve, ky numër është dyfishuar në krahasim me ekstraktin e parë të publikuar.

Sipas shpjegimit të dhënë nga DPGJC-ja auditëve teknicienë, kjo situatë ka ardhur si pasojë e mosidentifikimit të saktë të personave me moshë mbi 100 vjeç në ekstraktin e parë, e më pas në vazhdim, pasi ata janë identifikuar manualisht, ndërkohë që në listën finale identifikimi është kryer direkt në sistem, duke përdorur një metodë automatike, nga kompania austriake e kontraktuar për mirëmbajtjen e RKGJC[307].

---

si një element me risk shumë të lartë për cenimin e integritetit të listës së zgjedhësve.
Për këtë arsye në mënyrë të vazhdueshme nga ana ime është kërkuar vënia në dispozicion dhe aksesimi i informacionit për çdo zgjedhës që ka pasur një nga kodet e sipër përmendura dhe emrin e përdoruesit të Zyrës të Gjendjes Civile që ka kryer veprimin në sistem dhe datën e veprimit.
Siç është sqaruar dhe në raportet e mëparshme nga përfaqësuesit e DPGJC raportohet që është e pamundur të eksportohen këto të dhëna për shkak se mungojnë informacionet e detajuara teknike të ndërtimit, konfigurimit dhe ndërlidhjes të elementeve të bazës të dhënave dhe sistemit, largimin drejt pozicioneve të tjera të punës të punonjësve IT që kanë marrë trajnime specifike mbi sistemin. Pamundësia për identifikimin e nëpunësve që kryejnë ndryshime mbi të dhënat e shtetasve cenon rëndë sigurinë e regjistrit dhe cenon integritetin e listës së zgjedhësve."

304 Po aty, fq. 17.

305 Transkript i fjalës së Nënkryetarit të KQZ-së, z. Denar Biba, gjatë mbledhjes së KQZ-së më datë 13 qershor 2019: *"...nuk ka, nga ky këndvështrim, por nga ky këndvështrim vetëm, asnjë lloj impakti, zero, zero, në lidhje me zgjedhjet. [...] Me sa duket nga synimi ynë, se ai 250 mijëshi historik shkoi drejt një minimizimi të jashtëzakonshëm në këto zgjedhje, me gjasë nuk meritonte duartrokitje.*
Dhe ndoshta në shpejtësi e sipër dhe me vullnet dhe dëshirë të tepruar punonjësit e gjendjes civile kanë rrasur (po e përdor tipikisht, me qëllim këtë shprehje, këtë folje, e cila nuk është dhe aq etike) njerëz në një numër kodi të caktuar, por kjo nuk ka asnjë lloj impakti.
Ju garantoj nga pozita e atij që ka disa vite që merret me proceset zgjedhore, nuk ka asnjë lloj impakti dhe nuk kërcënon në mënyrë absolute, absolute, të drejtën e qytetarëve për të votuar. Ata qytetarë e kanë qendrën e tyre të votimit. [...] Disa konkluzione tuajat [...] janë të ekzagjeruara. .. .".

306 Ekstrakti i datës 4 dhjetor 2018- 1309 zgjedhës, Ekstrakti i datës 3 Janar 2019 – 1255 zgjedhës, Ekstrakti i datës 1 shkurt 2019 – 1232 zgjedhës, Ekstrakti i datës 2 mars 2019 – 1101 zgjedhës, Ekstrakti i datës 29 mars 2019 – 1077 zgjedhës, Ekstrakti i datës 28 prill 2019 – 1087 zgjedhës, lista përfundimtare e zgjedhësve 2797 zgjedhës.

307 Raporti i audituesit Zamir Hoxha *"Mbi verifikimin e veprimeve në bazën e të dhënave të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile"*: *"...Në kundërshtim me deklarimet e mëparshme ku është raportuar se vetëm përdoruesit e ZGJC kanë të drejtën e ndërhyrjes dhe ndryshimit të dhënave dhe elementëve zgjedhore në rastin e problematikës për ata shtetas qe mbushin ose kalojnë moshën 100 vjeç, deri me datë 30.06.2019 raportohet që me mbështetjen e kontraktuesit, nëpërmjet procedurave që ekzekutohen direkt në bazën e te dhënave te Regjistrit Kombëtar te Gjendjes Civile, është mundësuar ndryshimi automatik i kodit të QV, konkretisht ne kodin*

Ky shpjegim i dhënë prej DPGJC ngre pikëpyetje mbi kapacitetet në dispozicion, përdorimin dhe menaxhimin e sistemit elektronik që administron Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGJC).

Konstatohet se kjo situatë për menaxhimin manual të të dhënave, pavarësisht arsyeve objektive që mund të parashtrohen, nuk ishte një zgjidhje e një momenti të fundit, por ishte e parashikuar të menaxhohej në mënyrë të tillë.

Kjo pasi ky gjenerim manual është parashikuar të bëhet i tillë nga udhëzimi i hartuar për këto zgjedhje, i cili është një udhëzim i ndryshëm nga udhëzimet e hartuara për zgjedhjet e mëparshme, të cilët parashikonin gjenerim automatik të listës nga sistemi i RKGJC-së

Udhëzimi nr. 295/1 datë 06.11.2018 i miratuar nga Ministria e Brendshme për zgjedhjet e vendore të vitit 2019 udhëzon që të "gjenerohet ekstrakti elektronik i përbërësve zgjedhorë"[308] pa e përcaktuar mënyrën se si të bëhet ky gjenerim, duke lënë, kështu, hapësirë edhe për menaxhim apo gjenerim manual të tij.
Ndërkohë, për dy proceset zgjedhorë të mëparshëm, atë Parlamentar 2017 dhe Vendor 2015, Udhëzimet e miratuara po nga Ministria e Brendshme, respektivisht ai me nr. 671 datë 6.12.2016[309] dhe ai me nr. 364 datë 16.12.2014[310], udhëzojnë se "ekstraktet e përbërësve zgjedhore dhe listat e zgjedhësve gjenerohen automatikisht nga RKGJC-ja" dhe se "Procedura e gjenerimit të ekstrakteve dhe listës së zgjedhësve është funksionalitet i sistemit të RKGjC-së".

Bazuar në Ligjin 138/2015, ose të ashtuquajturin ligj i dekriminalizimit, dhe në Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm Nr.225, datë 11.05.2016[311], DPGJC në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, duhet të evidentojnë dhe heqin nga listat e zgjedhësve shtetasit që nuk mund të ushtrojnë të drejtën e votës për shkak të ligjit.

Në këto zgjedhje lidhur me mirë-zbatimin e këtij procesi pati sërish moskoordinimin ndërmjet institucioneve[312], gjë që është vërejtur edhe në procesin e mëparshëm zgjedhor.

'8899'. Pra është realizuar një ndërhyrje në bazën e të dhënave dhe elementeve zgjedhor në kundërshtim me legjislacionin ne fuqi duke cenuar rëndë listën e zgjedhësve".
Raport final i audituesit teknicien Lorenc Bako *"Mbi auditimin e ekstrakteve të përbërësve zgjedhorë për Zgjedhjet Vendore 2019"* : *"...Kjo ka ndodhur për faktin sepse deri në periudhën përpara se të kryhej kontrata e mirëmbajtjes me kompaninë XION, kodet 8899 për këtë kategori zgjedhësish janë ndryshuar manualisht nga zyrat e gjendjes civile, proces ky i cili ka shkaktuar mosreflektimin e saktë të këtij grupi zgjedhësish. Në listën përfundimtare me ndihmën e kompanisë së suportit,* është mundësuar ndryshimi automatik i kodit të QV, konkretisht në kodin '8899', për ata shtetas që mbushin ose kalojnë moshën 100 vjeç, deri më datë 30.06.2019".

308 Udhëzimi Nr. 295/1 datë 6.11.2018 *"Për procedurat e* hartimit të listave të *zgjedhësve për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore"*, pika 1 *"Brenda datës 20.11.2018, nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile (RKGJC) i vitit 2010, të gjenerohet ekstrakti elektronik i përbërësve zgjedhorë, në përbërje të të cilit janë të gjithë shtetasit me të drejtë vote, të cilët deri në datën 30.6.2019 kanë mbushur moshën 18 vjeç, të lindur deri në datën 30.6.2001. ...".*

309 Udhëzimi Nr. 671 datë 06.12.2016 *"Për procedurat e hartimit të listave të zgjedhësve për zgjedhjet për Kuvendin"*, pika 1 *"Ekstraktet e përbërësve zgjedhore dhe listat e zgjedhësve gjenerohen automatikisht nga RKGJC-ja, në afatet që parashikon ligji dhe janë të vlefshme në ndërfaqen grafike online të RKGJC-së. Procedura e gjenerimit të ekstrakteve dhe listës së zgjedhësve është funksionalitet i sistemit të RKGjC-së, ku përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile shkarkon nga RKGJC përbërësit zgjedhorë për zgjedhësit përkatës, si më poshtë: përzgjedh tek menuja në të majtë të faqes së RKGjC-së, opsionin "Procesi i regjistrimit", "Raportime" dhe zgjedh listën. ...".*

310 Udhëzimi Nr. 364 datë 16.12.2014 *"Për procedurat e* hartimit të listave të *zgjedhësve për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore"*, pika 1. *"Ekstraktet e përbërësve zgjedhorë dhe listat e zgjedhësve gjenerohen automatikisht nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile, në afatet që parashikon ligji dhe janë të vlefshme për t'u shkarkuar on-line nga aplikacioni përkatës i Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile. Procedura e gjenerimit të ekstrakteve dhe listës së zgjedhësve është funksionalitet i sistemit, Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile, ku përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile shkarkon nga ky sistem përbërësit zgjedhorë, për zgjedhësit sipas vendbanimit përkatës, si më poshtë: - përzgjedh në menunë në të majtë të faqes së RKGJC-së, opsionin "Procesi i regjistrimit", "Raportime" dhe zgjedh listën. ...".*

311 Udhëzimi Nr.225, datë 11.05.2016 i Ministrit të Brendshëm "*Për procedurat e pezullimit nga lista e zgjedhësve për shtetasit që vuajnë dënimin e parashikuar nga Ligji Nr.138/2015 "Për garantimin e personave që zgjidhen, emërohen dhe ushtrojnë funksione publike*"

312 Sipas auditit teknicien Lorenc Bako: *"... Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në bazë të këtij udhëzimi duhet të dërgojë brenda afateve pranë DPGJC listat e këtyre zgjedhësve, pasi në varësi të numrit të tyre mund të ndryshojë edhe konfigurimi i numrit të qendrave të votimit. Pavarësisht këtij problem organizativ janë hequr nga lista përfundimtare e zgjedhësve të gjithë ata shtetas që preken nga ky udhëzim".*

Në rezultante të këtij procesi, u realizua heqja nga lista e 1.114 shtetasve që janë duke vuajtur dënimin në IEVP për vepra të ndryshme penale, të cilat hyjnë ne sferën e ndalimit që parashikon ligji nr. 138/2015.
Për shkak të refuzimit dhe mosdhënies informacion mbi këtë proces nga Ministria e Brendshme, bëhet e pamundur një vështrim i plotë mbi funksionimin e mekanizmit dhe sjelljen e institucioneve përsa parashikon dhe detyron legjislacioni për këtë proces.

VIII.3. Njoftimi me shkrim i zgjedhësve

Për zgjedhjet e 30 qershorit, procesi i njoftimit me shkrim[313] duhet të kryhej në periudhën 4 dhjetor 2018 deri më 2 shkurt 2019.

Duke mos patur informacion zyrtar prej Ministrisë së Brendshme, është e pamundur të evidentohet se sa ka qenë fondi i lëvruar prej kësaj ministrie në funksion të realizimit të procesit të njoftimit me shkrim të zgjedhësve.

KRIIK i është drejtuar me shkresë zyrtare 61 bashkive në vend, në lidhje me procesin e hartimit dhe publikimit të listave të zgjedhësve si dhe të njoftimit me shkrim të zgjedhësve.

Nga 61 bashki, 30[314] kthyen përgjigje, ndër të cilat 5 bashki[315] referojnë se nuk u është alokuar asnjë fond prej Ministrisë së Brendshme për njoftimin me shkrim të zgjedhësve, ndërsa 22 Bashki[316] referojnë se pavarësisht se iu është lëvruar fondi, procesi i njoftimit të zgjedhësve nuk kishte filluar.

Disa bashki[317], në përgjigjen ndaj shkresës zyrtare të KRIIK, kanë reflektuar mosnjohje të kuadrit ligjor në lidhje me procesin e njoftimit me shkrim të zgjedhësve, duke u shprehur se ky proces kryhet pasi të gjenerohet lista finale e zgjedhësve.

Ndërkohë, referuar raportit të auditit teknicien të listave të zgjedhësve, z. Hoxha, duket se mosnjohja e kuadrit ligjor në lidhje me njoftimin me shkrim të zgjedhësve nuk manifestohet vetëm në nivel bashkie, por edhe në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile ose më saktë është një orientim prej kësaj Drejtorie për të realizuar në mënyrë të tillë këtë proces.

Auditi teknicien, në raportin e vet përfundimtar citon një mesazh elektronik drejtuar atij nga DPGJC, në të cilin pohohet se DPGJC mori masat për gjenerimin e njoftimit te zgjedhësve për çdo njësi administrative / bashki pasi u gjenerua lista finale e zgjedhësve[318], fakt i cili e ngarkon akoma me më shumë përgjegjësi këtë institucion.

313 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 52 "*Njoftimi me shkrim i zgjedhësve*" pika 1 *"Brenda 60 ditëve nga publikimi i ekstraktit të përbërësve zgjedhorë të zgjedhësve, sipas pikave 1, 2 dhe 3 të nenit 51, kryetari i njësisë së qeverisjes vendore kryen lajmërimin me shkrim për çdo zgjedhës të përfshirë në ekstraktin e përbërësve zgjedhorë të qendrave të votimit në njësinë përkatëse të qeverisjes vendore. Njoftim bëhet edhe për shtetasit që kanë mbushur 100 vjeç, sipas të dhënave në RKGjC, duke i njoftuar ata për arsyen e mospërfshirjes në listë"*

314 Bashkia Berat, Bashkia Kuçovë, Bashkia Skrapar, Bashkia Poliçan, Bashkia Dibër, Bashkia Mat, Bashkia Bulqize, Bashkia Durrës, Bashkia Shijak, Bashkia Elbasan, Bashkia Cërrik, Bashkia Belsh, Bashkia Patos, Bashkia Roskovec, Bashkia Lushnjë, Bashkia Mallakastër, Bashkia Gjirokastër, Bashkia Libohovë, Bashkia Përmet, Bashkia Këlcyre, Bashkia Dropull, Bashkia Korçë, Bashkia Maliq, Bashkia Devoll, Bashkia Pustec, Bashkia Kukës, Bashkia Kurbin, Bashkia Pukë, Bashkia Konispol, Bashkia Delvinë.

315 Bashkia Kukës, Bashkia Kurbin, Bashkia Dibër, Bashkia Mat, Bashkia Durrës.

316 Bashkia Berat, Bashkia Kuçovë, Bashkia Skrapar, Bashkia Poliçan, Bashkia Bulqize, Bashkia Shijak, Bashkia Elbasan, Bashkia Cërrik, Bashkia Patos, Bashkia Roskovec, Bashkia Lushnjë, Bashkia Mallakastër, Bashkia Gjirokastër, Bashkia Libohovë, Bashkia Dropull, Bashkia Korçë, Bashkia Maliq, Bashkia Devoll, Bashkia Pustec, Bashkia Pukë, Bashkia Konispol, Bashkia Delvinë.

317 Bashkia Bulqizë, Bashkia Berat, Bashkia Cërrik, Bashkia Dibër, Bashkia Konispol, Bashkia Libohovë, Bashkia Lushnjë, Bashkia Poliçan.

318 Raporti i audituesit Zamir Hoxha *"Mbi verifikimin e veprimeve në bazën e të dhënave të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile"*: *"Nëpërmjet email të dërguar me datë 30 Maj 2019 gjithashtu është kërkuar informacion mbi njoftimin*

Një shqetësim tjetër i evidentuar në këto zgjedhje, lidhet me përdorimin e njoftimit me shkrim të qytetarëve prej njësisë administrative në qytetin e Tiranës, si një formë për të kuptuar përkatësinë politike apo edhe deklaruar votën e qytetarëve. Në kontekstin e një radikalizimi të skajshëm të krijuar, opozita e bashkuar iu kërkonte mbështetësve të vet dhe të gjithë qytetarëve për të mos e njohur 30 qershorin si ditë zgjedhjesh dhe për ta braktisur atë, nga ana tjetër, mazhoranca iu bënte thirrje për të kundërtën mbështetësve të vet dhe të gjithë qytetarëve, duke përdorur të tërë mekanizmat e saj, për ta konsideruar 30 qershorin si datë zgjedhjesh dhe për të nxitur qytetarët që të shkonin për të votuar.
Në një situatë të tillë, njohja ose jo e 30 qershorit si datë zgjedhjesh, si dhe shkuarja ose jo për të votuar, nënkuptonte automatikisht identifikimin si mbështetës dhe votues i mazhorancës ose i opozitës[319].

Është e nevojshme të shëndoshet më tej praktika pozitive e ndjekur duke e rregulluar në mënyrë *mënyrë më të plotë mekanizmin e njoftimit me shkrim, në të tërë elementët e tij, në mënyrë që të parandalohet vullneti individual apo edhe institucional për sabotimin e këtij procesi.*

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet të zhvillojë përgjegjësitë e tij në përmbushje të detyrimeve të ngarkuara nga ligji për të mbikëqyrur procesin si dhe siguruar zbatimin me efikasitet të të tërë elementëve përbërës së tij, me synim garantimin e integritetit të procesit zgjedhor.

Kuvendi i Shqipërisë duhet që nëpërmjet mekanizmave të vet apo procesit reformues të kuadrit ligjor, të detyrojë përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësive të *Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, duke zhbërë praktikat apo precedentët negativë të aplikuar deri më tani nga ky institucion.*

IX. MJEDISI I FUSHATËS

IX.1. Fushata e parakohshme

Sipas Kodit Zgjedhor, fushata zgjedhore nis 30 ditë përpara ditës së zgjedhjeve dhe përfundon 24 orë përpara saj.
Fushata zgjedhore, zyrtarisht, nisi në 31 Maj 2019, megjithatë, në vazhdën e një tradite tanimë të konsoliduar, aktivitete me karakter elektoral[320] u zhvilluan muaj

me poste te qytetareve nga ana e njësive vendore dhe raportimet e tyre n.q.s. ka pasur. Në përgjigjen e tyre DPGJC thekson që me gjenerimin e listës përfundimtare te zgjedhësve, DPGJC, mori masat për gjenerimin e njoftimit te zgjedhësve për çdo njësi administrative / bashki. Jemi informuar nga ana e ZGJC-ve se janë printuar dhe janë dërguar për tu firmosur nga ana e Kryetarit te Bashkisë dhe me tej për t'u dërguar me poste, ne adrese te zgjedhësve".

319 Sipas informacionit të raportuar, në javën e tretë të qershorit vëzhguesi i KRIIK u kontaktua nga një ekip prej dy personash, të cilët u prezantuan si studentë dhe të angazhuar nga kompania "Aleat" për të dorëzuar njoftimin se ku qytetari ka qendrën e tij të votimit dhe i sati ai është në listën e zgjedhësve.
Pas dorëzimit të njoftimit, ekipi e pyeste qytetarin nëse do të shkonte të votonte më datë 30 qershor, duke mbajtur shënim për gjithçka, në një bllok ku kishte lista me emra të shënuar paraprakisht.
Nga bashkëbisedimi me ta, u deklarua se ekipi, nuk përfaqësonte kompaninë "Aleat", por ishte i punësuar për të bërë këtë shërbim, si pjesë e një organizimi të drejtuar nga njësia administrative e bashkisë. Theksohet se edhe njoftimi me shkrim që dorëzohej prej tyre, ishte modeli i përcaktuar sipas udhëzimit të Ministrisë së Brendshme, i printuar, i firmosur dhe vulosur nga kryetari i njësisë administrative të bashkisë.

320 - 26 tetor 2018: Veliaj zbulon sloganin e zgjedhjeve: Mbështesni PS-në masivisht, Veliaj: *"Kushdo që do të shkojë të votojë vitin tjetër për kryetarin e Bashkisë ose për Këshillin Bashkiak duhet të mendojë e të thotë: mirë kryetarin e Bashkisë, por me votën e Këshillit Bashkiak nuk bëj më qokë, do t'ia jap vetëm PS sepse vetëm ajo ma garanton që kryetari i Bashkisë mbështetet për të bërë këto lloj punësh". ("Balkanëeb.com")*
- 30 tetor 2018: Buxheti dhe bilanci i punëve në 3 vjet, Veliaj dëgjesë me banorët e Njësinë 10, Veliaj: *"Që punët e mira të vazhdojnë për Tiranën, është jetike shumica në Këshillin Bashkiak, ndaj është e nevojshme që në zgjedhjet e radhës, vota të shkojë për Partinë Socialiste"*. Në takim morri pjesë edhe deputeti i PS në Njësinë 10, Fatmir Xhafaj, i cili theksoi se Veliaj kërkon një mandat të dytë jo për të qëndruar në atë karrige, por për të

përpara se fushata zgjedhore të niste zyrtarisht.

Mospërkufizimi në ligj i fushatës zgjedhore krijon një vakum ligjor në lidhje me mundësinë e subjekteve zgjedhore për të kryer aktivitete elektorale, duke e lënë të hapur mundësinë që, *de-facto*, fushata të zhvillohet gjatë gjithë kohës.

Përveç efekteve negative në ngritjen e tensioneve politike dhe neglizhimin e detyrave prej zyrtarëve publikë, veçanërisht atyre të nivelit të lartë[321], kjo sjell edhe vështirësi në përllogaritjen e shpenzimeve të kryera gjatë fushatës.

Madje, shumë aktivitete të kryera nga partitë politike gjatë periudhës disa mujore përpara ditës së zgjedhjeve do të duhej të përllogariteshin si shpenzime për llogari të fushatës elektorale në llogari të subjekteve zgjedhore.

IX.2. Fushata në median sociale

Kodi Zgjedhor ka pak rregullime mbi vetë fushatën, duke u fokusuar me tepër në mbulimin e saj në mediat audiovizive, ndërkohë, një mungesë e ndjeshme është mosrregullimi i fushatës në mediat sociale, të cilat janë aktualisht një kanal i rëndësishëm komunikimi për subjektet zgjedhore, e veçanërisht me të rinjtë.

Ndërsa në lidhje me sjelljen e medias audiovizive ka një numër rregullimesh, media sociale mbetet e parregulluar dhe pamonitoruar, çka rrit gjasat për abuzim me të[322].

IX.3. Aktivitetet gjatë fushatës

Fushata Zgjedhore për Zgjedhjet Lokale 2019 ishte e ndryshme në shumë elementë nga të tjera fushata zgjedhore të mëparshme, për vetë specifikat e këtyre zgjedhjeve dhe mungesën e pjesëmarrjes së partive më të mëdha opozitare në to.

Ndërsa bojkotonin zgjedhjet dhe pasi kishin hequr dorë nga mandatet në Kuvendin e Shqipërisë, këto parti të grupuara dhe të quajtura tashmë si "opozita e bashkuar" kryen protesta të vazhdueshme, të cilat shpesh u shoqëruan me sulme ndaj institucioneve dhe përleshje me policinë, duke kërkuar dorëheqjen e kryeministrit Rama dhe zhvillimin e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare.

Aktivitetet elektorale të maxhorancës u fokusuan, në një masë të konsiderueshme në arsyen se pse zgjedhjet lokale duhet të kryheshin më datë 30 qershor, nxitjen e qytetarëve të merrnin pjesë në zgjedhje dhe në arritjet e qeverisë qendrore.

---

shërbyer dhe për ta çuar përpara misionin e tij për transformimin e Tiranës. (*"GazetaDita.al"*).
- 8 nëntor 2018: Kryeministri Rama së bashku me ministren e Arsimit Lindita Nikolli dhe deputetin socialist Pjerin Ndreu zhvilluan një takim me të rinjtë e Partisë Socialiste në Lezhë. "*Kemi rrugë të vështirë të përpara sepse kërkojmë fitore"*, deklaroi Ndreu, i cili bëri të ditur dy ditë më parë në emisionin "45 minuta" të Report TV se do të kandidojë për postin e kryetarit të Bashkisë së Lezhës. Në takimin që dukej si fillimi i fushatës për vendoret e 30 qershorit, Rama thumboi bashkinë që drejtohet nga demokratët. *"Bashkëjetesa e makinave me delet në mes të qytetit iu duket si model zhvillimi, iu duket vizion atyre. Një vizion i tillë të çon për lesh dhie"* komentoi Rama. *("Shqiptarja.com")*

321 Të cilët angazhohen aktivisht në fushatë edhe si drejtues politikë në disa qarqe.

322 Përgjatë fushatës zgjedhore, në mediat sociale *(shih p.sh. spotin e shpërndarë në faqen personale në Facebook të zv. Ministrit të Mbrojtjes, Petro Koçi)* është vërejtur një spot me pamje nga disa prej veprave infrastrukturore të kryera në Bashkinë Tiranë në vitet e fundit, në fund të së cilës ishin mesazhet #30qershor dhe #unëvotoj.
Pavarësisht se spoti, qartas, përmbante elementë të propagandës elektorale në favor të Partisë Socialiste, nuk kishte asnjë informacion se nga kush ishte prodhuar dhe cili ishte subjekti zgjedhor që mbështetej nëpërmjet tij, çka do të sillte që të ishte në kundërshtim me pikën 1 të nenit 80 dhe pikën 4 të nenit 84 të Kodit Zgjedhor, nëse do të ishte transmetuar në mediat audiovizive. Ndërkohë, shpërndarja e saj në mediat sociale është e lirë dhe e pakontrolluar.

Në këtë situatë, problematikat lokale morën fare pak vëmendje nga subjektet elektorale, duke i dhënë kësaj fushate karakteristikat e një fushate politike për zgjedhje të përgjithshme dhe të një konfirmimi për qeverisjen qendrore, më tepër se ato të zgjedhjeve vendore.

Fushata u zhvillua më tepër me anë të takimeve derë më derë, veçanërisht nëpërmjet takimeve të ngushta me komunitetin, si dhe nëpërmjet mediave sociale.
Mitingjet masive ishin të kufizuara. Në këto mitingje masive, protagonistë ishin zyrtarë të lartë shtetërorë, veçanërisht Kryeministri Rama, ndërkohë që kandidatët lokalë morën pak ose aspak vëmendje gjatë tyre.

Aktivitetet elektorale të mbajtura me praninë e Kryeministrit Rama u shoqëruan me protesta të organizuara nga partitë e opozitës[323], madje, në disa raste pati edhe përplasje fizike mes policisë dhe protestuesve.

Me afrimin e datës së zgjedhjeve, në një numër bashkish pati protesta të opozitës dhe sulme ndaj zyrave të administratës zgjedhore, të cilat në disa raste rezultuan me shkatërrim të materialeve zgjedhore ose të mjediseve në të cilat këto të fundit ishin vendosur[324], apo edhe në konfrontime mes policisë bashkiake, në qytetet ku kryetari i bashkisë ishte zgjedhur nga partitë e opozitës, dhe policisë së shtetit.

Pavarësisht regjistrimit të një numri subjektesh zgjedhore, të grupuara në dy koalicione parazgjedhore, si dhe një numri partish që garonin jashtë dy koalicioneve parazgjedhore, zgjedhësit shqiptarë nuk patën realisht mundësinë për të bërë zgjedhje dhe fushata konkurruese ishte gati inekzistente.

Fushata e mazhorancës u karakterizua nga një retorikë agresive, sulme personale dhe komente tallëse e denigruese ndaj kundërshtarëve politikë, veçanërisht ndaj liderëve të Partisë Demokratike dhe Lëvizjes Socialiste për Integrim.
Por edhe gjuha e përdorur nga opozita gjatë protestave apo antimitingjeve të organizuara ishte agresive dhe nxitëse, dhe shpesh këto protesta rezultuan në përplasje fizike mes protestuesve dhe policisë së shtetit.

IX.4. Përdorimi i administratës në fushatë

Përgjatë periudhës zgjedhore janë ngritur një sërë pretendimesh të besueshme, shumë prej të cilave janë bërë publike në media, për presion ndaj zgjedhësve, veçanërisht atyre që janë të punësuar në administratën shtetërore, me qëllim angazhimin në fushatë, pjesëmarrjen në aktivitete elektorale si dhe për të votuar ditën e zgjedhjeve.

Në një numër aktivitetesh të organizuara në nivel lokal, menjëherë pas orarit të punës, janë vërejtur të marrin pjesë punonjës të administratës lokale, ashtu sikundër edhe janë vërejtur të marrin pjesë edhe në protestat e organizuara nga opozita në ato bashki ku kreu i bashkisë ishte zgjedhur nga lista e kësaj të fundit.

IX.5. Zyrat zgjedhore

Në vazhdën e ndryshimeve ligjore të 22 Majit 2017 në zbatim të Ligjit për Partitë Politike, vendosja e materialeve propagandistike për fushatën zgjedhore u krye vetëm në afërsi të zyrave zgjedhore duke bërë që fushata të mos ishte e dukshme në infrastrukturën urbane nëpërmjet posterave apo të tjera materialeve propagandistike statike.

323 Si në bashkitë: Devoll, Shkodër, Bajram Curri, Fier, Durrës, Patos, etj.

324 Si në Bushat, Has, Vau i Dejës, etj.

Numri i zyrave zgjedhore të hapura për këto zgjedhje ishte relativisht i ulët, ndërkohë që shumë zyra të deklaruara si të tilla, sipas raporteve të ekspertëve financiarë që vëzhguan fushatën të kontraktuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nuk ishin të identifikuara si të tilla me anë të logove apo shenjave.

Pavarësisht numrit, relativisht, të ulët të zyrave zgjedhore të hapura, referuar raporteve të ekspertëve të angazhuar për monitorimin e fushatës zgjedhore[325], ka patur raste të hapjes së më shumë se një zyre zgjedhore për një lagje, në kundërshtim me Udhëzimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve[326].

IX.6. Task-Forca për monitorimin e veprimtarisë së administratës në fushatë

Në datë 10 maj 2019, Këshilli i Ministrave miratoi Vendimin për marrjen e masave dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore gjatë procesit zgjedhor[327].

Vendimi përcakton një sërë detyrimesh për institucionet e administratës shtetërore. Ndër të tjera, Vendimi parashikonte ngritjen e një Task-Force me qëllim koordinimin e procesit të monitorimit. Task Forca drejtohej nga zv. Kryeministri dhe në përbërje të saj ishin 10 institucione të tjera[328], ndërkohë që të tjera institucione[329] ftoheshin të merrnin pjesë në mbledhjet e saj.

KRIIK i ka kërkuar, me anë të një letre zyrtare, dërguar më 31 korrik 2019 Zv/Kryeministrit kopje të procesverbaleve të mbledhjeve të Task Forcës gjatë periudhës së funksionimit, por ende nuk ka marrë një përgjigje zyrtare në lidhje me këtë[330].

Nga informacioni i marrë nga institucionet shtetërore në lidhje me veprimtarinë e grupeve monitoruese për sjelljen e nëpunësve civilë gjatë fushatës, në zbatim të udhëzimit të dërguar institucioneve nga Komisioneri per Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka të dhëna për një mbledhje të kryer nga Task-Forca, në datë 19 qershor 2019[331].

Deri në momentin e publikimit të këtij raporti, Task Forca nuk ka nxjerrë një raport publik në lidhje me veprimtarinë e vet dhe është e paqartë nëse ajo ka funksionuar realisht.

325 Raportet e Ndërmjetme të Monitorimit për Fushatën Zgjedhore 2019.

326 Udhëzim Nr. 1, datë 31.05.2017, i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (ndryshuar me vendimin nr.153, datë 11.04.2019 të KQZ-së) Neni 2, pika 2 *"Subjektet zgjedhore lejohen të ngrenë jo më shumë se një zyrë elektorale për lagje qyteti ose fshat".*

327 Vendim nr. 238, datë 10.05.2019 i Këshillit të Ministrave *"Për marrjen e masave dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore, gjatë procesit zgjedhor për zgjedhjet vendore për vitin 2019".*

328 Ministri i Brendshëm; Ministri i Mbrojtjes; Ministri i Financave dhe Ekonomisë; Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë; Ministri i Drejtësisë; Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin; Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave; Drejtori i Departamentit të Administratës Publike; Drejtori i Përgjithshëm të Policisë së Shtetit; Drejtori i Parandalimit dhe Pastrimit të Parave në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

329 Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil; Avokati i Popullit; një përfaqësues nga Prokuroria e Përgjithshme; një përfaqësues nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

330 Ndërkohë, 17 institucioneve të tjera të cilat kishin detyrimin të merrnin pjesë dhe raportonin ndaj Task Forcës kanë marrë kërkesa zyrtare për informacion, përfshi Raportet e dërguara Task Forcës. Nga këto dhjetë institucione kanë kthyer përgjigje duke vënë në dispozicion vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar.

331 Informacioni citohet nga një memo e dërguar Ministres së Drejtësisë, zj. Etilda Gjonaj, në datë 8 korrik 2019 nga Grupi i Monitorimit i ngritur pranë Ministrisë së Drejtësisë, memo e cila përfshihet në përgjigjen zyrtare të kthyer nga Ministria e Drejtësisë për KRIIK. Kjo referencë, është e vetmja e gjetur nga KRIIK në lidhje me mbledhje të kryera prej Task-Forcës. Sipas memos, mbledhja e datës 19 qershor 2019 është mbledhja e dytë e Task-Forcës, por nuk ka informacion se kur është kryer mbledhja e parë. Gjithashtu, në raportin e Ministrisë së Bujqësisë, dërguar KRIIK në përgjigje të kërkesës për informacion, citohet një mbledhje e kryer nga Task-Forca, por pa cituar datën në të cilën kryer, ndërkohë që vetë raporti në dispozicion është pa datë.

Aktiviteti i task-forcës për monitorimin e përdorimit të administratës dhe burimeve shtetërore në fushatën zgjedhore, një eksperiencë pozitive e nisur në vitin 2017 duhet të mirë-rregullohet dhe të garantohet funksionimi real i saj, si një garanci më shumë në ndalimin e shpërdorimit të burimeve shtetërore, por edhe për aspekte të tjera të integritetit të procesit zgjedhor.

IX.7. Angazhimi zyrtarëve të lartë qendrorë në fushatë

Angazhimi i zyrtarëve të lartë në fushatën zgjedhore ishte i dukshëm në fushatë. Titullarë të qeverisjes qendrore u angazhuan në aktivitete me karakter institucional që propagandonin inaugurime apo nisje punimesh, me praninë e drejtuesve vendorë që aktualisht ishin edhe kandidatë për kryetarë bashkie[332].

Angazhimi i zyrtarëve të lartë dhe mbështetja, e drejtpërdrejtë ose jo e tyre, ndaj kandidatëve ngre disa shqetësime, si zbehje e dallimit mes partisë dhe shtetit, ndikim të pushtetit qendror në atë lokal, si dhe përdorim të burimeve shtetërore për qëllime elektorale, çka është në kundërshtim me kuadrin ligjor.

Kuadri ligjor duhet të parashikojë ndalimin e zyrtarëve të lartë qendrorë të marrin pjesë në fushatë në mbështetje të kandidatëve lokalë, në mënyrë që të garantohet barazia në garë e kandidatëve si dhe ndarja e qartë e pushtetit lokal nga ai qendror.

X. FINANCIMI I FUSHATËS ZGJEDHORE

Transparenca dhe kontrolli i financave politike, qoftë gjatë fushatave zgjedhore, qoftë jashtë tyre, përbën një shqetësim madhor për të gjitha vendet demokratike.

Financuesit e partive politike sigurojnë akses të privilegjuar tek vendimmarrësit, akses i cili mund të keqpërdoret, duke vendosur interesin privat të individëve a grupimeve të individëve mbi interesin publik.

Problematika e kontrollit të financave zgjedhore është akoma më e mprehtë për Shqipërinë, për dy arsye. *Së pari,* si pasojë e institucioneve të dobëta dhe moszbatueshmërisë së ligjit, kontrolli i financave politike mbetet një sfidë madhore pasi, de-facto, financat politike janë mbikëqyrur vetëm formalisht në vijimësi.

Së dyti, mungesa e kontrollit lë të hapur mundësinë për infiltrim të parave të gjeneruara nga veprimtaritë kriminale apo korruptive, duke i mbajtur

332 Në vazhdim mund të gjenden disa njoftime në faqet zyrtare të ministrive të Infrastrukturës, Shëndetësisë dhe Turizmit, të cilat pasqyrojnë aktivitete institucionale të ministrave të shoqëruar nga kandidatë të Aleancës për Shqipërinë Europiane për kryetar bashkie, apo deklarata që mund të merren si fushatë elektorale:
- 31 maj 2019, Ministrja e Infrastrukturës dhe Energjisë, zj. Belinda Balluku në inaugurimin e rrjetit të ujësjellësit në Rrëshen, e shoqëruar nga Kryetari i Bashkisë dhe njëkohësisht kandidat për kryetar të Bashkisë Rrëshen nga ASHE, z. Ndrec Dedaj;
- 12 qershor 2019, Ministrja e Shëndetësisë, zj. Ogerta Manastirliu në Durrës e shoqëruar nga kandidatja e ASHE për kryetare të Bashkisë në këtë bashki, zj. Valbona Sako;
- 14 qershor 2019, Ministrja e Shëndetësisë, zj. Ogerta Manastirliu në inaugurimin e rehabilitimit të Qendrës Shëndetësore Poliçan e shoqëruar nga Kryetari i Bashkisë dhe kandidat për kryetar Bashkie nga ASHE, z. Adriatik Zotkaj;
- 18 qershor 2019, Ministrja e Shëndetësisë, zj. Ogerta Manastirliu në nisjen e punimeve për rehabilitimin e spitalit rajonal Kukës e shoqëruar nga kandidati i ASHE për kryetar të Bashkisë Kukës, z. Safet Gjici;
- 19 qershor 2019, Ministri i Turizmit dhe Mjedisit, z. Blendi Klosi, në Berat, gjatë një takimi institucional thotë: *"Unë besoj që kryetarët e rinj të bashkive që do të dalin nga zgjedhjet e 30 qershorit do ta kenë shumë mirë parasysh këtë hapësirë të re për nxitjen e investimeve dhe me politikat fiskale dhe ato që ka shteti për të nxitur ndërtimin e këtyre qendrave agroturistike.."*;
- 23 qershor 2019: Ministrja e Infrastrukturës dhe Energjisë, zj. Belinda Balluku në Sukth e shoqëruar nga kandidatja e ASHE për Kryetare të Bashkisë Durrës, zj. Valbona Sako;
- 27 qershor 2019: Ministrja e Infrastrukturës dhe Energjisë, zj. Belinda Balluku, e shoqëruar nga Kryeministri Rama dhe Kryetari dhe njëkohësisht kandidati për kryetar të Bashkisë Fier z. Armando Subashi në hapjen e by-pass-it të Fierit. Në foton që shoqëron lajmin, si Kryeministri ashtu edhe kandidati për Bashkinë Fier, Subashi kanë veshur këmisha me simbole elektorale të Partisë Socialiste.

të zgjedhurit e ardhshëm peng të interesave private apo edhe të interesave të jashtëligjshme, duke krijuar premisa të qenësishme për kapjen e pushtetit nga këto interesa, apo, më rrezikshëm akoma, të vetë shtetit.

Një sistem administrimi zgjedhor i menaxhuar nga një ndikim i drejtpërdrejtë i vetë forcave politike, ka lejuar dhe përligjur de-facto një "lloj amnistie" ndaj zbatimit të ligjit prej partive politike në raport me detyrimet e bërjes transparencë dhe kontroll të burimeve të tyre të financimit.

Pavarësisht rëndësisë që ka ky komponent në një proces zgjedhor, aktualisht, afatet e përcaktuara në kuadrin ligjor mundësojnë që financimi i subjekteve zgjedhore të dalë jashtë fokusit të vëzhgimit të procesit. Kjo pasi një numër elementësh shumë të rëndësishëm të kontrollit të financimit të subjekteve zgjedhore përfundojnë disa muaj pasi procesi zgjedhor ka përfunduar, rezultati është certifikuar dhe të zgjedhurit përkatës kanë marrë dhe ushtrojnë ndërkohë mandatin.
Si rrjedhim, kontrolli mbi financat e fushatës zgjedhore, pavarësisht se përbën një fazë tepër të rëndësishme të procesit zgjedhor që mbart potencialin të anulojë edhe vetë rezultatin zgjedhor në rast të identifikimit dhe provimit të shkeljeve, nuk trajtohet në raportet e vëzhgimit të procesit zgjedhor, ose trajtohet përciptazi bazuar në të dhëna paraprake dhe të paplota.

Për herë të parë, në zgjedhjet e 30 qershorit 2019, KRIIK aplikoi një qasje metodologjike vëzhgimi dhe raportimi duke përfshirë të gjitha fazat e procesit, deri në përmbylljen e tij (auditimin e financave zgjedhore dhe alokimin e fondeve publike për partitë politike për vitin në vijim). Me përmbylljen e këtij procesi, përmbyllet i gjithë cikli elektoral i Zgjedhjeve Vendore të 30 qershorit.

Monitorimi i financimit të fushatës zgjedhore u realizua nëpërmjet monitorimit të veprimtarisë së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në raport me këtë çështje si dhe nëpërmjet këqyrjes së raporteve financiare të fushatës zgjedhore, pra raporteve të vetë-deklarimit të partive politike, raporteve të monitorimit prej ekspertëve financiarë të kontraktuar nga KQZ-ja si dhe raporteve të auditimit prej auditëve të kontraktuar po nga KQZ-ja.

Nga monitorimi i KQZ-së dhe nga këqyrja e raporteve financiare të dorëzuara në këtë institucion, konkludohet se, pavarësisht plotësimit të elementëve ligjorë dhe vëmendjes së shtuar nga ana e KQZ-së mbi këtë çështje, raportimi i financimit të fushatës zgjedhore edhe në Zgjedhjet e 30 qershorit 2019, vuan nga një sërë problematikash të tilla si: shkelje të afateve ligjore nga subjektet zgjedhorë dhe ekspertët financiarë; raportim bazik dhe formal si nga partitë politike ashtu edhe nga ekspertët financiarë; evidentim i një sërë shkeljesh përmbajtësore; mungesë kontrolli nga ana e KQZ-së mbi raportet e marra në dorëzim; mungesë iniciative nga ana e KQZ-së për të verifikuar problematikat apo kundërshtitë e evidentuara në raportet financiare si dhe mosrespektim i ligjit nga vetë KQZ-ja për të aplikuar sanksione në raport me shkeljet e evidentuara.

X.1. Kuadri ligjor dhe mekanizmat e mbikëqyrjes

Sipas legjislacionit shqiptar[333], burimet e ligjshme të financimit për fushatën zgjedhore janë fondet e alokuara nga buxheti i shtetit për subjektet zgjedhore me qëllim fushatën elektorale, të ardhurat nga burime të vetë subjektit zgjedhor, dhurimet nga burime jo-publike në vlerë monetare apo materiale, si dhe kreditë. Fondi i alokuar nga buxheti i shtetit përllogaritet dhe alokohet paraprakisht, bazuar në rezultatin e subjekteve zgjedhore në zgjedhjet e mëparshme të të

333 Kodi Zgjedhor Neni 87/1 *"Burimet e financimit të fushatës zgjedhore"*, si dhe Ligji *"Për partitë politike"* neni 17 dhe neni 20, pika 2.

njëjtit lloj. Shuma finale e financimit që merr çdo subjekt zgjedhor nga buxheti i shtetit, përcaktohet me vendim të KQZ-së pas nxjerrjes së rezultatit final të zgjedhjeve, bazuar në numrin e votave të marra prej secilit subjekt. Përllogaritja bëhet sipas formulave të parashikuara në Kodin Zgjedhor, duke llogaritur vlerën në para të çdo vote të fituar, për subjektet zgjedhore që kanë marrë së paku 0.5 përqind të votave të vlefshme në shkallë vendi[334].

Kodi Zgjedhor dhe Ligji për Partitë Politike i ngarkojnë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) një sërë përgjegjësish në mbikëqyrjen e financimit të fushatës zgjedhore dhe të financimit të partive politike në tërësi. Disa nga përgjegjësitë shtesë përfshijnë alokimin e financimeve publike vjetore për partitë politike; përzgjedhjen e ekspertëve financiarë dhe auditëve që kontrollojnë financat e subjekteve zgjedhore dhe partive politike; mbikëqyrjen e veprimtarisë financiare të subjekteve zgjedhore si dhe të partive politike në veprimtarinë vjetore; verifikimin e të dhënave të auditimit financiar të partive politike; aplikimin e sanksioneve përkatëse për subjektet apo partitë që shkelin kuadrin ligjor, etj.
Në funksion të transparencës dhe kontrollit të të ardhurave dhe shpenzimeve të realizuara përgjatë fushatës, ligji parashikon disa mekanizma, që kombinojnë aktivitetin e subjekteve zgjedhorë gjatë fushatës dhe kontrollin nga ekspertët financiarë të emëruar prej KQZ-së.
Partitë politike duhet të dorëzojnë në KQZ një raport vetë-deklarimi për fondet e përfituara dhe shpenzuara për qëllim të fushatës.

Ndërkohë, nga ana tjetër KQZ-ja kontrakton ekspertë financiarë të cilët monitorojnë fushatën zgjedhore të subjekteve zgjedhorë duke kostuar në mënyrë të pavarur shpenzimet e kryera prej tyre. Pas zgjedhjeve, KQZ kontrakton ekspertë financiarë të tjerë të cilët kryejnë auditimin e shpenzimeve të fushatës. Ekspertët financiarë dhe auditët hartojnë raportet përkatëse dhe i depozitojnë ato në KQZ.
Pas kësaj administrata e KQZ-së, bën kontrollin dhe verifikimin e të gjitha raporteve, duke përgatitur në konkludim relacionin përkatës të cilin ia paraqet trupës së KQZ-së. Tërë ky proces së bashku me shqyrtimin prej KQZ-së dhe konkludimin në një vendimmarrje prej saj duhet të kishte përfunduar si rregull në mes të muajit shkurt 2020.

Në mbledhjen e datës 11 prill 2019, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve miratoi tre akte nënligjore[335] me synim rritjen e transparencës financiare të partive politike dhe subjekteve zgjedhore. Ky proces u vlerësua në tërësi si një hap pozitiv për rritjen e transparencës së financave të partive politike dhe subjekteve zgjedhorë, madje iu bë e njohur opinionit publik edhe nëpërmjet një deklarate[336] të kryetarit të KQZ-së.
Në funksion të akteve të sipërpërmendura nënligjore dhe për të lehtësuar plotësimin e formateve tip të raportimit të miratuara, KQZ nxori udhëzues për raportimin financiar prej kandidatëve[337] dhe për raportimin financiar prej partive politike[338] pjesëmarrëse në zgjedhje.

---

334 Nëse shuma përfundimtare që i takon një subjekti zgjedhor është më e vogël se shuma e dhënë si paradhënie përpara zgjedhjeve, subjekti zgjedhor do të duhet t›i kthejë fondet brenda 90 ditëve. Nëse subjekti zgjedhor nuk e bën një gjë të tillë, sipas nenit 87, pika 8, të Kodit Zgjedhor, atëherë ky subjekt humbet të drejtën për të marrë fonde publike për të paktën 5 vjet dhe nuk do të regjistrohet si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e ardhshme. Kodi Zgjedhor Neni 87 *"Fondet nga Buxheti i Shtetit për financimin e partive pjesëmarrëse në zgjedhje".*

335 Udhëzimi nr. 1 datë 11.04.2019 "*Për procedurën e kontrollit dhe verifikimit të financimeve dhe shpenzimeve të partive politike dhe fushatës zgjedhore*"; Vendimi 152 datë 11.04.2019 "*Për miratimin e formateve të standardizuara të raportit të auditimit të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike gjatë vitit kalendarik, për fushatën zgjedhore dhe raportit të monitorimit të fushatës zgjedhore"*; Vendimi 153 datë 11.04.2019 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr.1, datë 31.05.2017 "*Për përdorimin e materialeve propagandistike dhe vendet për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore*".

336 Deklarata e Kryetari të KQZ, z. Zguri, 11 Prill 2019: "*...Puna intensive me ekspertët ndërkombëtarë për analizimin e të gjithë aspekteve që kanë të bëjnë me financimin e partive, studimin e praktikave më të mira ndërkombëtare dhe identifikimin e metodologjive të cilat mund të përshtaten në vendin tonë, bëri që sot të kemi një kuadër më të plotësuar ligjor për transparencën e financave të partive politike. Konsulta me ekspertët financiarë të partive, shoqërinë civile dhe auditët e licencuar, të cilët bashkëpunuan me ne, sugjerimet dhe opinionet e tyre të çmuara, ndikuan në konsolidimin e akteve të miratuara".*

337 Udhëzues për Raportimin Financiar për Kandidatët 2019

338 Udhëzues për Raportimin Financiar për Partitë 2019

Konsiderohet arritje pozitive që në procesin zgjedhor të 30 qershorit, për herë të parë u përcaktua detyrimi për të raportuar financat e fushatës jo vetëm partia politike, por edhe kandidati për kryetar i bashkisë. Raportimi i këtyre kandidatëve parashikohet të kryhet pranë subjektit politik që i ka propozuar dhe të përfshihet në raportin që partia politike duhet të depozitojë në KQZ.
Nga ana tjetër, u la pa u mbuluar me kuadër rregullator raportimi i kandidatëve të pavarur, qoftë lidhur me raportin e vetëdeklarimit, qoftë lidhur me auditimin e shpenzimeve të tyre, pasi është e paqartë se mbi cilin raport do të bëhet auditimi.

Duke e konsideruar tepër pozitiv plotësimin e kuadrit rregullator prej KQZ-së, gjykohet se është i nevojshëm që ky kuadër të përmirësohet akoma më tej duke plotësuar mangësitë e vërejtura si dhe duke përfshirë detyrimin për të raportuar për financat e fushatës zgjedhore edhe prej kandidatëve për anëtarë të këshillave bashkiakë.

X.2. Shpërndarja e fondeve publike për fushatën zgjedhore

X.2.1 Shpërndarja e fondeve publike

Kodi Zgjedhor[339] përcakton se, partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhje dhe që kanë marrë jo më pak se 0.5 përqind të votave në shkallë vendi, përfitojnë fonde nga Buxheti i Shtetit, në bazë të numrit të votave që secila parti ka marrë në ato zgjedhje. Fondi total, që iu shpërnda si paradhënie partive politike të regjistrua në këto zgjedhje, ishte në shumën 65.000.000 Lekë. Ky fond iu shpërnda 36 subjekteve zgjedhorë[340] më datën 10 qershor 2019[341], në tejkalim të afateve ligjore[342].
Alokimi i fondeve publike në tejkalim të afateve ligjore, përveç se përbën shkelje të kuadrit ligjor, krijon padrejtësisht vështirësi në kryerjen e fushatës për partitë politike të vogla ose të reja, të cilat kanë burime të kufizuara financiare apo kanë si burim të vetëm fondin prej buxhetit të shtetit.
Në këndvështrimin e standardit të ofruar, cenohet, me aq sa mund të ndikojë, parimi i barazisë në garë mes subjekteve zgjedhore, pasi krijon indirekt avantazh për partitë parlamentare që kanë një gjendje financiare me solide falë mbështetjes vjetore financiare prej buxhetit të shtetit, së paku.

Pas shpalljes së rezultatit përfundimtar, KQZ-ja kreu përllogaritjen sipas përcaktimeve të nenit 87 të Kodit Zgjedhor. Ligji parashikon që nëse shuma e marrë paradhënie nga një subjekt zgjedhor është më e madhe se shuma që i takon pas përllogaritjes bazuar në rezultatin zgjedhor të arritur, partia duhet të kthejë fondet në buxhetin e shtetit. Ndërsa, nëse kjo shumë figuron më e ulët, atëherë partia politike përfiton si shtesë nga buxheti i shtetit diferencën që rezulton.

Referuar përllogaritjeve finale, sipas bazës ligjore të sipërpërmendur, rezultoi se fondi prej 65.000.000 Lekësh iu shpërnda në përfundim 17 subjekteve

339 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 87, pika 1 *"Partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhje dhe që kanë marrë jo më pak se 0,5 për qind të votave në shkallë vendi, përfitojnë fonde nga Buxheti i Shtetit, në bazë të numrit të votave që secila parti ka marrë në ato zgjedhje"*.

340 Për më shumë mbi shpërndarjen e fondeve shih Shtojcën xxx

341 Vendim nr. 830 datë 10.06.2019 i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve *"Për përcaktimin e sasisë së fondit publik që do t'u shpërndahet si paradhënie partive të regjistruara si subjekte zgjedhore në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019"*.

342 Neni 87/3 i Kodit Zgjedhor, pika 4: *"Fondi i përcaktuar për tu shpërndarë i jepet secilës parti jo më vonë se 5 ditë nga regjistrimi i listave shumë-emërore, apo kandidatëve për kryetar të njësisë së qeverisjes vendore të partisë përkatëse"*.

zgjedhore[343]. Partia Socialiste përfitoi 77% të vlerës totale të fondeve të alokuara për partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhje. Pjesa tjetër prej 23% iu shpërndarë 16 subjekteve të tjera, ku Partia Socialdemokrate përfitoi 3.7%, Partia Demokracia Sociale 3.8%, Partia Bindja Demokratike 2.8% të fondeve, etj.

Ndërkohë, rezultoi se 19 parti politike duhet të kthenin shumën e alokuar paraprakisht[344], pasi nuk kishin arritur 0.5 % të votave të kërkuara.

Nga shqyrtimi i raporteve, vlen të theksohet se vetëm pesë parti[345] deklaruan që në funksion të fushatës zgjedhore kanë patur të ardhura vetëm nga fondet publike.

X.2.2. Kthimi i fondeve publike

Me datë 27 korrik 2019 KQZ-ja[346] vendosi se 28 subjekte[347] duhet të kthenin të gjithë apo një pjesë të shumës së alokuar si paradhënie për fushatën, deri më datën 30 shtator 2019.

Rezultoi se: 19 nga këto parti nuk e kishin tërhequr fondin e alokuar paradhënie[348] e për rrjedhim nuk duhet të kryenin procedurat e kthimit të tij; katër parti e kishte tërhequr dhe kthyer fondin[349] sipas përcaktimeve ligjore, ndërkohë që pesë parti nuk e kanë kthyer ende këtë fond[350], ndonëse është tejkaluar afati ligjor[351].
Për këto të fundit, Kodi Zgjedhor parashikon penalitete, që konsistojnë në

343 Fryma e Re Demokratike 763,635 Lekë; Partia Aleanca Arbnore Kombëtare 841,768 Lekë; Partia Aleanca Demokratike Shqiptare 588,875 Lekë; Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë 709,305 Lekë; Partia Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet 399,249 Lekë; Partia Ardhmëria Shqiptare 446,766 Lekë; Partia Bindja Demokratike 1,800,691 Lekë; Partia Demokracia Sociale 2,465,664 Lekë; Partia e Gjelbër 1,260,572 Lekë; Partia e Reformave Demokratike Shqiptare 414,115 Lekë; Partia G99 439,333 Lekë; Partia Kristian Demokrate 459,950 Lekë; Partia Socialdemokrate e Shqipërisë 2,426,465 Lekë; Partia Socialiste e Moderuar 768,236 Lekë; Partia Socialiste e Shqipërisë 49,966,218 Lekë; Partia Socialpunëtore Shqiptare 360,315 Lekë; Partia Unitetit Kombëtar 888,842 Lekë.

344 Për më shumë në lidhje me shumën e përfituar si financim publik për secilën prej partive politike pjesëmarrëse në zgjedhje shih Shtojca nr. 9 – Financimi dhe Raportimi Financiar i Partive Politike për Fushatën Zgjedhore.

345 Fryma e Re Demokratike, Partia Aleanca Demokratike Shqiptare, Partia e Gjelbër, Partia Kristian Demokrate, Partia Socialdemokrate e Shqipërisë.

346 Vendimi nr. 1098 datë 27.07.2019 i KQZ-së *"Për caktimin e sasisë së fondit publik që do t'u shpërndahet partive politike pjesëmarrëse në zgjedhjet e datës 30 qershor 2019"*, vendim i pa publikuar në faqen e internetit të KQZ.

347 Fryma e Re Demokratike 2,279,233 Lekë; Partia Aleanca Demokratike Shqiptare 567,220 Lekë; Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë 97,790 Lekë; Partia Aleanca e Maqedonasve për Integrim Europian 162,500 Lekë; Partia Aleanca Kuq e Zi 162,500 Lekë; Partia Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane 162,500 Lekë; Partia Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet 514,910 Lekë; Partia Balli Kombëtar 1,434,666 Lekë; Partia Bashkimi Liberal Demokrat 1,314,104 Lekë; Partia Demokracia e Re Europiane 162,500 Lekë; Partia Demokrate për Integrim e Prosperitet 162,500 Lekë; Partia e Pajtimit Kombëtar Shqiptar 162,500 Lekë; Partia e të Drejtave të Mohuara 162,500 Lekë; Partia Emigracionit Shqiptar 162,500 Lekë; Partia G99 523,741 Lekë; Partia Kombëtare Konservatore Albania 162,500 Lekë; Partia Komuniste e Shqipërisë 162,500 Lekë; Partia Kristian Demokrate 496,426 Lekë; Partia Lëvizja Punëtore Shqiptare 162,500 Lekë; Partia Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen 162,500 Lekë; Partia Ora e Shqipërisë 1,090,435 Lekë; Partia për Liri Demokraci dhe Etikë 162,500 Lekë; Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve 162,500 Lekë; Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve të Shqipërisë 162,500 Lekë; Partia Personat me Aftësi të Kufizuar 162,500 Lekë; Partia Socialiste e Moderuar 790,036 Lekë; Partia Unitetit Kombëtar 133,904 Lekë.

348 Partia Aleanca Demokratike Shqiptare, Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë, Partia Aleanca e Maqedonasve për Integrim Europian, Partia Aleanca Kuq e Zi, Partia Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane, Partia Balli Kombëtar, Partia Demokracia e Re Europiane, Partia e të Drejtave të Mohuara, Partia Emigracionit Shqiptar, Partia G99, Partia Komuniste e Shqipërisë, Partia Lëvizja Punëtore Shqiptare, Partia Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen, Partia Ora e Shqipërisë, Partia për Liri Demokraci dhe Etikë, Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve, Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve, Partia Personat me Aftësi të Kufizuar, Partia Unitetit Kombëtar.

349 Partia Bashkimi Liberal Demokrat, Partia Fryma e Re Demokratike, Partia Kristian Demokrate, Partia Socialiste e Moderuar.

350 Partia Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet, Partia Demokrate për Integrim e Prosperitet, Partia e Pajtimit Kombëtar Shqiptar, Partia Kombëtare Konservatore Albania, Partia Aleanca Arbnore Kombëtare.

351 Për më shumë mbi shpërndarjen e fondeve shih Shtojca nr. 9 – Financimi dhe Raportimi Financiar i Partive Politike për Fushatën Zgjedhore.

mosfinancim nga buxheti i shtetit për të paktën 5 vjet si dhe humbjen e së drejtës së regjistrimit në zgjedhjet e radhës[352].

Mostërheqja e fondit të alokuar prej partive politike, reflekton, së paku, pasigurinë e tyre në arritjen e pragut të nevojshëm për të mos i kthyer ato para, por edhe mund të thuhet se ngrihen pikëpyetje lidhur me qëllimin dhe seriozitetin e angazhimit të tyre në garën elektorale.
Nga ana tjetër, mund të ngrihen pikëpyetje gjithashtu mbi skemën që aplikohet për mbështetjen financiare të partive politike, nëse i referohemi madhësisë së fondit që iu alokohet, gjithnjë kjo nëse qëllimi i kësaj skeme të financimit publik është që t'i vërë sadopak në kushte të barabarta subjektet garuese në zgjedhje.

Sipas ligjit *"Për partitë politike"*, fondet e përfituara nga buxheti i shtetit për fushatë zgjedhore, të pa dokumentuara si të shpenzuara prej subjekteve zgjedhore, duhet të kthehen në buxhetin e shtetit brenda 90 ditëve, në të kundërt ato penalizohen[353].
Nga konsultimi i raporteve financiare të zgjedhjeve vendore të 30 qershorit 2019, evidentohen tre parti politike që nuk i kanë shpenzuar për fushatë zgjedhore fondet e përfituara[354] dhe që duhet t'i kthejnë ato.

Një ndër partitë që nuk e ka shpenzuar për qëllim të fushatës zgjedhore një pjesë të fondit të marrë nga buxheti i shtetit është Partia Socialiste (PS). Në raportin e vetë-deklarimit financiar të PS-së, por edhe në raportet e monitorimit dhe në atë të auditimit të fondeve të fushatës zgjedhore, evidentohet se një shumë prej 7 milion lekësh nga fondet e fushatës është përdorur si donacion apo kontribut për rindërtimin e banesave të të prekurve nga tërmeti në fshatin Floq në Korçë. Kjo përbën, në rastin më të mirë, shkelje të ligjit për mospërdorim të fondit për qëllim të kryerjes së fushatës zgjedhore, e si i tillë duhet t'i kthehet buxhetit të shtetit.

Moskthimi i fondeve në buxhetin e shtetit nga partitë politike, sipas përcaktimeve të Kodit Zgjedhor dhe vendimmarrjes së KQZ-së, është evidentuar edhe pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 2017. Rezulton se Partia Demokratike, Partia Republikane dhe Partia Aleanca Popullore për Drejtësi nuk kthyen brenda afatit ligjor fondet e përcaktuara, madje ende nuk e kanë bërë atë.
Në kundërshtim me penalitetet e qarta që parashikon ligji, KQZ-ja nuk morri asnjë masë lidhur me këtë fakt. Pavarësisht se, sipas Kodit Zgjedhor këto parti duhet të kishin humbur të drejtën e financimeve të tjera nga fondet publike për një periudhë kohe jo më pak se 5 vjet, Partia Demokratike ka vazhduar të përfitojë fonde publike në vitin 2018 dhe 2019[355] nga buxheti i shtetit me vendim të KQZ-së.

352 Kodi Zgjedhor Neni 87 pika 8 *"Fondet nga Buxheti i Shtetit për financimin e partive pjesëmarrëse në zgjedhje"*.

353 Ligji 8580 datë 17.2.2000 *"Për partitë politike"*, ndryshuar me ligjin nr. 10374 datë 10.2.2011, ndryshuar me ligjin nr. 17/2014 datë 20.2.2014, ligjin nr. 90 datë 22.5.2017, Neni 24/3, pika 4 *"Në rast se shuma e përfituar nga partia politike, sipas Kodit Zgjedhor, është më e madhe se shuma e dokumentuar si e shpenzuar për financimin e fushatës zgjedhore, partia është e detyruar të kthejë diferencën e përfituar në KQZ"*, si dhe pika 5 *"Partia, e cila nuk kthen fondet përkatëse, sipas pikës 4, të këtij neni, brenda 90 ditëve nga shpallja e rezultatit të zgjedhjeve, humbet të drejtën e financimeve të tjera nga fondet publike për një periudhë kohe jo më pak se 5 vjet, si dhe nuk regjistrohet si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e radhës, pavarësisht llojit të tyre, as vetëm dhe as si pjesëtare e ndonjë koalicioni"*.

354 - PSD - fondi publik prej 2.265.102 Lekë rezulton i gjithë i papërdorur.
- PDS, ka deklaruar në raport vetëm shumën e përfituar nga Buxheti i shtetit 2,036,156 Lekë dhe asnjë shpenzim të kryer. Edhe në raportet e monitorimit dhe auditimit partia evidentohet me 0 shpenzime.

355 Vendimi nr. 9 datë 29.01.2018 i KQZ-së *"Për shpërndarjen e fondeve vjetore partive politike në formën e ndihmës financiare vjetore për vitin 2018"* dhe Vendimi nr. 25 datë 11.02.2019 i KQZ-së "*Për shpërndarjen e fondeve vjetore partive politike në formën e ndihmës financiare vjetore për vitin 2019*" të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

X.2.3. Alokimi i fondeve vjetore për partitë politike për vitin 2020

Buxheti i Shtetit përcakton çdo vit një fond ndihme financiare për kryerjen e veprimtarisë vjetore të partive politike, i cili shpërndahet prej KQZ-së.
Në datë 3 shkurt 2020, KQZ-ja zhvilloi mbledhjen për shpërndarjen e fondit publik si ndihmë financiare vjetore për vitin 2020 për partitë politike. Përfitues të fondit prej 140.000.000 lekë, të ndarë sipas përcaktimeve të ligjit "Për partitë politike"[356], ishin gjashtë parti politike[357].

Vërehet se sasia e fondit e alokuar për vitin 2020, është më e ulët se ajo e alokuar nga buxheti i shtetit në vitin 2019 dhe në vitin 2018 (respektivisht 190 milionë lekë dhe 186 milionë lekë), ndryshe nga sa parashikohet në ligj, i cili parashikon se si rregull kjo ndihmë nuk mund të jetë më e ulët nga viti paraardhës[358].

Pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 2017, KQZ-ja vendosi një standard pozitiv në praktikën e saj duke marrë në shqyrtim raportet financiare të fushatës së partive përpara vendimmarrjes për shpërndarjen e ndihmës financiare ndaj tyre për vitin pasardhës, në mënyrë që të mund të reflektonte në të sanksionet e mundshme të marra në raport me shkeljet e evidentuara. Kështu, masa e sanksionit administrativ të vendosur në raport me fushatën zgjedhore të vitit 2017, u reflektua në vendimmarrjen e KQZ-së, për shpërndarjen e fondeve vjetore të vitit 2018, duke e zbritur atë nga totali i fondit që përfitonte çdo parti[359].
Kjo praktikë pozitive nuk u ndoq pas zgjedhjeve të vitit 2019, pasi KQZ-ja ende nuk ka përfunduar shqyrtimin e raporteve dhe ende s'ka asnjë vendimmarrje për to.

Në gjykimin e KRIIK, KQZ-ja kishte të gjitha mundësitë dhe kapacitetet për t'a mbyllur procesin e shqyrtimit në kohë, sikundër parashihet nga dispozitat ligjore, duke patur parasysh se afati për raportimin e detajuar financiar mbi fushatën zgjedhore nga vetë partitë politike ishte më datë 26 shtator 2019, afati për dorëzimin e raportimeve të monitorimit prej ekspertëve financiarë ishte më datë 26 Nëntor 2019 dhe afati për dorëzimin e raportimeve të auditimit nga po të njëjtët ekspertë ishte më datë 16 dhjetor 2019.
Një shqyrtim i plotë i raportimeve dhe publikimi i shkeljeve të evidentuara do të ishte më shumë interes publik, pasi për herë të parë do të bëhej i mundur evidentimi i sjelljes dhe vullnetit politik, në raport me zbatimin e formateve të thjeshta të raportimit dhe problematikave të tjera, bazuar në përmirësimet e kuadrit ligjor të miratuara në unison prej KQZ-së me nxitjen edhe të aktorëve ndërkombëtarë të rëndësishëm e me përvojë në këtë fushë.

Zvarritja e procesit të shqyrtimit dhe vendimmarrjes së KQZ-së mbi këtë aspekt thelbësor të procesit zgjedhor, dhe me një natyrë objektive në raport me zbatimin ose jo të ligjit, është në vazhdën e qëndrimit politik të saj për të mos penalizuar partitë politike, sidomos ato më të mëdhatë prej të cilave janë propozuar si anëtarë të Trupës, duke zhbërë kështu tërë instrumentet ligjorë të

356 Ligji 8580 datë 17.2.2000 *"Për partitë politike"*, ndryshuar me ligjin nr. 10374 datë 10.2.2011, ndryshuar me ligjin nr. 17/2014 datë 20.2.2014, ligjin nr. 90 datë 22.5.2017, Neni 19 pika 2.

357 Partia Socialiste e Shqipërisë 63.417.047 lekë; Partia Demokratike 38.911.877 lekë; Lëvizja Socialiste për Integrim 20.012.797 lekë; Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet 7.447.477 lekë; Lista e Barabartë 4.841.667 lekë dhe Partia Socialdemokrate 5.369.137 lekë.

358 Ligji 8580 datë 17.2.2000 *"Për partitë politike"*, Neni 19 pika 1 *"Ndihma financiare e parashikuar në Buxhetin e Shtetit në vitet jozgjedhore, si rregull, nuk mund të jetë më e vogël se ndihma e parashikuar në vitin paraardhës".*

359 Vendimi nr. 9 datë 29.01.2018 *"Për shpërndarjen e fondeve vjetore partive politike për vitin 2018", "Shuma totale që përfiton secila parti politike si mbështetje financiare për vitin 2018, është shumatorja e të gjitha shumave që rezulton nga llogaritjet e mësipërme duke zbritur sanksionet administrative me gjobë, vendosur nga KQZ, në zbatim të Ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000 "Për partitë politike", i ndryshuar, përkatësisht: për Partinë Socialiste 1 milionë lekë Vendimi i KQZ-së nr.576, datë 12.12.2017, për Partinë Demokratike 1 milionë lekë Vendimi i KQZ-së nr.578, datë 12.12.2017, për Partinë Lëvizja Socialiste për Integrim 1 milionë lekë Vendimi i KQZ-së nr.577, datë 12.12.2017, Partia Socialdemokrate 1 milionë lekë Vendimi i KQZ-së nr.579, datë 12.12.2017".*

ndërtuar dhe përmirësuar nga vetë ajo e duke forcuar edhe më tej kulturën e pandëshkueshmërisë në raport me partitë politike, kandidatët e stafet e tyre.

X.3. Raportet e vetë-deklarimit financiar të partive politike për fushatën zgjedhore

Ndryshimet ligjore në ligjin "Për Partitë Politike"[360] të miratuara në vitin 2017 sanksionuan për herë të parë detyrimin e partive politike për të depozituar në KQZ, brenda 60 ditëve nga shpallja e rezultatit të zgjedhjeve, raportim të detajuar financiar për fushatën zgjedhore.
Lidhur me afatet, procesin e kontrollit e verifikimit të të ardhurave e shpenzimeve të partive politike, si dhe sanksionet përkatëse, KQZ-ja miratoi në 11 prill 2019 një udhëzim të posaçëm. Gjithashtu, hartoi formatin standard të raportimit për subjektet zgjedhore[361] dhe kandidatët për kryetarë të bashkive[362], si dhe udhëzuesit[363] për plotësimin e tyre. Me fokus të gjitha këto ndryshime dhe praktika ligjore, KQZ, në fillim të muajit qershor, organizoi një seri trajnimesh me të gjithë financierët e partive si dhe me të gjithë kandidatët.

Mund të thuhet se KQZ ka luajtur një rol aktiv për të informuar subjektet elektorale për detyrimet e parashikuara nga ligji. Madje dy ditë përpara afatit të 26 shtatorit 2019, KQZ bëri një deklaratë publike[364] duke iu kujtuar partive politike pjesëmarrëse në zgjedhje, detyrimin ligjor për të depozituar brenda afatit të përcaktuar ligjor, raportet e vetë-deklarimit financiar.

Konkludohet se pavarësisht ndryshimeve ligjore të kryera, vendosjes në dispozicion të subjekteve zgjedhore të formateve të thjeshta të raportimit, trajnimeve të zhvilluara nga KQZ-ja apo të tjerë aktorë me partitë politike në vazhdim, situata e raportimit financiar edhe në zgjedhjet e 30 qershorit 2019 mbeti në nivele bazike dhe formale, duke mos garantuar transparencë të plotë të fondeve të përftuara dhe shpenzuara gjatë fushatës[365].

Nga 36 subjekte zgjedhore pjesëmarrëse në zgjedhjet e datës 30 qershor, vetëm 21[366] prej tyre i dorëzuan raportet e vetë-deklarimit financiar pranë KQZ-së, ku

360 Ligji nr. 8580 datë 17.02.2000 *"Për Partitë Politike"* u ndryshua me ligjin nr. 90/2017 datë 22.05.2017 *"Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8580, datë 17.2.2000, "Për partitë politike""*, të ndryshuar.
Në nenin 24/3 të tij *"Dokumentimi i shpenzimeve"*, pika 2 sanksionohet se: *"Partia politike dorëzon në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve kopje të plotë të dokumentacionit për çdo pagesë të kryer gjatë periudhës së fushatës zgjedhore. Brenda 60 ditëve nga shpallja e rezultatit të zgjedhjeve, çdo parti politike që është regjistruar në zgjedhje, duhet të bëjë publik dhe të dorëzojë pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve një raport për deklarimin financiar të fushatës, duke përfshirë të gjitha degët dhe pjesët e veta përbërëse. Raporti përmban në mënyrë të saktë: a) të ardhurat e përfituara apo që ka në gjendje partia politike, duke përfshirë burimin dhe datën e përfitimit, për periudhën nga caktimi i datës së zgjedhjeve, deri në ditën e zgjedhjeve; b) të gjitha shpenzimet e kryera për periudhën nga caktimi i datës së zgjedhjeve, deri në ditën e zgjedhjeve, duke detajuar çdo shpenzim që i është bërë fondit financiar të dhënë për shpenzimet e fushatës zgjedhore; c) bilancin e pasurive dhe detyrimeve që ka partia politike, për periudhën nga data e caktimit të ditës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve"*.

361 Formati tip i raportimit - Zgjedhje Lokale 2019 – Partia

362 Formati tip i raportimit - Zgjedhje Lokale 2019 - Kandidati

363 Udhëzues për raportimin financiar për partine 2019 dhe Udhëzues për raportimin financiar për kandidatet 2019 .

364 Deklaratë e KQZ datë 24.09.2019 : "*Partitë politike te dorëzojnë raportet për financat e fushatës brenda datës 26 shtator*".

365 Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2017 nga 18 subjekte pjesëmarrëse, 16 dorëzuan raport vetë-deklarimi financiar për fushatën në KQZ, ku 12 prej tyre raportuan në formatin e miratuar nga KQZ-ja, ndërsa 2 prej tyre apo 11% e tyre nuk e dorëzuan.
Ndërkohë, në Zgjedhjet Lokale të vitit 2019, nga 36 parti politike pjesëmarrëse, 14 prej tyre ose 39% e tyre nuk e kanë dorëzuar raportin e vetë-deklarimit financiar për fushatën zgjedhore.

366 Fryma e Re Demokratike; Partia Aleanca Arbnore Kombëtare; Partia Aleanca Demokratike Shqiptare; Partia Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane; Partia Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet; Partia Ardhmëria Shqiptare; Partia Balli Kombëtar; Partia Bashkimi Liberal Demokrat; Partia Bindja Demokratike; Partia Demokracia e Re Europiane; Partia e Gjelbër; Partia Komuniste e Shqipërisë; Partia Kristian Demokrate; Partia Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen; Partia Ora e Shqipërisë; Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të

shtatë prej tyre[367] i dorëzuan jashtë afatit ligjor.
Ndërkohë, për 16 partitë politike[368] të cilat nuk e kanë dorëzuar raportin e vetë-deklarimit financiar, KQZ-ja nuk ka ndërmarrë asnjë hap apo aplikuar ndonjë sanksion megjithëse mosdorëzimi apo edhe shkelja e afatit përbën shkelje ligjore për të cilën parashikohen shprehimisht sanksione administrative[369].
Për më tepër, rezulton se disa parti nuk kanë depozituar raport vetë-deklarimi[370] financiar në KQZ apo në raportin e dorëzuar deklarohen zero të ardhura dhe shpenzime[371], ndërkohë që nga raportet e monitorimit dhe auditimit ekspertët evidentojnë se këto parti kanë patur aktivitet financiar.

Në raportet e dorëzuara vërehen një sërë problematikash përsa i përket formatimit të tyre si dhe detyrimeve formale.
Sa i përket formatit të raportit, vetëm Partia Socialiste e ka depozituar raportin si në format elektronik, ashtu edhe të printuar, në përputhje me Udhëzimin e KQZ-së[372], ndërkohë që të gjitha partitë e tjera e kanë depozituar raportin vetëm fizikisht (hard-copy).
Përpos mos depozitimit të raporteve në format elektronik, katër[373] nga 21 raportet e dorëzuara janë të plotësuara me shkrim dore duke e bërë të vështirë leximin e tyre, ndërsa dy parti[374] të tjera kanë dorëzuar dokumente që nuk janë në formatin e standardizuar të KQZ-së. Një prej këtyre dy partive[375] ka deklaruar të ardhura dhe shpenzime, por jo në formatin e kërkuar, ndërsa tjetra ka referuar vetëm se nuk ka patur asnjë aktivitet financiar.
Nëntë prej partive politike[376] kanë raportuar zero të ardhura dhe shpenzime përgjatë gjithë fushatës zgjedhore.

Punëtorëve të Shqipërisë; Partia Socialdemokrate e Shqipërisë; Partia Socialiste e Moderuar; Partia Socialiste e Shqipërisë; Partia për Liri Demokraci dhe Etikë; Partia Demokracia Sociale.

367 Partia Aleanca Demokratike Shqiptare; Partia Bashkimi Liberal Demokrat; Partia Demokracia e Re Europiane; Partia Komuniste e Shqipërisë; Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve të Shqipërisë; Partia për Liri Demokraci dhe Etikë; Partia Demokracia Sociale.

368 Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë; Partia Aleanca e Maqedonasve për Integrim Europian; Partia Aleanca Kuq e Zi; Partia Demokracia Sociale; Partia Demokrate për Integrim e Prosperitet; Partia e Pajtimit Kombëtar Shqiptar; Partia e Reformave Demokratike Shqiptare; Partia e të Drejtave të Mohuara; Partia Emigracionit Shqiptar; Partia G99; Partia Kombëtare Konservatore Albania; Partia Lëvizja Punëtore Shqiptare; Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve; Partia Personat me Aftësi të Kufizuar; Partia Socialpunëtore Shqiptare; Partia Unitetit Kombëtar.

369 Ligji 8580 datë 17.2.2000, ndryshuar, Neni 23/4, pika 4 *"Shkelja e afatit të dorëzimit të raportit financiar në kohën e duhur apo paraqitja e raporteve në shkelje të formateve të standardizuara, të miratuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, dënohet me gjobë nga 50 000 deri në 100 000 lekë"*.

370 - Partia Aleanca Kuq e Zi nuk ka depozituar Raport vetë-deklarimi, por eksperti financiar në Raportin e monitorimit ka evidentuar një shpenzim total prej 909,495 Lekë, nga një prej kandidatëve të saj për anëtar të këshillave bashkiakë.
- Partia Kombëtare Konservatore Albania nuk ka depozituar Raport vetë-deklarimi por në Raporti i auditimit të partisë ka konstatuar 162.500 Lekë të ardhura dhe 158.000 Lekë shpenzime prej kësaj partie.

371 - Partia Komuniste e Shqipërisë ka dorëzuar Raportin e Vetë-deklarimit me 0 të ardhura dhe shpenzime ndërkohë që në Raportin e auditimit të saj ka 70,000 Lekë të ardhura nga burimet e vetë partisë (30,000 Lekë kuota anëtarësie dhe 40,000 Lekë nga botimi i gazetës), të cilat janë shpenzuar si: 48,000 Lekë për shpenzime administrative dhe 22.000 Lekë për botimin e gazetës.
- Partia Ora e Shqipërisë ka dorëzuar Raportin e Vetëdeklarimit me 0 të ardhura dhe shpenzime, ndërkohë që në Raportin e monitorimit përmenden disa takime ku janë kryer shpenzime (takim në Lezhë me 2,000 Lekë shpenzime, takim në Kurbin me 650 Lekë shpenzime, takim në Librazhd me 1,470 Lekë shpenzime, takim në Belsh 1,500 Lekë shpenzime, etj.)

372 Udhëzues për raportimin financiar për partine 2019 *"Të gjitha subjektet zgjedhore duhet të raportojnë në lidhje me dhurimet dhe shpenzimet e tyre për periudhën e fushatës, dhe duhet të mbajnë dokumentacionin mbështetës. Komisioni Qendror Zgjedhor ka miratuar një format tip për raportim, i cili detajon gjithë informacionin që duhet të jepet nga subjektet zgjedhore. Formulari tip i miratuar është në formatin Excel dhe do të dorëzohet në KQZ i printuar si dhe në formatin elektronik në Excel"*.

373 Partia Socialdemokrate, Partia Balli Kombëtar, Partia Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane dhe Partia Bindja Demokratike.

374 Partia Ardhmëria Shqiptare dhe Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve të Shqipërisë.

375 Partia Ardhmëria Shqiptare.

376 Partia Komuniste; Partia Ora e Shqipërisë; Partia për Liri Demokraci dhe Etikë; Partia Aleanca e Maqedonasve për Integrim Europian; Partia Demokracia e Re Europiane; Partia Bashkimi Liberal Demokrat; Partia Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane; Partia Balli Kombëtar; Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve të Shqipërisë.

Dy subjekte zgjedhore[377], pavarësisht se kanë dorëzuar raportin në formatin e miratuar nga KQZ-ja, nuk kanë përfshirë në të asnjë të dhënë tjetër përveç shumës së përfituar nga buxheti i shtetit. Konkretisht, FRD ka deklaruar shumën referuar përllogaritjeve të bëra pas shpalljes së rezultatit nga KQZ, ndërsa Partia Socialdemokrate ka referuar në raport vetëm shumën e marrë paradhënie, pa përfshirë në deklarim shumën e alokuar shtesë nga KQZ-ja pas shpalljes së rezultatit përfundimtar. Të dyja këto parti nuk kanë deklaruar asnjë shpenzim në raportet e tyre.

X.3.1. Të ardhurat e partive politike sipas raporteve të vetë-deklarimit

X.3.1.1. Financimi publik

Përveç fondeve në para të alokuara nga buxheti i shtetit, në formën e ndihmës financiare për subjektet zgjedhore, në dispozicion të tyre vihet edhe mbështetje jo-direkte publike, në formën e minutazhit falas në radio dhe televizionin publik dhe privat, por edhe të vendeve publike ku partitë politike mund të vendosin materiale me karakter propagandistik zgjedhor[378].

Vërehet se vetëm tre parti politike e kanë deklaruar minutazhin falas në televizione si të ardhur jo-direkte[379]. Është e paqartë nëse partitë, që nuk e kanë deklaruar këtë zë, nuk e kanë përdorur minutazhin falas apo vetëm nuk e kanë deklaruar atë.

Nga këqyrja e raporteve financiare vërehet se ka parti të cilat e kanë deklaruar gabim shumën e alokuar të fondeve publike[380].

- Lëvrimi i fondeve nga thesari

Fondet publike që iu shpërndahen në formën e ndihmës financiare partive politike pjesëmarrëse në zgjedhje, duhet t'i alokohen secilës prej tyre jo më vonë se 5 ditë nga regjistrimi i listave shumë-emërore[381].
Në vijueshmëri, gjatë proceseve zgjedhore në vend ka ndodhur që vendimmarrja e KQZ-së[382] dhe lëvrimi i fondeve publike paradhënie, në funksion të organizimit të fushatës zgjedhore, të ndodhë pas fushatës zgjedhore[383].
Edhe në Zgjedhjet e 30 qershorit 2019, alokimi i fondeve u krye në shkelje të afateve ligjore, pasi fondet u alokuan më datë 10 qershor 2019, ndërkohë që duhet të ishin alokuar që në datën 18 maj 2019.

377 Partia Socialdemokrate dhe Partia Fryma e Re Demokratike.

378 Kodi Zgjedhor Neni 80 *"Fushata zgjedhore e subjekteve zgjedhore në radiotelevizionin publik"* dhe neni 84 *"Fushata zgjedhore në radiot dhe televizionet private"*.

379 Partia Aleanca Demokratike 10 minuta në TVSH; Partia Kristiandemokrate 10 minuta në TVSH; Partia Bindja Demokratike 10 minuta në TVSH dhe nga 30 minuta në ABC News, TV Klan, Top News, Vizion Plus, Report TV.

380 - AAK ka referuar gabim fondin e marrë dhe të kthyer në KQZ. Konkretisht, duhet të kishte marrë paradhënie 1,283,456 Lekë dhe më pas të kthente 441,688 Lekë. Por në raport ka deklaruar se ka marrë 1,275,000 Lekë dhe kthyer 325,275 Lekë. Sipas transaksioneve të thesarit i është lëvruar më 8 korrik 2019 shuma prej 1,283,456 Lekësh.
- Bindja Demokratike ka deklaruar të ardhura 1,820,000 Lekë, ndërkohë sipas vendimeve të KQZ-së duhet të marrë 1,800,691 Lekë. Sipas transaksioneve të thesarit nuk i ka kaluar akoma asnjë pagesë.
- PKD ka deklaruar të ardhura nga fondet publike 919,900 Lekë, ndërkohë që ka marrë paradhënie 956,376 Lekë. Sipas vendimit të KQZ-së asaj i takojnë të marrë 459,950 Lekë, ndërsa shumën prej 496,426 Lekësh duhet ta kthejë. Sipas transaksioneve të thesarit më datën 28 qershor 2019 i është lëvruar shuma prej 956,376 Lekësh.

381 Kodi Zgjedhor Neni 87/3 *"Mënyra e përllogaritjes së fondit paradhënie"*, pika 4 *"Fondi i përcaktuar për t'u shpërndarë, sipas nenit 87/2, i jepet secilës parti jo më vonë se 5 ditë nga regjistrimi i listave shumë-emërore, apo kandidatëve për kryetar të njësive të qeverisjes vendore të partisë përkatëse".*

382 Vendim nr. 830 datë 10.06.2019 i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve *"Për përcaktimin e sasisë së fondit publik që do t'u shpërndahet si paradhënie partive të regjistruara si subjekte zgjedhore në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019".*

383 Për më shumë në lidhje me fondet e lëvruara nga thesari dhe datën e lëvrimit të tyre shih Shtojca nr. 9 – Financimi dhe Raportimi Financiar i Partive Politike për Fushatën Zgjedhore.

Përtej shpërndarjes së vonë nga ana e KQZ-së, vërehet se një pjesë e partive politike[384] pjesëmarrëse në zgjedhjet e qershorit, për të cilat u alokua edhe fond shtesë nga KQZ-ja me rishpërndarjen e fondeve pas shpalljes së rezultatit përfundimtar, nuk figurojnë në listën e transaksioneve të thesarit, pra për rrjedhim nuk kanë marrë ende asnjë fond nga buxheti i shtetit.
Sipas komunikimit me Thesarin e Shtetit, shkak për këtë situatë është mosparaqitja e partive politike për të plotësuar dokumentacionin e nevojshëm pranë këtij institucioni, në mënyrë që të vijojnë procedurat e lëvrimit të fondeve përkatëse.

X.3.1.2. Financimi jo-publik

Subjektet zgjedhore mund të përfitojnë dhurime nga subjekte fizike apo juridikë, në para dhe/ose në natyrë. Subjektet dhuruese duhet të jenë shtetas shqiptarë, ndërkohë që Kodi Zgjedhor përcakton ndalimin për të dhuruar në disa raste konflikti interesi[385]. Subjektet që dhurojnë nënshkruajnë deklaratën që nuk ndodhen në kushtet e ndalimit për të dhuruar.

- Financimi jo-publik në vlerë monetare
Nga raportet e vetë-deklarimit rezulton se katër subjekte[386] kanë përfituar dhurime nga persona fizikë në vlerë monetare. Ligji përcakton[387] se shumat mbi 100,000 Lekë duhet të dhurohen vetëm nëpërmjet llogarisë së posaçme bankare për fushatën zgjedhore të hapur prej subjektit.
Në asnjë raport vetë-deklarimi nuk evidentohen dhurime mbi këtë shumë të kryera me para në dorë.

- Financimi jo-publik në natyrë
Dhurime apo donacione në natyrë janë dhurimet e përfituara në formën e të mirave materiale ose shërbimeve të ofruara pa pagesë, ose me vlerë më të ulët se ajo e tregut[388], pa përfshirë dhurimet monetare. Dhurimet në natyrë i nënshtrohen të njëjtave rregulla si dhurimet në para. Dhurimet në natyrë raportohen si dhuratë për fushatën dhe njëkohësisht si shpenzim indirekt i fushatës.

Tre parti politike kanë deklaruar se kanë patur dhurime në natyrë[389], të cilat janë thuajse të gjitha në formën e vënies në dispozicion të zyrave apo ambienteve elektorale.

384 Partia e Unitetit Kombëtar, Partia Aleanca Demokristiane, Partia Socialpunëtore Shqiptare, Partia G99, Partia e Reformave Demokratike Shqiptare.

385 Kodi Zgjedhor Neni 89 pika 3 *"Ndalohet dhënia e fondeve nga një person juridik apo çdo aksionar i tij, nëse ndodhet në një nga kushtet e mëposhtme: a) ka përfituar fonde publike, kontrata publike apo koncesione në 2 vitet e fundit me vlerë mbi 10 milionë Lekë; b) ushtron veprimtari në fushën e medias; c) ka qenë partner me fonde publike në projekte të ndryshme; ç) ka detyrime monetare ndaj Buxhetit të Shtetit ose ndaj çdo institucioni publik. Ky detyrim nuk zbatohet nëse aksionari i zotëron këto aksione si rezultat i ofertës publike".*

386 Partia Socialiste, Partia Bindja Demokratike, Partia Aleanca Arbnore Kombëtare, Partia Ardhmëria Shqiptare, Partia Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet dhe Partia Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen. Në lidhje me shumën e dhuruar shih Shtojca nr. 9 – Financimi dhe Raportimi Financiar i Partive Politike për Fushatën Zgjedhore.

387 Kodi Zgjedhor Neni 90, pika 2 *"Dhurimi i fondeve jopublike me vlerë më të madhe se 100 mijë Lekë duhet të bëhet vetëm në një llogari të posaçme të hapur në një bankë nga subjekti zgjedhor".*

388 Quhet dhurim nëse ulja e vlerës së të mirave apo shërbimeve është më e lartë se 10% e vlerës reale të së mirës apo shërbimit, apo në rast se ulja e bërë e tejkalon shumën prej 50,000 lekësh.

389 - Partia Socialiste e Moderuar ka deklaruar dhurim në natyrë shumën 10,000 Lekë në formën e vënies në dispozicion të ambientit për takim elektoral.
- Partia Bindja Demokratike ka deklaruar dhurim në natyrë shumën 322,000 Lekë, prej të cilave 272,000 Lekë janë dhuruar në formën e zyrave elektorale dhe 50,000 Lekë janë dhuruar nëpërmjet vënies në përdorim të një automjeti për fushatën.
- Partia Socialiste ka deklaruar dhurim në natyrë shumën 2,153,761 Lekë, ku e gjithë shuma përfshihet në zërin "qira për zyra elektorale".

- Kreditë

Kreditë janë një formë e lejuar e financimit në funksion të realizimit të fushatës zgjedhore. Ato llogariten përkundrejt tavanit të dhurimit prej 1 milion Lekësh[390]. Kur merr një kredi, subjekti zgjedhor duhet të respektojë legjislacionin fiskal në fuqi.

Referuar raporteve të vetë-deklarimit financiar për fushatën zgjedhore, vetëm një parti[391] ka deklaruar huamarrje në vlerën 480,000 Lek, që është realizuar nëpërmjet deklaratave të huadhënësve, të cilët figurojnë të jenë kryetari dhe disa anëtarë të partisë.

- Kuotat e anëtarësisë

Një nga burimet financiare dhe materiale të partive politike janë kuotat e anëtarësisë. Evidentimi i shumës totale të grumbulluara nga kuotat e anëtarësisë prej partive politike pamundësohet nga fakti se të dhënat në lidhje me numrin e anëtarëve të partive politike, si dhe shuma që anëtarët duhet të paguajnë si kuotë anëtarësimi nuk janë publike.

Si rrjedhim, e vetmja e dhënë që mundëson përllogaritjen e sasisë se të ardhurave që ka një parti politike me burim kuotat e anëtarëve, është vetë-deklarimi prej vetë partive.

Në raportin e vetë-deklarimit për fushatën zgjedhore 2019, vetëm Partia Socialiste ka deklaruar shumën prej 2,976,735 Lekë të ardhura nga kuotat e anëtarësisë[392].

Në gjykimin e KRIIK, nisur edhe nga pasaktësitë dhe kundërshtitë që rezultojnë nga këqyrja e raporteve financiarë të partive politike edhe në proceset e mëparshme zgjedhore, paraqitet si domosdoshmëri informacioni mbi listën e anëtarësisë si kontribuuese financiare, dhe por edhe si organi më i lartë vendimmarrës që është asambleja e përgjithshme e anëtarëve.
Ky informacion nuk mund të jetë instrument i vetëm e i mbyllur i vetë partive politike, të cilët kanë treguar se e përdorin këtë zë sipas nevojës për të rakorduar të ardhura/shpenzimet në raportimet e bëra.

X.3.2. Shpenzimet e partive politike sipas raporteve të vetë-deklarimit

Në seksionin e shpenzimeve të fushatës, përfshihet çdo shpenzim që lidhet me fushatën dhe që kryhet nga data e shpalljes së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve. Gjithashtu në raport përfshihet çdo shpenzim i fushatës, pavarësisht se likuidimi i faturës ose pagesa përfundimtare e saj mund të shtyhet dhe të bëhet edhe në periudhën pas datës së zgjedhjeve.

Në raportet e katër partive[393] janë deklaruar shpenzime me datë fature në korrik 2019, pra jashtë periudhës së fushatës zgjedhore.
Përpos faktit që kemi të bëjmë me shpenzime të cilat janë kryer jashtë periudhës së fushatës zgjedhore, evidentohet moskorrektësi edhe nga ana e subjekteve që i kanë lëshuar këto fatura, pasi ato deklarojnë kryerje të shpenzimeve në funksion të një aktiviteti elektoral, pas datës së zgjedhjeve.

390 Kodi Zgjedhor Neni 89, pika 2 *"Shuma që çdo person fizik ose juridik mund t'i japë një subjekti zgjedhor nuk mund të jetë më e madhe se 1 milion Lekë ose kundërvlefta në sende ose shërbime".*

391 Partia Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet nëpërmjet 4 akt-marrëveshjeve me persona fizikë, njëri prej të cilëve është kryetari, ka deklaruar se ka marrë 480,000 Lekë të ardhura në formën e huave. Këto hua janë marrë me 0% interes dhe pa kolateral.

392 Në statutin e Partisë Socialiste, në nenin 84, përcaktohet detyrimi i çdo anëtari të partisë për të paguar kuotën e anëtarësisë. Vlera monetare e çdo kuote përcaktohet nga Asambleja Kombëtare e Partisë Socialiste në mbledhjen e parë të çdo viti, duke patur në konsideratë pozicionin e çdo anëtari, pra duke aplikuar kuota më të ulëta për grupet si të moshuar, studentë, të papunë etj., dhe kuota më të larta për anëtarët me funksione të larta publike. Mospagimi i kuotës është shkak për marrjen e masave disiplinore ndaj anëtarit/es.

393 Partia Socialiste, Partia Aleanca Demokratike, Partia Kristiandemokrate dhe Partia Aleanca Arbnore Kombëtare.

Kjo është në kundërshtim me ligjin pasi sipas legjislacionit tatimor në fuqi[394], fatura përpilohet dhe nxirret nga subjekti ofrues apo shitës në momentin e kryerjes së shërbimit, pavarësisht momentit kur kryhet likuidimi i saj.

Legjislacioni tatimor[395] në Republikën e Shqipërisë përcakton se pagesat kundrejt shërbimeve mund të realizohen me para në dorë nëse ato janë deri në vlerën 150,000 Lekë. Për vlera më të mëdha pagesat duhet të kryhen nëpërmjet bankës. Partia Socialiste[396] ka raportuar pagesa me para në dorë në shuma më të mëdha se 150,000 Lekë, çka është në kundërshtim me legjislacionin tatimor.
Gjithashtu, Partia Aleanca Arbnore Kombëtare[397] nuk ka përfshirë në raportin e vetë-deklarimit specifikime në lidhje me mënyrën e kryerjes së pagesave më të mëdha se limiti, pra nëse i ka kryer ato me para në dorë apo nëpërmjet bankës.

Asnjë prej partive politike që kanë raportuar nuk i kanë plotësuar tabelat përmbledhëse të shpenzimeve në mënyrë shteruese, duke lënë së paku disa seksione apo fusha të paplotësuara, të tilla si data e faturës, numri i faturës, seksionin nëse pagesa është kryer me para në dorë apo nëpërmjet transfertës bankare, etj.

Në raportet e disa partive evidentohen mospërputhje midis kategorisë së shpenzimeve dhe shitësit apo shpjegimit të shpenzimit[398].

Një fenomen shqetësues që evidentohet është përdorimi i fondeve të fushatës për qëllime të tjera të cilat nuk lidhen me fushatën zgjedhore[399].
Dy prej partive pjesëmarrëse në zgjedhje i kanë përdorur fondet për fushatën zgjedhore për të shlyer detyrime të prapambetura nga fushata e mëparshme zgjedhore dhe jo specifikisht për fushatën zgjedhore të qershorit 2019.

Ndërkohë, një problematikë madhore në këtë drejtim, përbën deklarimi i Partisë Socialiste (PS) se ka shpenzuar fondet e fushatës zgjedhore për rindërtimin e banesave të dëmtuara në Qarkun e Korçës nga tërmeti i qershorit 2019. Ky lajm është bërë fillimisht publik në datën 10 qershor 2019, pas një mbledhje të Kryesisë së Partisë Socialiste[400], por pa specifikuar se çfarë fondesh do të përdorte PS për këtë qëllim.

394 Udhëzimi Nr.24 datë 02.09.2008 *"Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë"* i Ministrit të Financave, ndryshuar me Udhëzimin Nr. 4, datë 25.01.2014, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 6 datë 30 janar 2014, pika 51.1 *"Shitësi lëshon faturë tatimore dhe blerësi duhet ta kërkojë atë në kohën e realizimit të shitjes apo të kryerjes së punimit ose shërbimit".*

395 Udhëzimi Nr.24 datë 02.09.2008 *"Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë"* i Ministrit të Financave, ndryshuar me Udhëzimin Nr. 4, datë 25.01.2014, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 6 datë 30 janar 2014, pika 59.1.1 "*Ne zbatim te pikës 1 te nenit 59 te Ligjit, personat e tatueshëm nuk mund te kryejnë midis tyre transaksione shitjeje dhe blerjeje me leke ne dore, kur vlera e çdo transaksioni është me e madhe se 150 mijë lekë. Kryerja me leke ne dore dhe jo nëpërmjet kalimit nga llogaria likuiduese e blerësit ne llogarinë likuiduese te shitësit e transaksioneve te shitblerjes qe e kalojnë vlerën 150 mijë lekë, përbën shkelje si për shitësin ashtu dhe për blerësin dhe dënohet, sipas nenit 120 te Ligjit me një gjobe sa 10 për qind e vlerës se çdo transaksioni te kryer me leke ne dore.*"

396 Partia Socialiste ka paguar cash shumat prej 225.000 Lekë ushqime e pije, 499,735 Lekë karburant, 158,200 Lekë ushqim dhe 180,000 Lekë qira zyre elektorale.

397 Partia Aleanca Arbnore Kombëtare nuk ka përfshirë të dhënat nëse pagesat janë bërë cash apo me bankë për të gjitha shpenzimet, ndër to edhe pagesën e shumës 210,320 Lekë dhe 690,000 Lekë.

398 - Partia Kristiandemokrate në kategorinë "Reklamime në natyrë" ka furnitor "Kastrati" dhe në shpjegimin e faturës "Blerje karburanti", vlera e faturës është 43.000 Lekë. Gjithashtu në kategorinë "Botime/publikime" ka furnitor "Grafika online" dhe në shpjegimin e faturës "Flet palosje", të cilat janë materiale promocionale, vlera e faturës është 20.000 Lekë.
- Partia Aleanca Demokratike nuk e ka plotësuar fare kolonën e kategorisë së shpenzimeve dhe as shpjegimin e faturës.
- Partia Socialiste në kategorinë "Mitingje tubime" ka përshkrimin "Zyrë elektorale".
- Partia Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet tek kolona "Shitësi/Furnizuesi" ka gjithmonë përshkrimin "privat të ndryshëm" dhe jo emrin e kompanisë, ndërsa tek numri i identifikimit të faturës është shkruar "shirit kase, ose faturë e thjeshtë tatimore".

399 Udhëzues për raportimin financiar për partine 2019 *"Si shpenzim i fushatës konsiderohet çdo shpenzim që lidhet me fushatën dhe që bëhet nga data e shpalljes së zgjedhjeve dhe deri në ditën e zgjedhjeve. Çdo shpenzim i fushatës, pagesa përfundimtare e të cilit shtyhet deri pas zgjedhjeve duhet gjithashtu të regjistrohet".*

400 Për më shumë shih artikullin tek gazeta "Shqiptarja.com": https://shqiptarja.com/lajm/partia-socialiste-70-milion-lekë-për-banorët-e-prekur-nga-tërmeti-në-korcë?order=parat.

Në raportin e vetë-deklarimit financiar të PS-së, por edhe në raportet e monitorimit dhe atë të auditimit të fondeve të fushatës zgjedhore të kësaj partie, evidentohet se një shumë prej 7 milion Lekësh nga fondet e fushatës është përdorur për këtë qëllim.

Deklarimi i përdorimit të fondeve të fushatës nga ana e kësaj partie si donacion apo kontribut për rindërtimin përbën, në rastin më të mirë, vetëm shkelje të ligjit për mospërdorimin e fondeve për fushatë zgjedhore.

Në rast se pranohet që ky shpenzim është kryer specifikisht për qëllim të fushatës zgjedhore, atëherë ky veprim nuk përbën gjë tjetër veçse blerje e drejtpërdrejtë vote, duke qenë se fondet e fushatës janë përdorur për benefite financiare të një numri të kufizuar individësh gjatë fushatës zgjedhore, çka përbën një shkelje të rëndë të cilën KQZ-ja duhet ta hetojë dhe investigojë me shumë kujdes e përparësi.

Rezulton se është se është e paqartë se në ç'mënyrë janë kaluar fondet për rindërtim, pra nëse fondet janë derdhur në një llogari specifike e cila shërbente për qëllim të rindërtimit apo ato janë përdorur në mënyrë të drejtpërdrejtë nga partia për rindërtim të objekteve specifike, në dobi të individëve specifikë, çka do ta bënte shkeljen edhe më evidente dhe me përmasa akoma më të mëdha.

X.3.2.1. Mitingjet elektorale

Raportet e vetë-deklarimit[401] duhet të përfshijnë të dhënat e kostimit të çdo mitingu të realizuar prej subjekteve zgjedhore. Reflektimi i plotë i të dhënave në këtë seksion do të jepte një panoramë sistematike të mitingjeve të realizuara, përfshirë evidentimin më të plotë dhe të qartë të shpenzimeve.

I vetmi subjekt zgjedhor që e ka plotësuar këtë seksion të raportit është Partia Socialiste. Megjithatë, edhe raportet e kësaj partie përmbajnë fare pak të dhëna në këtë seksion, çka e bën të pamundur krijimin e një panoramë të qartë mbi veprimtarinë e kryer. Konkretisht, dihet gjerësisht se PS-ja ka bërë miting gati në çdo bashki të vendit, ndërkohë që në raport ka deklaruar vetëm koston për 4 mitingje të zhvilluara në Vlorë, Durrës, Fier dhe Elbasan.

X.3.2.2. Ligji i vullnetarizmit

Në deklarimet e shpeshta publike të eksponentëve të partive politike evidentohet shpesh se një pjesë e konsiderueshme e personave që angazhohen pranë këtyre partive përgjatë fushatës elektorale, i ofrojnë kontributet dhe shërbimet e tyre në mënyrë vullnetare.

Theksohet se ky është një fenomen ende i parregulluar ligjërisht në mënyrë të plotë. Sipas ligjit[402] vullnetarët duhet të regjistrohen në Regjistrin Kombëtar të Vullnetarëve dhe të pajisen me Librezën e Vullnetarit.
Libreza e Vullnetarit dhe formati i regjistrit Kombëtar të Vullnetarëve nuk është miratuar ende prej ministrisë përgjegjëse, megjithëse kanë kaluar tashmë katër vite duke e bërë kështu jo-efektiv zbatimin në praktikë të ligjit.

Në këto kushte është i pamundur identifikimi i numrit të vullnetarëve të angazhuar konkretisht pranë partive politike, rrjedhimisht edhe i kontributit apo shërbimit të ofruar prej tyre, duke lënë jo pak shteg për mundësi abuzimi e manipulimi deklarimesh. Kjo pasi, sipas Udhëzuesit të aprovuar nga KQZ-ja[403], përjashtohet

401 Udhëzues për raportimin financiar për partine 2019 *"Çdo miting i fushatës, ku marrin pjesë 5,000 ose më shumë individë, duhet të regjistrohet në një rresht në seksionin 4b. Në rast se për një miting të caktuar, ju nuk jeni të sigurt nëse kanë marrë pjesë 5,000 veta apo jo, atëherë ju duhet ta konsideroni dhe ta raportoni këtë miting njësoj sikur numri i pjesëmarrësve të ishte 5000 apo më tepër".*

402 Ligji nr. 45/2016 datë 28.04.2016 *"Për vullnetarizmin",* Fletorja Zyrtare Nr. 92/2016.

403 Udhëzues për raportimin financiar për partine 2019 *"Kur dikush ofron kohën e tij/saj pa pagesë për të*

përfshirja e kontributit vullnetar si kontribut në natyrë në raportet e vetë-deklarimit financiar.

X.3.3. Raportimi nga kandidatët

Sipas Kodit Zgjedhor kandidatët për kryetarë bashkie janë subjekte zgjedhore[404]. Ata konkurrojnë në zgjedhje sipas sistemit maxhoritar dhe votohen veçmas nga subjektet politike që i mbështesin. Si të tillë kandidatët për kryetarë bashkie mund të mbledhin të ardhura dhe të shpenzojnë fonde në mënyrë të pavarur nga partia politike apo koalicioni që i mbështet, fonde të cilat mund të arrijnë edhe shumë të konsiderueshme.

Në rast se një kandidat për kryetar bashkie mbështetet nga një koalicion partish, atëherë partitë brenda koalicionit duhet të bien dakord me marrëveshje ndërmjet tyre se cili subjekt zgjedhor do të raportojë shpenzimet e kandidatit në raportin financiar të fushatës zgjedhore. Partia politike që ka rënë dakord të raportojë të ardhurat dhe shpenzimet e kandidatit duhet të paraqesë një deklaratë në KQZ.

Nga 97 kandidatë për kryetarë bashkie në këto zgjedhje, 91 ishin përfaqësues të tetë partive politike apo koalicioneve pjesëmarrëse në zgjedhje dhe gjashtë kandidatë garuan si të pavarur.

Në zgjedhjet e datës 30 qershor 2019 garuan dy koalicione parazgjedhore, "Aleanca për Shqipërinë Europiane" (ASHE) dhe "Shpresa për Ndryshim".

Raportimet financiare të kandidatëve të propozuar nga ASHE janë përfshirë në raportin e Partisë Socialiste. Nga 60 kandidatët e ASHE-së janë shpenzuar në total 32,331,770 Lekë.

Dymbëdhjetë[405] prej këtyre kandidatëve kanë raportuar 0 të ardhura dhe shpenzime. Në këtë grup janë përfshirë edhe kandidatë për bashki të mëdha si Elbasani, Durrësi, Shkodra, për të cilët dihet gjerësisht që ka patur aktivitet të ngjeshur elektoral, dhe që nuk mundet në asnjë rast që të jenë zero, së paku, shpenzimet e aktiviteteve të zhvilluara.

Koalicioni Shpresa për Ndryshim propozoi tre kandidatë për kryetar bashkie.

Nga gjashtë parti pjesë e këtij koalicioni, katër[406] kanë dorëzuar raporte me 0 të ardhura dhe shpenzime, pra nuk kanë përfshirë raporte të kandidatëve të koalicionit.

Dy partitë e tjera[407] nuk kanë depozituar fare raport në KQZ.

Si rrjedhim, asnjë nga kandidatët për kryetar bashkie të Koalicionit Shpresa për Ndryshim nuk ka raportuar të ardhurat dhe shpenzimet e fushatës zgjedhore.

---

ndihmuar fushatën (p.sh. duke shpërndarë fletushka për disa orë në fundjavë), ky është "aktivitet vullnetar" dhe jo "dhurim në natyrë". Ai nuk do të përfshihet në raportin e financimit të zgjedhjeve të subjektit zgjedhor. Nëse shërbimet nuk ofrohen sipas kushteve të tregut dhe as në formë vullnetare, atëherë këto konsiderohen dhurime në natyrë dhe si të tilla duhet të kostohen dhe regjistrohen".

404 Kodi Zgjedhor Neni 2, pika 20 *"Subjekte zgjedhore, janë partitë politike, koalicionet dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, si dhe kandidatët për kryetarë të organeve të qeverisjes vendore, të regjistruar në përputhje me këtë Kod".*

405 Gledjan Llatja, Valbona Sako, Valdrin Pjetri, Klement Ndoni, Liman Morina, Tonin Marinaj, Gjolek Guci, Ilir Xhakolli, Adriatik Zotkaj, Nuri Belba, Gjon Gjonaj dhe Adriatik Mema.

406 Partia Demokracia e Re Europiane, Partia Balli Kombëtar, Partia Bashkimi Liberal Demokrat dhe Partia Ora e Shqipërisë.

407 Partia Aleanca Kuq e Zi dhe Partia e Emigracionit Shqiptar.

Sa i përket gjashtë partive politike të cilat garuan jashtë koalicioneve zgjedhore[408], të gjitha ato garuan me kandidatë për kryetarë bashkie në disa Bashki të vendit.

Me përjashtim të një kandidati[409], asnjë tjetër nuk është përfshirë në asnjë rast në raportet financiare të partive politike përkatëse[410], ose rezulton që as vetë partitë nuk kanë depozituar fare raport vetë-deklarimi[411] në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Sa i përket kandidatëve të propozuar nga zgjedhësit, ligji parashikon[412] se ata i nënshtrohen të njëjtave rregulla si partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhje, me përjashtim të përllogaritjes së kufirit të shpenzimeve, i cili kryhet ndryshe.

Megjithatë, aktet nënligjore të aprovuara nga KQZ-ja i përjashtojnë këta subjekte nga dorëzimi i raportit të vetë-deklarimit për fushatën zgjedhore.
Ata janë subjekt vetëm i auditimit të fondeve të përfituara dhe shpenzuara për llogari të fushatës. Por edhe në këtë rast mbetet sërish e paqartë se mbi bazën e kujt raporti apo pasqyre financiare do të bëhet auditimi i veprimtarisë financiare të tyre.

X.4. Raportet e monitorimit dhe raportet e auditimit

Monitorimi i shpenzimeve të fushatës zgjedhore nga ekspertë financiarë, duke përfshirë aktivitetet, veprimtaritë dhe materialet e përdorura prej partive politike, u vendos për herë të parë me ndryshimet që iu bënë ligjit "Për Partitë Politike" në Maj të vitit 2017. Në funksion të këtij ligji, para zgjedhjeve parlamentare të vitit 2017, KQZ miratoi 3 udhëzime[413] të cilat drejtonin organizimin e punës në terren prej ekspertëve financiarë.

Në mbledhjen e datës 31 maj 2019, KQZ-ja hodhi shortin dhe emëroi ekspertët financiarë dhe audituesit, të cilët do të kryenin monitorimin dhe auditimin e të ardhurave dhe shpenzimeve të fushatës zgjedhore nga subjektet zgjedhorë[414].

408 Partia Bindja Demokratike, Partia Minoriteti Etnik grek për të Ardhmen, Partia Aleanca e Maqedonasve për Integrim Europian, Partia Komuniste, Partia Fryma e Re Demokratike dhe Partia Kombëtare Konservatore Albania.

409 Partia Bindja Demokratike nga 22 kandidatë, ka paraqitur në raport aktivitetin financiar vetëm për kandidatin e Bashkisë Tiranë, i cili ka të ardhura dhe shpenzime në një vlerë prej 1,100 Euro.

410 - Partia Bindja Demokratike. Përsa i përket 21 kandidatëve të tjerë të mbështetur dhe propozuar prej saj, ata nuk figurojnë të deklaruar me aktivitet financiar në raportin e vetë-deklarimit të partisë. Ndërkohë ata figurojnë në këtë raport si dhurues në natyrë duke vënë në dispozicion zyra zgjedhore.
Në raportin e vetë-deklarimit është ë paqartë nëse klasifikimi si dhurim në natyrë është korrekt, duke qenë se kandidatët kanë paguar qiranë për zyrën përkatëse dhe nuk janë pronarë të ambientit të vënë në dispozicion për zyrë elektorale.
- Partia Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen, kryetari i së cilës ishte kandidat për kryetar të Bashkisë Finiq, nuk ka përfshirë në raportin e vetë-deklarimit të partisë asnjë të dhënë për të si kandidat.
- Partia Aleanca e Maqedonasve për Integrim Europian dhe Partia Komuniste, janë parti politike që kanë patur respektivisht një dhe dy kandidatë për kryetar bashkie. Të dyja këto parti kanë paraqitur raport me 0 të ardhura dhe shpenzime dhe me asnjë të dhënë për kandidatët në fjalë.
- Partia Fryma e Re Demokratike ka patur një kandidat për kryetar bashkie, por nuk ka përfshirë në raport asnjë të dhënë financiare për të.

411 Partia Kombëtare Konservatore Albania, parti politike që ka patur një kandidat për kryetar bashkie nuk ka depozituar raport vetë-deklarimi financiar në KQZ.

412 Kodi Zgjedhor Neni 90 pika 4 *"Detyrimet e parashikuara në këtë nen vlejnë edhe për kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, të regjistruar sipas neneve 69 dhe 70 të këtij Kodi. Shpenzimi total që mund të kryejë kandidati i propozuar nga zgjedhësit nuk duhet të kalojë 50 për qind të shumës më të madhe që një subjekt zgjedhor ka marrë nga fondet publike, sipas nenit 87/3 të këtij Kodi".*

413 Udhëzimi nr.1 datë 31.05.2017 *"Për përdorimin e materialeve propagandistike dhe vendet për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore"*; Udhëzimi nr. 2 datë 01.06.2017 *"Për miratimin e procedurave dhe kritereve të përzgjedhjes së listës paraprake dhe emërimit të ekspertëve financiar për monitorimin e fushatës zgjedhore"*; Udhëzimi nr. 3 datë 02.06.2017 *"Për mënyrën e përllogaritjes së kostos financiare të veprimtarive, shërbimeve apo materialeve që do të përdoren për qëllime zgjedhore ose politike, nga partitë politike gjatë fushatës zgjedhore".*

414 Vendimi nr. 740 datë 31.05.2019 i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve *"Për emërimin e ekspertëve financiarë dhe auditëve ligjorë, të cilët do të kryenin monitorimin dhe auditimin e fondeve dhe shpenzimeve të fushatës zgjedhore nga subjektet zgjedhore për organet e qeverisjes vendore të vitit 2019"*

Për herë të parë në këto zgjedhje, me një vendimmarrje të kundraligjshme të KQZ-së[415], u emëruan të njëjtët ekspertë[416], të cilët kryen të dyja proceset për të njëjtët subjekte zgjedhorë, pra i njëjti ekspert realizoi për të njëjtin subjekt edhe monitorimin e shpenzimeve të fushatës zgjedhore, edhe auditimin e fondeve të përfituara dhe shpenzuara gjatë fushatës.

Ekspertët financiarë që monitorojnë fushatën zgjedhore hartojnë dhe dorëzojnë në KQZ[417] raporte javore të monitorimit, raporte të cilët shqyrtohen dhe verifikohen nga administrata e KQZ-së.
Në faqen zyrtare të KQZ janë publikuar raportet e ndërmjetme të monitorimit për katër javët e fushatës zgjedhore[418].
Vihet re se numri i raporteve të publikuara[419] nuk përfshin të gjitha subjektet zgjedhorë[420].

Nga këqyrja e raporteve të ndërmjetme të monitorimit të ekspertëve, rezultojnë kontradikta në raportim dhe evidentohen një numër problematikash për monitorimin e fushatës apo të zyrave zgjedhore.
Në shumë raste, ekspertët shkruajnë se nuk janë pajisur nga bashkitë me listën e zyrave zgjedhore me adresa të sakta, çka ka vështirësuar monitorimin e tyre.

Nga ana tjetër, në disa raporte, ekspertët ngrenë pretendimin se nuk kanë patur mundësi të monitorojnë aktivitetin e zyrave elektorale pasi ato janë gjetur të mbyllura, ndërkohë që janë vënë në dijeni se zyrat funksionojnë vetëm gjatë pasdites. Është e paqartë se për çfarë arsye monitorimi nuk është kryer gjatë pasdites, pasi në raporte nuk jepen shpjegime lidhur me këtë aspekt.

Vërehet se raportet e ndërmjetme të monitorimit, në shumë raste, nuk përfshijnë kostot e aktiviteteve të vëzhguara apo të zyrave elektorale, duke e lënë shpesh këtë seksion bosh apo duke cituar se ai do të vlerësohet në vazhdim.

X.4.1. Dorëzimi dhe publikimi i raporteve të monitorimit dhe të auditimit

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve më datën 31 maj 2019, emëroi 34 ekspertë për monitorimin dhe auditimin e fondeve të fushatës zgjedhore për 52 subjekte zgjedhorë në total, nga të cilët 36 parti politike dhe 16 kandidatë të pavarur (për kryetarë bashkie dhe anëtarë të këshillave bashkiakë).

415 Shih seksionin *"IV.7. Financat e subjekteve zgjedhore"* të këtij Raporti.

416 U emëruan nga KQZ-ja 34 ekspertë financiarë për monitorimin dhe auditimin e 36 subjekteve zgjedhore.

417 Udhëzimi nr. 1 datë 11.04.2019 "*Për procedurën e kontrollit dhe verifikimit të financimeve dhe shpenzimeve të partive politike dhe fushatës zgjedhore*", Neni 6, pika 1 *"Ekspertët financiarë, të kontraktuar nga KQZ për monitorimin e shpenzimeve të fushatës zgjedhore, duhet të depozitojnë dhe në formatin elektronik pranë KQZ-së, çdo javë raport të ndërmjetëm për rezultatet e monitorimit".*

418 Raportet e ndërmjetme të monitorimit për periudhën 1 – 9 qershor 2019; 10 – 16 qershor 2019; 17 – 23 qershor 2019; 24 – 30 qershor 2019.

419 Për javën e parë të fushatës zgjedhore janë publikuar 33 raporte të ndërmjetme monitorimi. Për javën e dytë të fushatës zgjedhore janë publikuar 34 raporte të ndërmjetme monitorimi. Për javën e tretë të fushatës zgjedhore janë publikuar 34 raporte të ndërmjetme monitorimi. Për javën e katërt të fushatës zgjedhore janë publikuar 31 raporte të ndërmjetme monitorimi.

420 - Për javën e parë të monitorimit të fushatës mungojnë raportet e ndërmjetme për 3 subjekte zgjedhorë (Partinë e Unitetit Kombëtar, Partinë Demokrate për Integrim dhe Prosperitet dhe Partinë e Pajtimit Kombëtar).
- Për javën e dytë të monitorimit të fushatës mungojnë raportet e ndërmjetme për 2 subjekte zgjedhorë (Partinë e Unitetit Kombëtar dhe Partinë Aleanca e Maqedonasve për Integrim Europian).
- Për javën e tretë të monitorimit të fushatës mungojnë raportet e ndërmjetme për 2 subjekte zgjedhorë (Partinë e Unitetit Kombëtar dhe Partinë Socialiste e Moderuar).
- Për javën e katërt të monitorimit të fushatës mungojnë raportet e ndërmjetme për 5 subjekte zgjedhorë (Partinë e Unitetit Kombëtar, Partinë Socialiste të Moderuar, Partinë Aleanca e Maqedonasve për Integrim Europian dhe Partinë Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane, Partia Balli Kombëtar).

Afati përfundimtar i dorëzimit të raporteve të monitorimit financiar në KQZ, ishte data 26 nëntor 2019[421]. Rezultoi se 17 prej raporteve[422] u dorëzuan jashtë afatit ligjor. Gjithashtu, raporti i monitorimit për një prej subjekteve zgjedhore nuk u dorëzua fare në KQZ[423]. Pra në total, deri në datën 3 shkurt 2020 janë dorëzuar vetëm 35 raporte nga 36 parti politike, pjesëmarrëse në zgjedhje.

Raportet e monitorimit financiar duhet të publikohen në faqen e internetit të KQZ-së brenda 10 ditësh nga dorëzimi i tyre[424].
Procesi i publikimit të raporteve në faqen e internetit të KQZ-së nisi më datën 17 dhjetor me publikimin e 29 raporteve. Në vazhdim u publikuan të tjera raporte dhe konkretisht: në datën 20 dhjetor tre raporte[425], në datën 24 dhjetor një raport[426], në datën 30 dhjetor një raport[427] dhe në datën15 janar 2020 një raport[428].

Në përmbajtje të raporteve ekspertët reflektojnë probleme që kanë të bëjnë me sjelljen e partive politike dhe institucioneve të ndryshme, si dhe problemet me mbajtjen e veprimtarisë financiare që zhvillohet në praktikë nga partitë.

Në lidhje me raportet e auditimit, përpos sa më sipër, subjekt i auditimit të pasqyrave financiare të të ardhurave dhe shpenzimeve të fushatës zgjedhore janë, përveç 36 partive politike të përmendura më lart, edhe 16 kandidatët e pavarur për kryetarë bashkie apo për anëtarë të këshillave bashkiakë.

Afati përfundimtar i dorëzimit të raporteve të auditimit financiar në KQZ, ishte data 16 dhjetor 2019[429].

---

421 Udhëzimi nr. 1 datë 11.04.2019, neni 2 *"Afatet e dorëzimit të raporteve"* pika 4 *"Eksperti financiar, i kontraktuar nga KQZ për të monitoruar shpenzimet e kryera nga partitë politike gjatë fushatës zgjedhore duhet të depozitojë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, raportin e monitorimit jo më vonë se 4 muaj nga data e shpalljes së rezultatit të zgjedhjeve edhe në format elektronik".*

422 Raporti i monitorimit të "Partisë Demokracia e Re Europiane", eksperte financiare znj. Aida Maloku; Raporti i monitorimit të "Partisë për Personat me Aftësi të Kufizuar", eksperte financiare znj. Arjana Reçi; Raporti i monitorimit të "Partisë për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve", ekspert financiar z. Doranin Agalliu; Raporti i monitorimit të "Partisë Socialpunëtore Shqiptare", eksperte financiare znj. Eftali Qirjaqi; Raporti i monitorimit të "Partisë Aleanca Kuq e Zi", eksperte financiare znj. Eleonora Olli; Raporti i monitorimit të "Partisë Komuniste të Shqipërisë", eksperte financiare znj. Eneida Rahmani; Raporti i monitorimit të "Partisë Aleanca Demokratike Shqiptare", eksperte financiare znj. Fatmira Sykja (Kastrati); Raporti i monitorimit të "Partisë Fryma e Re Demokratike", eksperte financiare znj. Hidajete Kraja; Raporti i monitorimit të "Partisë për Liri, Demokraci dhe Etikë", eksperte financiare znj. Ingegerta Bebi; Raporti i monitorimit të "Partisë Aleanca e Maqedonasve për Integrim Europian", ekspert financiar z. Lavdimir Fusha; Raporti i monitorimit të "Partisë Lëvizja Punëtore Shqiptare", eksperte financiare znj. Liri Gjoka; Raporti i monitorimit të "Partisë Demokrate për Integrim dhe Prosperitet", ekspert financiar z. Luan Muça; Raporti i monitorimit të "Partisë Socialiste të Moderuar", eksperte financiare znj. Margarita Kalemasi; Raporti i monitorimit të "Partisë së Gjelbër", eksperte financiare znj. Meri Lika; Raporti i monitorimit të "Partisë së të Drejtave të Mohuara", eksperte financiare znj. Vullnetare Çela Hoxha; Raporti i monitorimit të Partisë "Ora e Shqipërisë", eksperte financiare znj. Violeta Mulla; Raporti i monitorimit të Partisë "Pajtimi Kombëtar", eksperte financiare znj. Valentina Haxhi.

423 Partia Balli Kombëtar, eksperte financiare Znj. Margarita Gjergji.

424 Udhëzimi nr. 1 datë 11.04.2019 neni 3 *"Publikimi i Raporteve: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, publikon në faqen zyrtare të internetit raportin financiar vjetor, raportin e audituesit ligjor për fondet vjetore dhe fondet e fushatës zgjedhore, raportin financiar të fushatës zgjedhore, raportin e monitorimit të fushatës të ekspertëve financiar, jo më vonë se 10 ditë nga depozitimi i tyre".*

425 Raporti i monitorimit të "Partisë për Liri Demokraci dhe Etikë", eksperte financiare znj. Ingegerta Bebi; Raporti i monitorimit të "Partisë për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve", ekspert financiar z. Doranin Agalliu; Raporti i monitorimit të "Partisë Socialiste të Moderuar", eksperte financiare znj. Margarita Kalemasi.

426 Raporti i monitorimit të "Partisë Emigracioni Shqiptar", ekspert financiar znj. Eleda Dhima.

427 Raporti i monitorimit të "Partisë së të Drejtave të Mohuara", eksperte financiare znj. Vullnetare Çela Hoxha.

428 Raporti i monitorimit të "Partisë Aleanca e Maqedonasve për Integrim Europian", ekspert financiar z. Lavdimir Fusha.

429 Udhëzimi nr. 1 datë 11.04.2019 neni 2 *"Afatet e dorëzimit të raporteve",* pika 5 *"Audituesi ligjor, i kontraktuar nga KQZ për të audituar fondet e përfituara dhe të shpenzuara gjatë fushatës zgjedhore nga partitë politike duhet të depozitojë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve edhe në format elektronik, raportin e auditimit jo më vonë se 20 ditë nga dorëzimi i raportit të monitorimit".*

U depozituan në KQZ jashtë afatit 13 raporte të auditimit të partive politike[430]. Sa i përket kandidatëve të pavarur, nga 16 kandidatë, 6 raporte[431] u dorëzuan jashtë afatit.

Publikimi i raporteve të auditimit të fushatës zgjedhore, në faqen e internetit të KQZ, nisi më datën 9 janar 2020 me publikimin e 28 raporteve.

Më pas është vazhduar me publikimin e gjashtë raporteve[432] të tjera në datën 15 janar 2020 dhe të një raporti[433] në datën 16 janar 2020.

Deri në datën 3 shkurt 2020 janë publikuar 34 raporte të auditimit financiar nga 36 parti politike pjesëmarrëse në zgjedhje[434].

Sa i përket raporteve të auditimit të kandidatëve të pavarur, të 16 raportet u publikuan deri në datën 27 janar 2020.

Për nëntë kandidatë raportet u publikuan më datën 15 janar 2020, katër u publikuan në datën 16 janar 2020[435], dy në datën 17 janar 2020[436] dhe një në datën 27 janar 2020[437].

X.4.2. Përmbajtja dhe problematika të vërejtura në raportet e monitorimit dhe të auditimit

Përmbajtja e raporteve të monitorimit financiar reflekton punën në terren të ekspertëve financiarë, me anë të vëzhgimit, inspektimit, verifikimit, konfirmimit dhe grumbullimit të informacionit për veprimtari dhe aktivitete te subjekteve zgjedhore. KQZ-ja ka unifikuar, me anë të formateve të standardizuara të raportimit, mënyrën e raportimit nga ekspertët financiarë si dhe mënyrën e përllogaritjes së dhurimeve në natyrë, por jo metodologjinë e monitorimit që duhet të ndiqet

430 Raporti i auditimit të "Partisë Demokracia e Re Europiane", eksperte financiare znj. Aida Maloku; Raporti i auditimit të "Partisë për Personat me Aftësi të Kufizuar", eksperte financiare znj. Arjana Reçi; Raporti i auditimit të "Partisë për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve", ekspert financiar z. Doranin Agalliu; Raporti i auditimit të "Partisë Komuniste të Shqipërisë", eksperte financiare znj. Eneida Rahmani; Raporti i auditimit të "Partisë Aleanca Demokratike Shqiptare", eksperte financiare znj. Fatmira Sykja (Kastrati); Raporti i auditimit të "Partisë për Liri Demokraci dhe Etikë", eksperte financiare znj. Ingegerta Bebi; Raporti i auditimit të "Partisë Lëvizja Punëtore Shqiptare ", eksperte financiare znj. Liri Gjoka; Raporti i auditimit të "Partisë Ora e Shqipërisë", eksperte financiare znj. Violeta Mulla; Raporti i auditimit të "Partisë Pajtimi Kombëtar", eksperte financiare znj. Valentina Haxhi; Raporti i auditimit të "Partisë Socialiste të Moderuar", eksperte financiare znj. Margarita Kalemasi; Raporti i auditimit të "Partisë së Gjelbër", eksperte financiare znj. Meri Lika; Raporti i auditimit të "Partisë Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet", eksperte financiare znj. Lumturi Velaj; Raporti i auditimit të "Partisë Kombëtare Konservatore", eksperte financiare znj. Margarita Kalemasi.

431 Raporti i auditimit të kandidatit Albert Shopi, eksperte financiare znj. Aida Maloku; Raporti i auditimit të kandidatit Gjon Ndoj, eksperte financiare znj. Eneida Rahmani; Raporti i auditimit të kandidatit Leonidha Hristo, eksperte financiare znj. Fatmira Sykja (Kastrati); Raporti i auditimit të kandidatit Fran Jushi, eksperte financiare znj. Ludmilla Paluka; Raporti i auditimit të kandidates Silva Burbo, eksperte financiare znj. Margarita Kalemasi; Raporti i auditimit të kandidatit të pavarur Mandi Loli, ekspert financiar z. Kastriot Haxhaj.

432 Raporti i auditimit të "Partisë për Personat me Aftësi të Kufizuar", eksperte financiare znj. Arjana Reçi; Raporti i auditimit të "Partisë Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet", eksperte financiare znj. Lumturi Velaj; Raporti i auditimit të "Partisë Ora e Shqipërisë", eksperte financiare znj. Violeta Mulla; Raporti i auditimit të "Partisë Aleanca e Maqedonasve për Integrim Europian", ekspert financiar z. Lavdimir Fusha; Raporti i auditimit të "Partisë për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve të Shqipërisë", eksperte financiare znj. Enkelejda Alite; Raporti i auditimit të "Partisë Kristiandemokrate", eksperte financiare znj. Enkelejda Alite.

433 Raporti i auditimit të "Partisë për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve", ekspert financiar z. Doranin Agalliu.

434 Në faqen e internetit të KQZ-së mungojnë 2 raporte: Raporti i auditimit të "Partisë Aleanca Kuq e Zi", eksperte financiare znj. Eleonora Olli dhe Raporti i auditimit të "Partisë Balli Kombëtar", eksperte financiare znj. Margarita Gjergji.

435 Raporti i auditimit të kandidates Areti Nasho, eksperte financiare znj. Enkelejda Alite; Raporti i auditimit të kandidatit Plarent Aleksi, eksperte financiare znj. Lumturi Velaj; Raporti i auditimit të kandidatit Leonidha Hristo, eksperte financiare znj. Fatmira Kastrati; Raporti i auditimit të kandidatit Fezi Shaholli, eksperte financiare znj. Anida Nuri.

436 Raporti i auditimit të kandidatit Petro Bozhori, eksperte financiare znj. Eftali Qirjaqi dhe Raporti i auditimit të kandidatit Bali Jazaj, ekspert financiar Z. Lavdimir Fusha.

437 Raporti i auditimit të kandidatit Mondi Loli ekspert financiar Z. Kastriot Haxhaj.

(p.sh. përzgjedhjen e mitingjeve elektorale që do të monitorohen, etj.).
Për këtë arsye mbetet në diskrecionin e ekspertëve interpretimi dhe zbatimi i kritereve metodologjike. Një situatë e tillë le hapësirë që ekspertët financiarë të zbatojnë metodologji të ndryshme, çka mund të rezultojë në hartimin e raporteve me të dhëna jo të krahasueshme.
Për më tepër, një qasje e tillë lejon hapësirë për mundësi keqpërdorimi dhe monitorimi jo të barabartë, duke targetuar disa subjekte zgjedhore në mënyrë diskriminuese.

Ndërsa, përsa i përket raporteve të auditimit financiar, në thelb, përmbajtja e tyre konsiston në kontrollin e pasqyrave financiare nga ana e auditëve financiarë, duke konkluduar me dhënien e opinionit përfundimtar mbi veprimtarinë financiare të subjektit përgjatë fushatës zgjedhore, bazuar në auditimin e kryer prej tyre, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit.

Konstatohet se mbetet problematike dhe e paqartë se mbi çfarë pasqyrash financiare apo mbi çfarë raporti financiar, auditët gjykojnë dhe kryejnë auditimin financiar ndaj veprimtarisë financiare të subjekteve elektoralë, kandidatë të pavarur.

X.4.2.1. Problematika që lidhen me përmbushjen e detyrës prej ekspertëve financiarë

Formati i raporteve të monitorimit financiar u miratua me vendimin nr. 152 datë 11 prill 2019[438].

Thuajse të gjitha raportet e monitorimit janë në formatin e miratuar nga KQZ-ja, ndonëse me të dhëna të pakta. Kjo edhe për shkak të mungesës së aktivitetit nga subjektet zgjedhorë përkatës, por edhe si pasojë e mungesës së komunikimit apo vënies së dokumentacionit në dispozicion të ekspertit financiar.

Nga këqyrja e raporteve të auditimit, konstatohet se katër raporte[439] nuk janë në formatin e miratuar nga KQZ-ja, ndërsa një ekspert, në vend të raportit të auditimit, ka dorëzuar në KQZ raport monitorimi[440].

Ndërsa, nga këqyrja e raporteve të monitorimit, vërehet se raportet përmbajnë në masë më të lartë informacion mbi elementë metodologjikë përshkrues (përshkrim të itinerarit apo veprimeve të kryera nga ekspertët financiarë) se sa gjetje nga procesi i monitorimit.
Ndërkohë, në asnjë raport nuk përshkruhet metodologjia e përdorur për përzgjedhjen e qyteteve apo të eventeve elektorale që janë vëzhguar.
Në shumë raporte gjenden fotografi të qyteteve të vizituara nga ekspertët, çka, në rastin më të mirë, është tregues se është kryer një vizitë monitorimi në qytetin përkatës.

Të gjithë ekspertët financiarë evidentojnë në raporte si propozim të tyre për përmirësimin e procesit, publikimin paraprak nga ana e partive të programit apo agjendës së aktiviteteve të tyre gjatë muajit të fushatës, çka është një tregues se ata nuk kanë patur një të tillë në dispozicion.

438 Vendimi nr. 152 datë 11.04.2019 *"Për miratimin e formateve të standardizuara të raportit të auditimit të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike gjatë vitit kalendarik, raportit të auditimit të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike për fushatën zgjedhore dhe raportit të monitorimit të fushatës zgjedhore"*.

439 Raporti i auditimit të "Partisë Aleanca Demokristiane", ekspert financiar z. Afrim Suli; Raporti i auditimit të "Partisë Lëvizja Punëtore Shqiptare", eksperte financiare znj. Liri Gjoka; Raporti i auditimit të "Partisë për Personat me Aftësi të Kufizuar", eksperte financiare znj. Arjana Reçi; Raporti i auditimit të "Partisë së të Drejtave të Mohuara", eksperte financiare znj. Vullnetare Hoxha.

440 Raporti i auditimit të kandidatit Mondi Loli i hartuar nga eksperti financiar z. Kastriot Haxhaj, në formatin dhe përmbajtjen e tij rezulton të jetë raport monitorimi.

Në këto kushte, është totalisht e paqartë se si ekspertët financiarë mund të kryenin përzgjedhje statistikore rigoroze të eventeve që duhet të monitoronin, çka e bën formulimin metodologjik në Udhëzimin e KQZ-së të pazbatueshëm në praktikë.

Nga këqyrja e raporteve evidentohen të tjera problematika, të cilat shpesh vënë në pah neglizhencë nga ana e ekspertëve financiarë, por edhe mungesë të kontrollit nga ana e KQZ-së mbi këto raporte në momentin e marrjes në dorëzim. Konkretisht konstatohet se:

- Në një numër raportesh, ka mospërputhje mes shifrave të raportuara në vetë raport[441].
- Disa raporte përmbajnë gabime materiale serioze, të tilla si emri i partisë apo personave përgjegjës në parti të shkruar gabim[442].
- Evidentohen mospërputhje në konstatimin e ekspertit në lidhje me hapjen ose jo të llogarisë bankare të posaçme për zgjedhjet nga ana e subjektit zgjedhor[443], apo përllogaritjet e shpenzimeve nga ana e ekspertit bazuar në numrin e votave që ka marrë subjekti zgjedhor[444].
- Në 18 raporte, respektivisht të dhjetë partive politike dhe tetë kandidatëve të pavarur, ekspertët nuk kanë dhënë një opinion të tyre, çka përbën, de-facto, mosplotësim të objektit të kontratës së nënshkruar me KQZ-në. (në disa prej rasteve kjo është shprehur edhe drejtpërdrejtë nga vetë ekspertët në raport).

Në të gjitha rastet, sipas deklarimeve të bëra në raporte, kjo ka ardhur si pasojë e mosbashkëpunimit të subjektit zgjedhor apo mungesës së evidencave financiare nga ana e tij[445].

---

441 Tek Raporti i monitorimit të Partisë Bindja Demokratike me ekspert financiar z. Shkëlzen Margjeka vërehet se:
- në faqen 135, zëri "Shpenzime publicitet FB" referohet vlera në Euro: 105 Euro, vlera në Lek 47.190 Lek, ndërsa vlera totale e monitoruar 50.000 Lek. Shuma e referuar si shpenzim për këtë zë nuk përputhet me specifikimin e zërave të shpenzuar. - Gjithashtu në po të njëjtin raport, në lidhje me kostimin e zyrës elektorale në Bashkinë Këlcyrë, eksperti në faqen 56 e vlerëson koston e saj 8,000 Lekë, ndërsa në faqen nr. 34 e vlerëson 10,000 Lekë.

442 - Raporti i monitorimit të Partisë së Pajtimit Kombëtar me eksperte financiare znj. Valentina Haxhi, në faqen nr. 1 dhe nr. 4 i referohet emrit të Partisë Demokracia Sociale; - Raporti i monitorimit të Partisë për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve me ekspert financiar z. Doranin Agalliu, në faqen 11 citon emrin e Partisë së Gjelbër. Vërehet lehtësisht se Raporti i auditimit i PMDE-së është kopje e Raportit të Partisë së Gjelbër, me të vetmen diferencë, ndryshimin e emrit të partisë; - Raporti i auditimit të Partisë së Unitetit Kombëtar me ekspert financiar z. Kastriot Haxhaj, në titull të tij shkruan Raporti i Partisë Demokracia Sociale; - Raporti i auditimit të Partisë së Pajtimit Kombëtar me eksperte financiare znj. Valentina Haxhi, sikurse raporti i monitorimit, është kopje e Raportit të auditimit të Partisë Demokracia Sociale, madje në disa raste referohet edhe emri i Partisë Demokracia Sociale; - Raporti i auditimit të Partisë Kombëtare Konservatore Albania me eksperte financiare znj. Ludmilla Paluka, në faqen 3 evidenton se PKKA nuk ka përgatitur dhe dorëzuar pasqyrat financiare sikurse e kërkon ligji, ndërsa në faqen 5 thekson se raporti financiar është përgatitur dhe firmosur nga Kristo Kiço. Ndërkohë, ky i fundit është kryetar i Partisë MEGA dhe jo i PKKA-së. - Raporti i auditimit të Partisë Socialiste të Moderuar paraqet se shuma e dhuruar dhe emri i partisë në faqen 9 të raportit i përkasin Partisë MEGA dhe jo Partisë Socialiste të Moderuar.

443 - Raporti i Partisë së të Drejtave të Mohuara me eksperte financiare znj. Vullnetare Çela, në faqen 5 bën me dije se evidenca e hapjes së llogarisë bankare shënon "Po", ndërsa në faqen 6 bëhet deklarimi se: *"Nuk është hapur llogari bankare sepse nuk ka donacione që kalojnë shumën 100,000 Lek"*; - Raporti i Partisë së Emigracionit Shqiptar me eksperte financiare znj. Eleda Dhima, në faqen 8 tek evidenca e hapjes së llogarisë bankare paraqet përgjigjen se "nuk ka", ndërkohë më poshtë bën deklarimin se *"Subjekti ka hapur një llogari bankare ne emër te Partisë se Emigracionit Shqiptar me date 13.06.2019 ne Bankën Raiffeisen"*; - Raporti i Partisë Aleanca Arbnore Kombëtare me eksperte financiare znj. Silvana Gjikdhima, në faqen 31 tek evidenca e hapjes së llogarisë bankare jep përgjigjen "jo", ndërkohë më poshtë në faqen 32 citon se *"Llogaria bankare është çelur ne Raiffesen bank me date 23/04/2019"*.

444 Raporti i Partisë Socialdemokrate, me eksperte financiare znj. Lejla Shahu, në faqen 10 paraqet se: *"Ne total janë 27,422 vota qe kane shpallur fitues 81 këshilltarë ne 36 bashki te vendit. Duke llogaritur një kosto minimale prej 5,000 Leke shpenzime te ndryshme dhe mesatarisht 338 vota te shpërndara ne mënyrë te njëtrajtshme midis 81 mandateve, rezulton se fushata për këshilltarë i ka kushtuar PSD rreth 1,690,000 Leke"*.

445 Raporti i Auditimit të Partisë Aleanca Demokristiane, ekspert financiar z. Afrim Suli; Raporti i Auditimit të Partisë Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane, ekspert financiar z. Hetem Sulaj; Raporti i Auditimit të Partisë Bashkimi Liberal Demokrat, ekspert financiar z. Neshat Maze; Raporti i Auditimit të Partisë Demokrate për Integrim e Prosperitet, ekspert financiar z. Luan Muça; Raporti i Auditimit të Partisë së Reformave Demokratike, eksperte financiare znj. Stoli Laze; Raporti i auditimit të Partisë së të Drejtave të Mohuara, eksperte financiare znj. Vullnetare Çela; Raporti i Auditimit të Partisë së Emigracionit Shqiptar, eksperte financiare znj. Eleda Dhima; Raporti i Auditimit të Partisë G99, ekspert financiar z. Afrim Suli; Raporti i Auditimit të kandidatit

- Në të gjithë raportet e monitorimi financiar evidentohet problemi i moskthimit të përgjigjes nga ana e disa bashkive[446], në lidhje me numrin dhe vendndodhjen e zyrave elektorale të partive politike në territorin e njësisë së qeverisjes vendore përkatëse.

Kjo përbën një shkelje të dyfishtë të kuadrit ligjor duke qenë se administrata e bashkive mbart detyrimin ligjor për përcjelljen e informacionit sipas ligjit për informimin publik dhe atij zgjedhor.

Përpos mangësive të vërejtura dhe të renditura më sipër, nga shqyrtimi i raporteve konstatohet edhe disa problematika të tjera në lidhje me zbatimin e legjislacionit në fuqi prej partive politike. Konkretisht është evidentuar se:

- Dy parti politike, të vetmet subjekte elektorale që kanë raportuar se kanë hapur zyra zgjedhore, nuk kanë njoftuar disa bashki për hapjen e zyrave zgjedhore në territorin e njësisë së tyre[447], në shkelje të detyrimit ligjor që përcakton Udhëzimi nr. 1 datë 31.05.2017 i KQZ-së.
- Partia Socialiste, në disa bashki ka hapur më shumë se sa një zyrë elektorale për lagje, në kundërshtim me Udhëzimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- Vërehen pasaktësi në raportimin e bërë prej partive politike në lidhje me numrin e zyrave zgjedhore të hapura.

Partia Socialiste ka raportuar se ka hapur katër zyra zgjedhore në secilën prej bashkive Durrës, Lushnje dhe Gjirokastër, ndërkohë që, nga verifikimi i dokumentacionit financiar pranë subjektit zgjedhor janë evidentuar shtatë kontrata qiraje për zyra elektorale[448].

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet të marrë një rol shumë më proaktiv në mbikëqyrjen e financave të subjekteve zgjedhore, duke mos u mjaftuar në miratimin e raporteve të depozituara nga auditët.
Mund të konsiderohet ngritja e një strukturë të specializuar, në formën e një task-force, nën koordinimin e KQZ-së dhe me pjesëmarrjen e të tjerë institucioneve shtetërore (p.sh. Kontrolli i Lartë i Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, etj.) për mbikëqyrjen e financave zgjedhore.

Profesionistët e kontraktuar nga KQZ-ja për auditimin e financave zgjedhore dhe atyre të partive politike duhet të kryejnë veprime të mirëfillta monitoruese dhe jo të bazohen mbi vetë-deklarimet e partive apo bashkive.
Metodologjia e vëzhgimit duhet të përcaktohet më në detaje.
Me qëllim që të rritet efektiviteti i monitorimit të fushatës nga ekspertët financiarë, subjektet zgjedhorë duhet që të paraqesin në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve një agjendë të aktiviteteve elektorale që do të kryejnë. Sugjerohet që agjenda paraprake të deklarohet në një afat të arsyeshëm përpara nisjes së fushatës zgjedhore. Nga ana tjetër, duhet të parashikohet edhe që subjektet zgjedhore të kenë detyrimin që të dërgojnë informacion të rifreskuar mbi kalendarin e aktiviteteve zgjedhore në KQZ si dhe drejtpërdrejtë monitoruesit financiar përkatës.

Vasillaq Bollano; eksperte financiare znj. Eleda Dhima; Raporti i Auditimit të kandidatit Petro Bozhori, eksperte financiare znj. Eftali Qirjaqi; Raporti i Auditimit të kandidates Silva Burbo, eksperte financiare znj. Margarita Kalemas; Raporti i Auditimit të kandidatit Ilir Nikolla, eksperte financiare znj. Stoli Laze; Raporti i Auditimit të kandidatit Bali Jazaj, ekspert financiar z. Lavdimir Fusha.

446 Bashkia Belsh, Bashkia Dibër, Bashkia Durrës, Bashkia Gjirokastër, Bashkia Has, Bashkia Kamëz, Bashkia Kavajë, Bashkia Konispol, Bashkia Korçë, Bashkia Krujë, Bashkia Librazhd, Bashkia Lushnje, Bashkia Mallakastër, Bashkia Roskovec, Bashkia Rrogozhinë, Bashkia Sarandë, Bashkia Shijak, Bashkia Tropojë, Bashkia Vlorë, Bashkia Vorë, Bashkia Bulqizë.

447 Sipas referimeve të ekspertëve financiarë në Raportet e monitorimit financiar të fushatës zgjedhore, Partia Bindja Demokratike nuk ka bërë njoftim në asnjë ndaj bashkive ku ka hapur zyra zgjedhore.
Ndërsa Partia Socialiste nuk ka bërë njoftim në bashkitë Shkodër, Vau Dejës, Tropojë, Skrapar, Devoll, Tepelenë, Gjirokastër, Delvinë.

448 Raporti i monitorimit të Partisë Socialiste të Shqipërisë.

X.4.2.2. Deklarimi i llogarive të posaçme bankare

Çdo subjekt zgjedhor, përfshirë kandidatët e pavarur, referuar Kodit Zgjedhor[449], duhet të hapë një llogari të posaçme bankare për përftimin e fondeve jopublike mbi shumën 100,000 Lekë dhe deklarojë në KQZ numrin e saj.

Sa i përket deklarimit dhe publikimit në faqen e internetit të KQZ-së, nga 36 subjekte zgjedhore pjesëmarrëse në zgjedhjet e datës 30 qershor, vetëm nëntë[450] prej tyre kanë deklaruar numrin e llogarisë bankare.
Ndërkohë përsa iu përket kandidatëve, vetëm 10 kandidatë për Kryetar Bashkie[451] dhe tre për Këshillat Bashkiake[452] kanë depozituar numrin e llogarisë bankare.

Sipas ekspertëve financiarë, ishin 23 subjekte zgjedhore[453] që nuk hapën llogari të posaçme bankare për fushatën. Pesë prej partive[454] deklaruan se kanë përdorur llogarinë e përhershme të partisë gjatë fushatës. Vetëm katër parti[455] hapën një llogari bankare të posaçme.
Për tre parti politike[456] ekspertët financiarë kanë deklaruar se nuk kanë informacion në lidhje me çeljen ose jo prej tyre të një llogarie bankare.

Përsa iu përket kandidatëve të pavarur, sipas raporteve të auditimit financiar, figuron se asnjë prej tyre nuk ka hapur llogari të posaçme bankare për fushatën zgjedhore, ndërkohë që rezulton se dy prej tyre e kanë hapur llogarinë dhe e kanë të publikuar në faqen e internetit të KQZ-së.

Kuadri ligjor duhet të parashikojë detyrimin e subjekteve zgjedhore për hapjen e një llogarie të posaçme për fondet e fushatës.
Të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet e bëra për qëllim të fushatës duhet të kalojnë nga kjo llogari bankare, pavarësisht burimit (fondet e vetë subjektit të qarkullojnë në këtë llogari përpara se të mund të shpenzohen për qëllim të fushatës, fondet nga buxheti i shtetit të lëvrohen aty, etj.) apo shumës së tyre (çdo dhurim jo-publik, pavarësisht masës, të kalojë në këtë llogari dhe të ndalohet dhurimi politik me para në dorë).

449 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 90 *"Regjistrimi i fondeve jopublike"* pika 2 *"Dhurimi i fondeve jopublike me vlerë më të madhe se 100 mijë Lekë duhet të bëhet vetëm në një llogari të posaçme të hapur në një bankë nga subjekti zgjedhor. Përgjegjësi i financës së subjektit zgjedhor, jo më vonë se tre ditë nga fillimi i fushatës zgjedhore, deklaron numrin e llogarisë bankare të hapur për këtë qëllim. Numri i llogarisë bankare për çdo subjekt politik publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së*".

450 Partia Socialiste; Partia e Gjelbër; Partia për Liri, Demokraci dhe Etikë; Partia e Emigracionit Shqiptar; Partia Balli Kombëtar; Partia Socialiste e Moderuar; Partia Kristian Demokrate; Partia Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane dhe Partia Aleanca Demokratike Shqiptare.

451 Gledjan Llatja, Qerim Ismailaj, Fatos Tushe, Rajmonda Balilaj, Kristo Kiço, Majlinda Bufi, Armando Subashi, Pjerin Ndreu, Fredi Kokoneshi dhe Sabri Ibrahimi.

452 Gjon Ndoj kandidat i pavarur për Këshillin e Bashkisë Mirditë, Fran Jushi kandidat i pavarur për Këshillin e Bashkisë Mirditë dhe Femi Luca kandidat i Partisë Socialpunëtore për Këshillin e Bashkisë Tiranë.

453 Partia Fryma e Re Demokratike, Partia Aleanca Arbnore Kombëtare, Partia Aleanca e Maqedonasve për Integrim Europian, Partia Aleanca Kuq e Zi, Partia Ardhmëria Shqiptare, Partia Bindja Demokratike, Partia Demokrate për Integrim e Prosperitet, Partia e Reformave Demokratike Shqiptare, Partia e të Drejtave të Mohuara, Partia e Emigracionit Shqiptar, Partia Kombëtare Konservatore Albania, Partia Komuniste e Shqipërisë, Partia Lëvizja Punëtore Shqiptare, Partia Ora e Shqipërisë, Partia për Liri Demokraci dhe Etikë, Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve, Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve, Partia për Personat me Aftësi të Kufizuar, Partia Socialdemokrate e Shqipërisë, Partia Socialiste e Moderuar, Partia Socialpunëtore Shqiptare, Partia e Unitetit Kombëtar dhe Partia Bashkimi Liberal Demokrat.

454 Partia Aleanca Demokratike Shqiptare, Partia Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet, Partia Demokracia Sociale, Partia e Pajtimit Kombëtar Shqiptar dhe Partia Kristian Demokrate.

455 Partia Demokracia e Re Europiane, Partia e Gjelbër, Partia Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen dhe Partia Socialiste e Shqipërisë.

456 Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë, Partia Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane si dhe Partia G99.

Gjithashtu, edhe pagesat për fushatën zgjedhore të kryhen të gjitha nga kjo llogari bankare, pavarësisht masës së tyre.
Me synim rritjen maksimale të transparencës së financave zgjedhore, KRIIK sugjeron që llogaritë bankare të partive politike dhe subjekteve zgjedhore të jenë "llogari transparente", të cilat të mundësojnë monitorimin e të gjitha lëvizjeve në kohë reale nëpërmjet internetit prej të gjithë subjekteve të interesuar. Një gjë e tillë kërkon investimin dhe aplikimin e llogarive të tilla prej sistemit bankar shqiptar.

X.4.2.3. Shkelje të tjera të vërejtura

Nga shqyrtimi i raporteve evidentohen raste të mungesës së komunikimit apo mos informimit të ekspertëve[457].
Janë konstatuar gjithashtu një sërë problematikash të tjera si:
- dokumentimi i shpenzimeve me fatura të parregullta tatimore[458];
- fatura tatimore të lëshuara jo në datën kur është kryer shpenzimi[459];
- fatura financiare globale, pra të pashoqëruara me situacion analitik, pra të detajuar në zëra, (PS);
- mospërfshirje e shpenzimeve të bëra si kontributeve në natyrë[460].
- moszbatimi i ligjit për prokurimet[461] në shpenzimet e kryera me fondet publike.

Për rrjedhim, kemi rritje të shpenzimeve të zërave të fushatës duke konkluduar në mospërputhje midis deklarimeve të kostove të faturuara dhe kostimit të kryer nga ekspertët financiarë[462].

457 - Partia Lëvizja Punëtore Shqiptare, sipas ekspertes, nuk i ka vendosur në dispozicion asnjë dokument; - Partia G99, sipas ekspertit, nuk ka krijuar asnjë mundësi komunikimi; - Partia e të Drejtave të Mohuara, sipas ekspertes, nuk i ka vendosur në dispozicion asnjë dokument; - Partia Bashkimi Liberal Demokrat, sipas ekspertit, ka bërë të mundur vetëm një komunikim verbal dhe më pas nuk ka vendosur asnjë dokument në dispozicion.

458 - Raporti i auditimit të Partisë Aleanca Demokratike, i përgatitur nga ekspertja financiare znj. Fatmira Kastrati konkludon se: "Partia "Aleanca Demokratike" nuk respekton kërkesat e ligjeve fiskale për raportim të shpenzimeve të saj të shoqëruara me faturat tatimore me emër dhe me NIPT të saj. Ajo raporton blerje vetëm me kuponë tatimorë të pashoqëruar me faturat tatimore përkatëse".
- Raporti i auditimit të Partisë Aleanca Arbnore Kombëtare, i përgatitur nga ekspertja financiare znj. Silvana Gjikdhima, konkludon se: "Nga financimi publik janë kryer shpenzime administrative nga degët ne masën 690,000 Leke. Këto shpenzime janë kryer pa dokumente fiskale".
- Raporti i auditimit të Partisë Ardhmëria Shqiptare, i përgatitur nga ekspertja financiare znj. Anita Pulaj, konkludon se: "Partia nuk ka fatura që dokumentojnë shpenzimet".
- Raporti i auditimit të Partisë Bindja Demokratike, i përgatitur nga eksperti financiar z. Shkëlzen Margjeka, konkludon se: "Personat përgjegjës për mbajtjen e dokumentacionit financiar nuk kanë mbledhur të gjithë dokumentacionin shoqërues të shpenzimeve të realizuara gjatë fushatës, me fatura të rregullta tatimore" dhe se "BD ka kryer shpenzime për fushatën me fatura jo të rregullta tatimore, të panjohura".
- Raporti i auditimit të Partisë Kombëtare Konservatore Albania, i përgatitur nga ekspertja financiare znj. Ludmilla Paluka, konkludon se: "PKKA deklaron se ka përdorur nga burime personale financime për fushatën, në vlerë 158.000 Lekë për të cilën disponon disa dokumente jo tatimore dhe kuponë kase për blerje karburanti".
- Raporti i monitorimit të Partisë Kristiandemokrate, i përgatitur nga ekspertja financiare znj. Enkelejda Alite, konkludon se: "Shpenzimet për fushatën zgjedhore nuk janë të shoqëruara me faturë tatimore".
- Raporti i monitorimit të Partisë Socialiste, i përgatitur nga ekspertja financiare znj. Sherife Hoxha, konkludon se: "Disa kandidatë kanë shpenzime të pajustifikuara me faturë tatimore, por vetëm me kupon çka sjell mungesë transparence".

459 Në raportin e monitorimit për Partinë Socialiste ekspertja financiare ka evidentuar si problem datën e disa faturave tatimore, të cilat nuk janë lëshuar në ditën kur është marrë shërbimi. Konkretisht shërbimet janë marrë në muajin qershor duke qenë se kanë qenë në funksion të fushatës elektorale, ndërkohë që faturat janë lëshuar më pas në muajin korrik.

460 - Raporti i monitorimit të Partisë së Gjelbër, i përgatitur nga ekspertja financiare znj. Meri Lika, pasqyron takim elektoral në një kafene në qytetin e Elbasanit në një ambient të vënë në dispozicion pa pagesë. Kjo konsiderohet dhurim në natyrë dhe do të duhet të ishte deklaruar si i tillë.
- Raporti i monitorimit të Partisë Ora e Shqipërisë, i përgatitur nga ekspertja financiare znj. Violeta Mulla, pasqyron disa takime elektorale, dy prej të cilëve janë zhvilluar në ambiente të vëna në dispozicion pa qira, gjë që duhet të raportohej si dhurim në natyrë.
- Raporti i monitorimit të Partisë Bindja Demokratike, i përgatitur nga eksperti financiar z. Shkëlzen Margjeka, pasqyron takime të kandidatit për kryetar bashkie në Korçë dhe Durrës, takime të cilat janë bërë në lokale të ofruara falas, gjë që do të duhej të ishte përllogaritur/deklaruar si dhurim në natyrë.
Gjithashtu në këtë raport janë paraqitur edhe realizimet e rreth 17 takimeve elektorale nga kandidatët në qytete të ndryshme, në disa prej të cilave janë ofruar pije, kosto e të cilave nuk është deklaruar në të ardhurat dhe shpenzimet e kandidatëve apo partisë.

461 Ligji nr. 9643, date 20.11.2006, i ndryshuar *"Për Prokurimin Publik"*.

462 - Raporti i monitorimit financiar Partia Kristiandemokrate, i përgatitur nga ekspertja financiare znj.

- kryerja e shpenzimeve me para në dorë mbi kufirin e lejuar nga ligji prej 150,000 Lekësh[463];
- mosregjistrimi fare në organet tatimore i dy partive politike pjesëmarrëse në zgjedhje[464].

Përpos rasteve më sipër, evidentohen edhe raste të tjera[465] të mospërputhjes së kostimit prej subjektit dhe ekspertit financiar.
Në raportin e vetëdeklarimit të Partisë Socialiste deklarohet e njëjta shumë si e ardhur dhe shpenzim nga ana e kandidateve, ndërkohë sipas auditit në gjashtë bashki[466] rezulton se në disa raste ka deficit dhe në disa të tjera suficit, pra nuk është një raport i balancuar.

Në raportet e auditimit të tre partive politike[467], ekspertët financiare deklarojnë se partitë e kanë plotësuar detyrimin që rrjedh prej vendimmarrjes së KQZ-së[468], për shpërndarjen e fondeve partive politike pas shpalljes së rezultatit të zgjedhjeve.
Nga komunikimi me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve këto parti nuk e kthyen brenda afatit shumën e përcaktuar sipas vendimit të sipërpërmendur[469].

Enkelejda Alite, evidenton se sipas raportit te vete-deklarimit totali i shpenzimeve është 480.910 Lekë, ndërsa sipas ekspertit 456,580 Lekë. Diferenca prej 24.330 Lekësh, vjen për arsye se subjekti zgjedhor nuk ka zbatuar ligjin e prokurimit publik në lidhje me blerjen e karburantit, i cili zë dhe peshën specifike më të madhe të shpenzimeve.
- Raporti i monitorimit të Partisë Socialiste, i përgatitur nga ekspertja financiare znj. Sherife Hoxha, pasqyron se: "Nga llogaritjet sipas monitorimit kostoja për eventet e monitoruara është 24,796,200 Lekë. Nga faturat e marra nga subjekti zgjedhor kostoja e aktiviteteve të monitoruara është 21,000,365 Lekë. Diferenca për aktivitetet e monitoruara është 3,795,835 Lekë, e cila vjen për arsye se subjekti zgjedhor nuk ka zbatuar ligjin e prokurimit publik".

463 Raporti i monitorimit të Partisë Aleanca Kuq e Zi, eksperte financiare Znj. Eleonora Olli: "1 nga 16 kandidatët për këshilltarë bashkiakë në listën shumë-emërore të Bashkisë Përrenjas, kandidati Myslim Karriqi, ka kryer shpenzime për fushatën elektorate me fondet e tij vetjakë, fonde në formë monetare dhe të ardhura ose dhurime në natyrë. Me një shpenzim total prej 909 495 Leke të evidentuara prej ekspertit financiar në raportin e monitorimit, kandidati ka paguar cash shumën 245,000 Lek për autobus".

464 Partia Socialpunëtore Shqiptare dhe Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve.

465 Raporti i monitorimit të Partisë Socialiste, eksperte financiare Znj. Sherife Hoxha. Në këtë raport deklarohet se shpenzime për qira zyrash janë 3,926,018 Lekë (1,897,568 Lekë dhurim në natyrë dhe 2,028,450 Lekë shpenzime me kontratë qiraje), ndërkohë sipas PS shuma është 6,057,811 Lekë (2,153,761 dhurim në natyrë dhe 3,904,050 Lekë si shpenzime me kontratë qiraje).
Diferenca vjen nga periudha e llogaritjes, pasi sipas ekspertes ka dy raste të përllogaritura gabim të vlerës se dhurimit në natyrë në zyrat zgjedhore në Bashkinë Elbasan dhe bashkinë Peqin, ku kontratat ishin vlerësuar me vlerë më të ulët se vlera e përcaktuar sipas çmimeve të referencës.
Në bashkinë Durrës në dy kontrata qiraje çmimi i vendosur në kontratë është më i ulët se çmimi i referencës.
Gjithashtu, nga PS nuk janë llogaritur shpenzime qiraje ose dhurimi në natyrë, përdorimi i pajisjeve të zyrave zgjedhore si dhe shpenzime për energji dhe ujë.
Eksperti referon shpenzime nga kandidatet shumën 32 387 070 Lekë, ndërkohë ne vete-deklarim kjo shumë është 32,331,770 Leke. Eksperti referon shpenzime nga partia shumën 44 556 803 Lekë, ndërkohë në vetë deklarim kjo shumë është 43,551,196 Leke. Parregullsitë e konstatuara ne lidhje me aktivitetet janë ne faqen 25 të raportit.

466 Bashkia Belsh, Bashkia Fushë-Arrëz, Bashkia Cërrik, Bashkia Libohovë, Bashkia Gjirokastër dhe Bashkia Mat.

467 Partia Fryma e Re Demokratike, Partia Socialiste e Moderuar dhe Partia Kristiandemokrate.

468 Vendim nr. 1098 datë 27.07.2019 i KQZ-së *"Për caktimin e sasisë së fondit publik që përfitojnë partitë politike për zgjedhjet e datës 30 qershor 2019".*

469 - Raporti i auditimit të Partisë Fryma e Re Demokratike, eksperte financiare znj. Hidajete Kraja: "Shuma e financimit publik e kthyer 2,279,233 Lekë data 19.09.2019".
Ndërkohë nga komunikimi i KRIIK me KQZ, kjo parti nuk e ka kthyer shumën që duhet të kthejë në buxhetin e shtetit.
- Raporti i auditimit të Partisë Socialiste të Moderuar, eksperte financiare znj. Margarita Kalemasi: "Shuma e financimit publik e kthyer 790,036 Lekë, data 22.08.2019".
Ndërkohë nga komunikimi i KRIIK me KQZ, kjo parti nuk e ka kthyer shumën që duhet të kthejë në buxhetin e shtetit.
- Raporti i auditimit të Partisë Kristiandemokrate, eksperte financiare znj. Enkelejda Alite: "Shpenzimet e fushatës zgjedhore 2019 janë përballuar nga fondet publike. Është akorduar një paradhënie nga Buxheti i Shtetit për shumen 956.376 Lekë për financimin e fushatës dhe me pas është kthyer shuma 496.426 Lekë".
Ndërkohë nga komunikimi i KRIIK me KQZ, kjo parti nuk e ka kthyer shumën që duhet të kthejë në buxhetin e shtetit.

KRIIK gjykon se kuadri ligjor dhe mekanizmat që garantojnë transparencën e financave zgjedhore duhet të rishihen në themel dhe të ndryshohen, me qëllim garantimin e një transparence maksimale dhe kontrolli efikas.
Ndryshimet ligjore duhet të përfshijnë jo vetëm Kodin Zgjedhor, por edhe ligjin për Partitë Politike apo të tjera ligje, sipas nevojës. Madje gjykohet se më e udhës do të ishte hartimi i një ligji të ri të plotë dhe të posaçëm për financat e partive politike dhe fushatave zgjedhore.

Duke konsideruar situatën aktuale të mos kontrollit të financimit politik, të moszbatimit të ligjit dhe të informalitetit të lartë në ekonomi, veçanërisht nivelin e lartë të korrupsionit si dhe të krimit të organizuar, KRIIK sugjeron të merret në konsideratë ndalimi totalisht i financimit jo-publik për partitë politike, me përjashtim të kuotave të anëtarësisë.
Kjo masë të merret për një periudhë kohore të kufizuar (së paku tre legjislatura). Një masë e tillë, e shoqëruar me kontroll më rigoroz dhe nga institucione më të specializuara në fushën e kontrollit financiar (p.sh. Kontrolli i Lartë i Shtetit, apo nëpërmjet ndërtimit një task-force do të rriste nivelin e transparencës dhe kontrollit). Gjithashtu, si një masë alternative ndaj ndalimit të financimit jo-publik në bllok, mund të konsiderohet ndalimi i financimit nga subjektet juridike dhe të lejohet vetëm financimi nga persona fizikë.

XI. MEDIA

Pavarësisht numrit të lartë të operatorëve mediatikë, veçanërisht përsa i përket portaleve online, sektori mediatik vuan nga mungesa e pavarësisë financiare, çka shpie në mungesë të pavarësisë së politikës editoriale.

Shqetësime madhore u ngritën në opinionin publik në dhjetor 2018 - janar 2019 mbi tentativën e shfaqur për të rritur kontrollin mbi mediat që operojnë në internet me anë të "paketës antishpifje"[470], konsultimi publik i së cilës u realizua në mënyrë shumë të përshpejtuar dhe jo-transparente.

Pas reagimeve ndërkombëtare dhe vendase, qeveria nuk e dërgoi ligjin për miratim në parlament, por projekt-ligji u miratua në mënyrë totalisht jo-transparente nëpërmjet Këshillit të Ministrave në mbledhjen e tij të datës 3 korrik 2019[471].

Kryeministri Rama deklaroi se hartimi i këtij legjislacioni ishte punuar në koordinim me OSBE-në dhe se do të futej në axhendën e punimeve të parlamentit në shtator 2019[472].

Më datë 23 korrik 2019, përfaqësuesi i OSBE-së për lirinë e mediave i dërgoi një letër kryeministrit ku theksohej se, pavarësisht se projektligjet e miratuara në korrik kishin përmirësime në krahasim me ato të dhjetorit 2018, nevojitej që gjatë procesit parlamentar të kishte përmirësime të tjera të ligjit në mënyrë që të rritej përputhshmëria e tij me standardet ndërkombëtare mbi lirinë e shprehjes dhe të medias[473].

470 Paketa parashikon amendime në dy ligje, konkretisht në Ligjin nr. 97/2013 *"Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë"* dhe Ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 *"Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë"*. Theksohet se tentativa të mëparshme në këtë drejtim ka patur edhe në vitin 2015, ku një projektligj i propozuar nga deputetja Majlinda Bregu për detyrimin e mediave online që të fshinin komentet fyese dhe denigruese, hapi nje debat të gjerë se si do të përkufizoheshin komentet fyese apo denigruese dhe mbi penalitetet ndaj mediave nëse komentet nuk fshiheshin në kohë. Pas presionit të rritur publik, kjo nismë nuk u pezullua.

471 Projektligjet e paketës antishpifje *(Kryeministria.al)*

472 Reporter.al, 30 korrik 2019, *Rama injoron OSBE dhe organizatat për ligjet e medias*.

473 Organizata për Bashkëpunim dhe Siguri në Europë (OSBE), *OSCE Media Freedom Representative presents neë revieë of laës on online media in Albania, recommends further improvements*.

Pavarësisht reagimeve të shumë aktorëve vendas e ndërkombëtarë kundër miratimit të këtyre dy projektligjeve, të cilat preknin thelbësisht lirinë e shprehjes dhe të mediave në vend, mazhoranca më datë 18.12.2019 i miratoi të dy ligjet[474].

Më datë 11.01.2020 Presidenti i Republikës i ktheu të dy ligjet për rishqyrtim[475] në Kuvend, pasi sipas tij "... parashikimet e ligjit nr. 91/2019, bien ndesh me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, nenin 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe nuk janë frymën dhe parimet e vendosur në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut ... ", ndërsa lidhur me ligjin 92/2019 argumentoi se "... bëhet e detyrueshme që ligjvënësi bashkërisht me shqyrtimin e ligjit nr. 91/2019, të rishqyrtojë edhe ligjin nr. 92/2019, pasi këto dy akte të reja ligjore janë pjesë e së njëjtës paketë të lidhura procedurialisht dhe materialisht me njëra- tjetrën".

Pas dërgimit të dy projektligjeve për t'u marrë në shqyrtim nga Komisioni i Venecias, mazhoranca socialiste u tërhoq nga rrëzimi i dy dekreteve të Presidentit, duke pranuar që t'i marrë në shqyrtim këto dekrete pas shpalljes së opinionit prej Komisionit të Venecias[476].

Diskutimi i paketës antishpifje, përpos kontekstit politik, nxiti akoma më shumë një klimë represive ndaj medias, të cilat u bënë shpesh objekt i sulmeve të politikanëve dhe zyrtarëve të lartë publikë, ku këta të fundit përdornin ndaj tyre gjuhë fyese e shprehnin konsiderata se mediat janë të kapura apo të kontrolluara, veçanërisht në raport me ato që ishin kritike ndaj tyre.

Polarizimi i lartë i klimës politike u pasqyrua edhe në sjelljen e medias përgjatë periudhës zgjedhore, qoftë në mbulimin e aktiviteteve të fushatës, qoftë në mbulimin e ngjarjeve të tjera të lidhura me zgjedhjet, të tilla si protestat e opozitës.

Një pjesë e konsiderueshme e portaleve online i pasqyruan ngjarjet politike dhe institucionale, përfshirë edhe aktivitetet e fushatës, në një mënyrë të njëanshme, duke lejuar që politika editoriale të ndikonte dhe në paraqitjen e lajmeve.

Fenomeni i përdorimit të kasetave të përgatitura, prej zgjedhjeve të vitit 2013 e në vazhdim, ka marrë gjithnjë e më shumë përmasa shqetësuese nga viti në vit, duke u kthyer në një modë të gjithanshme tashmë jo vetëm për partitë politike, por edhe për institucionet shtetërore[477] dhe jo vetëm përgjatë fushatave zgjedhore, por edhe në përditshmërinë normale të funksionimit të tyre.

Nga ana tjetër, një pjesë e konsiderueshme e operatorëve mediatikë nuk prodhuan përmbajtje të vetën në mbulim të aktiviteteve të fushatës zgjedhore apo të institucioneve publike, por thjesht i pasqyruan ato duke përdorur materialet e gatshme të ofruara dhe të parapërgatitura nga shtabet elektorale apo "shtabet mediatike" që funksionojnë pranë institucioneve përkatëse.

474 - Ligji nr. 91/2019, datë 18.12.2019 *"Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar"".*
- Ligji nr. 92/2019, datë 18.12.2019 *"Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9918 datë 19.5.2008, "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar"".*

475 - Dekreti nr. 11413 datë 11.01.2020 i Presidentit të Republikës *"Për kthimin e ligjit nr. 91/2019 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar"".*
- Dekreti nr. 11414 datë 11.01.2020 i Presidentit të Republikës *"Për kthimin e ligjit nr. 92/2019 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9918 datë 19.5.2008, "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar"".*

476 Datë 30.01.2020, Taulant Balla: *"Dua t'u informoj se sapo më ka ardhur një komunikim nga Komisioni i Venecias, që ka pranuar të shqyrtojë me procedurë të përshpejtuar në sesionin e 21 marsit. Gjatë muajit shkurt, përfaqësues të Komisionit të Venecias do të vijnë në Tiranë për të dialoguar me ne, me këdo. Votimi i dekretit për mediat audiovizive, diskutimi për të të shtyhet, deri sa Komisioni i Venecias të na sjellë raportin e vet më 20-21 mars". (Reporter.al)*

477 Si raste tipike mund të përmenden institucioni i Kryeministrisë, të gjitha kronikat e të cilit prodhohen nëpërmjet televizionit online ERTV, si dhe Bashkia e Tiranës, kronikat e prodhuara të së cilës në të tëra mediat janë identike.

Në çdo rast, publikimi i këtyre materialeve u bë pa u shoqëruar me njoftimin përkatës se kush e kishte përgatitur materialin, në kundërshtim me parashikimet e ligjore të bëra.

Aktivitetet e qeverisë dhe të Kryeministrit Rama janë transmetuar duke përdorur materiale të gatshme nga televizioni në Facebook ERTV[478], i cili paraqitet si e vetmja dritare mediatike për aktivitetin e qeverisë, si dhe është e vetmja mundësi për mediat për të marrë sinjalin e për të transmetuar aktivitetet e Kryeministrit, me përjashtim të konferencave të organizuara të shtypit, ku mediat lejohen të regjistrojnë e përcjellin sinjalin e tyre.

Kodi Zgjedhor në dispozitat e tij përcakton detyrimin e mediave për t'i dërguar KQZ-së tarifat për reklamë politike përpara nisjes së fushatës, si dhe detyrimin e KQZ-së për t'i publikuar ato në faqen e vet të internetit[479].
Konstatohet se në faqen zyrtare të KQZ-së gjenden tarifat vetëm për shtatë media[480].

XI.1. Veprimtaria e Bordit të Monitorimit të Medias

Mbulimi i fushatës nga media audiovizive monitorohet nga Bordi i Monitorimit të Medias (BMM), një organ ad-hoc që ngrihet për çdo zgjedhje dhe ia raporton gjetjet e veta Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, shoqëruar me propozime të mundshme për sanksione ndaj operatorëve mediatikë kur ata konsiderohen me shkelje.

Personat që bëhen pjesë e BMM-së përzgjidhen nga anëtarët e KQZ-së, ku secili prej tyre përzgjedh dhe propozon një prej kandidaturave të paraqitura nga organizata të shoqërisë civile që operojnë në fushën e medias.

Pavarësisht se, sipas Kodit Zgjedhor, Bordi i Monitorimit të Medias do të duhej të ishte ngritur 40 ditë përpara nisjes së fushatës zgjedhore, ai u ngrit vetëm dy ditë përpara nisjes së saj, më 28 maj 2019. Ndërkohë, edhe ngritja e tij u bë mbi bazën e shkeljeve të tjera ligjore[481] të kryera nga anëtarët e trupës si dhe administrata e KQZ-së.

BMM e nisi monitorimin e fushatës në media më datë 1 qershor 2019 një ditë pasi kjo kishte nisur, ndërkohë që raporti i parë ditor i publikuar në faqen e KQZ-së është i datës 6 qershor.

Monitorimi i kryer ishte i kufizuar në vetëm 14 media[482], ndërkohë që ngrihen pikëpyetje për mospërfshirjen në monitorim të mediave të tjera të cilat transmetojnë tashmë në kanalet digjitale[483].

478 Medium i cili nuk është i rregulluar në asnjë formë ligjore dhe operon në një mungesë transparence totale mbi asetet dhe pajisjet teknologjike që përdor, të financimit, stafit, rregullimit ligjor, etj.

479 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, neni 84 *"Fushata zgjedhore në radiot dhe televizionet private"*, pika 5 *"... Operatorët radiotelevizivë detyrohen të dorëzojnë 5 ditë përpara fillimit të fushatës tarifat për çdo segment kohor pranë KQZ-së. Tarifat publikohen në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve"*.

480 Tarifat zyrtare të medias janë dorëzuar nga mediat: Report TV, Fax News TV, A2 CNN TV, ABC News TV, RTV Scan, TV News 24 dhe TV Klan.

481 Shih për më shumë sesionin *V.1.7.3. Ngritja e Bordit të Monitorimit të Medias* në këtë raport.

482 Në mbledhjen e KQZ-së të datës 28 qershor, me paraqitjen e raportit të fundit të monitorimit, anëtarë të BMM-së u shprehën se, pavarësisht se monitorimi i tyre ishte i kufizuar në vetëm në 14 operatorë audiovizivë, si pasojë e procesit të digjitalizimit, të gjithë operatorët audiovizivë janë të monitorueshëm, pasi përmbajtja është e regjistruar dhe, në rast ankesash, ata kishin mundësi të gjenin përmbajtjen e kontestuar dhe të gjykonin mbi të.

483 Në proceset e mëparshme zgjedhore, një nga problemet jo të vogla që shoqëronin punë e BMM-së ishte pamundësia për të monitoruar TV lokale. Këto TV kontrolloheshin nga disa inspektore rajonale, në mënyrë të rastësishme, për shkak se ato transmetonin në platforma të sinjalit analog, duke e bërë të pamundur objektivisht

Këqyrja e raporteve të BMM-së nxori në pah diferenca të forta mes raporteve ditore dhe atyre javore të publikuara nga kjo trupë, gjë që është vërejtur edhe në raportet e BMM-së gjatë zgjedhjeve parlamentare të vitit 2017.

Shuma e minutave të të gjithë raporteve ditore është shumë më e lartë (deri në dyfish më lartë) sesa minutat e raportuara në raportin javor, ndërkohë që ky i fundit presupozohet të jetë një përmbledhje e raporteve ditore[484].

Fakti që diferenca vërehet në mënyrë konsistente në të gjithë raportet, ngre dyshime të forta se nuk është një gabim njerëzor në përllogaritje, por fshehje e qëllimtë e shifrave reale me qëllim mospenalizimin e mediave.

Theksojmë këtu, gjithashtu, se në këto raporte nuk përfshihet ndjekja dhe monitorimi i transmetimeve "live" nga aktiviteti i liderëve dhe partive politike, apo i kryetarëve apo drejtuesve të institucioneve shtetërore, të cilat zënë një kohë të konsiderueshme përgjatë periudhës së fushatës zgjedhore, por jo vetëm.

Publikimi i raporteve të BMM-së vuan nga mungesa e transparencës. Ato paraqiten të publikuara në një format që e bën të vështirë të kuptuarin e tyre për publikun e gjerë dhe nuk janë në formatin e të dhënave të hapur.

Gjithashtu, konstatohet se ka mungesa në raporte. Raporti i fundit i publikuar në faqen e KQZ-së është raporti ditor i datës 28 qershor, ndërkohë që nuk ka një raport të javës së fundit dhe as një raport përmbledhës.

Pas propozimit nga BMM, KQZ-ja vendosi detyrimin e disa televizioneve[485] për kompensim me kohë televizive ndaj dy subjekteve zgjedhore PSD dhe BD, por raporti i radhës i BMM tregoi se ky detyrim nuk ishte plotësuar. Lidhur me këtë situatë KQZ-ja nuk ndërmori asnjë hap të mëtejshëm.

KRIIK gjykon se BMM duhet të institucionalizohet si trupë, apo t'i atashohet si një strukturë e përhershme pranë AMA-s, me një sekretari mbështetëse dhe arkivë permanente. Kjo do të ndihmojë për referenca të mëvonshme mbi sjelljen e operatorëve audiovizualë gjatë proceseve zgjedhore. Nga ana tjetër ofrohet mundësia e monitorimit të një periudhe më të gjatë përpara fillimit të fushatës zgjedhore, apo edhe pas zgjedhjeve, duke u siguruar për *respektimin dhe zbatimin e ligjit dhe masave të ndërmarra ndaj tyre.*

monitorimin e tyre. Lidhur me këtë shqetësim, nga diskutimet e atëherëshme të bëra me AMA, BMM dhe vetë KQZ-në, pranohej se kontrolli i TV lokale do të zgjidhej përfundimisht kur ato të transmetonin në platformat me sinjal digjital, situatë që sot është një realitet.

484 Për diferencat në minutazh shih Shtojca nr. 8 - **Minutazhi i paraqitur në Raportet e BMM për Fushatën Zgjedhore**.

485 Vendimi 853, datë 22.06.2019 i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve: "*KQZ vendosi: Të urdhërojë operatorët TVSH, Top Channel, TV Klan, Vizion Plus, Ora News, News 24, Channel One, ABC News, Top News, Report TV, Fax News, A2, RTSH Gjirokastra, RTSH Korça, të kompensojë në bazë të nenit 81, pika 1, subjektin politik Partia Socialdemokrate me 30 minuta. 2. Të urdhëroj operatorët Ora News, News 24, të kompensojë në bazë të nenit 81, pika 1, subjektin politik Partia Bindja Demokratike me 30 minuta*".

XII. DITA E ZGJEDHJEVE DHE NUMËRIMI I VOTAVE

Gjatë këtij procesi zgjedhor, përpos vëzhgimit të pandërprerë të KQZ-së dhe Kolegjit Zgjedhor, monitorimi u përqendrua mbi aktivitetin e Komisioneve Zonale të Administrimit Zgjedhor (KZAZ), sidomos në dy ditët që paraprinë ditën e zgjedhjeve[486], gjatë ditës së zgjedhjeve dhe përgjatë procesit të numërimit të votave, deri në përfundimin e numërimit dhe përpilimin e tabelave përmbledhëse të rezultateve për zonën zgjedhore/bashkinë përkatëse.

XII.1. Aktiviteti i KZAZ-së përpara ditës së zgjedhjeve

Shumica e KZAZ-ve qëndruan të mbledhura gati gjatë gjithë ditës së premte, ndërkohë që gjashtë KZAZ ishin të hapura me orare të kufizuara[487].

Në 13 KZAZ, jo të gjithë anëtarët ishin të pranishëm ditën e premte[488].
Nga informacioni i marrë, rezultoi se në tre prej tyre nuk u dha ndonjë arsye për mungesat e evidentuara, ndërsa në dhjetë të tjerat u raportua se sekretari i KZAZ-së nuk ishte prezent për shkak të pjesëmarrjes në një trajnim të organizuar nga KQZ-ja.

Të gjitha KZAZ-të raportuan se i kishin marrë në dorëzim materialet zgjedhore nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve deri ditën e premte, me përjashtim të KZAZ-së nr. 2, e cila ditën e premte është zhvendosur në një vendndodhje të re, duke qenë se vendndodhja e mëparshme nuk ishte lejuar të përdorej nga ana e Bashkisë Shkodër.
Gjithashtu, për shkak të djegies së materialeve gjatë një proteste më datën 27 qershor 2019, edhe KZAZ nr. 6 arriti që t'i merrte në dorëzim materialet zëvendësuese së bashku me fletët e votimit, vetëm pak orë para nisjes së votimit duke i shpërndarë më pas në qendrat e votimit përgjatë orëve të para të mëngjesit të ditës së diel.

Shumica e Komisioneve të ZAZ-ve janë shprehur se i kishin në dispozicion të gjitha materialet dhe logjistikën e nevojshme për të përmbushur detyrat e tyre, me përjashtim të katër KZAZ-ve[489], të cilët deklaruan se nuk kishin ende në dispozicion kompjuterë, lidhje në internet apo se kishin printera jofunksionalë[490].

KZAZ-të raportuan se të gjitha Komisionet e Qendrave të Votimit (KQV) ishin konstituuar deri ditën e premte, datë 28 qershor, me përjashtim të ZAZ-ve në Bashkinë Shkodër, si pasojë e bllokimit të QV-ve nga ana e Bashkisë Shkodër.

Ndërkohë, tetë KZAZ raportuan se deri ditën e premte ende nuk i kishin konstituuar grupet e numërimit të votave[491], në shkelje të parashikimeve ligjore.

486 E premte, dt. 28 qershor dhe e shtunë, dt. 29 qershor 2019.

487 KZAZ nr. 8, Bashkia Fushë-Arrëz; KZAZ nr. 13, Bashkia Lezhë; KZAZ nr. 50, Bashkia Elbasan dhe KZAZ nr. 56, Bashkia Divjakë. KZAZ numër 11, Bashkia Kukës, është vizituar disa herë, në orare të ndryshme përgjatë paradites dhe pasdites së ditës së premte nga vëzhguesi i KRIIK, por raportohet të mos jetë e gjetur e hapur në asnjë nga vizitat e kryera.

488 KZAZ nr. 27, Bashkia Kamëz; KZAZ nr. 34, Bashkia Tiranë; KZAZ nr. 56, Bashkia Divjakë; KZAZ nr. 69, Bashkia Pustec; KZAZ nr. 73, Bashkia Kolonjë; KZAZ nr. 68, Bashkia Maliq; KZAZ nr. 71 dhe nr. 72, Bashkia Korçë; KZAZ nr. 81, nr. 82 dhe nr. 83, Bashkia Vlorë; KZAZ nr. 86, Bashkia Himarë dhe KZAZ nr. 90, Bashkia Konispol.

489 KZAZ nr. 9, Bashkia Bajram Curri; KZAZ nr. 34 dhe nr. 37, Bashkia Tiranë dhe KZAZ nr. 50, Bashkia Elbasan.

490 KZAZ nr. 9, Bashkia Bajram Curri dhe KZAZ nr. 50, Bashkia Elbasan.

491 KZAZ nr. 8, Bashkia Fushë-Arrëz; KZAZ nr. 48, nr. 49 dhe nr. 50, Bashkia Elbasan; KZAZ nr. 52, Bashkia

Gjatë ditës së shtunë, të gjitha KZAZ-të kanë qenë të mbledhura dhe kanë dorëzuar materialet zgjedhore tek qendrat e votimit përkatëse.

Në përgjithësi, procesi i dorëzimit të materialeve zgjedhore tek komisionet e qendrave të votimit ka shkuar pa probleme dhe përfunduar në kohë.

Vetëm në dy KZAZ, vëzhguesit kanë raportuar për konfuzion apo rrëmujë të krijuar gjatë këtij procesi[492], ndërkohë që në një pjesë të tyre ka patur radhë, por procesi është administruar mirë nga komisionerët e KZAZ-ve.

Në 48 KZAZ procesi i dorëzimit të materialeve zgjedhore tek komisionet e qendrave të votimit përfundoi përtej orës 16:00, 35 prej të cilave e përfunduan procesin pas orës 18:00 dhe më e vona në orën 23:00. Në shumicën e rasteve, shpërndarja pas orës 16 ka ndodhur si pasojë e ecurisë së ngadaltë të procesit.
Në këtë proces shpërndarje, përjashtim bëjnë gjashtë qendrat e votimit në Postribë, Bashkia Shkodër, të cilat nuk i kanë marrë në dorëzim materialet zgjedhore dhe në të cilat nuk u zhvilluan votime në datë 30 qershor.

Përsa i përket trajnimit të komisionerëve, vetëm në 12 KZAZ komisionerët kanë informuar vëzhguesit se ka komisionerë të qendrave të votimit të cilët janë të pa trajnuar, ndërsa të tjerët janë shprehur se janë trajnuar 100% e komisionerëve.
Ndërkohë, edhe nga ata që kanë raportuar të kenë komisionerë të patrajnuar, vetëm një KZAZ ka qenë në gjendje të japë një shifër të përafërt të numrit të komisionerëve të patrajnuar ende (rreth 30%), ndërkohë që në KZAZ-të e tjera nuk janë dhënë shifra.

Shifrat e raportuara, nuk duken të besueshme, duke qenë se në shumë KZAZ ka patur ndërrime të komisionerëve të QV-ve deri në momentin e fundit. Madje kjo e fundit, është servirur si një nga arsyet për mos trajnimin e komisionerëve në disa prej KZAZ-ve që e kanë raportuar mungesën e trajnimit.
Të tjera arsye të servirura për mostrajnimin e komisionerëve, përmenden mosparaqitja e tyre gjatë ditës së trajnimit dhe në një rast[493] është argumentuar se trajnimi është i panevojshëm pasi komisionerët janë tanimë të trajnuar nga që kanë qenë komisionerë në procese të mëparshme zgjedhore.

Përsa i përket transparencës së ofruar dhe lehtësisë në monitorim, raportohet se në nëntë KZAZ vëzhguesit kanë raportuar pengesa serioze në procesin e vëzhgimit dhe të aksesimit të vendimmarrjes dhe dokumentacionit të KZAZ-së[494].

Përsa i përket pranisë së vëzhguesve të tjerë, në 36 prej KZAZ-ve, vëzhguesit nuk kanë ndeshur dhe iu është raportuar nga komisionerët se nuk ka vëzhgues të tjerë, veç atyre të partive politike, që ndjekin punën e KZAZ-së.

Ndërsa, përsa iu përket vëzhguesve jo-politikë, raportohet se është konstatuar në një numër KZAZ-sh prezencë e vëzhguesve të ndërkombëtarë[495], ndërkohë që vëzhgues vendas janë raportuar vetëm në shtatë KZAZ[496].

Librazhd; KZAZ nr. 63, Bashkia Kuçovë; KZAZ nr. 66, Bashkia Skrapar dhe KZAZ nr. 71, Bashkia Korçë.

492 KZAZ nr. 10 Bashkia Krumë dhe KZAZ nr. 39 Bashkia Tiranë.

493 KZAZ nr. 85 Bashkia Selenicë.

494 KZAZ nr. 1 Bashkia Malësi e Madhe; KZAZ nr. 4 Bashkia Shkodër; KZAZ nr. 14 Bashkia Rrëshen; KZAZ nr. 26 Bashkia Vorë; KZAZ nr. 35, nr. 38 dhe nr. 39 Bashkia Tiranë; KZAZ nr. 49 dhe nr. 50 Bashkia Elbasan.

495 Vëzhgues të OSBE/ODIHR.

496 Në të gjitha rastet vëzhguesit vendas ishin të akredituar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit.

XII.2. Aktiviteti i KZAZ-ve gjatë ditës së zgjedhjeve

Përgjithësisht, gjatë ditës së zgjedhjeve KZAZ-të operuan në mënyrë të qetë dhe ishin në gatishmëri për t'iu përgjigjur kërkesave që mund të vinin nga qendrat e votimit apo për të adresuar problematikat që mund të lindnin.

Sipas informacionit që komisionerët e KZAZ-ve u përcollën vëzhguesve, rezultoi se vetëm tetë qendra votimi u hapën me vonesë në të gjithë vendin.
Përgjithësisht, arsyeja e hapjes së qendrave të votimit me vonesë ishte vonesa e komisionerëve, apo ndërrimi i tyre në momentin e fundit, përveç dy rasteve në të cilat arsyet ishin të natyrës teknike[497].

Po sipas informacioneve të përcjella tek komisionerët e KZAZ-ve, rezultoi se vetëm në pesë qendra votimi është ndërprerë procesi i votimit gjatë ditës së zgjedhjeve[498].

Përgjithësisht, gjatë ditës së zgjedhjeve, situata përreth KZAZ-ve ka qenë e qetë. Një incident është regjistruar në KZAZ nr. 27 rreth përfundimit të procesit të votimit, ku një grup protestuesish tentuan të hynin në mjedisin ku operonte KZAZ-ja, por incidenti u shmang nga forcat e rendit.

Gjithashtu, përpara KZAZ-së nr. 35 pati protestues me pankarta që protestuan në mënyrë paqësore kundër zgjedhjeve të 30 qershorit, por që nuk ndikuar në mbarëvajtjen e punës së KZAZ-së[499].

XII.3. Marrja në dorëzim e materialeve zgjedhore

Ndërsa kuadri ligjor parashikon se grupet e marrjes në dorëzim të materialeve zgjedhore që formon KZAZ-ja duhet të jenë politikisht të balancuar, kjo kërkesë nuk ishte e mundur të përmbushej në Zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të 30 qershorit, si pasojë e mungesës së balancës politike në komisione.

Gjithashtu, duke qenë se KZAZ-të në këto zgjedhje ishin të përbëra vetëm nga katër anëtarë plus sekretari, kjo kufizonte edhe numrin e grupeve të formuara për marrjen në dorëzim të materialeve zgjedhore vetëm në dy, me nga dy persona secili.

Marrja në dorëzim e materialeve zgjedhore pati një procedim relativisht të shpejtë dhe pa problematika për t'u shënuar, me përjashtim vetëm të një KZAZ-je ku u raportuar tensione, si pasojë e radhëve të gjata[500].

Në pesë KZAZ vëzhguesit raportuan se hapësira në dispozicion të KZAZ-ve nuk ishte e mjaftueshme për marrjen në dorëzim të materialeve zgjedhore.

497 Në QV nr. 3635/1, në KZAZ nr. 72 Bashkia Korçë, kodet e vulave për mbylljen e kutisë së votimit nuk korrespondonin me kodet e shkruara në procesverbal dhe në QV nr. 2724, KZAZ nr. 52 Bashkia Librazhd, komisionerët e qendrës së votimit kishin vendosur kutinë e votimit në kutinë e materialeve zgjedhore. Në të dy rastet, problematikat u zgjidhën me ndërhyrjen e KZAZ-së përkatëse.

498 Në QV nr. 3389 në KZAZ nr. 76 Bashkia Memaliaj; QV nr. 3052 në KZAZ nr. 59 Bashkia Patos; QV nr. 4408, në KZAZ nr. 81 Bashkia Vlorë dhe në një QV në KZAZ nr. 71 Bashkia Korçë, për të cilën numri i qendrës së votimit nuk ishte raportuar. Në QV e fundit, në fshatin Barç, ndërprerja ndodhi pas një konflikti midis një oficeri policie dhe një personi tjetër jashtë qendrës së votimit, për arsye të paditura.

499 Protestuesit hynë në oborrin e shkollës ku ishte vendosur KZAZ-ja, por pasi forcat e rendit ndërhynë, protestuesit dolën nga oborri dhe e vazhduan protestën në hyrje të shkollës.

500 Në KZAZ nr. 81, në Bashkinë Vlorë, situata e tensionuar u qetësua nga Prefekti i Qarkut Vlorë, i cili hyri në KZAZ, i pa pajisur me dokument vëzhgimi, për të qetësuar komisionerët dhe për të rivendosur rregullin.

Megjithatë, u vërejt se në 45% të KZAZ-ve u krijuan radhë të gjata pritjeje gjatë këtij procesi.

Theksohet se në asnjë KZAZ nuk u raportua për kuti votimi të klasifikuara si të parregullta.

XII.4. Aktiviteti i KZAZ-ve gjatë procesit të numërimit

Procesi i numërimit të votave u parapri, në pothuajse të gjitha KZAZ-të nga trajnimi i anëtarëve të grupeve të numërimit të votave.

Kjo është një praktikë tanimë e vendosur dhe e pranuar në Shqipëri, por që ndikon negativisht në proces duke zgjatur procesin e numërimit në mënyrë artificiale, si dhe duke mos ofruar një trajnim cilësor ndaj numëruesve.
Nga ana tjetër, duke marrë në konsideratë faktin se një pjesë e konsiderueshme e anëtarëve të grupeve të numërimit të votave janë persona të cilat kanë qenë të angazhuar si komisionerë gjatë ditës së votimit, kjo rrit mundësinë për kryerjen e gabimeve njerëzore gjatë procesit, si dhe e ngadalëson më tej atë si pasojë e lodhjes që manifestojnë komisionerët.

Procesi i numërimit, në linjë me ditën e zgjedhjeve, u zhvillua përgjithësisht qetë në të gjitha VNV-të e vendit dhe u procedua relativisht shpejt, falë edhe pjesëmarrjes së ulët në votime, çka uli numrin e votave që duhet të numëroheshin.

Vetëm në tri KZAZ u pa e nevojshme të thirreshin forcat e rendit për të rivendosur rregullin brenda VNV-së gjatë procesit të numërimit[501].

Megjithatë, vëzhguesit vërejtën probleme gjatë procesit të numërimit që ulnin transparencën e procesit.
Një nga këto probleme, i vërejtur edhe në procese të mëparshme, është kalimi shumë i shpejtë i fletëve të votimit përpara kamerës. Ky fakt, shoqëruar edhe me cilësinë e dobët të filmimit në disa prej KZAZ-ve, krijonte vështirësi në dallimin e qartë të shenjës që kishte bërë votuesi në fletën e votimit.

Në një KZAZ, raportohet se vëzhguesi vuri re një fletë votimi të shpallur të pavlefshme, të cilën e vendosën në grumbullin e fletëve të votimit të kandidatit për kryetar të ASHE[502].

Pavarësisht se një rast i izoluar, i cili, përveçse nuk mund të gjykohet nëse ishte gabim njerëzor apo manipulim i ndërgjegjshëm i rezultatit zgjedhor dhe faktit që ky rast i vetëm nuk ndikon në rezultatin zgjedhor, episodi ngre dyshime lidhur me qasjen e ndjekur nga komisionerët politikë dhe me transparencën e procesit, në përgjithësi. Veçanërisht shqetësues bëhet ky episod, nën dritën e fakteve të përmendura më sipër në lidhje me cilësinë e kamerave dhe kalimin e shpejtë të fletëve të votimit poshtë kamerës, si dhe të mungesës së vëzhguesve të opozitës në një numër të konsiderueshëm të KZAZ-ve.

Në tetë KZAZ, jo të gjithë vëzhguesit partiakë morën një kopje të tabelës së rezultateve, siç e parashikon legjislacioni[503].

501 Në KZAZ nr. 9 Bashkia Bajram Curri, KZAZ nr. 75 Bashkia Këlcyrë dhe KZAZ nr. 86 Bashkia Himarë .

502 KZAZ nr. 40 Bashkia Tiranë.

503 Në KZAZ nr. 5 Bashkia Shkodër, KZAZ nr. 9 Bashkia Bajram Curri, KZAZ nr. 22 Bashkia Durrës, KZAZ nr. 24 Bashkia Durrës, KZAZ nr. 34 Bashkia Tiranë, KZAZ nr. 56 Divjakë, KZAZ nr. 71 Bashkia Korçë dhe KZAZ nr. 90 Bashkia Konispol.

Në një vlerësim të përgjithshëm rezulton se niveli i zbatimit të Kodit Zgjedhor dhe Udhëzimeve të KQZ-së nga KZAZ-ja gjatë procesit të numërimit të votave u vlerësua si shumë i mirë nga vëzhguesit në 54% të KZAZ-ve dhe si i mirë në 42% të tyre.

Në 4%, ky u vlerësua si me probleme dhe në asnjë KZAZ si shumë problematik. Arsye për vlerësimin problematik janë cituar mungesa e njohurive të komisionerëve mbi kërkesat e legjislacionit, konsultimi i tyre mbi procedurat me persona të paautorizuar, kaosi në VNV dhe mungesa e transparencës gjatë numërimit dhe vendimmarrjes së KZAZ-ve.

Niveli i kualifikimit të anëtarëve të KZAZ-së u vlerësua si shumë i mirë në 54% të KZAZ-ve dhe i mirë në 39% të tyre. Në 7% të KZAZ-ve, niveli i kualifikimit u vlerësua me probleme.

Ndërkohë, niveli i kualifikimit të anëtarëve të grupeve të numërimit të votave u vlerësua si shumë i mirë në 45% të KZAZ-ve, si i mirë në 53% dhe me probleme në 2% të tyre.

XII.5. Mosrealizimi i votimit në disa QV të Bashkisë Shkodër

Më datën 11.07.2019, gjatë mbledhjes së KQZ-së për nxjerrjen e rezultatit të Kryetarit të Bashkisë Shkodër, u deklarua se nga verifikimi i dokumentacionit të KZAZ nr. 2, se me datë 30 qershor 2019, rezultoi që në 9 Qendra Votimi të kësaj ZAZ-je në Bashkinë Shkodër[504] nuk u realizua procesi i votimit.

Ky numër qendrash votimi është i ndryshëm nga numri që KQZ-ja bëri me dije nëpërmjet një deklarate publike në ditën e zgjedhjeve[505], apo edhe nga deklaratat publike të anëtarëve të trupës së KQZ-së[506], sipas të cilëve ishin vetëm shtatë Qendra Votimi ku nuk ishte zhvilluar procesi i votimit.

Mos zhvillimi i procesit të votimit u mohoi 4491 qytetarëve të 9 QV-ve të drejtën e zgjedhjes për organet e tyre të qeverisjes vendore, dhe pavarësisht se në përllogaritjen e votave për kryetarin e bashkisë, vota e tyre nuk rezulton të ketë ndikim duke qenë se konkuronte një kandidat i vetëm, nuk mund të thuhet e njëjta gjë për konfigurimin e anëtarësisë së Këshillit Bashkiak.

Nga monitorimi i çështjes rezultoi një situatë e paqartë, në pikëpamje të ecurisë dhe adresimit ligjor e institucional të problematikës.

Theksohet se dispozitat e Kodit Penal, përkatësisht nenet 329 *"Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje"* dhe 330/a *"Braktisja e detyrës nga anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve"* ngarkojnë me përgjegjësi ligjore këdo që ka penguar zhvillimin e procesit me veprim apo mosveprim.

504 Referuar vendimit të KQZ nr. 1083 datë 11.07.2019 *"...Nga verifikimi i dokumentacionit të KZAZ nr. 02, Librit të Protokollit të Mbledhjeve rezulton se në QV nr. 0077 Njësia Administrative Postribë; QV nr. 00771 Njësia Administrative Postribë; QV nr. 00791 Njësia Administrative Postribë; QV nr. 0082 Njësia Administrative Postribë; QV nr. 0083 Njësia Administrative Postribë; QV nr. 0086 Njësia Administrative Postribë; QV nr. 00861 Njësia Administrative Postribë; QV nr.0224 Njësia Administrative Dajç; QV nr. 0345 Njësia Administrative Gur i Zi; në datë 30 Qershor 2019, votimi nuk është zhvilluar".*

505 Deklaratë e KQZ-së, datë 30.06.2019, ora 11.00 *"Komisioni Qendror i Zgjedhjeve informon opinionin publik se janë hapur të gjithë qendrat e votimit në të gjithë vendin, duke përjashtuar 7 Qendra Votimi në Postribë të qarkut Shkodër. Nga këto, 6 qendra votimi nuk ka filluar ende votimi, ndërsa për 1 qendër votimi janë djegur materialet zgjedhore".*

506 Intervistë e z. Bledar Skënderi për ABC News: *"Kemi një situatë në Shkodër ku në 7 qendra votimi nuk ka vazhduar procesi i votimit. Po presin që KZAZ-të të marri masa për të nisur procesi i votimit në këto qendra".*

Nga komunikimi me Kryetarin e KZAZ nr. 2, pranohet se për 8 qendra votimi[507] komisionerët i kanë tërhequr materialet zgjedhore, por nuk ka qenë e mundur hapja e QV-ve për shkak të pamundësisë së aksesit në ambientet e përcaktuara për t'u zhvilluar votimi[508]. Ndërsa në 1 qendër votimi në fshatin Prekal materialet zgjedhore u dogjën nga një grup personash, megjithëse sipas një vendimi të KZAZ nr. 2 deklarohet se punonjësi i policisë i ngarkuar për të shoqëruar materialet ka qenë prezent, por nuk ka ndërhyrë[509].

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të KZAZ nr. 2, për aq sa u bë e mundur nga vënia në dispozicion prej KQZ-së, rezulton një vendimmarrje formalisht jo e rregullt, sikundër konstatohet tek vendimi nr. 3 datë 9 qershor 2019[510], me të cilën është kryer konstituimi i QV-ve të saj, apo edhe vendime të tjera të cilat figurojnë të shënuara në librin e protokollit dhe jo sipas formateve të udhëzuara, etj,. Një problematikë e vërejtur kjo edhe në KZAZ-të e tjera.

Në komunikimet verbale të zhvilluara, por edhe në procesverbalet e dorëzimit të materialeve në KZAZ prej QV-ve ku nuk u zhvillua votimi, deklarohet se "nuk u bë i mundur aksesimi i ambienteve". Këto procesverbale kanë të njëjtën përmbajtje dhe janë hartuar midis orareve 08.15 - 08.36.

Gjithashtu, u vërejt se, dy anëtarë të KQV-së nr. 345 kishin depozituar pranë KZAZ-së dy Deklarata dorëheqje, pasi sikurse ata deklaronin "ndodheshin nën presion psikologjik nga situata e krijuar", ndaj ata kërkonin të zëvendësoheshin në mënyrë të menjëhershme. Këto deklarat me text të njëjtë, nuk kanë të shënuar orën se se kur janë dëpozituar. Nuk dihet nëse anëtarët e KQV-ve të tjera kanë bërë të njëjtën deklaratë dorëheqje, pasi dokumentacioni i vënë në dispozicion prej KQZ-së, nuk i përmban këto deklarata.

Në orën 11.35, KZAZ-ja i drejtohet Partisë Socialiste - Dega Shkodër duke e njoftuar se "duke marrë shkas nga deklaratat e komisionerëve të QV nr. 0345 dhe nr. 0224 për dorëheqje nga detyra, KZAZ nr. 2 kërkon zëvendësimin e tyre sa më shpejtër të jetë e mundur pasi afati i fundit është ora 12.00".
Në përgjigje të kësaj shkrese Dega e PS-së Shkodër me shkresën nr.168 prot, datë 30.06.2019, dhe pa orë të shënuar në të, i bën me dije KZAZ-së nr. 2 se "megjithë angazhimin tonë maksimal, duke patur parasysh angazhimin e të gjitha strukturave tona në procesin zgjedhor, kohën tejet të shkurtër në dispozicion si dhe pozicionin gjeografik të KQV-ve përkatëse, e kemi të pamundur të plotësojmë me anëtarë KQV-të nr. 0345 dhe 0224".

Nga komunikimi me KQZ-në dhe me autoritetet e policisë së shtetit, u evidentua se nuk kishte asnjë informacion shtesë rreth asaj që kishte ndodhur, si dhe nuk ishte ndërmarrë ndonjë masë administrative apo edhe penale, për të adresuar sa më sipër në zbatim ligjit.

---

507 QV nr. 0077 Njësia Administrative Postribë; QV nr. 00771 Njësia Administrative Postribë; QV nr. 00791 Njësia Administrative Postribë; QV nr. 0083 Njësia Administrative Postribë; QV nr. 0086 Njësia Administrative Postribë; QV nr. 00861 Njësia Administrative Postribë; QV nr.0224 Njësia Administrative Dajç; QV nr. 0345 Njësia Administrative Gur i Zi.

508 Kryetari i KZAZ nr. 2, z. Gazmir Jahiqi, deklaroi se komisionerët e 8 qendrave të votimit kanë tërhequr materialet zgjedhore gjatë mbrëmjes së ditës së shtunë. Pas mbërritjes në ambientet ku ishte vendosur të ishin këto QV, është vënë re se ka qenë i pamundur aksesi në to për shkak se ishin të mbyllura. Edhe përpjekjet e komisionerëve për t'i hapur apo për të gjetur ambiente të tjera ku mund të zhvillonin votimin, nuk sollën asnjë zgjidhje. Të gjendur në ato kushte, me arsyetimin se vendvotimet janë të paaksesueshme, komisionerët vendosën të kthenin materialet zgjedhore pranë KZAZ-së. Kjo e fundit, ka njoftuar në rrugë telefonike Drejtorinë e Komisioneve Zgjedhore në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Gjithashtu është njoftuar edhe Dega e Partisë Socialiste në Bashkinë Shkodër.

509 Vendim i KZAZ nr.2 i marrë më datë 30.06.2019, ora 11.40, për marrjen në dorëzim të materialeve zgjedhore të QV nr. 0082, që shpëtuan nga djegia.

510 Vendimi nr. 3 datë 09.06.2019 *"Për emërimin e antarëve të KQV-së"* ka emëruar: Në QV nr. 0077, 3 anëtarë përfaqësues të Partisë Socialiste; Në QV nr. 00771, 4 anëtarë përfaqësues të Partisë Socialiste; Në QV nr. 0079/1, 4 anëtarë përfaqësues të Partisë Socialiste; Në QV nr. 0082, 4 anëtarë përfaqësues të Partisë Socialiste; Në QV nr. 0083, 3 anëtarë përfaqësues të Partisë Socialiste; Në QV nr. 0086, 4 anëtarë përfaqësues të Partisë Socialiste; Në QV nr. 0086/1, 3 anëtarë përfaqësues të Partisë Socialiste; Në QV nr. 0224, 3 anëtarë nga të cilët 2 përfaqësues të Partisë Socialiste dhe një nga shoqëria civile; Në QV nr. 0345, 2 anëtarë përfaqësues të Partisë Socialiste.

Për gjithë sa më sipër ngrihen një sërë shqetësimesh dhe pikëpyetjesh lidhur me ligjzbatimin dhe përgjegjësinë ligjore të çdo aktori të përfshirë në këtë proces, e konkretisht lidhur me:
- arsyen e pengesës së konstatuar për mosaksesimin e ambienteve të QV-ve;
- hapat ligjorë të anëtarëve të QV-ve dhe të punonjësit të policisë që shoqëronte kutinë e materialeve zgjedhore;
- hapat e ndërmarrë nga KZAZ-ja për të zgjidhur situatën, prej së shtunës mbasdite deri në mesditën e së dielës;
- hapat e ndërmarrë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për adresimin e shqetësimit të përcjellë, qoftë nëpërmjet një mbledhjeje apo ndonjë reagimi publik, qoftë nëpërmjet përcjelljes institucionale të shqetësimit tek Policia e Shtetit dhe tek Prokuoria;
- përgjegjësinë e partisë politike për mosplotësim të anëtarësisë së KQV-së, pasi deklarohet që nuk nuk ka kapacitete;
- rolin e drejtëpërdrejtë të strukturës së policisë të ngarkuar për mbarëvajtjen e procesit zgjedhor;

Në tërë kompleksitetin që mbart ngjarja e mos zhvillimit të procesit zgjedhor në 9 QV-të e ZAZ-së nr. 2, sinjifikohet më së miri funksionimi i ligjit dhe i mekanizmit të ndërtuar, si dhe efikasiteti i ndërveprimit të tyre. Analiza e çështjes duhet të vlejë për adresimin konkret të rasteve të tilla të mundshme duke adresuar përmirësimet e nevojshme për vënien në funksionim të ligjit dhe garantimin e funksioinalitetit të mekanizmit për të vënë para përgjergjësisë këdo që prek dhe cënon të drejtat dhe liritë e qytetarëve në raport me votën.

XIII. ANKESAT DHE APELIMET

Ankimimet dhe apelimet mbi çështjet zgjedhore ndjekin rrugën administrative ose atë gjyqësore[511]. Vendimet e komisioneve të nivelit të dytë ankimohen në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ndërkohë që vendimet e këtij të fundit, apo mosmarrja vendim brenda afateve ligjore nga ana e tij ankimohet në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit të Tiranës.

Të drejtën për t'u ankuar e kanë subjektet zgjedhore, partitë politike apo kandidatët, të cilëve iu është refuzuar regjistrimi si subjekte zgjedhore, si dhe subjektet të cilat kanë të drejtën të akreditojnë vëzhgues, për mosakreditimin e tyre.

Ngushtimi i subjekteve që mund të ankimojnë vendimet e trupës së administrimit zgjedhor vetëm në ato subjekte që janë regjistruar si subjekte zgjedhore, apo që iu është refuzuar regjistrimi ngushton efektivitetin e drejtësisë zgjedhore.

Ngushtimi i së drejtës justifikohet me ekzistencën e interesit të ligjshëm të ankimuesit. Ndërkohë, për vetë rëndësinë që procesi zgjedhor ka për shoqërinë, si e tërë, çdo individ ka një interes të ligjshëm në këtë proces.

Në total, në Zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të 30 Qershorit, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve u paraqitën 61 kërkesa ankimore, nga të cilat 14 përpara ditës së zgjedhjeve nga nëntë subjekte zgjedhore[512] dhe 47 pas ditës së zgjedhjeve, nga shtatë subjekte zgjedhore[513].

511 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Pjesa X dhe XI.

512 Partia Bindja Demokratike, Aleanca Arbnore Kombëtare, Partia Komuniste, Partia Aleanca Demokratike, Bashkimi Liberal Demokrat, Partia Ora e Shqipërisë, Partia Demokracia e Re, Partia Emigracioni Shqiptar, Partia Uniteti Kombëtar.

513 Partia Bindja Demokratike, Partia Emigracioni Shqiptar, Partia Kombëtarë Konservatore Albania, Partia Aleanca Demokratike, Kandidati Edmond Piroli, Kandidati Ylber Gjeta, Kandidati Leonidha Hristo.

Ndërsa në Kolegjin Zgjedhor u apeluan 81 vendime të KQZ-së nga 13 subjekte zgjedhore dhe një bashki. 12 vendime u morën përpara ditës së zgjedhjeve.

Në këtë proces zgjedhor, Kolegji u investua në shpërndarjen e mandateve të këshilltarëve bashkiakë në të 61 bashkitë e vendit, si rezultat i 61 kërkesave ankimore të depozituara nga Partia Socialiste për mosmarrje vendimi nga ana e KQZ-së brenda afateve ligjore për këtë çështje, pasi ky i fundit nuk arriti të merrte vendim me një shumicë të cilësuar prej të paktën 5 vota "pro".

Nga ndjekia me kujdes e tërë situatës, çështjeve të evidentuara dhe proceseve të lidhura me mekanizmin e drejtësinë zgjedhore, mund të shprehet konsiderata se:

Drejtësia zgjedhore në vijueshmërinë e proceseve zgjedhore ka qenë përcaktuese në një mënyrë ose një tjetër. Që prej Reformës Zgjedhore të fundit të vitit 2012-të, mekanizmi i drejtësisë zgjedhore është zhbërë në precedentët e njëpasnjëshëm të vendosur.

Si ndër precedentët më të rëndësishëm të deformimit të mekanizmit përmendet vendimi i Gjykatës Kushtetuese që e konsideroi veten jashtë çështjeve zgjedhore[514], qendrimi i trupës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ndaj kërkesave të subjekteve zgjedhore për rinumërimin e kutive të votimit dhe tani në këtë proces zgjedhor qendrimi i Kolegjit Zgjedhor mbi vlerësimin e interesit të ligjshëm të domosdoshëm për të bërë të mundur investimin e kësaj trupe.

Procesi i fundit i 30 Qershorit 2019, në formalizmin e mbajtjes së tij në një situatë me mungesa të shumta të kandidaturave elektorale, e kaparosi mekanizmin e drejtësisë zgjedhore thjesht në një formalizëm ligjor. Madje ky proces, arriti të prodhojë paradokse ligjore duke evidentuar një mekanizëm të drejtësisë zgjedhore, thjesht si zgjatim "burokratik" të administrimit zgjedhor.

XIII.1. Procesi i ankimimeve para ditës së zgjedhjeve

Paditë e paraqitura në Kolegj para ditës së zgjedhjeve konsistonin, në kundërshtimin e vendimeve të KQZ-së në lidhje më regjistrimin apo mosregjistrimin e kandidatëve të paraqitur nga subjekte të ndryshme, kërkesën e PD dhe LSI për emërimin e komisionerëve në KZAZ, si dhe kërkesën për çregjistrim të Partisë së Unitetit Kombëtar, e cila referuar arsyetimit të saj, gjerësisht në opinionin publik, u interpretua si një kërkesë ndaj Kolegjit Zgjedhor për t'u shprehur mbi legjitimitetin e Dekretit të datës 10 qershor të Presidentit të Republikës.

Në tërësinë e 12 vendimeve të marra nga trupa e Kolegjit përpara ditës së zgjedhjeve, katër kërkesë padi[515] u rrëzuan për shkak të mungesës së legjitimitetit të ankuesit.

Në lidhje me regjistrimin e kandidatëve të subjekteve zgjedhore, në Kolegjin Zgjedhor u vërejt një qasje e ngjashme me atë të KQZ-së, për të regjistruar sa më shumë kandidatë, duke regjistruar edhe ata kandidatë[516] që kishin probleme dhe mungesë

514 Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, Vendimi Nr. 53, datë 07/05/2013, Rrok Rroku kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

515 - Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar me objekt *"Kundërshtim i vendimit të KQZ nr. 230, dt. 27.04.2019 "Për regjistrimin si subjekt zgjedhor "Partia Bindja Demokratike" për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të dt. 30.06.2019""*; - Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar me objekt *"Kundërshtim i vendimit të KQZ me nr. 599, datë 20.05.2019 "Për regjistrimin për Kryetar Bashkie Kamëz të propozuar nga Partia 'Bindja Demokratike' z. Ylber Gjeta për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019""*; - Partia Demokratike dhe LSI me objekt *"Kundërshtimi i vendimit të KQZ, nr. 657, datë 23.05.2019. Gjykimin e çështjes në themel duke vendosur pranimin e kërkesës për emërim të anëtarëve dhe sekretarëve të KZAZ-ve të propozuar nga Partia Demokratike e Shqipërisë dhe Lëvizja Socialiste për Integrim""*; - Bashkia Kamëz me objekt *"Kundërshtim i Vendimit Nr. 651 datë 26.05.2019 dhe Vendimit Nr. 796 datë 03.06.2019 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve"*.

516 Vendimi nr.646 datë 23.05.2019 i KQZ-së: *"KQZ vendosi: Rrëzimin e kërkesës ankimore nr. 1, datë 21.05.2019 të Partisë*

të dokumentacionit të regjistrimit[517], shkak për të cilën KQZ-ja i kishte refuzuar.

Mungesa e legjitimimit të ankuesit është karakteristika që do t'i bashkëlidhet vendimmarrjes së Kolegjit Zgjedhor, në kuadrin e risive që solli ky proces zgjedhor në përvojën vendase.
Në gjykimin e KRIIK ky argument është i pavend dhe vendimmarrja e Kolegjit nuk qëndron.

Precedenti i rrëzimit të padisë për shkak të mungesës së legjitimitetit u bë gjatë procesit zgjedhor të vitit 2017, me ankimimin që bëri partia Forca Rinia në Kolegjin Zgjedhor ndaj regjistrimit të PD-së dhe PR-së, sipas saj jashtë afateve, nga KQZ-ja.

Në thelb të këtij parashtrimi qendron mbështetja në jurisprudencën e Gjykatës së Lartë dhe Kushtetuese, në bazë të të cilave subjekti që vë në lëvizje gjykatën duhet të ketë interes vetjak konkret.

Në gjykimin e KRIIK, mbështetja në këtë bazë është e pavend, pasi rrathanat janë krejt të ndryshme për rastin për të cilën është ndërtuar kjo praktikë, pra për një interes personal i natyrës materialiste.
Ky nuk është rasti për t'u aplikuar ndaj partive politike, pasi gjeneza e nisjes dhe ekzistencës së një partie politike është pikërisht interesi i lartë ndaj së mirës publike, kategorive në nevojë, e çështjeve të tjera të ndryshme që lidhen më zhvillimin dhe progresin e shoqërisë dhe të vendit.

Për më tepër në një garë zgjedhore, favorizimi apo shkelja e rregullave të lojës në raport me garimin e një konkurrenti politik, nuk është as më shumë e as më pak, por një interes i drejtëpërdrejtë i subjektit elektoral për të mbrojtur së pari interesin e tij të ligjshëm për një garë elektorale në kushte të barabarta dhe, së dyti, për hir të integritetit të ligjzbatueshmërisë, të procesit administrativ e institucional, apo në një shkallë edhe më të gjerë, të interesit legjitim për të kërkuar dhe siguruar integritetin e të gjitha hallkave që përbëjnë procesin zgjedhor.

XIII.1.1. Kërkesa e PD dhe LSI për të emëruar komisionerë në KZAZ

Në 20 maj, Partia Demokratike dhe Lëvizja Socialiste për Integrim, vendosën të ushtronin të drejtën për të propozuar anëtarë të KZAZ-ve, pasi këto të fundit ishin konstituuar, referuar mundësisë për plotësim vakancash që iu jep Kodi Zgjedhor[518].
Argumenti i paraqitur për këtë kërkesë, duke qenë se të dy partitë nuk ishin regjistru-

Bindja Demokratike dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 4, datë 18.05.2019 i KZAZ nr. 64 "Për mosregjistrimin e kandidatit për Kryetar Bashkie, Z. Pavllo Shkarpa, Bashkia Berat, propozuar nga Partia Bindja Demokratike"".
Vendimi nr. 653 datë 25.05.2019 i KQZ-së: *"KQZ vendosi: Rrëzimin e kërkesës ankimore nr.02, datë 24.05.2019 të Partisë Bindja Demokratike dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 6, datë 21.05.2019 i KZAZ nr. 46 Cërrik "Për mosregjistrimin e kandidatit për Kryetar Bashkie, zj. Merita Sherif Xhika, Bashkia Cërrik, propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Bindja Demokratike"".*

517 - Me vendimin nr.4 datë 18.05.2019, KZAZ nr.64 Bashkia Berat, vendosi mosregjistrimin si kandidat për kryetar bashkie të z. Pavllo Shkarpa, propozuar nga subjekti Bindja Demokratike, me arsyetimin se z. Shkarpa nuk ishte banor i Bashkisë Berat me datë 13 maj 2019 (afati fundor për regjistrimin e kandidatëve) kusht i përcaktuar në nenin 109 të Kushtetutës. Z. Shkarpa ishte bërë banor i Bashkisë Berat me datë 16 maj 2019. Në këto rrethana, KQZ vendosi lënien në fuqi të vendimit të KZAZ-së.
Ndërkohë, Kolegji Zgjedhor vendosi shfuqizimin e vendimit të KZAZ-së, me arsyetimin se kriteri i vendbanimit nuk duhet domosdoshmërisht të jetë i plotësuar që në datën e paraqitjes së dokumentacionit, por në datën që merret vendimi. Duke qenë se vendimi mban datën 18 maj, ndërsa kandidati është bërë banor në datën 16 maj 2019, ai i përmbush kriteret ligjore për të qenë kandidat. - Me vendimin nr.6 datë 21.05.2019 të KZAZ nr.46, Bashkia Cërrik, vendosi mosregjistrimi si kandidat për kryetar bashkie të znj. Merita Xhika propozuar nga subjekti Bindja Demokratike, me arsyetimin se znj. Xhika nuk ishte banore e Bashkisë Cërrik më datë 13 maj 2019 (afati fundor për regjistrimin e kandidatëve) kusht i përcaktuar në nenin 109 të Kushtetutës. KQZ vendosi lënien në fuqi të vendimit të KZAZ-së.
Ndërkohë, Kolegji Zgjedhor vendosi shfuqizimin e vendimit të KQZ-së, me arsyetimin se verifikimi i kushteve për të kandiduar bëhet në datën që mblidhet dhe vendos KZAZ-ja dhe jo në datën që janë dorëzuar dokumentet nga subjekti zgjedhor.

518 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë Neni 29, pika 5, paragrafi 2 *"Anëtarët e emëruar kryesisht qëndrojnë në detyrë deri në emërimin e anëtarëve të propozuar nga partitë politike, sipas këtij neni. Zëvendësimi duhet të kryhet jo më vonë se 30 ditë nga dita e zgjedhjeve."*

ar si subjekt zgjedhor, ishte nevoja për të bërë transparencë mbi procesin zgjedhor. Kërkesa e tyre u refuzua nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me arsyetimin se, duke mos qenë subjekte zgjedhore, ato nuk kishin të drejtë të kenë përfaqësuesit e tyre në komisionet e administrimit të zgjedhjeve[519].

Vendimi i KQZ-së për rrëzimin e kërkesës së PD dhe LSI për të propozuar komisionerë, ishte një vendimmarrje me një qasje të njëanshme dhe e paplotë në trajtimin ligjor, sipas gërmës dhe frymës së Kodit Zgjedhor për ndërtimin e komisioneve administruese zgjedhore të balancuara politikisht, sipas konfiguracionit politik parlamentar.

U vërejt se KQZ-ja e lexoi Kodin Zgjedhor në dy standarde. Ky lexim i Kodit Zgjedhor, ndonëse mund të gjej logjikë ligjore në ambiguitetin që mbart Kodi Zgjedhor, hapi mundësinë e përfshirjes së partisë Bindja Demokratike në propozimin e anëtarësisë së administratës zgjedhore. Duke vendosur kriterin e të qenit subjekt zgjedhor si i domosdoshëm për të propozuar anëtarësinë e administratës zgjedhore, ishte subjekti politik në fjalë që gëzonte këtë të drejtë. Për më shumë shih seksionin V.2.1.1. Refuzimi i listave të PD dhe LSI për anëtarë dhe sekretarë të KZAZ-ve.

Ky vendim u ankimua në Kolegjin Zgjedhor[520]. Kolegji Zgjedhor nuk u shpreh për themelin e çështjes, duke qenë se i konsideroi palët paditëse sërish në mungesë legjitimiteti[521].

XIII.1.2. Kërkesa e Partisë së Unitetit Kombëtar për çregjistrimin nga zgjedhjet

Në datën 13 qershor 2019, Partia e Uniteti Kombëtar paraqiti në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t'u çregjistruar si subjekt zgjedhor dhe heqjen e emrit të partisë nga fletët e votimit.

Kërkesa ankimore vinte pasi partia ishte njohur me Dekretin nr. 11199 të datës 10 qershor të Presidentit, me anë të të cilit shfuqizohej Dekreti i 5 Nëntorit për caktimin e datës së zgjedhjeve në 30 qershor.

Ky ankimim nga subjekti në fjalë u rrëzua me argumentin ndër të tjera se kuadri ligjor nuk e parashikon të drejtën e subjektit zgjedhor për çregjistrim si dhe duke marrë parasysh pamundësinë teknike për riprintimin e fletëve të votimit.

Në mbledhjen e po së njëjtës ditë, pra më datë 13 qershor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve e futi në rendin e ditës, e shqyrtoi dhe mori vendim duke e rrëzuar kërkesën e subjektit zgjedhor me argumentin[522] se KQZ-ja e konsideronte Dekretin 11199 të Presidentit si një akt administrativ absolutisht të pavlefshëm, bazuar, ndër të tjera, edhe në Rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë, të aprovuar po më datë 13 qershor 2019.
Vendimi u ankimua[523] në Kolegjin Zgjedhor, i cili më datë 24 qershor 2019 e la në fuqi.

519 Vendimi nr. 657 datë 23.05.2019 *"...KQZ gjykon se Partia Demokratike e Shqipërisë dhe Partia Lëvizja Socialiste për Integrim duke mos u regjistruar në zgjedhjet e datës 30 qershor 2019 nuk përmbushin kriterin ligjor për të qenë subjekt zgjedhor në procesin zgjedhor të zgjedhjeve të datës 30 qershor 2019 dhe për pasojë nuk mund të propozojnë në këtë fazë të procesit zgjedhor anëtarë për KZAZ (e respektivisht edhe për KQV e GNV)".*

520 Objekti i padisë *"Kundërshtimi i vendimit të KQZ, nr. 657, datë 23.05.2019. Gjykimin e çështjes në themel duke vendosur pranimin e kërkesës për emërim të anëtarëve dhe sekretarëve të KZAZ-ve të propozuar nga Partia Demokratike e Shqipërisë dhe Lëvizja Socialiste për Integrim".*

521 Vendimi nr. 10 datë 06.06.2019 i Kolegjit Zgjedhor: *"... Kodi Zgjedhor i ka njohur të drejtën e ankimit kundër veprimtarisë së KQZ-së në Kolegjin Zgjedhor, vetëm subjekteve zgjedhore. Në kushtet e rrethanat konkrete, subjektet politike palë paditëse në gjykim, nuk gëzojnë legjitimitetin aktiv për të kundërshtuar veprimtarinë e palës së paditur, KQZ-së, duke u ankuar në Kolegjin Zgjedhor".*

522 Vendim nr. 836, datë 13.06.2019 i KQZ-së *"Për shqyrtimin e kërkesës të Partisë Uniteti Kombëtar për çregjistrimin nga zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019".*

523 Kolegji Zgjedhor, Gjykata e Apelit të Rrethit Gjyqësor Tiranë, Vendimi Nr. 13, datë 14/06/2019, Partia Uniteti Kombëtar kundër Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Përgjatë arsyetimit të kryer, trupa e Kolegjit Zgjedhor u shpreh se vendimmarrja e Presidentit të Republikës në ndryshim të datës së zgjedhjeve kishte qenë jashtë tagrave të tij ligjorë.[524] Një arsyetim ky i cili përbënte edhe qendrimin e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë e shprehur me Rezolutën e datës 13/06/2019.

Vendimmarrja e menjëhershme prej KQZ-së dhe Kuvendit të Shqipërisë, në nxitje të kërkesës prej një subjekti zgjedhor, konsiderohet se është një veprim zinxhir, në funksion të konfliktit politik dhe institucional të mazhorancës për të futur në betejën politike kartën e një vendimi gjykate (zgjedhore dhe apeli), sidomos në kushtet e mungesës së Gjykatës Kushtetuese, autoritetit të vetëm që mund të interpretojë dhe vendosë mbi kushtetueshmërinë dhe konfliktin midis institucioneve kushtetuese.
Kjo situatë bëhet edhe më e qartë duke patur parasysh se as KQZ-ja dhe as Kolegji Zgjedhor nuk kanë objekt të tyre marrjen në shqyrtim apo interpretimin e dekretit të një institucioni kushtetues siç është Presidenti i Republikës.

Nga ana tjetër, sikundër KRIIK ka bërë me dije nëpërmjet Deklaratës[525] së tij të datës 6 maj 2019, i ka sjellë KQZ-së në vëmendje procesin e Drejtësisë Zgjedhore, sidomos situatën dhe pozicionin ku ndodheshin gjyqtarët[526] e Kolegjit Zgjedhor, duke i kërkuar për rrjedhojë, që si një organ kolegjial, është e domosdoshme që institucioni i KQZ-së të marrë rol proaktiv në sigurimin e integritetit të të gjitha aspekteve të procesit zgjedhor, me një qasje gardiane kryekëput institucionale dhe brenda ligjit[527].

XIII.2. Procesi i ankimimeve pas ditës së zgjedhjeve

XIII.2.1. Kërkesat ankimore nga Partia Bindja Demokratike për shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve në një numër bashkish

Pas përfundimit të procesit të votimit dhe numërimit, Partia Bindja Demokratike në datën 5 korrik 2019 paraqiti në KQZ 41 kërkesa ankimore me anë të të cilave kërkonte shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve në 41 bashki[528] të vendit të përfshira secila në një kërkesë të veçantë.

Të gjitha kërkesat ankimore ishin mbështetur në arsyetimin se, nga raportimet e

524 (...) "*Në vijim të këtij arsyetimi, Kolegji Zgjedhor çmon se Presidenti i Republikës, nëpërmjet anulimit të datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të 30 qershorit 2019, në mungesë të kompetencës ligjore dhe tej afateve të parashikuara nga Kodi Zgjedhor, ka marrë kompetencat e një organi tjetër, konkretisht ka marrë kompetencat e Kuvendit të Shqipërisë. Në kushtet kur është Kuvendi organi që ka parashikuar afatet dhe rregullat e përcaktimit të datës së zgjedhjeve përmes parashikimeve të Kodit Zgjedhor, çdo ndryshim i mundshëm i tyre, në mungesë të delegimit, duhet të bëhet vetëm nga ky organ, pra vetëm nga Kuvendi i Shqipërisë.*
Gjithashtu, Kolegji Zgjedhor çmon se anullimi i datës së zgjedhjeve në mungesë të kompetencës ligjore dhe në shkelje të afateve të parashikuara nga Kodi Zgjedhor bën që në fakt, shtetasve shqiptarë me të drejtë vote t'iu mohohet një e drejtë kushtetuese e parashikuar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë: e drejta për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur sipas nenit 45 të Kushtetutës."

525 Deklaratë datë 06.05.2019 e KRIIK: *"Ruajtja e paanësisë dhe integritetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, rëndësi jetike për funksionimin e shtetit demokratik e ligjor"*.

526 Po aty: *"... Për shkak të procesit të reformës në drejtësi, aktualisht Gjykata Kushtetuese nuk është funksionale. Ndërkohë të tetë gjyqtarët e Apelit, anëtarë të Kolegjit Zgjedhor janë futur në proces rivlerësimi prej Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Nga tetë anëtarët e Kolegjit Zgjedhor njëri është konfirmuar në detyrë dhe një tjetër është shkarkuar , ndërkohë që të dy vendimet janë apeluar në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit. Gjashtë anëtarët e tjerë janë tashmë në proces rivlerësimi. ...".*

527 Po aty: *"... sjellja dhe mirëfunksionimi i KQZ-së merr një rëndësi jetike. ... Anëtarët e trupës së KQZ-së duhet të respektojnë vetëm ligjin dhe t'i përmbahen plotësisht betimit të bërë para përfaqësuesve të popullit shqiptar në momentin e marrjes së detyrës. ...".*

528 Bashkia Sarandë, Bashkia Maliq, Bashkia Skrapar, Bashkia Gjirokastër, Bashkia Libohovë, Bashkia Himarë, Bashkia Lushnjë, Bashkia Divjakë, Bashkia Patos, Bashkia Kurbin, Bashkia Malësi e Madhe, Bashkia Berat, Bashkia Durrës, Bashkia Dibër, Bashkia Kolonjë, Bashkia Cërrik, Bashkia Tiranë, Bashkia Shijak, Bashkia Lezhë, Bashkia Bulqizë, Bashkia Kukës, Bashkia Shkodër, Bashkia Tropojë, Bashkia Klos, Bashkia Tepelenë, Bashkia Selenicë, Bashkia Mallakastër, Bashkia Gramsh, Bashkia Vlorë, Bashkia Këlcyrë, Bashkia Korçë, Bashkia Fier, Bashkia Përrenjas, Bashkia Librazhd, Bashkia Rrogozhinë, Bashkia Belsh, Bashkia Elbasan, Bashkia Vorë, Bashkia Krujë, Bashkia Kamëz, Bashkia Has.

vëzhguesve të saj, ishte konstatuar se pothuajse në të gjitha QV-të kishte mospërputhje të lartë midis numrit të personave të paraqitur për të votuar me numrin e fletëve të gjendura në kutitë përkatëse të votimit[529]. Subjekti ankimues përdori si argument për kërkesën indiciet nga vëzhguesit e vet gjatë procesit të numërimit[530].

KQZ-ja vendosi rrëzimin e të gjitha kërkesave ankimore të BD, me arsyetimin [531]se vëzhguesit e kësaj force politike nuk kanë paraqitur asnjë ankesë me shkrim pranë komisioneve zgjedhore, për të parashtruar konstatimet e tyre.

Asnjë prej vendimeve të arsyetuara në lidhje me këto kërkesa ankimore të këtij subjekti nuk është publikuar ende në faqen e internetit të KQZ-së.

Pavarësisht numrit të lartë të ankimimeve të depozituara në KQZ, të cilat përfshinin të gjitha bashkitë ku kishte kandiduar, BD ankimoi në Kolegj vendimet e KQZ-së në lidhje me kërkesat e saj ankimore vetëm për 5 bashki[532].
Edhe Kolegji Zgjedhor [533] la në fuqi vendimin e KQZ-së, me arsyetimin[534] se padia është e pabazuar në ligj e prova.

Nga monitorimi i çështjeve të ankimuara dhe ecurisë së tyre, shprehet konsiderata paraprake për mungesën e njohurive, dispozitave të ligjit, mekanizmit të procesit administrativ si dhe atij të ankimimit.

Paraqitja formale thuajse me të njëjtën përmbajtje në herën e parë të depozitimit të ankimimeve në KQZ, problematikat në përmbajtje, depozitimi i një ankimimi për një bashki vendimi për të cilën nuk ishte marrë ende, deklarimi i prezencës në qendrat e votimit dhe vendet e numërimit të votave të vëzhguesve të BD-së, por të paakredituar si të tillë e për rrjedhojë pamundësia për të depozituar zyrtarisht vërejtjet për shkeljet e konstatuara, e të tjerë elementë tregojnë se qartazi nuk ky subjekt nuk kishte asnjë provë për të nisur një proces të suksesshëm ankimimi. Ngrihen pikëpyetje për arsyet e vërteta të investimit të KQZ-së dhe Kolegjit Zgjedhor në këtë proces ankimimi, i cili duket se vetëm formën kishte të tillë.

XIII.2.2. Rinumërimi i votave për 11 QV të Bashkisë Lezhë

Partia Konservatore Kombëtare Albania depozitoi në KQZ kërkesën ankimore nr. 58 datë 4 Korrik 2019, me objekt "Shpallja e pavlefshme e zgjedhjeve në disa QV[535] në Zonën Zgjedhore Bashkia Lezhë".

529 Bindja Demokratike: *"...vëzhguesit tanë kanë krijuar bindjen së gjatë procesit të votimit zgjedhësve të ndryshëm u është dhënë më shumë se një fletë votimi për të votuar dhe këta zgjedhës vetë ose anëtarë të Komisionit të Qendrës së Votimit kanë firmosur fiktivisht në listën e zgjedhësve, me qëllim rritjen fiktive të pjesëmarrjes në zgjedhje dhe manipulimin e rezultatit të zgjedhjeve në favor të Partisë Socialiste dhe aleatëve të saj, të cilët kishin të gjithë anëtarët e komisioneve të Qendrave të Votimit në këtë zonë zgjedhore. Me përfundimin e procesit të votimit vëzhguesve tanë u është kërkuar të dalin jashtë qendrës së votimit. Ne kemi indicie të forta, që vijnë nga numërimi i votuesve gjatë ditës së votimit, se Komisionerët e QV-ve kanë shtuar vota në kutitë e votimit dhe kanë firmosur në listën e zgjedhësve, me qëllim rritjen e pjesëmarrjes dhe ndryshimit të rezultatit të zgjedhjeve në atë QV. Gjetjet e vëzhguesve tanë për shtimin e votave në kuti gjatë procesit të numërimit dhe ndryshimi i rezultateve nga grupet e numërimit, janë konstatuar vetëm me sy të lirë prej tyre".*

530 Gjatë parashtrimeve përpara Kolegjit Zgjedhor, përfaqësuesi i Bindjes Demokratike është shprehur se: *"Vëzhguesit tanë të paakredituar, të pozicionuar përballë të gjithë televizorëve të grupeve të numërimit në këtë Zonë Zgjedhore gjatë procesit të numërimit, kanë konstatuar se pothuaj në çdo kuti të numëruar prej grupeve të numërimit, ka një mospërputhshmëri të lartë midis votave reale të marra nga kandidatët tanë, në krahasim me rezultatin e shënuar në tabelat e numërimit të votave për këto qendra votimi nga ana e numëruesve, të cilët edhe në këtë rast kanë qenë te gjithë përfaqësues të PS, madje edhe në ato raste kur ndonjëri prej tyre është shënuar si i propozuar nga shoqëria civile".*

531 Sipas Nenit 7 të Kodit Zgjedhor vëzhguesit kanë të drejtë të paraqesin vërejtje me shkrim para komisioneve të zgjedhjeve për çdo lloj parregullsie që vërejnë. Nga hetimi i dokumentacionit zgjedhor nga vëzhguesit e palës ankuese nuk është administruar asnjë vërejtje me shkrim gjatë procesit të numërimit të votave.

532 Bashkia Shijak, Bashkia Kurbin, Bashkia Tiranë, Bashkia Selenicë, Bashkia Berat.

533 Vendimet nr. 13, nr.14, nr. 15, nr. 16 dhe nr. 17, datë 22.07.2019 të Kolegjit Zgjedhor.

534 *"... Kolegji Zgjedhor nuk konstaton elemente të pavlefshmërisë apo paligjshmërisë në veprimtarinë e kundërshtuar të palës së paditur, KQZ-së, e në kushtet kur konstatohet se padia është e pabazuar në ligj e prova, ky Kolegj vlerëson të disponojë rrëzimin e padisë".*

535 QV nr. 0686, QV nr. 0791, QV nr.07141, QV nr. 07142, QV nr. 07171, QV nr. 07294, QV nr. 0740, QV nr. 07403,

Kërkesa ankimore citonte se në qendrat e votimit për të cilat kërkohej shpallja e pavlefshmërisë së rezultatit kishte mospërputhje mes numrit të zgjedhësve që kanë votuar dhe fletëve të votimit të gjetura në kuti gjatë procesit të numërimit[536].

Mbështetur në arsyetimin se kjo është një kërkesë ankimore e mbështetur në prova të besueshme dhe në faktin se transparenca është e një rëndësie të veçantë në besueshmërinë e procesit, dy anëtarë[537] të KQZ-së kërkuan hapjen e kutive në fjalë dhe rinumërimin e votave në KQZ[538].

Nga shqyrtimi administrativ i provave dhe i fakteve nuk rezultoi të kishte asnjë lloj shkelje të tillë në masën që të shpallen të pavlefshme zgjedhjet në qendrat e votimit të sipërcituara. Për rrjedhim KQZ-ja nuk konstatoi shkelje të ligjit, çka solli rrëzimin e padisë[539].

Ajo çka përbën nonsens ligjor në këtë rast, ishte fakti që kërkohej rinumërimi në disa QV ku nuk përputheshin të dhënat e pasqyruara në Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit të miratuar nga KQZ-ja, me pretendimin se kishte më shumë vota në kuti se sa votues.

Ndërkohë ajo që do të mund të hidhte më shumë dritë mbi jëtë situatë do të ishte këqyrja e listave të votuesve, kërkesë e cila nuk u parashtrua nga pala paditëse.

PKKA ankimoi vendimin e KQZ-së në Kolegjin Zgjedhor duke kërkuar tashmë edhe hapjen e kutive të materialeve zgjedhore[540], por në përfundim Kolegji Zgjedhor vendosi rrëzimin e padisë[541].

Në një situatë të ngjashme, shprehet konsiderata për mos përcaktimin e saktë të

QV nr. 0727, QV nr.0770 dhe QV nr. 0705.

536 Ankuesi pretendon se në shumë qendra votimi nga procesverbalet përkatëse kanë rezultuar më shumë vota të gjendura në kutitë e votimit se sa numri i zgjedhësve që kanë marrë pjesë. Kjo shkelje sipas ankuesit përbën shkelje të rëndë të ligjit që ka cenuar në mënyrë të pariparueshme procesin zgjedhor duke bërë shkak për shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve në këta qendra votimi. Sipas ankuesit në QV e mëposhtme rezulton se :
QV 0686 kanë votuar 52 vetë, por fletë të gjetura në kuti janë 53; QV 07091 kanë votuar 127 vetë por fletë të gjetura në kuti janë 128; QV 07141 kanë votuar 162 vetë por fletë të gjetura në kuti janë 163; QV 07142 kanë votuar 164 vetë por fletë të gjetura në kuti janë 166; QV 07171 kanë votuar 141vetë por fletë të gjetura në kuti janë 142; QV 07294 kanë votuar 215 vetë por fletë të gjetura në kuti janë 216; QV 0740 kanë votuar 203 vetë por fletë të gjetura në kuti janë 223; QV 07403 kanë votuar 148 vetë por fletë të gjetura në kuti janë 149; QV 0727 kanë votuar 138 vetë por fletë të gjetura në kuti janë 139; QV 0770 kanë votuar 70 vetë por fletë të gjetura në kuti janë 69; QV 0705 kanë votuar 67 vetë por fletë të gjetura në kuti janë 68.

537 Z. Bledar Skënderi dhe znj. Edlira Jorgaqi.

538 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve arsyetoi se transparenca në lidhje me numërimin dhe vlerësimin e votave për zonën zgjedhore qarku Lezhë ka një rëndësi të madhe për besueshmërinë e procesit zgjedhor dhe për integritetin e tij. Për sa koha ankuesit kanë dyshim se në disa qendra votimi objekt ankimi, vota nuk është vlerësuar saktë, referuar faktit të mosrakordimit të rezultatit për një qendër votimi, nevoja për transparencë të procesit të numërimit për këto Qendra Votimi, bindi dy anëtarë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të kërkojnë marrjen e provave për të vërtetuar faktet e paraqitura nga ankuesit nëpërmjet rinumërimit dhe rivlerësimit të votave në kutitë e votimit të qendrave të votimit sipas parashtrimeve të ankuesve.

539 Vendimi nr. 1088 datë 12.07.2019 i KQZ-së *"Për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 58 të Partisë Kombëtare Konservatore Albania, me objekt "Shpalljen e pavlefshme te zgjedhjeve në QV nr. 0686, QV nr. 0791, QV, 07141, QV nr. 07142, QV nr. 07171, QV nr. 07294, QV nr. 0740, QV nr. 07403, QV nr. 0727, QV nr. 0770, QV nr. 0705" për Kryetar të Bashkisë Lezhë"* i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

540 Deklarimi i PKKA *"...Vetëm nga rinumërimi i disa kutive, pa u futur tek listat e zgjedhësve, të cilat do të tregonin pjesëmarrjen e qartë dhe reale në votime, tregoi parregullsi, dhe në këto kushte hapja e gjithë kutive dhe materialeve zgjedhore rinumërimi dhe një hetim i plotë i listave të zgjedhësve, do të tregonte nëse ndodhemi para një procesi te rregullt zgjedhor apo para një farse. Ky hetim i thelluar do ti shërbente për të bërë transparencë jo vetëm ankuesit por gjithë publikut. Pra në kushtet e një rëndësie të thellë për transparencë, kërkojmë hetim dhe rinumërim të të gjitha QV-ve".*

541 Vendimi nr. 39 datë 25.07.2019 i Kolegjit Zgjedhor: *"... Kolegji Zgjedhor vlerëson se pala paditëse nuk solli para gjykatës prova që mund të provonin pretendimet e saj, në lidhje ekzistencën e kushteve të pavlefshmërisë së zgjedhjeve sipas përcaktimeve të nenit 161 të Kodit Zgjedhor. Në këto kushte, kërkesë padia ngelet e pa provuar si dhe e pa bazuar në kërkesat ligjore të nenit 161 të Kodit Zgjedhor, e si e tillë ajo duhet rrëzuar".*

objektit të ankimimit, duke dhënë mundësinë anëtarëve të trupës të tregohen të gatshëm për të shfrytëzuar një dispozitë në emër të rritjes së transparencës së procesit, standard mës e i kërkuar dhe inkurajuar të ndiqet nga antarët e truioës në tërë sferën e veprimtarisë së tyre dhe institucinit që drejtojnë. Ndërkohë përsa i përket dispozitës ku u bazuan dy anëtarët, mund të thuhet se mbetet një nga dispozitat më të debatueshme e që ka vuajtur në zbatueshmëri, për hir të sensivitetit të lartë politik e të drejtëpërdremtë me "një lloj auditimi" të procesit zgjedhor.

XIII.2.3. Shpërndarja e mandateve nga Kolegji Zgjedhor

Për shpërndarjen e mandateve për anëtarët e Këshillave Bashkiakë, Kodi Zgjedhor parashikon miratimin e tyre me shumicë të cilësuar prej pesë votash *"pro"*.

KQZ-ja nuk arriti dot këtë shumicë, pasi Kryetari i KQZ-së, në linjë me qendrimin e shprehur publikisht prej tij, votoi kundër.

Partia Socialiste e Shqipërisë iu drejtua Kolegjit Zgjedhor, me 61 kërkesë padi me objekt "Kundërshtim ndaj mosmarrjes vendim brenda afatit ligjor nga KQZ, për shpërndarjen e mandateve të këshillit bashkiak përkatës. Gjykimin e çështjes në themel dhe shpërndarjen e mandateve të kësaj bashkie".

Në seancat e zhvilluara nga data 22 deri në 26 korrik 2019, Kolegji Zgjedhor mori përsipër dhe realizoi shpërndarjen e mandateve sipas dispozitave ligjore të nenit 163 pika 5, dhe të nenit 166 pika 3 të Kodit Zgjedhor, ku përcaktohen mandatet nominale për çdo parti politike mbi bazën e renditjes në listat shumë-emërore të rezultatit të votimit të miratuara nga KZAZ-ja përkatëse.

Shpërbarja e mandateve prej Kolegjit Zgjedhor ka ndodhur edhe më parë gjatë procesit të zgjedhjeve parlamentare, ku atëherë u gjet artifica duke marrë vendim "për të mos marrë vendim", gjë e cila nuk u pa e nevojshme të përdorej në këtë rast, pasi Kolegji Zgjedhor e mori përsipër shpërndarjen e tyre.

XIV. VËZHGUESIT

Kodi Zgjedhor u njeh të drejtën për të caktuar vëzhgues partive politike/koalicioneve të regjistruara si subjekte zgjedhore si dhe kandidatëve të mbështetur nga zgjedhësit, si dhe organizatave vendase apo të huaja. Ligji u njeh të drejtën vëzhguesve të vëzhgojnë pa pengesë të gjitha aspektet e përgatitjes dhe zhvillimit të zgjedhjeve dhe të gjitha fazat e procesit zgjedhor.

Vëzhguesit politikë akreditohen pranë Komisioneve Zonale të Administrimit Zgjedhor, ndërkohë që vëzhguesit e organizatave jofitimprurëse, medias si dhe organizatave të huaja akreditohen nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, sipas disa afateve dhe procedurave të mirëpërcaktuara në Kodin Zgjedhor.

Në Zgjedhjet Vendore të 30 Qershorit 2019 u akredituan gjithsej 2091 vëzhguesve jo partiakë, prej të cilëve 853 ishin vëzhgues të organizatave jofitimprurëse vendase, 783 gazetarë vendas, 271 vëzhgues të organizmave të huaja, 35 gazetarë të huaj si dhe 149 përkthyes[542].
Radikalizimi i situatës politike dhe zhvillimi i njëanshëm i procesit zgjedhor ndikoi

542 Për më shumë shih Shtojca nr. 14 - Vëzhgues dhe përfaqësues te mediave të akredituar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

ndjeshëm në prezencën e vëzhguesve vendas apo edhe të huaj duke shënuar numrin më të ulët të tyre në katër proceset e fundit zgjedhore të zhvilluara[543]. Madje pjesëmarrja apo jo e vëzhguesve në proces dhe numri faktik i vëzhguesve të akredituar u bë pjesë e diskutimeve dhe përplasjeve politike mbi vlefshmërinë apo jo të procesit të 30 qershorit.

Kongresi i Autoriteteve Rajonale dhe Lokale, një institucion i Këshillit të Europës përgjegjës për forcimin e demokracisë rajonale dhe lokale në vendet anëtare të Këshillit të Europës, njoftoi në datën 26 qershor 2019 se kishte anuluar dërgimin e misionit të vëzhguesve të tij për zgjedhjet vendore[544].

Arsyet e cituara në një deklaratë të Presidentit të Kongresit, z. Anders Knape, për anulimin e misionit të vëzhgimit ishin pasiguria në lidhje me pjesëmarrjen e spektrit të plotë politik të kandidatëve dhe partive në zgjedhjet lokale të 30 qershorit. Në deklaratë theksohej se, duke qenë se në 31 nga 61 bashkitë e vendit kishte vetëm një kandidat, ishte e vështirë të pritej një konkurrencë politike kuptimplotë. Gjithashtu theksohej se Kongresi nuk kishte vëzhguar kurrë më parë zgjedhje pa një pjesëmarrje kuptimplotë të opozitës, si dhe përmendeshin sfida logjistike dhe sigurie[545].

Anulimi i Misionit të Kongresit të Autoriteteve Lokale dhe Rajonale u bë objekt diskutimesh dhe spekulimesh si nga opozita, ashtu edhe nga maxhoranca lidhur me domethënien e tërheqjes së një organizmi ndërkombëtar[546], diku duke aluduar se tërheqja e vëzhguesve mund të ishte e ndikuar nga Rusia[547], e diku tjetër se tërheqja e vëzhguesve nuk ishte e vërtetë dhe se ata do t'a vëzhgonin procesin[548].

Për herë të parë në proceset zgjedhore të zhvilluara pas miratimit në vitin 2008 të Kodit Zgjedhor aktualisht në fuqi, u evidentua një proces problematik në akreditimin e vëzhguesve prej Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Problematikë që konsistoi në shkeljen haptazi të afateve ligjore të parashikuara, akreditim të bazuar në dokumentacion të parregullt si dhe në zbardhje të vendimmarrjes në mënyrë të kundërt me atë të marrë në mbledhje.

Kodi Zgjedhor, në nenin 6 pika 5 të tij, parashikon që vëzhguesit vendas mund të bëjnë kërkesë për akreditim në KQZ jo më vonë se 15 ditë para datës së zgjedhjeve ndërsa ata të huaj jo më vonë se 72 orë para datës së zgjedhjeve.

Një pjesë e konsiderueshme e mediave shqiptare[549], i paraqitën kërkesat për akreditim të gazetarëve dhe stafeve të tyre jashtë afatit ligjor, megjithëse zëdhënësi i KQZ-së në një njoftim të posaçëm për ta[550], iu bënte me dije se afati i fundit për paraqitjen e kërkesave për akreditim ishte data 14 qershor 2019.

Përpos mediave, edhe dy organizata të shoqërisë civile "Qendra për Zhvillim dhe Mbrojtjen e Medias së Re" dhe "Shoqata për Integrimin e Zonave Informale" e

543 Zgjedhjet Parlamentare të vitit 2017 u vëzhguan nga 5335 vëzhgues; Zgjedhjet Vendore të vitit 2015 u vëzhguan nga 5185 vëzhgues, ndërsa Zgjedhjet Parlamentare të vitit 2013 u vëzhguan nga 9174 vëzhgues.

544 Vëzhguesit e Kongresit të Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Europës u akredituan me Vendimin nr. 844, datë 21.06.2019 *"Për miratimin e vëzhguesve afatshkurtër dhe përkthyesve të Kongresit të Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019"* të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

545 Deklarata e Presidentit të Kongresit, z. Anders Knape u la në faqen e internetit të institucionit vetëm për pak kohë, dhe më pas u hoq.

546 Agjencia Telegrafike Shqiptare, Balla: Ekskluzivitetin për monitorimin e zgjedhjeve në Shqipëri e ka OSBE/ODIHR, 26 qershor 2019.

547 Zv. Ministri i Mbrojtjes, z. Petro Koçi postoi në faqen personale në Facebook, pak pasi lajmi ishte bërë publik një status "Këshilli i Evropës një organizate ne te cilën sapo eshte kthyer Rusia". Postimi u fshi brenda pak orësh nga zv. Ministri.

548 Top Channel citon z. Erion Veliaj, Kryetarin e Bashkisë Tiranë. Veliaj: Vëzhguesit e KiE do vijnë për 30 qershorin, i informova se shqiptarët nuk janë të dhunshëm, 26 qershor 2019.

549 TV Klan, Ora News, A2 CNN, RTSh, News 24, BBF Televizion, Gazeta Panorama, Bold News, TV ONE Vlora, etj.

550 Njoftim i shpërndarë nëpërmjet emailit më datën 5 qershor 2019.

paraqitën kërkesën për akreditim të vëzhguesve jashtë afatit ligjor.

Lidhur me akreditimin e vëzhguesve të organizatës "Qendra për Zhvillim dhe Mbrojtjen e Medias së Re", referuar materialeve paraprake të mbledhjes dhe vendimit të KQZ-së[551], rezultoi se kërkesa e paraqitur nga kjo organizatë nuk i plotësonte kriteret ligjore[552], pasi ishte paraqitur jashtë afatit ligjor si dhe i mungonte vërtetimi i regjistrimit në gjykatë. Për këto arsye, gjatë mbledhjes së datës 21 qershor 2019, trupa e KQZ me votim unanim vendosi refuzimin[553] e kësaj kërkese. Por, ky vendim refuzimi u pasqyrua si i miratuar në njoftimin e mbledhjes të shpërndarë për mediat si dhe në vendimin e publikuar në faqen zyrtare të internetit të KQZ-së.

Ndërsa lidhur me akreditimin e vëzhguesve të organizatës "Shoqata për Integrimin e Zonave Informale", kërkesa e paraqitur prej saj në KQZ mban datën 24 qershor 2019, duke qenë jashtë afatit ligjor të përcaktuar në Kodin Zgjedhor. Nga ana tjetër, referuar materialeve paraprake të mbledhjes, kërkesa është bashkëshoqëruar me kopje të vendimit të gjykatës[554] dhe jo me vërtetim të regjistrimit në gjykatë, i cili ka për qëllim të evidentojë gjendjen e përditësuar të organizatës si subjekt juridik, sikurse përcaktohet në udhëzimin e KQZ-së[555]. Pavarësisht se kërkesa nuk i plotësonte dy kriteret ligjore të sipërpërmendura, KQZ-ja në vendimin e marrë[556] arsyetonte se "... nga shqyrtimi i dokumentacionit, KQZ vëren se ai është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 4 të Udhëzimit nr.13 datë 22.04.2009".

Përsa iu përket akreditimit të vëzhguesve të subjekteve zgjedhore pranë Komisioneve Zonale të Administrimit Zgjedhor (KZAZ), Qendrave të Votimit (QV) dhe Vendeve të Numërimit të Votave (VNV), bazuar në vëzhgimin e bërë nga vëzhguesit afatgjatë të KRIIK si dhe në kopjen e vendimmarrjeve të KZAZ-ve të depozituar pranë KQZ-së, rezulton se në asnjë rast nuk është marrë një vendim formal prej KZAZ-ve. Është e paqartë se si KZAZ-të kanë dokumentuar dhe vepruar në zbatimin e procedurave të parashikuara ligjore për zëvendësimin e vëzhguesve, numrin e lejuar të tyre për një subjekt zgjedhor pranë VNV-ve, etj.

U evidentua se gjatë këtij procesi zgjedhor, ndryshe nga proceset e mëparshme zgjedhore, nuk u vërejtën situata ku prezenca e lartë e vëzhguesve partiakë të bëhej problematike.

Edhe gjatë këtij procesi zgjedhor, sikundër edhe në proceset e tjera të mëparshme, e drejta e vëzhguesve për të vëzhguar pa pengesë të gjitha aspektet e përgatitjes dhe zhvillimit të zgjedhjeve dhe të gjitha fazat e procesit zgjedhor, u cenua. Kjo u vërejt kryesisht në moslejimin e vëzhguesve gjatë procesit të marrjes në dorëzim prej KZAZ-ve të materialeve të Qendrave të Votimit, pas mbylljes së procesit të votimit. Gjithashtu theksohet se vazhdon të mbetet problematike transparenca dhe mosvënia në dispozicion të vëzhguesve e vendimmarrjes së Komisioneve Zonale të Administrimit Zgjedhor, sikundër detyrohet nga neni 34 i Kodit Zgjedhor dhe udhëzimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

551 Vendimi 845, datë 21.06.2019 *"Për shqyrtimin e kërkesës të Qendrës për Zhvillim dhe Mbrojtjen e Medias së Re në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019"* i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

552 "...Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vëren se ai është jashtë afatit të përcaktuar në nenin 6 të Kodit Zgjedhor dhe është jo i plotë pasi mungon vërtetimi i regjistrimit në gjykatë në bazë të të cilit verifikohet dhe objekti i veprimtarisë së organizatës".

553 Minuta xx.xx e rregjistrimit video të mbledhjes së KQZ-së së datës 21.06.2019 ora yy.yy.

554 Vendimi i paraqitur i gjykatës nga organizata "Shoqata për Integrimin e Zonave Informale" mban nr. 2170/3 dhe është i datës 19.11.2019, pra xx muaj më parë, duke mos paraqitur gjendjen juridike të përditësuar të saj.

555 Udhëzim nr. 13 datë 22.04.2009 i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, "*Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja dhe mediave*".

556 Vendimi nr. 860, datë 25.06.2019 *"Për miratimin e vëzhguesve afatshkurtër të Shoqatës për Integrimin e Zonave Informale për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019"* i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

XV. PJESËMARJA E GRAVE, PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA DHE MINORITETEVE

XV.1. Pjesëmarja e grave

Pjesëmarrja e grave në përgatitjen e proceseve zgjedhore, në zhvillimin e fushatave zgjedhore dhe në përfaqësimin politik, vazhdon të mbetet sfidë në shoqërinë shqiptare. Vihet re një rritje e numrit të pjesëmarrjes së grave, por që mbetet një rritje numerike, që nuk përkon me njëvlefshmërinë e fuqizimit politik.

Trupa e Komisioni Qendror të Zgjedhjeve përbëhet aktualisht nga pesë anëtarë, dy prej të cilave janë gra. Në trupën e Kolegjit Zgjedhor është aktualisht vetëm një grua, nga tetë anëtarë të kësaj trupe. Ndërkohë 35% e anëtarëve të komisioneve të nivelit të dytë ishin gra (126 nga 360). Në Komisionet e Qendrave të Votimit 22% ishin gra, dhe në Grupet e Numërimit të Votave 17 % ishin gra.

Nga totali prej 97 kandidatësh për kryetarë të bashkive vetëm 11 ishin gra (11.3%), nga të cilat 8 rezultuan fituese. Nga totali prej 9872 kandidatësh për anëtar/e në këshillat bashkiake 4839 ishin gra (49,02%), ku 711 rezultuan fituese (43,9 %).

Kodi Zgjedhor[557], përcakton detyrimin ligjor për përfaqësimin gjinor në listat e kandidatëve për këshillat bashkiake, sipas të cilit një në çdo dy emra në listë duhet të jetë grua. Sërish u vu re një mungesë vullneti dhe serioziteti nga ana e partive politike lidhur me respektimin e këtij detyrimi ligjor. Nga vëzhgimi i bërë një pjese të listave të kandidatëve për anëtarë të këshillave bashkiakë të depozituar në KQZ për efekt të kontrollit në kuadër të ligjit të dekriminalizimit, u vu re se në disa raste nuk respektohej renditja sipas kriterit gjinor. Për shkak të pamundësisë për të ndjekur vendimmarrjen e plotë prej Komisioneve Zonale të Administrimit Zgjedhor (KZAZ), nuk është e qartë nëse u ndoq procedura e parashikuar ligjore nëpërmjet vendimmarrjes së KZAZ-ve për prapësimin dhe korrigjimin e tyre, e më pas për regjistrimin e tyre.

Ndërkohë ky fenomen u vërejt edhe në bashkitë më të mëdha me më shumë se një ZAZ, ku regjistrimi i listave të kandidatëve për anëtarë të këshillave bashkiakë bëhet në KQZ. Me arsyetimin e mospërmbushjes së kriterit të përfaqësimit gjinor të parashikuar në ligj, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ktheu për plotësim katër lista[558] kandidatësh për anëtarë të Këshillave Bashkiakë të paraqitura nga 3 subjekte zgjedhore dhe pas korrigjimit të tyre i miratoi më pas ato.

Përsa i përket pjesëmarrjes në votime, rezultoi se 55.4% e zgjedhësve që votuan në datë 30 qershor ishin burra dhe 44.6% ishin gra. Ndërkohë, përqindja e grave që kanë votuar referuar numrit total të grave në listat e zgjedhësve është më e ulët se ajo e burrave. Konkretisht në Zgjedhjet e 30 qershorit votuan 25.1% e burrave të përfshirë në lista dhe vetëm 20.7% e grave të përfshira në lista[559].

557 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 67 "*Lista e kandidatëve të partive dhe koalicioneve të partive*" pika 6 *"...Për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, për çdo këshill bashkie, një në çdo dy emra të njëpasnjëshëm në renditje duhet t'i përkasë së njëjtës gjini. Subjekti paraqitës i listës deklaron vendet, sipas kuotës gjinore, me qëllim zbatimin e përjashtimit, sipas paragrafit të dytë, të pikës 2, të nenit 164, të këtij Kodi."*

558 Lista me kandidatë e Partisë Fryma e Re Demokratike për Këshillin e Bashkisë Kamëz (vendimi nr. 496 datë 17.05.2019 dhe vendimi nr. 634 datë 22.05.2019); Lista me kandidatë e Partisë Aleanca Demokristiane për Këshillin e Bashkisë Vlorë dhe Lezhë (vendimi nr. 432 datë 16.05.2019, vendimi nr. 436 datë 16.05.2019 dhe vendimi nr. 626 datë 22.05.2019); Lista me kandidatë e Partisë Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet për Këshillin e Bashkisë Lezhë (vendimi nr. 505 datë 17.05.2019 dhe vendimi nr. 624 datë 22.05.2019).

559 Përllogaritjet bazohen në Tabelën Përmbledhëse të publikuar nga KQZ-ja. Duke qenë se në këtë tabelë mungojnë të dhënat mbi komponentin gjinor për 383 qendra votimi, kjo shifër bazohet në informacionin e dhënë

XV.2. Personat me afësi të kufizuara

Sigurimi i kushteve të nevojshme për ushtrimin lirisht dhe pa pengesa të së drejtës së votës prej individëve me aftësi të kufizuara ka qenë dhe mbetet një sfidë e vazhdueshme në proceset zgjedhore.

Sipas statistikave nga Shërbimi Social Shtetëror (SHSSH) deri në muajin Qershor 2019, numri i personave që janë njohur zyrtarisht të kenë një aftësi të kufizuar në Shqipëri është 71.096 persona[560], pra rreth 2 % e totalit të votuesve të përfshirë në listën përfundimtare të zgjedhësve. Megjithëse të dhënat figurojnë pranë çdo bashkie, evidentohet një koordinimin jo i mirë i strukturave shtetërore për të siguruar paraprakisht një informacion të plotë dhe më pas edhe kushtet e nevojshme pranë çdo qendre votimi, në territorin e së cilës janë të regjistruar shtetas me aftësi të kufizuara, në mënyrë që të lehtësohet votimi prej tyre.

Megjithëse sipas informacioneve të marra janë vënë në dispozicion rampa për të lehtësuar lëvizjen e personave me aftësi të kufizuara fizike, si dhe maska *braille* në çdo qendër votimi për të lehtësuar votimin e personave të verbër, sërish u evidentuan problematika në këtë drejtim.

Duke qenë se KRIIK nuk angazhoi vëzhgues gjatë ditës së votimit, u vu në kontakt me disa nga organizatat përfaqësuese të këtij komuniteti. Sipas Forumit Rinor të të Verbërve të Shqipërisë në mjaft QV u evidentua mungesa e shablloneve ose e informacionit që komisionerët duhet të kishin mbi arsyen e përdorimit të tyre, e rrjedhimisht mos vënia e tyre në dispozicion personave të verbër. Shabllonet e përdorura këtë radhë ishin lehtësisht të shenjueshëm në anët e kuadratit duke cenuar fshehtësinë e votës. Ndërkohë në këto zgjedhje u evidentuan edhe ambiente të QV-ve me ndriçim të ulët, të cilat e vështirësuan votimin e personave me shikim të pjesshëm. Gjithashtu, po sipas përfaqësuesve të kësaj shoqate, spoti i prodhuar nga KQZ-ja nuk ka qenë ndihmues për këtë komunitet, pasi përmbajtja e tij kishte më shumë figura se sa informacione me zë.

KQZ në bashkëpunim me Bashkitë, duhet të përpunojë akte nënligjore të cilat garantojnë aksesueshmërinë e personave më aftësi të kufizuara në qendrat e votimit përkatëse, në funksion të garantimit të të drejtës së votës për ta. Sugjerohet një databazë e përhershme e cila të mund të përditësohet dhe të kihet në konsideratë në vazhdimësi në përgatitjen e infrastrukturës zgjedhore të radhës.

KQZ duhet të vazhdojë dhe forcojë më tej traditën e bashkëpunimit me organizatat përfaqësuese të këtij komuniteti, duke nxitur pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të përfaqësuesve të tyre në procesin e trajnimit, hartimit të paketës sensibilizuese dhe metodologjisë së përdorur.

XV.3. Minoritetet

Prej nëntorit 2017 pakicat kombëtare në Shqipëri gëzojnë ushtrimin e lirive dhe të të drejtave specifike të tyre nëpërmjet një ligji të posaçëm[561]. Sipas kuptimit të këtij ligji, pakicat kombëtare në Republikën e Shqipërisë janë pakicat greke, maqedonase, arumune, rome, egjiptiane, malazeze, boshnjake, serbe dhe bullgare[562]. Ligji parashikon se në njësitë e vetëqeverisjes vendore ku personat,

prej 5033 qendrave të votimit.

560 Më konkretisht 12.422 të verbër, 6.660 para-tetraplegjikë, 52.014 invalidë mendor dhe fizik.

561 Ligji 96/2017 *"Për pakicat Kombëtare"*, miratuar më datë 13.10 2017 dhe publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 196 datë 09.11.2017.

562 Po aty, Neni 3 *"Përkufizime"*, pika 2.

që u përkasin pakicave kombëtare, përbëjnë mbi 20 % të numrit të përgjithshëm të popullsisë së kësaj njësie, ata kanë të drejtë të marrin informacion, krahas gjuhës shqipe, edhe në gjuhën e pakicës, mbi zhvillimin e procesit zgjedhor[563].

Për dhënien e këtyre informacioneve në gjuhën e pakicave ligji detyron KQZ-në që të nxjerrë akte rregulluese brenda gjashtë muajve[564] nga hyrja në fuqi e tij, pra brenda datës 24 maj 2018. Deri më sot ende KQZ-ja nuk ka miratuar asnjë akt rregullues në përmbushje të këtij detyrimi.

Megjithatë në përmbushje të detyrimit për informimin mbi zhvillimin e procesit zgjedhor të datës 30 qershor 2019, përmes materialeve informuese, edukuese dhe ndërgjegjësuese në gjuhët e pakicave kombëtare, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nënshkroi me datën 08.05.2019 një marrëveshje bashkëpunimi me Komitetin për Pakicat Kombëtare.

Në zbatim të kësaj marrëveshje dhe detyrimit ligjor KQZ-ja deklaroi se prodhoi materiale zgjedhore informuese në të nëntë gjuhët e pakicave kombëtare të njohura sipas ligjit të mësipërm. Këto materiale nuk gjenden në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, por sipas komunikimit me administratën e KQZ, këto materiale janë prodhuar në gjuhën e çdo pakice kombëtare dhe janë shpërndarë në secilën prej zonave ku këto komunitete banojnë më së shumti.

Sa i përket kandidatëve të pakicave kombëtare të kandiduara nga subjektet zgjedhore, nuk pati ndonjë vëmendje të veçantë për nxitjen dhe promovimin në publik të tyre dhe as të çështjeve me interes të posaçëm ndaj tyre.

Në këto zgjedhje u regjistruan dhe kandiduan dy parti të pakicave kombëtare, Partia Aleanca e Maqedonasve për Integrim Europian dhe Partia Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen, të cilat rezultuan respektivisht: e para me fitoren e 4 mandateve të këshilltarëve në Bashkinë Pustec dhe e dyta me fitoren e Kryetarit të Bashkisë dhe të 9 këshilltarëve bashkiakë në Finiq, 1 këshilltari bashkiak në Sarandë dhe të 3 këshilltarëve bashkiakë në Bashkinë Dropull.

XVI. SHPALLJA E REZULTATEVE DHE SHPËRNDARJA E MANDATEVE

XVI.1. Shpërndarja e mandateve për Kryetarët e Bashkive

Kuadri ligjor zgjedhor parashikon që për zgjedhjet vendore, trupa e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve miraton me shumicë të thjeshtë Tabelën Përmbledhëse të rezultateve zgjedhore[565] dhe më pas më shumicë të cilësuar merr vendim për shpërndarjen e mandateve të anëtarëve të këshillave bashkiakë të të gjitha bashkive, si dhe për kryetarët e bashkive, territori i të cilave shtrihet në më shumë se një ZAZ[566].

Ndërsa për bashkitë, territori i të cilave përputhet me mbulimin e një ZAZ-je, mandati i kryetarit të bashkisë jepet nga Komisionet Zonale të Administrimit të Zgjedhjeve (KZAZ)[567].

563 Po aty, Neni 15 *"Përdorimi i gjuhës"*, pika 4.

564 Po aty, Neni 23 *"Aktet nënligjore",* pika 2.

565 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 122.

566 11 bashki janë në këtë kategori.

567 50 bashki janë në këtë kategori.

Në fund të këtij procesi, sipas Ligjit "Për vetëqeverisjen vendore" parashikohet që mandati i Kryetarit të Bashkisë të vërtetohet nga gjykata e rrethit gjyqësor, në juridiksionin e së cilës përfshihet bashkia përkatëse[568].

Sipas këtij rregullimi të Ligjit "Për vetëqeverisjen vendore", deklarimi i vlefshmërisë ose pavlefshmërisë së mandatit të kryetarit të bashkisë bëhet kur vërehet se plotësohen ose jo kushtet e përcaktuara sipas nenit 45 të Kushtetutës dhe dispozitat përkatëse të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

Neni 45 i Kushtetutës, është pjesë e Kreut të titulluar "Liritë dhe të drejtat politike" dhe në të përcaktohen standardet që duhet të përmbushë një proces zgjedhor[569].

Në gjykimin e KRIIK, ky rregullim ligjor ngjan në dukje si një moment tejet procedural, por nga logjika e tërë mekanizmit, më së shumti, evidentohet se vullneti i ligjvënësit e ka përcaktuar këtë procedurë si një valvul garancie për integritetin e procesit zgjedhor, përsa parashtrohet në këtë nen të Kushtetutës dhe përsa garantohet nga përmbushja e dispozitave të Kodit Zgjedhor.

Pas depozitimit të kërkesave nga vetë kandidatët pranë Gjykatave të Rrethit Gjyqësor përkatës, për ligjshmërinë e mandatit të dhënë nga KQZ-ja apo KZAZ-ja, në përfundim të zgjedhjeve të datës 30 qershor 2019, mandatet e 61 Kryetarëve të Bashkive në vend u verifikuan nga 22 Gjykata Rrethi. Ky proces verifikimi dhe man datimi nisi në datën 11.07.2019 dhe përfundoi në datën 31.07.2019.

Në rezultante të këtij procesi, u vu re se Gjykatat e Rrethit u shprehën me tre lloje të ndryshme vendimesh, megjithëse të gjitha kërkesat kishin të njëjtin objekt. Konkretisht:

- Vendimi nr. 11-2011-4127, datë 17.07.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, vendosi rrëzimin e kërkesës së kërkueses Valbona Sako për vërtetimin e mandatit të Kryetarit të Bashkisë Durrës me argumentin[570] se partia Bindja Demokratike u regjistrua si pjesëmarrëse në procesin zgjedhor të 30 qershorit 2019, prej Komisionit Qendror të Zgjedhjeve jashtë afateve ligjore. Element ky, sipas Gjykatës, që i kthente disa vendime të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve[571] në akte administrative absolutisht të pavlefshme.

568 Ligji nr. 139/2015 datë 17.12.2015, "*Për vetëqeverisjen Vendore*", Neni 60 "*Mandati i kryetarit të bashkisë*", pika *"1. Mandati i kryetarit të bashkisë vërtetohet nga gjykata e rrethit gjyqësor, (dhoma civile) në juridiksionin e së cilës përfshihet bashkia përkatëse, brenda 20 ditëve nga data e shpalljes së rezultatit të zgjedhjes së tij."*

569 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 45, "1. Çdo shtetas që ka mbushur tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, ka të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet.
2. *Përjashtohen nga e drejta e zgjedhjes shtetasit e deklaruar me vendim gjyqësor të formës së prerë si të paaftë mendërisht.*
3. *Përjashtohen nga e drejta për t'u zgjedhur shtetasit që janë dënuar me burgim, me vendim përfundimtar të formës së prerë, për kryerjen e një krimi, sipas rregullave të përcaktuara me ligj të miratuar me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Në raste përjashtimore dhe të justifikuara, ligji mund të parashikojë kufizime të së drejtës për të zgjedhur të shtetasve që vuajnë dënimin me heqje lirie, ose të së drejtës për t'u zgjedhur para dhënies së një vendimi përfundimtar apo kur shtetasit janë dëbuar për një krim ose për cenim shumë të rëndë dhe serioz të sigurisë publike.*
4. *Vota është vetjake, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë.*"

570 Vendimi nr. 11-2011-4127 datë 17.07.2019, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës: "*Në momentin e paraqitjes së kërkesës "Partia Bindja Demokratike", nuk kishte fituar akoma personalitetin juridik, pasi në mbështetje të nenit 9/2 te ligjit "Për Partitë Politike", "Partia politike njihet si person juridik që nga data kur gjykata ta ketë miratuar dhe regjistruar atë". Gjithashtu Partia 'Bindja Demokratike", duke mos qene e regjistruar në Gjykatë, në momentin e paraqitjes së kërkesës për tu regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ, nuk kishte zotësi juridike për të fituar të drejta dhe për të marrë përsipër detyrime, sikurse është marrja pjesë në zgjedhjet e Organeve të Qeverisjes vendore të datës 30.06.2019. Partia Bindja Demokratike është regjistruar nga Kolegji Zgjedhor në shkelje të nenit 64 të Kodit Zgjedhor dhe të nenit 9 të ligjit "Për partitë politike".*

571 Vendimi nr. 230 datë 27.04.2019 i KQZ-së *"Për regjistrimin si subjekt zgjedhor, Partia "Bindja Demokratike" për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019"*; Vendimi nr. 660 datë 27.05.2019 i KQZ-së *"Për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatët për Kryetar Bashkia Durrës për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019"* dhe Vendimi nr. 944 datë 05.07.2019 i KQZ-së *"Për nxjerrjen e rezultatit të votimit për zgjedhjen e Këshillit të Bashkisë Fier, Qarku Fier, në zgjedhjet vendore të datës 30 qershor 2019"* të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Por, pavarësisht se në dispozitivin e këtij vendimi gjykate, citohej se kundër vendimit mund të bëhej ankimim pranë Gjykatës së Apelit Durrës, subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, vendosi të ri-depozitonte të njëjtën kërkesë, me të njëjtin objekt, sërish pranë Gjykatës së Rrethit Durrës.
Gjykata, këtë herë, nëpërmjet një gjykimi me një tjetër gjyqtar, për të njëjtën çështje, por tashmë me kërkues subjektin politik[572], vendosi verifikimin e mandatit të Kryetares së Bashkisë Durrës.

- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë nëpërmjet Vendimit të datës 15.07.2019, vendosi të shpallë moskompetencë lëndore për shqyrtimin e kërkesës së Kryetarit të Bashkisë Vorë për vërtetimin e mandatit si Kryetar i Bashkisë Vorë, i zgjedhur nga Koalicioni Aleanca për Shqipërinë Europiane.
Kjo gjykatë ia delegoi kompetencën Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Në vendim parashikohej se kundër tij mund të bëhej ankimim pranë Gjykatës së Lartë.
Pavarësisht kësaj situate, Partia Socialiste ndoqi sërish të njëjtën rrugë, sikurse me mandatin e Kryetares së Bashkisë Durrës, duke depozituar një kërkesë të re në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
Nga shqyrtimi i kërkesës së dytë me një tjetër gjyqtar u vendos verifikimi i mandatit të Kryetarit të Bashkisë Vorë.
- Vendimet e gjykatave të tjera të rrethit vendosën verifikimin e mandateve të kryetarëve të bashkive të zgjedhur në 30 qershor 2019.

XVI.2. Shpërndarja e mandateve për anëtarët e këshillave bashkiakë

Mandatet e këshillave bashkiakë, ndahen nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pas miratimit të Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve nga secili prej Komisioneve Zonale të Administrimit të Zgjedhjeve (KZAZ).
Procedurat e realizimit të këtij procesi, përcaktohen në nenet 162 dhe 163 të Kodit Zgjedhor, duke parashikuar një miratim me shumicë të cilësuar votimi me 5 vota "pro"[573].

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 27 korrik 2019 mori në shqyrtim projekt-vendimin për shpërndarjen e mandateve për çdo zonë zgjedhore për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore.

Për shkak të mos arritjes së kuorumit të anëtarësisë prej pesë anëtarësh të domosdoshëm për shumicën e cilësuar për miratimin e projekt-aktit[574], trupa e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nuk u shpreh procedurialisht.
Një situatë mungese kuorumi në shpalljen e rezultatit përfundimtar, të cilën në vitin 2013-të trupa e KQZ-së së asaj kohe e zgjidhi duke përdorur një artificë ligjore të kritikueshme.
Në atë proces zgjedhor, trupa e atëhershme e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve mori një vendim "për të mos marrë vendim", duke krijuar kështu mundësinë formale që të ishte Kolegji Zgjedhor që të merrte vendim për shpalljen e rezultatit përfundimtar. Një artificë dhe një praktikë që në këtë proces zgjedhor nuk u risoll, sepse vendimmarrja e Kolegjit Zgjedhor, në përgjigje të kërkesë-padive të Partisë Socialiste, mori përsipër shpërndarjen e mandateve[575] për Këshillat Bashkiakë.

572 Kjo artificë tjetër e gjetur është në kundërshtim me parimin e gjykimit të gjësë së gjykuar prej të njëjtës gjykatë, në kuptim të neneve 58 dhe 451/a të Kodit të Procedurës Civile.

573 Kodi Zgjedhor Neni 24 *"Vendimmarrja në KQZ"*, Pika 1, germa a: "*Konsiderohen të miratuara, kur votojnë "pro" jo më pak se 5 anëtarë të KQZ-së, vendimet lidhur me: a) shpërndarjen e mandateve për çdo zonë zgjedhore, sipas neneve 162, 163 dhe 166, pika 3 të këtij Kodi.*"

574 Kryetari i KQZ-së votoi kundër, në vijim të votimit kundër ndaj çdo vendimi të lidhur me procesin zgjedhor, qëndrim ky i bërë me dije prej tij qysh me shfuqizimin e datës së zgjedhjeve prej Presidentit të Republikës.

575 Partia Socialiste e Shqipërisë, depozitoi 61 kërkesë-padi, në Kolegjin Zgjedhor me objekt *"kundërshtim*

Pas kësaj vendimmarrje, morën mandatin 1.619 këshilltarë bashkiakë, dhe nisi konstituimi i Këshillave Bashkiake, i cili u realizua ndërmjet datave 26 korrik deri në 19 gusht 2019[576].
Në disa bashki, të cilat në mandatin e kaluar ishin drejtuar nga përfaqësues të Partisë Demokratike apo të Lëvizjes Socialiste për Integrim, ky proces u shoqërua me protesta.

Mekanizmat garantues për integritetin e procesit dhe si instrument për subjektet zgjedhore që ndërton kuadri ligjor, meritojnë të marrin një imunitet ligjor të shtuar dhe detajim procedural që të përballet me vullnetet burokratike antiligjore.

Me procesin e fundit të ndodhur*, mekanizmat garantues të integriteti zgjedhor sado të pakët që ofron kuadrin ligjor janë zhbërë tërësisht dhe janë afirmime jo realë që bën kuadri ligjor.*

ndaj mosmarrjes vendim nga KQZ-ja për shpërndarjen e mandateve për këshillat e bashkive, gjykimin e çështjes në themel dhe shpërndarjen e mandateve për këshillat e bashkive". Duke pranuar kërkesat e Partisë Socialiste për 61 bashki, Kolegji Zgjedhor vendosi shqyrtimin e çështjes në themel, duke bërë shpërndarjen e mandateve për këshillat bashkiakë në 61 bashki të vendit.

576 Për më shumë shih Shtojca nr. 15 - Konstituimi i Këshillave Bashkiake.

XVII. REKOMANDIME

XVII.1. Rekomandime parësore

Është e domosdoshme që procesi për një reformë të thellë dhe strukturore të kuadrit ligjor që afekton zgjedhjet, përfshirë, por pa u kufizuar në Kodin Zgjedhor, të vazhdojë përtej procesit aktual dhe amendimeve që ai do të sjellë. Procesi reformues duhet të bazohet në parimet e transparencës së plotë dhe gjithëpërfshirjes reale të aktorëve të interesuar apo atyre me ekspertizë, vendas apo ndërkombëtarë dhe jo të kufizohet vetëm tek aktorët politikë dhe ekspertiza e huaj.

Në frymën e sa më sipër, duke qenë se procesit aktual i ka munguar kjo qasje transparente dhe gjithëpërfshirëse, qoftë në nivelin e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore, qoftë në nivelin e Këshillit Politik, duhet që drafti ligjor që do të prodhohet të konsultohet me sa më shumë aktorë që të jetë e mundur, brenda kufizimeve kohore potenciale, në mënyrë që produkti i këtij procesi të garantojë amendime të mirëmenduara, sado të pjesshme.

Mekanizmi i shpërndarjes së mandateve apo edhe vetë sistemi zgjedhor duhet të rishikohet në integral, kombinuar me ndryshime në Ligjin për Partitë Politike dhe mënyrën e administrimit të procesit zgjedhor, apo edhe të tjera, me qëllim forcimin dhe garantimin e përfaqësimit real të qytetarëve, hapjen e sistemit dhe nxitjen e forcave apo alternativave të reja politike, garantimin e barazisë në garë si dhe forcimin e demokracisë së brendshme të partive politike.

Është e domosdoshme që të garantohen mekanizmat ligjorë për të krijuar një Komision Qendror të Zgjedhjeve si *de jure* ashtu edhe *de facto* të pavarur nga partitë politike dhe interesat e ngushtë dhe afatshkurtër të tyre, si dhe për të ndaluar sjelljen e kësaj trupe mbi ligjin.
Në gjykimin e KRIIK, është e nevojshme, që megjithëse do të ngrihet një KQZ e re, të merren në konsideratë dhe të adresohet zhbërja e precedentëve absurdë dhe antiligjorë të vendosur tanimë, dhe të kihen parasysh gjithë praktikat ligjore negative të shënuara si nga ana e Trupës së KQZ-së ashtu edhe nga ana e Administratës së saj, në mënyrë që fryma e ngritjes së institucianit të ri të përmbushë aspiratat kushtetuese si dhe të përçohet nga integriteti dhe moskompromisi me antiligjin dhe pandëshkueshmërinë e partive politike, veçanërisht në raport me financat e tyre.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet t'i kushtojë vëmendje maksimale transparencës në të gjitha fazat e procesit zgjedhor. Përpos përmbushjes së plotë dhe në kohë të detyrimeve ligjore aktuale, nevojitet të adoptohen mekanizma shtesë që të garantojnë rritje të transparencës, përfshi përdorimin e mundësive që ofron teknologjia e informacionit.

Kuadri ligjor dhe mekanizmat që garantojnë transparencën e financave zgjedhore duhet të rishihen në themel dhe të ndryshohen, me qëllim garantimin e një transparence maksimale dhe kontrolli efikas.

Ndryshimet ligjore duhet të përfshijnë jo vetëm Kodin Zgjedhor, por edhe ligjin për Partitë Politike apo të tjera ligje, sipas nevojës. Madje gjykohet se më e udhës do të ishte hartimi i një ligji të ri të plotë dhe të posaçëm për financat e partive politike dhe fushatave zgjedhore.

Është i nevojshëm përcaktimi dhe lejimi i subjekteve zgjedhore për të patur të drejta në procesin e ankimimit referuar vendimmarrjes së administratës zgjedhore apo edhe elementëve në tërësi që prekin integritetin e procesit zgjedhor, përtej një interesi të drejtpërdrejtë përfitues të këtyre subjekteve.
Madje kjo e drejtë duhet të shtrihet edhe ndaj grupimeve qytetare dhe atyre politike që nuk janë pjesë e procesit zgjedhor.

Kuadri ligjor duhet të parashikojë një procedure denoncimi dhe mekanizëm hetimi efektiv ndaj fenomeneve që cenojnë lirinë dhe integritetin e proceseve zgjedhore.

Kuadri ligjor duhet të parashikojë ndalimin e zyrtarëve të lartë qendrorë të marrin pjesë në fushatë në mbështetje të kandidatëve lokalë, në mënyrë që të garantohet barazia në garë e kandidatëve si dhe ndarja e qartë e pushtetit lokal nga ai qendror.

Kuadri ligjor dhe mekanizmat që garantojnë transparencën e financave zgjedhore duhet të përmirësohen, me qëllim garantimin e një transparence maksimale.

XVII.2. Rekomandime të tjera

Në kuadër të filozofisë së ndërtimit të një pushteti vendor sa më pranë qytetarit dhe veçanërisht pas reformës administrativo-territoriale, nevojitet që të rritet legjitimiteti dhe forca e kryetarit të bashkisë, duke marrë në konsideratë që kryetarët e bashkive të konsiderohen të zgjedhur vetëm nëse kanë marrë një shumicë absolute të votave të komunitetit përkatës, çka do të kërkojë parashikimin e sistemit me dy raunde.

Vendosja e një minimumi pjesëmarrjeje në rastin e zgjedhjeve lokale, në mënyrë që ato të konsiderohen të vlefshme mund të konsiderohej, duke qenë se do të rriste legjitimitetin e të zgjedhurve vendorë, por edhe do të shërbente si një siguri shtesë për evitimin e proceseve zgjedhore në mungesë të pluralizmit real.

Rekomandohet ngritja e një trupe profesionale komisionerësh zgjedhorë në përbërje të komisioneve zonale të administrimit zgjedhor me individë profesionistë, pa lidhje me forcat politike. Kjo është e domosdoshme të shoqërohet me mekanizma që të garantojnë se këta individë nuk do të ndëshkohen apo shpërblehen për veprimet apo mosveprimet e tyre në zbatim të ligjit gjatë procesit zgjedhor.

Rekomandohet që legjislacioni të parashikojë vendndodhje të përhershme të mjediseve ku trupat e administratës zgjedhore kryejnë aktivitetin e tyre, vendndodhje që mund të rifreskohet në vijimësi nga administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, sipas mundësive në terren. Kjo qasje do të rriste operativitetin e administratës së KQZ-së për pajisjen në kohë të komisioneve me infrastrukturën dhe shërbimet e nevojshme.

KQZ duhet të adoptojë mekanizma që garantojnë rritje të transparencës, të tilla si ofrimi i të dhënave të hapura, hapja për publikun e arkivës video të mbledhjeve të KQZ-së, publikimi i regjistrimeve video nga tavolinat e numërimit, publikimi i menjëhershëm i vendimeve të komisioneve zonale të nivelit të dytë dhe atij të tretë, etj. Në konsideratë duhet marrë edhe transmetimi video në kohë reale i procesit të numërimit (përfshi mjediset e KZAZ-ve dhe tavolinat e numërimit), apo edhe i procesit të votimit.

Koordinimi ndërinstitucional për monitorimin e përdorimit të administratës dhe burimeve shtetërore në fushatën zgjedhore duhet të shihet me prioritet dhe të aplikohet në vazhdimësi, por duke garantuar që koordinimi të jetë real dhe funksional nëpërmjet parashikimeve të plota procedurale si dhe detyrimi që gjetjet e monitorimit të bëhen publike gjatë dhe pas procesit zgjedhor, dhe të adresohen menjeherë nga institucionet përkatëse.

KQZ-ja nxitet të marrë një rol proaktiv ndaj partive politike, në përmbushje të parimit të barazisë përpara ligjit, përputhjes me parimet demokratike që ato duhet të reflektojnë, si dhe integritetit moral dhe politik që ato duhet të përcjellin, në kuadër edhe të sigurimit të integritetit të procesit zgjedhor dhe të ofertës elektorale që paraqitet për qeverisjen e popullit dhe vendit.

KQZ-ja duhet të sigurojë dhe garantojë, në maksimumin e hapësirave që lejon ligji, shmangien e konfliktin e interesit dhe manifestimin e parimit të barazisë në garë si vlerë e tërë elementëve përbërës të procesit zgjedhor.

Ligji duhet të saktësojë në mënyrë që të mos lejojë ekuivok dhe interpretim për kriteret bazuar në të cilin partitë lirohen nga detyrimi për të mbledhur firma mbështetëse për kandidatët, në mënyrë që të garantohet trajtimi i barabartë në kandidim.

Është e nevojshme të shëndoshet më tej praktika pozitive e ndjekur duke e rregulluar në mënyrë më të plotë mekanizmin e njoftimit me shkrim, në të tërë elementët e tij, në mënyrë që të parandalohet vullneti individual apo edhe institucional për sabotimin e këtij procesi.

Duke konsideruar situatën aktuale të mos kontrollit të financimit politik, të moszbatimit të ligjit dhe të informalitetit të lartë në ekonomi, veçanërisht nivelin e lartë të korrupsionit si dhe të krimit të organizuar, KRIIK sugjeron të merret në konsideratë ndalimi totalisht i financimit jo-publik për partitë politike, me përjashtim të kuotave të anëtarësisë për një periudhë kohore të kufizuar (së paku tre legjislatura). Një masë e tillë, e shoqëruar me kontroll më rigoroz dhe nga institucione më të specializuara në fushën e kontrollit financiar (p.sh. Kontrolli i Lartë i Shtetit, apo nëpërmjet ndërtimit një task-force do të rriste nivelin e transparencës dhe kontrollit).
Si një masë alternative ndaj ndalimit të financimit jo-publik në bllok, mund të konsiderohet ndalimi i financimit nga subjektet juridike dhe të lejohet vetëm financimi nga persona fizikë.

Duke e konsideruar tepër pozitiv plotësimin e deritanishëm të kuadrit rregullator mbi financat e subjekteve zgjedhore dhe partive politike prej KQZ-së, gjykohet se është i nevojshëm që ky kuadër të përmirësohet akoma më tej duke plotësuar mangësitë e vërejtura si dhe duke përfshirë detyrimin për të raportuar për financat e fushatës zgjedhore edhe prej kandidatëve për anëtarë të këshillave bashkiakë.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet të marrë një rol shumë më proaktiv në mbikëqyrjen e financave të subjekteve zgjedhore, duke mos u mjaftuar në miratimin e raporteve të depozituara nga auditët. Mund të konsiderohet ngritja e një strukture koordinimi mes institucioneve të ndryshme, nën drejtimin dhe koordinimin e KQZ-së, me synim rritjen e efektivitet të monitorimit dhe kontrollit të financave zgjedhore.

Auditët që kryejnë auditimin e financave zgjedhore dhe atyre të partive politike duhet të kryejnë veprime të mirëfillta monitoruese, bazuar në një metodologji të qartë dhe konsistente, në mënyrë që gjetjet të jenë të krahasueshme. Auditët nevojitet të pajisjen me mjete financiare dhe logjistike të mjaftueshme që të kryejnë detyrën e vet me efektivitet.

Një vëmendje të veçantë duhet të marrë monitorimi i aktiviteteve të partive politike përpara nisjes së fushatës zgjedhore, me qëllim vlerësimin e saktë dhe të vërtetë të shpenzimeve të kryera me qëllime elektorale, duke qenë se partitë politike në Shqipëri, prej vitesh tanimë e nisin fushatën disa muaj përpara fillimit ligjor të saj.

Subjektet zgjedhorë duhet që të paraqesin në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve një agjendë të aktiviteteve elektorale që do të kryejnë. Sugjerohet që agjenda paraprake të deklarohet në një afat të arsyeshëm përpara nisjes së fushatës zgjedhore.
Nga ana tjetër, duhet të parashikohet edhe që subjektet zgjedhore të kenë detyrimin që të dërgojnë informacion të rifreskuar mbi kalendarin e aktiviteteve zgjedhore në KQZ si dhe drejtpërdrejtë monitoruesit financiar përkatës.

Kuadri ligjor duhet të parashikojë detyrimin e subjekteve zgjedhore për hapjen e një llogarie të posaçme për fondet e fushatës. Të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet e bëra për qëllim të fushatës duhet të kalojnë nga kjo llogari bankare, pavarësisht burimit apo shumës së tyre.

Gjithashtu, edhe pagesat për fushatën zgjedhore të kryhen të gjitha nga kjo llogari bankare, pavarësisht masës së tyre.

Me synim rritjen maksimale të transparencës së financave zgjedhore, KRIIK sugjeron që llogaritë bankare të partive politike dhe subjekteve zgjedhore të jenë "llogari transparente", të cilat të mundësojnë monitorimin e të gjitha lëvizjeve në kohë reale nëpërmjet internetit prej të gjithë subjekteve të interesuar. Një gjë e tillë kërkon investimin dhe aplikimin e llogarive të tilla prej sistemit bankar shqiptar.

KRIIK gjykon se Bordi i Monitorimit të Medias (BMM) duhet të institucionalizohet si trupë, apo të atashohet si një strukturë e përhershme pranë AMA-s.

Kjo do të ndihmojë për referenca të mëvonshme mbi sjelljen e operatorëve audiovizualë gjatë proceseve zgjedhore. Nga ana tjetër ofrohet mundësia e monitorimit të një periudhe më të gjatë përpara fillimit të fushatës zgjedhore, apo edhe pas zgjedhjeve, duke u siguruar për respektimin dhe zbatimin e ligjit dhe masave të ndërmarra ndaj tyre.

KQZ në bashkëpunim me Bashkitë, duhet të përpunojë akte nënligjore të cilat garantojnë aksesueshmërinë e personave më aftësi të kufizuara në qendrat e votimit përkatëse, në funksion të garantimit të të drejtës së votës për ta. Sugjerohet ndërtimi i një bazë të dhënash të përhershme e cila të mund të përditësohet dhe të kihet në konsideratë në vazhdimësi në përgatitjen e infrastrukturës zgjedhore të radhës.

KQZ duhet të vazhdojë dhe forcojë më tej traditën e bashkëpunimit me organizatat që punojnë në fushën e aftësisë së kufizuar, duke nxitur pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të përfaqësuesve të tyre në procesin e trajnimit, hartimit të paketës sensibilizuese dhe metodologjisë së përdorur.

Mekanizmat garantues për integritetin e procesit dhe si instrument për subjektet zgjedhore që ndërton kuadri ligjor, meritojnë të marrin një imunitet ligjor të shtuar dhe detajim procedural që të përballet me vullnetet burokratike antiligjore.

XVIII. MBI KRIIK

XVIII.1. Mbi organizatën

Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK Albania) është një organizatë jo-fitimprurëse dhe jo-qeveritare, e themeluar në tetor të vitit 1997 nga një grup studentësh. Qendra e organizatës është në Tiranë, dhe aktiviteti i saj shtrihet në të gjithë vendin, duke operuar nëpërmjet përfaqësuesve lokalë dhe/ose organizatave partnere. KRIIK është regjistruar në dhjetor 1997, në formën e shoqatës me anëtarësi. Trupa më e lartë vendimmarrëse e organizatës është Mbledhja e Përgjithshme e Anëtarëve.

KRIIK punon për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe sigurisë njerëzore, forcimin e shtetit të së drejtës dhe qeverisjes demokratike; nxitjen e aktivizmit dhe angazhimit qytetar dhe nxitjen e llogaridhënies së institucioneve publike dhe politike.

Vizioni i KRIIK është ai i një shoqërie ku mbizotëron shteti ligjor; respektohen katërcipërisht dhe pa kompromis të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, liritë qytetare, politike dhe të ndërgjegjes të të gjithë individëve, pa asnjë dallim; ku mbizotëron sensi i komunitetit dhe qytetarët janë të angazhuar në hartimin e politikave publike në mënyrë domethënëse dhe sovrane dhe ku përfaqësuesit e zgjedhur e zyrtarët e tjerë publikë kanë si interes parësor mirëqenien e qytetarëve.

Vlerat themelore në të cilat bazohet aktiviteti i KRIIK janë angazhimi qytetar vullnetar; paanësia dhe pavarësia; integriteti; konsekuenca në përmbushjen e misionit me profesionalizëm dhe përkushtim; objektiviteti në vlerësimin e fakteve dhe argumenteve; respekti për diversitetin njerëzor dhe atë të opinioneve; transparenca në veprimtari dhe ruajtja e mjedisit.

XVIII.2. Angazhimi i mëparshëm në lidhje me integritetin zgjedhor

KRIIK ka ndjekur në vijueshmëri zhvillimin e proceseve zgjedhore prej miratimit me referendum të Kushtetutës në vitin 1998 e deri më sot. Prej vitit 2000, KRIIK ka qenë pjesë aksioneve të përbashkëta të vëzhgimit të disa grupimeve të organizatave vendase.
Prej 2005, KRIIK ka qenë anëtar themelues e më pas edhe një nga organizatat drejtuese të Koalicionit të Vëzhguesve Vendorë (KVV), grupimi më i madh i organizatave vendore që kanë vëzhguar zgjedhjet në Shqipëri. Në kuadër të apo në bashkëpunim me Koalicionin e Vëzhguesve Vendorë, KRIIK ka vëzhguar të gjitha zgjedhjet e përgjithshme, parlamentare apo lokale, të zhvilluara në Shqipëri prej vitit 2005 deri në vitin 2017 si dhe shumicën e proceseve zgjedhore të pjesshme të zhvilluara gjatë kësaj periudhe.

KRIIK, në bashkëpunim me Elections to Conduct Agency (ECA) kanë realizuar për herë të parë në Shqipëri numërimin paralel të votave në rang vendi, në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2009.

Një përvojë të pasur, KRIIK ka grumbulluar në formën e rritjes së kapaciteteve dhe të ekspertizës së vet edhe nëpërmjet angazhimeve në Misionet Ndërkombëtare të Vëzhgimit të Zgjedhjeve, në kuadër të Rrjetit Europian të Organizatave që Vëzhgojnë Zgjedhjet (ENEMO), në Sekretariatin Drejtues të të cilit është anëtar prej dy mandatesh.

Prej Reformës Zgjedhore të vitit 2012, KRIIK, në bashkëpunim me apo në kuadër të Koalicionit të Vëzhguesve Vendorë, ka ndjekur në mënyrë të pandërprerë performancën dhe të gjitha mbledhjet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve deri më sot, si dhe gati tërë proceset institucionalë dhe politikë që kanë afektuar drejtpërdrejtë apo indirekt integritetin e proceseve zgjedhore.

Në vazhdimësi të veprimtarisë së tij përpos angazhimit dhe ndërveprimit me partitë politike në aktivitete të përbashkëta, ku janë shprehur zotime të nivelit më të lartë të Lidershipit Politik, ka ndjekur gjithashtu tërë ecurinë e Komisioneve të Posaçme Parlamentare për Reformën Zgjedhore të ngritura pas Zgjedhjeve Parlamentare të vitit 2013, dhe në veçanti ecurinë e Komisionit aktual, që prej ngritjes së tij më tetor 2017 e deri më sot, përfshirë edhe ngritjen dhe funksionimin e Këshillit Politik, përsa është bërë e mundur të mësohet për veprimtarinë e tij nga deklarimet e bëra në media nga anëtarët e tij apo kontakteve të tjera indirekte.

XIX. AKRONIME

AAK	Partia Aleanca Arbnore Kombëtare
ABDE	Partia Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane
ADK	Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë
ADS	Partia Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet
AK	Partia Aleanca Kuq e Zi
AMA	Autoriteti i Mediave Audiovizive
AMIE	Partia Aleanca e Maqedonasve per Integrim Europian
AP	Avokati i Popullit
BD	Partia Bindja Demokratike
BMM	Bordi i Monitorimit të Mediave
DPGJC	Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile
FRD	Partia Fryma e Re Demokratike
G99	Partia G99
GNV	Grupi i Numërimit të Votave
IEVP	Institucion i Ekzekutimit të Veprave Penale
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
KONSAL	Partia Kombetare Konservatore Albania
KQV	Komisioni i Qendrës së Votimit
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
KZ	Kolegji Zgjedhor
KZAZ	Komisioni Zonal i Administrimit Zgjedhor
LDE	Partia Per Liri Demokraci dhe Etike
MEGA	Partia Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
NJQV	Njësi e Qeverisjes Vendore
ODHIR	Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut
PAD	Partia Aleanca Demokratike
PASH	Partia Ardhmëria Shqiptare
PBK	Partia Balli Kombëtar
PBLD	Partia Bashkimi Liberal Demokrat
PD	Partia Demokratike
PDIP	Partia Demokrate per Integrim dhe Prosperitet
PDIU	Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet
PDM	Partia e të Drejtave të Mohuara
PDRE	Partia Demokracia e Re Europiane
PDS	Partia Demokracia Sociale
PESH	Partia Emigracioni Shqiptar
PGJ	Partia e Gjelbër
PKD	Partia Kristian Demokrate e Shqipërisë
PKSH	Partia Komuniste e Shqipërisë
PLPSH	Partia Lëvizja Punetore Shqiptare
PMDE	Partia për Mbrojtjen e te Drejtave te Emigranteve
PMDPSH	Partia për Mbrojtjen e te Drejtave te Punëtoreve të Shqipërisë
POSH	Partia Ora e Shqipërisë
PPAK	Partia Personat me Aftësi të Kufizuar
PPK	Partia e Pajtimit Kombëtar
PRDSH	Partia e Reformave Demokratike Shqiptare
PS	Partia Socialiste e Shqipërisë
PSD	Partia Socialdemokrate e Shqiperise
PSM	Partia Socialiste e Moderuar
PSPSH	Partia Social Punëtore e Shqipërisë
PUK	Partia e Unitetit Kombëtar
QV	Qendër Votimi
RKGJC	Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VNV	Vend i Numërimit të Votave
ZAZ	Zonë e Administrimit Zgjedhor
ZGJC	Zyrë e Gjendjes Civile
ZRZ	Zyrë Rajonale Zgjedhore

XX. SHTOJCA

DEKLARATA PUBLIKE TË KRIIK PËRGJATË PROCESIT ZGJEDHOR

SHTOJCA NR. 1.1 – *DEKLARATË - Vizita e sotme e Zëvendës/Ndihmës Sekretarit të Shtetit të SHBA-ve, moment madhor për zgjidhjen e duhur e vizionare të së ardhmes demokratike të vendit*

KRIIK Albania është një organizatë jo-qeveritare, jo-fitimprurëse dhe jo-partizane e cila ka si mision mbrojtjen dhe garantimin e lirive e të drejtave të njeriut nëpërmjet forcimit të shtetit të së drejtës, qeverisjes demokratike si dhe nxitjes për përgjegjshmëri, transparencë e llogaridhënie të plotë të institucioneve publike dhe politike.

KRIIK Albania në bashkëpunim me apo në kuadër të Koalicionit të Vëzhguesve Vendorë (KVV), si një ndër organizatat themeluese dhe drejtuese të KVV, ka ndjekur në vazhdimësi zhvillimin e të gjitha proceseve politike, institucionale dhe ligjore të cilat afektojnë drejtëpërsëdrejti apo indirekt integritetin e proceseve zgjedhore dhe ecurinë e procesit demokratik në tërësi.

Në vazhdim të këtij angazhim, KRIIK ka ndjekur nga afër dhe me shumë vëmendje situatën politike dhe institucionale në vend veçanërisht pas krizës së pranverës 2017, krizë e cila shënon **si zgjatim dhe produkt të saj situatën e paprecedentë dhe të jashtëzakonshme në të cilën ndodhet sot vendi**.

Përpjekjet shtetformuese dhe reformat e mëdha që janë duke u kryer janë një kontribut i pamohueshëm dhe i drejtëpërdrejtë, veçanërisht i dy forcave politike më të mëdha e liderëve të tyre, sikundër është edhe qasja e re proaktive e ndjekur pas vitit 2013 në komunikimin institucional e politik, por që nuk arriti të jetë një dialog dhe komunikim i hapur e gjithëpërfshirës mbi baza të forta të parimeve demokratike e shtetformuese, larg dakortësive të mbyllura e të ngushta.

Retorika e ashpër politike, gjuha e fortë konfliktuale e përdorur nga liderët politikë dhe qasjet e njëanshme radikale të ofruara si zgjidhje prej krerëve të të dy partive të mëdha PS e PD, jo vetëm që **nuk kanë bazë të fortë vlerash e parimesh demokratike por vështirësojnë shumë çdo qasje tjetër dhe nuk lënë asnjë shteg për zgjidhje**.

Në një situatë kur fryma e parimeve demokratike e kushtetuese të jetësuara nga populli shqiptar në Kushtetutën e Republikës është vënë në pikëpyetje, kur pushteti parlamentar e ai ekzekutiv është shndrruar në një pushtet të njëanshëm politik dhe kur pushteti gjyqësor është në një proces të thellë reformimi e pjesërisht jofunksional, çdo vazhdimësi e kësaj sjellje në këtë trend jo vetëm që dëmton rëndë projektin shtetformues shqiptar por mund të çojë në separatizëm dhe konliktualitet të gjerë shoqëror.

Raportet e fundit të institucioneve ndërkombëtare, sidomos ai i situatës së të drejtave të njeriut dhe Raporti i Strategjisë për Kontrollin Ndërkombëtar të Narkotikëve të Departementit të Shtetit vënë theksin tek situata serioze dhe problematikat e mëdha me të cilat duhet të përballen demokracia dhe institucionet e brishta të shtetit shqiptar.

Është koha që **e gjithë klasa politike në vend, veçanërisht partia Socialiste dhe ajo Demokratike të marrin me seriozitet dhe maturi të lartë përgjegjësitë** që iu takojnë. Kjo situatë është, as më shumë dhe as më pak, **një meritë dhe përgjegjësi e drejtëpërdrejtë e tyre dhe veçanërisht e dy kryetarëve të tyre**. Tranzicioni 27 vjeçar, krizat ciklike politike dhe institucionale si dhe zgjidhjet dritëshkurtra jovizionare duhet të marrin fund.

Kjo mazhorancë dhe kjo opozitë, në rradhë të parë, por **edhe gjithë klasa politike dhe mbarë elita e vendit duhet të marrin përgjegjësitë përballë të ardhmes së vendit duke treguar pjekuri e kulturë europiane duke filluar përpjekjet për ndërtimin e:**

- një platforme zhvillimi politik e institucional afatgjatë, vizionar e gjithëpërfshirës të ngritur dhe bazuar mbi një sistem vlerash që farkëtohet në vazhdimësi prej procesesh zgjedhore të lira e

të ndershme që sigurojnë dhe pasqyrojnë vullnetin e lirë e të pandikuar të shtetasve;
- një sistemi politik të hapur dhe mbështetës ndaj alternativave të mendimit apo kandidimit;
- një sistemi me institucione të konsoliduara, transparente e llogaridhënëse dhe të varuara vetëm nga zbatimi me koherencë, në mënyrë të plotë dhe të barabartë të ligjit;
- një sistemi me një shoqëri të informuar dhe mbrujtur me parimet e kulturës demokratike ku kryefjalë mbetet përgjegjësia, moraliteti dhe integriteti individual, politik e institucional dhe që ka besim dhe **mbështet një sistem drejtësie të pavarur, të pastër, të pandikuar e funksional**.

Dialogu i menjëhershëm midis dy liderëve, Kryetarit të Partisë Socialiste Z. Edi Rama dhe Kryetarit të Partisë Demokratike Z. Lulzim Basha, **i hapur e gjithëpërfshirës, për zgjidhjen e krizës së të ardhmes demokratike të vendit është një dosmosdoshmëri**. Një dialog i cili përpos sigurimit të vlerave dhe lirive demokratike, **të sigurojë pandalshmërinë dhe mbështetjen pa rezerva të procesit të reformës në drejtësi, proceseve të tjera madhore si ai i dekriminalizimit apo i kulturës së vetingut në të gjitha hallkat me rol dhe ndikim në projektin shteformues**, si edhe luftën pa kompromis ndaj korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Politika shqiptare dhe aktorët me ndikim duhet të vlerësojnë se një ndër kontributet, me të cilat Shqipëria të mund të shprehë mirënjohjen ndaj mbështetjes në vazhdimësi prej partnerëve ndërkombëtarë veçanërisht Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Vendeve të Bashkimit Europian, duke u bërë vërtet lider dhe faktor stabiliteti në rajon e më gjerë, është jetësimi dhe manifestimi në të gjitha hallkat e shoqërisë **i vlerave më të mira të parimeve dhe lirive demokratike duke manifestuar një demokraci funksionale dhe të gjallë**.

Duke vlerësuar vizitën e sotme të Zëvendës Ndihmës Sekretarit Amerikan të Shtetit z. Matthew Palmer si një mundësi të artë dhe në kohën e duhur, KRIIK **nxit dhe beson tek pjekuria dhe vizioni i secilit prej dy liderëve z. Rama dhe z. Basha që nëpërmjet një dialogu të sinqertë, transparent e gjithëpërfshirës të ofrojnë zgjidhjen e duhur e vizionare** për të ardhmen demokratike të vendit.

Tiranë, më 08.04.2019

SHTOJCA NR. 1.2. - *DEKLARATË - Ruajtja e paanësisë dhe integritetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, rëndësi jetike për funksionimin e shtetit demokratik e ligjor*

Shoqëritë me demokraci të qëndrueshme dhe të shëndetshme karakterizohen, ndër të tjera, nga një zbatim shumë i mirë i ligjit si dhe institucione të forta, të pavarura dhe llogaridhënëse. Në vendet me demokraci të brishtë dhe në tranzicion shtetformues si vendi ynë, ndërtimi dhe funksionimi në mënyrë të pavarur i institucioneve mbetet një sfidë e vështirë. Mirëfunksionimi i tyre mbi bazën e kushtetutës dhe ligjit është thelbësor për të frenuar ndikimin e vullneteve politike dhe për të siguruar besimin e qytetarëve në funksionimin e shtetit demokratik e ligjor.

Veçanërisht në kushtet e një krize politike, mirëfunksionimi i institucioneve dhe zbatimi pa ekuivok dhe i drejtë i ligjit është domosdoshmëri dhe garanci për ekzistencën e shtetit demokratik e ligjor.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) si një ndër institucionet e pavarura ka një rëndësi madhore në shëndoshjen e demokracisë pasi ai është organi i ngarkuar nga Kushtetuta dhe ligji për ruajtjen e integritetit të votës dhe të vullnetit të qytetarëve, i cili i shprehur nëpërmjet proceseve zgjedhore legjitimon pushtetin qeverisës dhe garanton fuqinë e votuesit.

KRIIK ka ndjekur në vazhdimësi funksionimin dhe vendimmarrjen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) dhe sidomos veprimtarinë e tij në mbikqyrjen dhe përgatitjen e procesit zgjedhor të 30 qershorit 2019. **Deri më tani, në tërësi, vlerësohet një performancë pozitive**

e KQZ-së në informimin dhe nxitjen e aktorëve për të respektuar zbatimin e kërkesave dhe procedurave të parashikuara për ndërtimin e procesit të ardhshëm zgjedhor.

KRIIK shpreh, gjithashtu, **shqetësimin e tij për shkeljen në mënyrë flagrante të ligjit lidhur me vendimin e marrë nga KQZ-ja më datë 27.04.2019 për regjistrimin e subjektit zgjedhor** "Partia Bindja Demokratike"[1].

Ky vendim jo vetëm që është në shkelje të afatit të përcaktuar nga Kodi Zgjedhor[2], por gjatë marrjes së tij trupa e KQZ-së nuk mori parasysh as praktikën ligjore të ndjekur nga vetë ajo në Zgjedhjet Parlamentare 2013[3] dhe në Zgjedhjet Vendore 2015[4] dhe as vendimmarrjen e Kolegjit Zgjedhor të vitit 2013[5], për mosregjistrimin e subjekteve zgjedhore të cilat, në afatin e përcaktuar nga Kodi Zgjedhor, ishin subjekte zgjedhore për të cilat ishte marrë vendim nga Gjykata, por ky vendim nuk kishte marrë ende formë të prerë.

Për më tepër, në rastin e regjistrimit të subjektit "Partia Bindja Demokratike" vendimi i regjistrimit në Gjykatë[6] është marrë dy ditë pas kalimit të afatit të regjistrimit të subjekteve zgjedhore, pra më datën 25 prill 2019.

Megjithëse Kryetari i KQZ-së z. Zguri solli në vëmendje të anëtarëve këtë shqetësim, katër anëtarët e tjerë të KQZ-së, jo vetëm **nuk e morrën në konsideratë praktikën e vendosur, por në mënyrë të paprecedentë nuk zhvilluan asnjë diskutim[7] apo parashtrim të qëndrimit të tyre dhe në bllok votuan pro regjistrimit të subjektit**, përkundrejt votës kundër të Kryetarit të KQZ-së.

Ky qendrim është i kundërt edhe me qendrimin e vetë KQZ-së të shprehur në Deklaratën për Shtyp[8] të datës 4 janar 2019, ku shprehet se për shkak edhe të kritikave nga misionet vëzhguese ndërkombëtare[9], ajo është e vendosur këtë herë që të mos mirëkuptojë dhe as tolerojë vonesat në aplikimin për regjistrim të subjekteve zgjedhore.

Gjithashtu, **shqetësues mbetet fakti që edhe administrata e KQZ-së, konkretisht Drejtoria Juridike dhe Sekretari i Përgjithshëm**, në relacionin e përgatitur[10] dhe atë të referuar[11] përpara trupës së KQZ-së në seancën e datës 27 prill e konsiderojnë konform ligjit dhe brenda afatit të 23 prillit kërkesën e paraqitur. Madje ata specifikojnë se bashkëlidhur me këtë kërkesë është paraqitur edhe vërtetimi i regjistrimit të subjektit në gjykatë, vërtetim i cili është lëshuar nga Kancelari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë tre ditë më vonë, pra më datë 26 Prill 2019, një ditë përpara mbledhjes së KQZ-së.

Ende sot, në datën e publikimit të kësaj deklarate, **ky vendim nuk është zbardhur dhe nuk është bërë publik**[12] në mënyrë që të gjykohet mbi arsyetimin e paraqitur rreth kësaj vendimmarrjeje. Nuk janë bërë publike as vendimet e tjera të marra në mbledhjen e asaj date, madje as ato të mbledhjes së mëparshme të datës 25 prill[13], **në kundërshtim me detyrimin e përcaktuar në Kodin Zgjedhor për publikimin e vendimeve të KQZ-së brenda 24 orëve** nga marrja e tyre[14].

Nga monitorimi i vazhdueshëm që i është bërë KQZ-së veçanërisht pas reformës zgjedhore të vitit 2012 e deri më sot, është evidentuar edhe herë të tjera sjellja e saj jo në përputhje me ligjin dhe me standarde të dyfishta. Madje në trajtimin e çështjeve me valencë politike dhe për të cilat ka patur qëndrime të kundërta të partive kryesore politike, trupa e KQZ-së ka operuar në vendimmarrjen e vet e ndarë më dysh **duke reflektuar anshmëritë përkatëse politike**.

Ndërkohë, në situatën e sotme, trupa e KQZ-së është e paplotë pas mospropozimit prej Partisë Demokratike të kandidaturave për dy vendet e mbetura bosh që në tetor të vitit 2018. Tre prej anëtarëve janë kandidatura të propozuara nga Partia Socialiste. Ndërkaq kandidati i propozuar nga Partia Republikane[15] dhe ai i zgjedhur kryetar nga kandidatura të pavarura[16], pas marrëveshjes politike të 18 Majit 2017, arbitrarisht ndërruan vendet[17], duke zhbërë përfundimisht aspiratën e reformës zgjedhore të kryer në vitin 2012 për ndërtimin e një trupe të pavarur të KQZ-së.

Kuadri ligjor parashikon ankimimin e parregullsive të procesit në KQZ, në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit në Tiranë dhe në Gjykatën Kushtetuese, pavarësisht se kjo e fundit e ka përjashtuar veten me vendim[18] për të shqyrtuar çështje zgjedhore.

Për shkak të procesit të reformës në drejtësi, aktualisht **Gjykata Kushtetuese nuk është funksionale**. Ndërkohë **të tetë gjyqtarët e Apelit, anëtarë**[19] të Kolegjit Zgjedhor janë futur në proces rivlerësimi[20] **prej Komisionit të Pavarur të Kualifikimit**. Nga tetë anëtarët e Kolegjit Zgjedhor njëri është konfirmuar në detyrë[21] dhe një tjetër është shkarkuar[22], ndërkohë që të dy vendimet janë apeluar në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit. Gjashtë anëtarët e tjerë janë tashmë në proces rivlerësimi[23].

Në këto rrethana dhe në kushtet kur opozita e dalë nga zgjedhjet e viti 2017 ka dorëzuar mandatet parlamentare dhe proteston në rrugë duke akuzuar mazhorancën se ka uzurpuar të gjitha pushtetet, **sjellja dhe mirëfunksionimi i KQZ-së merr një rëndësi jetike**. Rëndësi që lidhet jo thjesht me administrimin e një procesi zgjedhor, por me ruajtjen e besimit të publikut në rolin e institucionit të KQZ-së në mbikqyrjen, mirëorganizmin dhe administrimin e procesit zgjedhor, si dhe në gatishmërinë e saj për të marrë në konsideratë dhe shqyrtuar me objektivitet, vërtetësi e paanësi të gjitha pretendimet apo shkeljet ligjore që mund denoncohen apo që mund të vërehen drejtpërdrejtë nga vetë KQZ-ja.

Organi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve i mandatuar në frymë e gërmë nga vullneti popullor i shprehur nëpërmjet referendumit për miratimin e Kushtetutës në 22 nëntor 1998, e më pas i materializuar në ligj pas ndryshimeve kushtetuese të vitit 2008, si një organ i përhershëm që përgatit, mbikëqyr, drejton dhe verifikon të gjitha aspektet që kanë të bëjnë me zgjedhjet, **duhet të marrë rol proaktiv në sigurimin e integritetit të të gjitha aspekteve të procesit zgjedhor**.

Në këtë frymë, **Anëtarët e trupës së KQZ-së duhet të respektojnë vetëm ligjin dhe t'i përmbahen plotësisht betimit**[24] të bërë para përfaqësuesve të popullit shqiptar në momentin e marrjes së detyrës.

Anëtarët e trupës së KQZ-së dhe administrata e saj duhet të përpiqen të shmangin çdo influencë apo presion politik dhe çdo referim në sjelljen apo praktikat e mëparshme, të vendimmarrjeve ekstraligjore, jo korrekte apo me standarde të dyfishta, pasi çdo qasje tjetër do të minonte besimin e qytetarëve dhe do të rëndonte akoma më shumë situatën e tensionuar në vend nga kriza aktuale politike.

Tiranë, më 6 Maj 2019!

SHTOJCA NR. 1.3 – *DEKLARATË - Procesi i regjistrimit të kandidatëve, po ngre pikëpyetje mbi integritetin e procesit të ardhshëm zgjedhor*

Më datën 6 maj KRIIK nëpërmjet një Deklarate i bëri thirrje Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) që në frymën e kushtetutës dhe ligjit ***të marrë rol proaktiv në sigurimin e integritetit të të gjitha aspekteve të procesit zgjedhor***[25]. Një rol ky më se i domosdoshëm në kushtet e një krize politike në rritje dhe të përgatitjes së një procesi zgjedhor me trupa administrimi të ndërtuara politikisht në mënyrë të njëanshme.

Komisionet Zonale të Administrimit Zgjedhor (KZAZ) në zgjedhjet vendore marrin një rol akoma më të rëndësishëm pasi ato kryejnë regjistrimin e kandidatëve dhe shpalljen e kryetarit të bashkisë në 51 bashkitë e vendit të cilat përputhen në shtrirje territoriale me atë të vetëm një ZAZ-je, ndërkohë që për 10 bashkitë e tjera regjistrimi dhe shpallja bëhet nga KQZ-ja[26].

Data 13 Maj 2019 ishte afati për regjistrimin e kandidatëve për t'u zgjedhur në organet e

pushtetit vendor për katërvjeçarin e ardhshëm, si kryetarë të bashkive dhe anëtarë të këshillave Bashkiakë, të propozuar nga partitë politike të regjistruara tashmë në zgjedhjet e ardhshme.

Në vazhdimësi të ndjekjes së ecurisë së procesit zgjedhor dhe nga kontaktet e marra me një pjesë të konsiderueshme të KZAZ-ve, KRIIK **konstaton me shqetësim se ka paqartësi,** qoftë nga organet e administrimit zgjedhor të nivelit të dytë qoftë edhe nga aktorë të tjerë institucionalë e politikë, **lidhur me procedurën e regjistrimit të kandidatëve**[27].

Kodi Zgjedhor parashikon se kandidatët e propozuar nga partitë politike që nuk kanë prej 6 muajsh asnjë mandat në kuvend apo në këshillin bashkiak ku bëhet regjistrimi, duhet të mbështeten nga lista me firma mbështetëse[28]. Dokumentet e kandidimit duhet të dorëzohen të gjitha njëherazi në afatin e përcaktuar[29], ndërkohë që ligji jep mundësinë edhe të plotësimit të mangësive në përmbajtje të dokumentacionit, por pas marrjes në shqyrtim dhe me vendim të komisionit administrues përkatës[30].

Në mbledhjen e tij të datës 16.05.2019, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vendosi të regjistrojë si kandidat për kryetar në Bashkinë Lezhë, z. Eduart Ndocaj të propozuar nga Partia Kombëtare Konservatore Albania. Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe kontaktet e marra, KRIIK **konstaton se ky vendim është marrë në shkelje të ligjit dhe procedurave të parashikuara.** Dokumentat që zëvendësojnë listën me firma mbështetëse ndaj kandidaturës së z. Ndocaj, konkretisht vërtetimi i lëshuar nga Kuvendi i Shqipërisë dhe ai i lëshuar nga Këshilli i Bashkisë Lezhë, **janë të pasaktë**.

Në vërtetimin e lëshuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit të Shqipërisë me Nr. 13 Prot datë 13.05.2019 thuhet se Deputeti Kujtim Gjuzi, i cili ka bërë betimin si deputet më datë 08.05.2019, është deklaruar se përfaqëson subjektin "Partia Kombëtare Konservatore Albania".

Gjithashtu vërtetimi citon se "Ai zotëron mandatin e deputetit të paktën 6 muajt e fundit, sipas parashikimeve në Kodin Zgjedhor", çka **nuk është e vërtetë, pasi mandati 6 mujor i deputetit, nëse do t'i referoheshim datës së zgjedhjeve apo afatit të regjistrimit të kandidatëve**[31], do të duhej të zotërohej prej z. Gjuzi së paku prej datës 30.12.2018[32], nëse.

Ndërsa në vërtetimin e lëshuar prej Këshillit të Bashkisë Lezhë me Nr. 4751/1 Prot datë 13.05.2019, thuhet se "mbështetur në vendimin Nr. 161 datë 03.07.2017 të Këshillit Bashkiak Lezhë[33], vërtetojmë se z. Petrit Ndreu është anëtar i Këshillit Bashkiak Lezhë, i propozuar nga subjekti politik, PKKA (Partia Kombëtare Konservatore Albania)". Kjo është e pasaktë pasi z. Ndreu është zgjedhur si anëtar i Këshillit Bashkiak Lezhë, i propozuar nga subjekti politik Partia Konservatore (KONS)[34], **e cila është një subjekt i ndryshëm elektoral nga Partia Kombëtare Konservatore Albania** (PKKA) apo ish-Partia Forca Albania[35]. Nga ana tjetër nga kontaktet e marra, konstatohet se z. Ndreu **nuk ka bërë ndonjë deklaratë me shkrim të depozituar tek sekretari i Këshillit Bashkiak Lezhë, 6 muaj më parë** ku të deklarojë përkatësinë e tij tashmë tek subjekti tjetër elektoral PKKA.

KRIIK gjithashtu vëren se **ka paqartësi mbi procedurat e kriteret edhe nga subjektet politike.** Përpos subjektit "Partia Kombëtare Konservatore Shqiptare", evidentohet edhe subjekti "Bindja Demokratike" e cila ka dorëzuar dokumentet e aplikimit të kandidatëve në disa KZAZ[36], pa i mbështetur me lista me firma mbështetëse, por i mbështet me një vërtetim nga Kuvendi i Shqipërsië ku Deputeti Andi Përmeti, i cili ka bërë betimin si deputet më datë 25.04.2019, është deklaruar se përfaqëson subjektin "Bindja Demokratike".

Në këto kushte **KRIIK i bën thirrje Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që të rimarrë në shqyrtim dhe të vendosë në shina ligjore regjistrimin e z. Ndocaj** si dhe, në mënyrë urgjente, **të marrë masat e duhura për të mbikqyrur sa më nga afër dhe me kujdes të gjithë procesin e regjistrimit të kandidatëve**, veçanërisht nga Komisionet Zonale të Administrimit Zgjedhor.

Gjithashtu, KRIIK i sugjeron KQZ-së që nëpërmjet një thirrje publike apo edhe nëpërmjet kanaleve të tjera të komunikimit të informojë në mënyrë të plotë dhe të qartë procedurat dhe kriteret që duhet të zbatohen në regjistrimin e kandidatëve, si për KZAZ-të ashtu edhe për

aktorët e tjerë apo publikun e gjerë.

KRIIK i bën thirrje **Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit të Shqipërisë të jetë i kujdesshëm në zbatimin e duhur të frymës dhe gërmës së ligjit**. Kodi Zgjedhor përcakton qartë se asnjë prej mandateteve individuale të deputetëve të rinj zëvendësues nuk mund të përdoret për të zëvendësuar listën me firma mbështetëse për asnjë subjekt zgjedhor.

Gjithashtu, iu bën thirrje Kryetarëve të Këshillave Bashkiakë që të përmbyllin me integritet dhe korrektësi mandatin dhe detyrën e tyre duke zbatuar më përpikmëri kërkesat e Kodit Zgjedhor dhe të legjislacionit në fuqi.

Në përfundim, KRIIK sjell në vëmendje se procesi i përzgjedhjes dhe regjistrimit të kandidatëve mbetet një proces thelbësor për qeverisjen vendore, veçanërisht në pikëpamje **të cilësisë së kandidatëve, integritetit dhe moralit që ata manifestojnë e përcjellin**, si dhe të mënyrës së përzgjedhjes së tyre, elementë këto që janë aktualisht veç eskluzivitet i vullnetit politik dhe dëshirave të partive politike.

Respektimi i afateve, procedurave dhe kërkesave të ligjit prej këtyre të fundit dhe kandidatëve të tyre **mbetet ndërkohë detyrim primar e i padiskutueshëm, por njëkohësisht edhe shumë domethënës**.

Tiranë, më 17 Maj 2019!

SHTOJCA NR. 1.4 - *QENDRIM PUBLIK - 30 Qershori si dështim i klasës politike dhe kërcënim ndaj demokracisë*

Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK Albania) ka ndjekur në vijueshmëri, që prej miratimit të Kodit Zgjedhor të vitit 2008, proceset zgjedhore dhe proceset institucionale të lidhura me to.

Pas reformës zgjedhore të vitit 2012, KRIIK, në bashkëpunim me apo në kuadër të Koalicionit të Vëzhguesve Vendorë, ka ndjekur në mënyrë të pandërprerë performancën dhe të gjitha mbledhjet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, të gjitha seancat dhe çështjet e trajtuara prej Kolegjit Zgjedhor, përgjithësisht punën e komisioneve të administrimit zgjedhor të niveleve të dyta dhe të treta përgjatë gjashtë proceseve zgjedhore të ndodhura si dhe gati të gjitha proceset e tjera institucionale e politike të lidhura me integritetin e procesit zgjedhor.

Po në këtë vazhdë, KRIIK ndoqi me shumë vëmendje dhe në vazhdimësi zhvillimet politike e institucionale në vend pas zgjedhjeve parlamentare 2017, si edhe ecurinë e përgatitjeve dhe të mbarëvajtjes së procesit të Zgjedhjeve Lokale 2019, veçanërisht menjëherë pas dekretimit të tyre prej Presidentit të Republikës më datë 5 Nëntor 2018.

Ecuri, e cila mes kundërshtish të forta politike, ligjore e institucionale, u konludua tashmë institucionalisht me konstitutimin e Këshillave Bashkiakë në të 61 Bashkitë e vendit dhe me marrjen e mandatit prej Kryetarëve të Bashkive në 60 prej tyre.

Procesi i 30 Qershorit 2019, i konsideruar "Zgjedhje" apo "Votime", ka passjellë tanimë mandatimin e qeverisjes vendore të re, pavarësisht se është e pamundur të vlerësohet si një proces zgjedhor ku u evidentua shprehja e vullnetit të lirë e demokratik. Kjo për shkak se, ndër të tjera, u shënua një administrim totalisht i njëanshëm politik me shkelje jo të pakta ligjore, si dhe rezultoi realisht një proces gati tërësisht pa garim duke përbërë kështu *de facto* një emërim politik të qeverisjes vendore.

Kësisoj, në vijueshmëri të monitorimit të kryer për rreth një dekadë, në konsideratën e KRIIK, **ky proces i ashtuquajtur zgjedhor shënoi përmbylljen e një serie dështimesh të klasës politike vendase.**

Madje ky dështim i fundit i klasës politike i faturoi vendit edhe dështimin në tre përpjekje madhore institucionale.

Pas procesit të 30 Qershorit të këtij viti, vlerësohet se në planin afatgjatë tanimë Shqipëria përballet ***me një mungesë të kapacitetit ligjor-institucional*** për të mbajtur zgjedhje me integritet. Përspektivë afatgjatë kjo që përballet së sotmi edhe ***me zhbërjen e qeverisjes vendore si një pushtet i decentralizuar*** si dhe me ***pamundësinë e një dialogu serioz politiko-institucional***, mungesa e të cilit ka sjellë radikalizimin e përballjes politike duke u përpjekur për të instaluar një krizë kushtetuese permanente.

* * *

Dëmi më i parë i përvojës zgjedhore të 30 Qershorit, por edhe i precedentëve të tjerë negativë të vendosur përgjatë proceseve të mëparshme zgjedhore, është **zhbërja definitive e tërë kuadrit ligjor përkatës, institucioneve përgjegjëse dhe traditës zgjedhore sipas Kodit Zgjedhor të vitit 2008**. Një kod që jo vetëm prej KRIIK dhe organizatave të tjera vendase, por edhe prej misioneve vëzhguese ndërkombëtare është vlerësuar në thelbin e tij si i pranueshëm dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Megjithatë, prej një dekade ky Kod është veshur në vijimësi me keq-lexime të vullnetshme në zbatim dhe me sjellje institucionale partizane ose jo-profesionale.

Mangësitë që mbart ky Kod në rregullimet që kryen, janë përdorur sipas interesit politik të ditës dhe mos-zbatimi i tij është kryer sipas dakordësive të ngushta bi-partizane. Gjendje kjo e mbartur e tillë në vazhdimësi qëllimisht edhe nëpërmjet mos-adresimit të problematikave në proceset e reformave zgjedhore, duke zgjedhur gjithmonë kryerjen e korrektimeve kozmetike apo duke i dështuar tërësisht këto procese reformuese të nisura.

Me këtë "proces zgjedhor", "**u hodh në erë" edhe mekanizmi i kundër-balancimit politik, praktikisht bi-partizan, në mbarëvajtjen zgjedhore.** Mekanizëm i imponuar deri më tani nga establishmenti politik si e vetmja alternativë për mbarëvajtjen normale të një procesi zgjedhor, pavarësisht se sërish nga ky establishment këto procese zgjedhore janë anatemuar si jo demokratike. Një mekanizëm ky tejet problematik dhe i kritikuar, pasi mënjanon aktorët e tretë politikë apo civilë nga administrimi, ankimimi apo investimi institucional në funksion të përmirësimit të integritetit të proceseve zgjedhore.

Në mënyrë paradoksale, vlerësohet se edhe **procesi i 30 Qershorit 2019 mbarti një "dakortësi" bi-partizane të rradhës. Kjo "dakordësi" rezultoi të amputonte të vetmen siguresë të mbetur në proceset zgjedhore për të qenë demokratike**, që ishte kundër-balancimi politik. Pasi u arrit për dekada të monopolizohej procesi zgjedhor nga bi-partizanizmi në administrimin e tij dhe në "çertifikimin" e rezultatit, me standardin e ri të vendosur, procesi u mundësua të jetë tashmë edhe krejt unilateral.

Nëse deri më tani marrëveshjet bi-partizane ishin kritikuar si jo-gjithëpërfshirëse, jo-transparente, anti-institucionale dhe anti-ligjore, me **këtë precedent edhe dakordësia bi-partizane u mënjanua si domosdoshmëri.**

Me procesin e 30 Qershorit, në shoqërinë shqiptare u imponua mënjanimi i tërë aspiratave demokratike përballë rrezikut të krizës që thellohet gjithmonë e më shumë.

Në kontekstin e një shoqërie pa mekanizma mbrojtës, si shoqëria civile dhe institucione të forta, dakordësia bi-partizane nga e anatemuar do jetë zgjidhja më e dëshirueshme përballë krizave që kërcënojnë në horizont. **Në këtë kontekst të dhënë, demokracia shqiptare duket se është bjerrur në moment ekzistencial**.

Mekanizmi kushtetues i Republikës së Shqipërisë në thelbin e tij duket tashmë i pajetë, sepse

pas 30 Qershorit **rotacioni mekanik zgjedhor, po orientohet drejt një rotacioni mirëfilltazi autokratik, me një "biletë dyshe" qeverisje qendrore-vendore së bashku.**

Projektimi shtetformues i një demokracie liberale kushtetuese banalizohet kështu në një dyluftim elektoral ku "fituesi i merr të gjitha".

Situatë kjo në të cilën bien tërë parimet e një demokracie kushtetuese si kontroll dhe balancë, transparenca vendimmarrëse, llogaridhënia ndaj qytetarëve, ligjzbatimi, e të tjera si këto.

* * *

Marrëdhënia kushtetuese e qeverisjes vendore me atë qendrore, në vijimësi të qeverisjes së vendit është de-natyruar.

Ilustruese për këtë de-natyrim kushtetues, është përfshirja e të dy pushteteve në proceset zgjedhore të njëri-tjetrit duke përcaktuar qendrimet e Kryebashkiakëve dhe i përfshirë ata sipas skalioneve përkatëse politike.

Pas 30 Qershorit, kjo mbivendosje e të dy pushteteve u rëndua duke e shndërruar qeverisjen vendore në një zgjatim të qeverisjes qendrore.

Përpjekjet disa vjeçare për forcimin e kësaj qeverisje, që kërkonin ta sillnin sa më afër qytetarit dhe larg debatit politik, si më e fundit Reforma Administrative-Territoriale apo të tjera, tanimë duket se janë nul.

Vertikalizimi i pushtetit pa prezencë opozitare, në kontekstin vendas të ligjzbatimit dhe sjelljes institucionale, paraqet një rrezik shumë të lartë për qeverisjen vendore.

Mbetet në vullnetin e të mandatuarve të rinj të qeverisjes vendore dhe në rolin e aktorëve vendorë, sigurimi i transparencës dhe gjithëpërfshirjes në vendimmarrjen vendore.

Nga ana tjetër, përballë këtij vertikalizimi pushteti dhe një opozite të angazhuar në një konflikt në rend madhor, problematikat e përditshme të jetesës së qytetarëve në nivel mikro, rrezikojnë të mbeten të pazëshme dhe të pambështetura politikisht.

* * *

Në situatën aktuale, në gjykimin e KRIIK, për hir të nulizimit të precedentëve absurdë dhe antiligjorë të vendosur tanimë, **nevojitet të merret në konsideratë shkrirja e trupës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe e Kolegjit Zgjedhor, si dhe nisja e punës për hartimin e një Kodi Zgjedhor të ri**.

Pas disa përpjekjesh për reformë zgjedhore, të dështuara në dakordësi bi-partizane dhe në kontekstin e sotëm institucional gati kritik, ndërmarrja e reformës zgjedhore është e një rëndesë aspak të lehtë, por ndërkohë përbën një domosdoshmëri urgjente.

Reforma Zgjedhore nevojitet të jetë e vetmja sipërmarrje që të konkurojë në vëmendje me Reformën në Drejtësi dhe me Luftën ndaj korrupsionit dhe krimit të organizuar, duke kaluar kësisoj në plan të dytë sipërmarrjet e tjera madhore të shtetit shqiptar.

Reforma zgjedhore e rradhës duhet të shërbejë si një mundësi për rikthimin e besimit të qytetarëve tek institucionet dhe forcimin e procesit konsultativ në procesin legjislativ.

Për këtë arsye, Reforma Zgjedhore nevojitet të ndërtohet mbi një platformë afatgjatë dhe mbi standarde të qarta.

Zgjedhjet e 30 Qershorit provuan që dakordësitë politike pas dyerve të mbyllura, pa transparencë, në minutat e fundit, të përsëritura njëra pas tjetrës si zgjidhje e krizës së rradhës, passjellin anomali të paprecendenta të përvojave demokratike si ky në fjalë.

Reforma zgjedhore duhet të jetë një proces model dhe e projektuar në një afatgjatësi për adresimin e vazhdueshëm edhe të problematikave të ardhshme, përpos atyre të deritanishme.

Në përfundim, KRIIK sjell në vëmendje dhe iu bën thirrje të gjithë aktorëve se Zgjedhjet e 30 Qershorit 2019, për aq sa meritojnë të quhen të tilla, **nuk mund të jenë në asnjë rast laku që të**

mbajë peng shoqërinë dhe institucionet shqiptare në një spirale të krizës kushtetuese dhe të një retorike radikale.

Rasti i 30 Qershorit ishte provë kaparosje e dështimit të demokracisë apo dhe e projektit shtetformues shqiptar. Megjithatë, si tërë momentet e krizave të mëdha, ky proces mund të konsiderohet si një moment vendimtar dhe si një mundësi për ri-ngritje, por ku nevojitet që shoqëria shqiptare të tejkalojë vetveten dhe të dalë nga spiralet problematike të tërë tranzicionit. Në rastin e vendit tonë, ky dështim është mundësi për të ri-filluar denjësisht përpjekjet për të mbajtur proces zgjedhor me integritet dhe të gjithëpranuar.

Pas përvojës së fundit, shoqëria shqiptare duhet të qartësohet e bindur se **demokracia dhe projekti shtetformues nuk mund të pritet më prej dakordësisë bi-partizane politike apo thjesht prej presionit të partnerëve gjeostrategjikë**.

Dialogu i vazhdueshëm dhe real me qytetarin, ligjzbatimi dhe forcimi i institucioneve, janë e vetmja zgjidhja reale për qytetarët që të jenë vetëvendosës.

Klasa politike, e sinqertë ose jo, parimore ose jo, nuk mund të vazhdojë të përdorë interesin e qytetarëve thjesht si kryefjalë të retorikës së saj.

Në gjykimin e KRIIK, tanimë, pikëpyetjet dhe kundërshtitë mbi 30 Qershorin duhet të ndjekin rrugët institucionale, në pritje të shqyrtimit prej Gjykatës Kushtetuese, me tërë efektet që mund të passjellë ky shqyrtim.

Klasës politike i mbetet përgjegjësia e lartë kombëtare të tregohet e maturuar, të nisë pa vonesë dialogun e të gjejë kompromisin dhe zgjidhjen e duhur për vendin dhe të ardhmen e demokracisë.

Njëkohësisht, mbetet sfidë dhe detyrë për të angazhimi maksimalisht për realizimin e Reformës në Drejtësi dhe për nisjen e një Reforme Zgjedhore gjithëpërfshirëse, ashtu sikundër mbetet e domosdoshme që të shprehet dhe të angazhohet fortë dhe qartë në luftën pa kompromis kundër korrupsionit të çdo niveli dhe krimit të organizuar.

Tërë energjitë dhe ekspertizat e forcave politike në vend duhet të shtyjnë përpara me urgjencë këto dy reforma, si një domosdoshmëri për të ringjallur shpresën qytetare në progresin e vendit. Nga ana tjetër, politika shqiptare duhet të heqë dorë nga retorika shterpë në mungesë të argumentave, në anatemim e kundërshtarëve dhe në injorimin e vullnetit real qytetar.

E përditshmja e qytetarëve shqiptarë vazhdon të rrjedhë e përballur me problematika madhore dhe me një cilësi jetese në nivel kritik.

Dështimi i një force politike apo dhe i tërë klasës politike, kurrësesi nuk mund t'iu ngarkohet apo të vuhet nga qytetarët shqiptarë. Janë këta të fundit që përpos shqetësimeve nga ku politikëbërja e ka zhytur shoqërinë shqiptare, po vuajnë gjithashtu edhe mungesën e shpresës për zgjidhje dhe një të ardhme më të mirë.

E tashmja dhe ardhmja e qytetarëve shqiptarë pas 3 dekadave nuk mund të jetë në pritje të dakordësive politike, apo më keq të atyre që rezultojnë të jenë "pazare" politike.

Nëse klasa politike aktuale është e paaftë së paku të prodhojë dialog serioz politik e institucional të mbështetur në parime, pa përmendur domosdoshmërinë për institucione të forta apo përmirësimin e cilësisë së jetesës së qytetarëve, fati i kësaj klase politike duhet të jetë tërheqja apo largimi.

Tiranë, më 23 Gusht 2019!

ENDNOTES

1 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Njoftimi i Mbledhjes datë 27.04.2019.

2 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 64 "Regjistrimi i partive politike në zgjedhje" pika 1.

3 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Vendimi nr. 241 datë 19.04.2013, "Për regjistrimin si subjekt zgjedhor të "Partia Civile e Shqipërisë" për zgjedhjet për Kuvendin të datës 23.06.2013" dhe Vendimi Nr. 279 datë 03.05.2013 "Për shqyrtimin e kërkesës së Partisë Civile për rishikimin e vendimit të KQZ-së nr 241, datë 19.04.2013 "Për mos-regjistrimin si subjekt zgjedhor i "Partia Civile e Shqipërisë", për zgjedhjet për Kuvendin të datës 23.06.2013".

4 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Vendimi nr. 158 datë 16.04.2015 "Për shqyrtimin e kërkesës së "Partisë Shkodra 2015" për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 21.06.2015".

5 Kolegji Zgjedhor i Gjykatës së Apelit Tiranë, Vendimi nr. 3, datë 27.04.2013.

6 Regjistruar me vendimin nr. 513 datë 25.04.2019 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Shih materialet paraprake të mbledhjes së KQZ-së.

7 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, regjistrimi video i mbledhjes së KQZ-së (minuta 59.53 - 1.13.40).

8 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Deklaratë për Shtyp, datë 04.01.2019: "Afati ligjor për regjistrimin e partive politike për këto zgjedhje mbaron më datë 21 prill, kurse për regjistrimin e koalicioneve zgjedhore në KQZ mbaron më datë 1 maj. Regjistrimi bëhet si gjithmonë pranë KQZ-së. Nëse partitë politike nuk respektojnë afatin e parë, ato nuk do të kenë mundësi të marrin pjesë në zgjedhjet e datës 30 qershor 2019. Nëse nuk respektojnë afatin e dytë, ato nuk mund të konkurrojnë si koalicione zgjedhore. Në të shkuarën KQZ -ja është kritikuar nga misionet vëzhguese ndërkombëtare për regjistrimin e subjekteve zgjedhore përtej afateve ligjore, ndaj është veçanërisht e vendosur këtë herë që të mos mirëkuptojë dhe as tolerojë vonesat në aplikimin për regjistrim. KQZ-ja u bën thirrje që sot partive politike që të organizohen në kohë për plotësimin dhe depozitimin e dokumentacionit të regjistrimit".

9 Raporti Përfundimtar i Misionit të OSBE/ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve për Kuvendin të 25 qershorit 2017, "I. Përmbledhje", faqe nr. 2: "Ndonëse përfshirës në një shkallë të gjerë, procesi i regjistrimit të kandidatëve u ndesh me zbatimin përzgjedhës dhe jo të njëjtë të ligjit dhe, në disa raste, u mbështet në marrëveshjen politike dhe jo në ligj".

10 Materialet paraprake të mbledhjes së KQZ-së.

11 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, regjistrimi video i mbledhjes së KQZ-së (minuta 59:53 – 1:02:19).

12 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, publikimi i vendimeve online të KQZ-së.

13 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Njoftim i Mbledhjes, datë 25.04.2019.

14 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 24 "Vendimmarrja në KQZ", pika 3 "Çdo vendim i KQZ-së zbardhet brenda 24 orëve nga marrja e tij. Jo më pak se dy ekzemplarë origjinalë të vendimit ose, sipas rastit, edhe të udhëzimit të KQZ-së, mbahen në arkivin e KQZ-së. Vendimet publikohen menjëherë në faqen zyrtare të KQZ-së".

15 Vendim i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Nr. 104/2015, datë 05.12.2015, "Për zgjedhjen e z. Klement Zguri anëtar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve", Fletore Zyrtare Nr. 220, datë 22.12.2015.

16 Vendim i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Nr. 74/2016, datë 03.11.2016, "Për zgjedhjen e z. Denar Biba Kryetar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve", Fletore Zyrtare Nr. 211, datë 08.11.2016.

17 Vendim i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Nr. 78/2017, datë 22.05.2017, "Për zgjedhjen e z. Klement Zguri Kryetar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve", Fletore Zyrtare Nr. 118, datë 23.05.2017.

Vendim i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Nr. 79/2017, datë 22.05.2017, "Për zgjedhjen e z. Denar Biba anëtar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve", Fletore Zyrtare Nr. 118, datë 23.05.2017.

18 Vendimi Nr. 53, datë 07.05.2013 i Gjykatës Kushtetuese.

19 Anëtarët e zgjedhur të Kolegjit Zgjedhor të Gjykatës së Apelit, Tiranë: Z. Artur Malaj, Z. Tomorr Shkreli, Z. Ridvan Hado, Znj. Lindita Sinanaj. Z. Shkëlqim Mustafa, Z. Gjin Gjoni, Z. Astrit Kalaja dhe Z. Sotiraq Lubonja.

20 Në zbatim të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" datë 30.08.2016.

21 Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Vendimi nr. 62, datë 03.08.2018. Rikonfirmim në detyrë i z. Artur Malaj. Apeluar në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, çështja (JR) nr.34/2018, datë 13.11.2018.

22 Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Vendimi nr. 68, datë 08.10.2018. Shkarkimi nga detyra i z. Sotiraq Lubonja. Apeluar në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, çështja (JR) nr.39/2018, datë 07.12.2018.

23 Z. Astrit Kalaja, Gjyqtar në Gjykatën e Apelit Shkodër (Njoftimi i KPK-së datë 18.09.2018); Z. Ridvan Hado, Gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë, Z. Gjin Gjoni, Gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe Znj. Lindita Sinanaj, Gjykata Administrative e Apelit (Njoftimi i KPK-së datë 16.11.2018); Z. Shkëlqim Mustafa, Gjykata e Apelit Tiranë (Njoftimi i KPK-së datë 16.01.2019); Z. Tomor Skreli, Gjykata e Apelit Gjirokastër (Njoftimi i KPK-së datë 18.03.2019).

24 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 13 "Mandati dhe koha e punës e anëtarëve të KQZ-së", pika 4 "Përpara fillimit të detyrës, anëtari i zgjedhur i KQZ-së kryen betimin para Kuvendit, në një ceremoni publike. Teksti i betimit është: "Betohem në nderin tim se do të angazhohem me të gjitha forcat e mia për realizimin e zgjedhjeve të drejta, të lira dhe demokratike në Republikën e Shqipërisë, do të siguroj dhe do të mbroj integritetin dhe fshehtësinë e votës, do të ruaj paanësinë në kryerjen e detyrës si anëtar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe do të tregoj profesionalizëm në kryerjen e saj"".

25 KRIIK, Deklaratë "Ruajtja e paanësisë dhe integritetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve,rëndësi jetike për funksionimin e shtetit demokratik e ligjor", datë 06.05.2019.

26 Bashkitë: Shkodër, Lezhë, Durrës, Kamëz, Tiranë, Elbasan, Lushnjë, Fier, Korçë dhe Vlorë.

Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 67 "Lista e kandidatëve të partive dhe koalicioneve të partive", pika 1 "... Për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, kandidati për kryetar të njësisë së qeverisjes vendore

dhe lista e kandidatëve për këshillat vendorë regjistrohen në KZAZ-në që mbulon njësinë e qeverisjes vendore brenda afatit të përcaktuar në këtë pikë. KZAZja dorëzon një kopje të listës në KQZ brenda 48 orëve", dhe pika "3. Në zbatim të paragrafit të dytë, të pikës 1, dhe të paragrafit të dytë, të pikës 2, të këtij neni, kandidati për kryetar bashkie dhe listat për këshillin e bashkisë, territori i të cilave nuk mbulohet nga një KZAZ e vetme, regjistrohen në KQZ".

27 Sipas informacioneve të marra pranë KZAZ-ve, KQZ ka rekomanduar të evitohet vendimmarrja në lidhje me regjistrimin e kandidatëve deri në marrjen e një autorizimi nga KQZ-ja, duke qenë se kjo e fundit po verifikon formularët e dekriminalizimit të kandidatëve. Ndërkohë disa KZAZ iu kanë kthyer dokumentacionin e paraqitur nga disa subjekteve pasi janë verifikuar mangësi.

28 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 68 "Listat mbështetëse të partive politike dhe koalicioneve", pika: "2. Kandidatët për organet e njësisë së qeverisjes vendore, të paraqitur nga partitë politike, të cilat nuk zotërojnë asnjë mandat në Kuvend ose në organet e njësisë përkatëse të qeverisjes vendore, duhet të mbështeten nga jo më pak se 1 për qind e zgjedhësve të asaj njësie, por, në çdo rast, jo më shumë se 3,000 dhe jo më pak se 50 zgjedhës. Bën përjashtim nga ky rregull koalicioni, ku partitë pjesëtare zotërojnë bashkërisht në Kuvend një numër mandatesh jo më të vogël se numri i partive pjesëtare të koalicionit, ose kur zotërojnë bashkërisht në këshillin përkatës një numër mandatesh jo më të vogël se numri i partive pjesëtare të koalicionit", dhe pika "3. Për qëllim të këtij neni, partia politike ose koalicioni paraqet një vërtetim me shkrim, të nënshkruar nga institucioni i Kuvendit apo njësia e qeverisjes vendore, ku vërtetohet zotërimi i mandatit të paktën 6 muajt e fundit".

29 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 72 "Dokumentet e kandidimit", pika "1. Dokumentet e kandidimit duhet të jenë në përputhje me kërkesat e këtij Kodi dhe sipas formës së përcaktuar në udhëzimet e KQZ-së".

30 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 73 "Verifikimi i dokumentacionit", pika "1. KQZ-ja ose, sipas rastit, KZAZ-ja verifikon rregullsinë e dokumentacionit të kandidimit dhe nëse vëren parregullsi apo mospërmbushje të kërkesave të këtij Kodi, ia kthen ato subjekteve zgjedhore për korrigjim jo më vonë se 45 ditë përpara datës së zgjedhjeve".

31 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Diskutimet e zhvilluara në interpretim të kësaj dispozite me synim adresimin në Vendimin Nr. 44, datë 17.02.2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr. 2, datë 29.01.2013 "Për caktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimi dhe afatet për publikimin e listave të kandidatëve".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Vendimi Nr. 284, datë 05.05.2017 "Për miratimin e listave shumemërore të Partisë "Lista e Barabartë" për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2017", duke u bazuar në listën mbështetëse të 9140 nënshkrimeve të vlefshme, ndërkohë që Partia "Lista e Barabartë" (Libra) zotëronte 2 mandate deputetësh në Kuvendin e Shqipërisë, përkatësisht nga Znj. Mimoza Hafizi dhe z. Ben Blushi, por që ishte regjistruar në Gjykatën e Tiranës më datë 25.11.2016.

Gazeta Panorama "Udhëzimi i fshehtë i KQZ-së për zgjedhjet/ Hafizi: Cënon vetëm LIBRA-n", datë 16.02.2017.

32 Nëse do të merrej si referencë data e zgjedhjeve.

33 Këshilli Bashkiak Lezhë, Vendimi Nr. 161, datë 03.07.2017 "Per mbarim para afatit te mandatit te keshilltarit dhe dhenie mandati keshilltarit nga krijimi i vendeve vakant".

34 Depozituar vendimi i Kongresit të Tretë të Partisë Konservatore, Regjistruar me Vendimin Nr. 2068 datë 15.03.2017 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me kryetar z. Armando Ruço (ndryshimet e fundit në regjistër).

Regjistruar si subjekt elektoral në Zgjedhjet Vendore 2015 nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me Vendimin Nr.140 datë 14.04.2015 "Për regjistrimin si subjekt zgjedhor të partisë, "Partia Konservatore", për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 21.06.2015".

"Partia Konservatore" rezulton se është regjistruar fillimisht me emrin "Partia Kombëtare e Legalitetit" me urdhërin nr. 11/1 datë 21.09.1995 të Ministrit të Drejtësisë, më pas me urdhërin Nr. 11/1 datë 09.09.1996 është bërë ndryshimi i emrit në "Partia Kombëtare Konservatore Shqiptare" dhe me vendimin Nr. 1846 datë 21.05.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është bërë ndryshimi i emrit në "Partia Konservatore" me sigël "KONS" dhe Kryetar të saj, z. Armando Ruço.

35 Partia "Forca Albania", themeluar më datë 02.11.1999 është regjistruar me Vendimin Nr. 1935 datë 14.06.2000 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke patur si Kryetar z. Iledin Pillati. Me Vendimin Nr. 13134 Akti dhe Nr. 8826 datë 04.11.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është bërë "Depozitimi i vendimeve të Kongresit të Partisë Forca Albania mbajtur më 24.09.2016. Sipas Vendimit të Gjykatës së Tiranës me Nr. 374 Regj. Themeltar, të marrë më datë 20.02.2017, vendim i cili bën sqarimin dhe interpretimin e Vendimit Nr. 13134 Regj. Themeltar Nr. 8826 datë 04.11.2016, dhe që i bashkangjitet këtij të fundit, qartësohet se është bërë ndër të tjera ndërrimi i emrit të Partisë në "Partia Kombëtare Konservatore Albania" (shkronja nistore "PKKA") si dhe është zgjedhur Kryetar z. Kujtim Gjuzi.

36 Në Bashkitë Tropojë, Bulqizë dhe Tepelenë.

SHTOJCA NR. 2 - VENDIMMARRJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Shtojca pasqyron të përmbledhur gjithë vendimmarrjen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, nga dekretimi i datës së zgjedhjeve deri në shpalljen e rezultatit përfundimtar, duke përfshirë të dhënat bazike të vendimit si: numri, data, titulli dhe rezultati i votimit. Mënyra si ka votuar një anëtar i KQZ-se, nuk gjendet e pasqyruar në vendimet e publikuara në faqen e internetit, pasi në fund të çdo vendimi gjendet emrat e te gjithë anëtarëve, pavarësisht nëse ka votuar pro apo kundër emri i tij figuron. Gjithashtu në tabelën e mëposhtme është përfshirë edhe data e publikimit të vendimit, për të patur një panoramë të plotë të respektimit të detyrimit ligjor të KQZ në lidhje me publikimin e vendimeve brenda 24 orëve nga miratimi i tyre, në faqen zyrtare të internetit të institucionit. Kolona e fundit, pasqyron publikimin e materialeve paraprake, përpara mbledhjes në faqen e internetit, edhe ky detyrim i diktuar nga Rregullorja e Brendshme e KQZ. Sikurse është e dukshme nga tabela, shumica dërrmuese e vendimeve janë publikuar jashtë afatit ligjor, madje 46 prej tyre janë ende të papublikuara.

